

SÚRJA AL--KAHF DHE BOTA MODERNE



Imran N. Hosein

Xhamia, qyteti San Fernando
Trinidad dhe Tobago

Një studim analitik i Sures Al-Kehf në Kuran që përpiqet të shpjegojë *realitetin* e aleancës misterioze çifute-krishtere, e cila po bënë luftë të padrejtë kundër Islamit duke i shtypur Myslimanët, ndërsa e shtynë përpara një agjendë globale mëkatore në emër të shtetit Jude-Krishtere të Izraelit

www.imranhosein.org

إِنَّكَ لَنْ تَسْتَطِيعَ مَعِيَ صَبْرًا
وَكَيْفَ تَصْبِرُ عَلَىٰ مَا لَمْ تُحِطْ بِهِ خُبْرًا

Khidr i tha Musës a.s.: “Sigurisht se ti nuk do të jesh në gjendje të tregosh durim me mua. Vërtet, si mund të tregosh durim për atë që është jashtë mundësive tua për të kuptuar (pasi që ti, përkohësisht, sheh vetëm me një sy dhe si rezultat mund të marrësh vetëm dijeni të jashtme empirike)?”

(Sūrah al-Kahf, 18:67-68)

Ata si Dexhalli, të cilët shohin vetëm me një sy, kurrë nuk mund të kenë durimin e mjaftueshëm për të mësuar nga ata si Khidri, të cilët shohin me dy sytë, i.e., sytë e jashtëm dhe të brendshëm. Sulmi epistemologjik i Dexhallit mbi njerëzimin i verbon ata nga brenda dhe kështu shumë lehtë i mashtron me ‘paraqitjen e jashtme’, duke i lënë në pamundësi për ta kuptuar realitetin e brendshëm, në të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me misionin e tij misterioz. Nganjëherë, ata e humbin besimin në Allahun Më Të Lartësuarin dhe bëhen thellësisht të keq udhëzuar, e aqë më keq, duke mos qenë në dijeni për këtë. Megjithatë, pothuajse gjithmonë, atyre u mungon kapaciteti për të kuptuar lëvizjen e historisë, ose rolin që Jerusalemi dhe Toka e Shenjtë e luajnë në Përfundimin e Historisë. Kurani deklaron për njerëzit e tillë se ata e kanë një status të ngjashëm me atë të “kafshëve”.

Abū Darda tregon se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Nëse ndonjëri i mëson përmendësh dhjetë ajetet e para të Sures al-Kahf, ai do të jetë i mbrojtur nga Dexhalli.”

(Sahīh Muslim)

“Ai mes jush i cili do të mbijetoj për ta parë atë (Dexhallin), duhet të recitojë para tij ajetet hyrëse të Sures al-Kahf.”

(Sahīh Muslim)

“Ai i cili i reciton tri ajetet hyrëse (fillestare) të Sures al-Kahf, to të jetë i mbrojtur nga sprova e Dexhallit.”

(Tirmīdhī)

Abu Sa’īd al-Khudri tregon se Profeti ka thënë: “Ai i cili e reciton Suren al-Kahf në ditën e Xhuma (i.e., ‘e premtdja’ në botën pagane) do të jetë i ndriçuar nga drita (e Sures) nga një Xhuma te tjetra.”

(Nasā’i, Baihaqī, Hākim)

E drejta e Kopjimit © Imran N. Hosein
Email: ihosein@tstt.net.tt ose inhosein@hotmail.com
Ueb-faqja: www.imranhosein.org
2007 / 1428

Publikuar nga Xhamia e Qytetit të San Fernandos.
70, Rruga Mucurapo,
San Fernando
Trinidad dhe Tobago

Versioni i shtypurë, është shpërndarë nga
Al Tasneem Sdn Bhd (630802-X)
No. 35-1, Kati 1-rë, Jalan Melati Utama 4,
Melati Utama, Setapak,
53100 Kuala Lumpur, Malaysia
Tel: 603-41072999 Fax: 603-41089815
Email: tasneem@streamyx.com

Dizajni i Kopertines – Edicioni i Shtypurë
Grafiket Bonus – Email: bouncegraphics@gmail.com

Dizajni i Kopertines dhe Nxjerrja në – Edicionin për Internet
Mogamat Abrahams – cool@coolstuff.co.za

Shpërndarja e lirë në formatin elektronik, nuk mund të shitet.

*Për gruanë time të dashurë Aisha,
E cila shehë me dy sytë.
Unë e kamë ndërtuar një shtëpi për të këtu në tokë,
Allahu ia ndërtostë asaj një në parajsë. Amin!*

PËRMBAJTJA

Seria për Përkujtimin e Ansarit

Parathënje

Kapitulli i parë	Hyrje
Kapitulli i dytë	Kurani dhe Koha
Kapitulli i tretë	Surja dhe Sunna
Kapitulli i katër	Historiku i shpalljes së Sures al-Kahf
Kapitulli i pestë	Ngjarja e djelmoshave dhe shpellës
Kapitulli i gjashtë	Parabola e dy burrave – Njëri i pasur dhe tjetri i varfër
Kapitulli i shtatë	Parabola e Musës dhe Khidrit
Kapitulli i tetë	Ngjarja e Dhul Karnein
Kapitulli i nëntë	Fillimi i Sures al-Kahf
Kapitulli i dhjetë	Përfundimi i Sures al-Kahf

Shtojca 1

Rëndësia Epistemologjike¹ e Ëndrrave në Islam

SERIA E MEMORIALIT ANSARI

Seria e Memorialit Ansāri, është publikuar për nderë të Dijetarit të dalluar të Islamit, filozofit dhe Sheikut Sūfist, Maulāna Dr. Muhammad Fadlur Rahmān Ansāri (1914–1974). Publikimi i serisë filloj në vitin 1997, për të përkujtuar përvjetorin e 25^{të} vdekjes së tij.

¹ Epistemologjia është degë e shekcës që e studion dijen

Maulāna Ansāri ishte një dijetar i Islamit, një mësues dhe një udhëzues shpirtëror, i cili e kaloi tërë jetën e tij duke luftuar për çështjen e shenjtë të Islamit, lidhur me botën e cila është bërë tërësisht e pafë². Puna e tij në këtë çështje të shenjtë e çoi atë disa herë në një udhëtim të plotë përreth botës, nëpër turne e leksione Islamike mes viteve 1950 dhe 1970. Ai do të dilte nga shtëpia e tij e re në Karachi (pasi që ka migruar nga India, kur u themelua Pakistani më 1947) dhe udhëtoi në përfundim të pastaj u kthye në shtëpi në atdheun e tij në lindje .

Maulana kishte diplomuar në Universitetin Mysliman Aligarh, Indi, ku studioi filozofin dhe fenë (religionin). Mendimet e tij Islamike, filozofike dhe shpirtërore buronin nga dijetari i Islamit, Dr. Muhammad Ikbali. Ikbali ishte autori i kryeveprës të Diturisë Islamike, “*Rindërtimi i Mendimit Fetar në Islam*.” Puna e madhe e Maulāna Ansārit në diturin Islame, “*Themelet Kuranore dhe Struktura e Shoqërisë Muslimane*”, vetë ai e themeloi një përgjigje për thirrjen e Iqbali për “*Rindërtimin e mendimit fetar*.”

Ai u stërvit në aspektin shpirtëror nga Mullana ‘Abdul ‘Aleem Sidikui, një dijetar Islamik, *Sehik Sufist*, dhe një misionar Islamik në udhëtim. Më e rëndësishmja nga të gjitha është se ai arriti një epistemologji Sūfiste nga këta të dy: Ikbali dhe Maulāna Sidiku dhe ia dha atë studentëve të tij. Epistemologjia Sūfiste e dinte se kur përqafohet e Vërteta (i.e., kur pranohet Islami) dhe jetohet me sinqeritet dhe përkushtim ndaj Allahut Më Të Lartësuarit, ajo përfundimisht hyn në zemër (i.e., Islāmi shndërrohet në Imān). Në Hadithin al-Qudsi tregohet se Allahu Më i Lartësuar deklaroi: “Qielli dhe Toka ime janë shumë të vogla për të më zënë Mua, por zemra e shërbëtorit Tim besnik mund të më zërë Mua.” Ky Hadith drejtpërdrejt tregon domethënien e hyrjes së të Vërtetës në zemër.

Kur e Vërteta hynë në zemër, atëherë një dritë hyjnore (nurullah) përfundimisht hynë në zemër dhe ajo dritë ia mundëson forcës së vrojtimit dhe mprehtësisë së brendshme shpirtërore që të depërtojë përtej paraqitjes së gjërave nga ana e ‘jashtme’, për të kuptuar realitetin e tyre të ‘brendshëm’. Si rezultat i rritjes së të Vërtetës, në zemër, besimtari tash sheh me dy palë sy - të ‘jashtmit’ dhe të ‘brendshmit’ (*Dexhalli*, Mesia i rrejshëm, sheh vetëm me një sy - të ‘jashtmin’). Besimtari i cili ndjek ‘*Jihād fillah*’ (i.e., luftë ‘për’ Allahun) është i bekuar me kalimin nga gjendja e *Imanit* në nivelin e *Ihsanit*. Kjo po ashtu njihet si *Tasawwuf*.

Vetëm me anë të dritës së brendshme në zemrën e dalluar të besimtarit të vërtet, vazhdimisht zbulohen dhe njihen Shenjat e Allahut (*Ajetullah*) dhe vetëm kështu mund të lexohet dhe të kuptohet drejt bota e sotme. Ata të cilët e kuptojnë *realitetin* e botës sot, e dinë se ne po jetojmë në kohën e *Fitnes*, i.e., Epokën e Fundit ose epokën e *al-Kijāmah* (e cila së pari do ta arrijë kulmin me përfundimin e historisë dhe me triumfin e Islamit, e pastaj me përfundimin e botës dhe me transformimin e saj në një botë tjetër).

Maulāna Ansāri ia përkushtoi dhjetë vitet e fundit të jetës së tij (1964–1974) për të themeluar Institutin Alemajja të Studimeve Islamike në Karachi. Ai luftoi në Alemajja për të trajnuar një gjeneratë të re të dijetarëve të Islamit, të cilët do të kenë mundësinë shpirtërore dhe intelektuale për të përdorur Kuranin dhe Hadithet, për të kuptuar kohën misterioze moderne, e

² Që nuk beson më në Zotin

pastaj për t'iu përgjigjur në mënyrën adekuate sfidave të mëdha të saj. Nga puna e tij dolën dijetarët si Dr. Waffie Muhammad dhe Imran N. Hosein (Trinidad, India Perëndimore), Dr. Abul Fadl Mohsin Ebrahim, Dr. Abbas Qasim (marhūm), Muhammad Ali Khan dhe others (Durban, Afrika e Jugut), Siddiq Ahmad Nasir, Raouf Zaman dhe Muhammad Saffie (Guyana, Amerika e Jugut), Ali Mustafa (Suriname, Amerika e Jugut), Basheer Ahmad Keeno (Mauritius), dhe shumë të tjerë të cilët diplomuan nga Instituti Alemaja i Studimeve Islamike, Karachi, Pakistan.

Seria e Memorialit Ansāri përbëhet nga librat në vijim, të gjitha të shkruara nga njëri prej studentëve të *Maulānās*:

- □Jerusalemi në Kuran - një Pikëpamje Islamike e Fatit të Jerusalemit; □
- Surah al-Kahf: Teksti, Përkthimi dhe Komentimi Modern;
- □Surah al-Kahf dhe Koha Moderne;
- Feja e Ibrahimit dhe Shteti i Izraelit - Një pikëpamje Islamike nga Kurani;
- Shenjat e Ditës së Fundit në Kohën Moderne;
- Rëndësia e ndalimit të Ribas (fajdes) në Islam; Ndalimi i Ribas në Kuran dhe Synet;
- Ëndrrat në Islam – Një Dritare për tek e Vërteta dhe tek Zemra;
- Kalifati, Hexhazi dhe Kombi-Shtetit Saudit-Vehabist;
- Domethënia Strategjike e Axxhërimit të Ramazanit dhe Isras dhe Mirazhit;
- Një xhemat - Një Amir: Organizimi i Komunitetit Mysliman në Kohën e Fitnes..

Tërësia e cila i përshkruan të paktën disa nga 'frytet' e 'pemës' që është mbjellë nga Maulāna, janë të përkushtuara në përpjekjet për të kuptuar 'realitetin' e botës sot, duke e shpjeguar atë saktësisht dhe duke iu përgjigjur në mënyrë adekuate sfidave të papritura.

Tre libra të rinj janë përfshirë në këtë tërësi. Dy prej tyre, lidhur me *Suren al-Kahf*, formojnë një pjesë të çerekut të propozuar të librave për atë Sure. Librat tjerë, lidhur me *Dexhallin* dhe me *Gog dhe Magog*, do ta kompletojnë çerekun, Insha-Allah. Libri i tret, i ri, në këtë seri përbëhet nga një përmbledhje e re e eseve lidhur me temën 'Shenjat e Ditës së Fundit në Kohën Moderne'.

Tërësia do të ishte e pakompletuar pa një biografi të vet dijetarit të madh të islamit - jetës së tij, punës së tij dhe mendimit të tij. Puna veç ka filluar lidhur me atë biografi.

Maulāna Ansāri e ka nderuar Sheikun e tij, Maulāna Muhammad 'Abdul 'Aleem Siddiqui, duke e themeluar Institutin Alemaja të Studimeve Islamike në Pakistan dhe duke e publikuar Serinë Memoriale të Alemajisë. Seria Memoraile Ansari përfaqëson një përpjekje modeste për ta ndjekur atë traditë fisnike.

Parathënie

Lavdërimii takon Allahut Më Të Lartësuarit përmes të Cilit *Sūrah al- Kahf dhe Koha Moderne* tani është publikuar. E bekoftë Ai këtë punë modeste, për t'i arritur Myslimanët në shumë pjesë të botës. Ju ndihmoftë atyre për t'iu ofruar përherë e më shumë Kuranit dhe kësaj Sūre - në veçanti në çdo ditë të Xhuma kur Sūrah duhet të recitohet për t'u mbrojtur nga *Fitnah* e

Dexhallit. Ua freskoftë kujtesën e tyre për kuptimin e Sûres dhe, më e rëndësishmja, që vazhdimisht ta thellojnë kuptimin e tyre për këtë *Sûreh. Amîn*

Derisa lufta kundër Islamit po intensifikohet dhe po afrohet koha kur shteti i rrejshëm çifut Izraeli po vendos bastin e tij për tu bërë Shteti *sundues* i botës dhe *Dexhalli*, Mesia i rrejshëm do ta sundojë botën nga Jerusalemi dhe të deklarojë se ai është Mesia i vërtet, unë frikësohem se do të ketë shumë të tillë që do t'i ndalojnë librat për Kuranin. Pra, unë lutem me përlulje dhe u kërkoj lexuesve të mi të dashur që po ashtu të bashkohen me mua në këtë lutje, që Allahu Më i Lartësuar i t'i mbrojë librat (siç është ky çerek modest i librave për *Suren al-Kahf*) ku vëmë në punë Kuranin e bekuar, për t'i ekspozuar ata që jetojnë në kohën moderne të pafe, të cilët po bëjnë luftë të padrejtë kundër Islamit dhe Myslimanëve. *Amîn!*

Një rregull misteriozë Euro - botëror, me një aleancë çifuto - krishtere, që lufton kundër Islamit, në emër të Shtetit Euro - Çifut të Izraelit. Nëse ky libër ka ndopak meritë, ajo ndoshta mund të gjendet në rolin e tij si një punë shumë modeste dhe pioniere, e cila ndoshta do t'i frymëzojë të tjerët, të cilët janë më kompetent se ky shkrimtar, për një përpjekje më të devotshme në përdorimin e kësaj *Sure* të Kuranit, për të shpjeguar botën e sotme.

Vëllimi i parë, nga katër vëllimet, përmban '*Tekstin, përkthimi dhe komentimin modern të Sures al-Kahf*', që doli në publik në po të njëjtën kohë sikur puna kryesore lidhur me këtë subjekt të titulluar '*Sûrah al-Kahf dhe Koha Moderne*' dhe ka pasur si qëllim të funksionojë si vëllim shoqëruar i veprës kryesore. Lutem që të kem mundësinë të shkruaj vëllime shtesë për këtë subjekt, Insh-Allah, në mënyrë që të përpiqem të bëj një interpretim më kuptimplot modern të *Hadīthit* dhe ajeteve Kuranore, të cilat trajtojnë (në mënyrë direkte dhe indirekte) pikat me rëndësi kritike për *Dexhallin*, Mesian e rrejshëm ose Anti-Krishtin dhe të Gog dhe Magog.

Shkrimi i dy librave të mëparshëm lidhur me *Suren al-Kahf* ishte sponsorizuar në emrat e Rabia Aboobakar Hussein Jakhura dhe Aboobakar Hussein Jakhura të Malawi në Afrikë, Abdul Majid Kader Sultan dhe Fatimah Abdullah nga Malajzia, Hajjah Haniffa Bte Omar Khan Sourattee dhe Hajjah Mariam Bte Fakir Mohammed nga Singapori.

Allahu Më i Dashuri i bekoftë të gjithë. *Amîn!*

Imran N. Hosein
Kuala Lumpur, Malaysia
June 2007

KAPITULLI I PARË

HYRJE

Ky libër analizon dhe interpreton *Sûren al-Kahf* të Kuranit, në përpjekje për të shpjeguar realitetin e botës në kohën moderne. Është shkruar për dobinë e atyre të cilët tashmë e besojnë

Kuranin si fjalën e shpallur të Zotit të vërtet. Ata të cilët nuk e besojnë Kuranin, ose ata të cilët e kundërshtojnë pohimin e tij se është një shpallje hyjnore, ftohen që ta vërtetojnë pohimin e tyre duke iu përgjigjur sfidës 1400 vjeçare për të shkruar një kapitull të ngjashëm me ndonjërin nga kapitujt e Librit të Shenjtë. Kështu pra ne fillojmë duke e drejtuar vëmendjen tonë në pohimin e Kuranit që thotë se funksioni i tij primar është që t'i shpjegojë të gjitha gjërat

..... وَنَزَّلْنَا عَلَيْكَ الْكِتَابَ تِبْيَانًا لِّكُلِّ شَيْءٍ



: “... dhe Ne ta dërguam ty librin (O Muhammad) (i.e., Kuranin) i cili i shpjegon të gjitha gjërat ...”

(Kuran, al-Nahl, 16:89)

Myslimanët nganjëherë harrojnë se askush nuk mund të depërtojë në *realitetin* e kohës moderne, në të cilën ne tani jetojmë, pa shpjegimin dhe udhëzimin që e jep Kurani. Kjo mbetet e vërtet për globalizimin, politikat ndërkombëtare, botën ekonomike, çështjet ndërkombëtare financiare, rritjen e prosperitetit të atyre që i përkasin, ose që e mbështesin rregullin botëror modern Euro-çifut/Euro-krishter dhe rritjen e varfërisë dhe vuajtjeve të atyre që i bëjnë rezistencë sundimit Euro-Çifut/Euro-Krishter. I mbetet besnik revolucionit modern feminist. Dhe është i vërtetë përkitazi me kthimin e çifutëve në Tokën e Shenjtë për të thënë se është e tyre, rivendosjen e shtetit të Izraelit (në Tokën e Shenjtë gati 2000 vjet pasi që Allahu Më i Lartësuar i pat urdhëruar shkatërrimin e tij), dhe supozimin e pashmangshëm të Izraeli për statusin e ‘shtetit sundues’ të botës.

Megjithatë, ai i cili nuk e kupton *realitetin* e botës sot, kurrë nuk mund të jetë i sigurt se është i udhëzuar drejt dhe kështu nuk mund të funksionojë si një udhëzues i besueshëm për të tjerët. Vështirësitë e myslihanëve sot kanë të bëjnë me atë se shumica e udhëheqësve nuk e kuptojnë *realitetin*, e kështu edhe ata vetë janë thellë të kequdhëzuar. Shërbëtorët e vërtet të Allahut Më Të Lartësuarit, të cilët janë të bekuar me diturinë e *realitetit* ose janë të përjashtuar nga dhënia e mësimi, ose janë demonizuar, kufizuar dhe persekutuar deri në atë masë, sa që nuk nuk kanë mundësi të funksionojnë si udhëzues. Kështu që, udhëzimi i tyre mezi i arrin ndonjëherë masat e Myslihanëve. Dijetari i Islamit i cili tani bënë përpjekje me një dituri të brendshme shpirtërore ta interpretojë Kuranin e bekuar dhe Hadithet e Profetit Muhamed (*paqja dhe bekimi i Allahut Më Të Lartësuarit qofshin mbi të*) për të shpjeguar botën e sotme misterioze, ballafaqohet me një problem tjetër shumë serioz. Shokët e tij që janë të verbër përbrenda e kanë shmangur atë dhe kanë vënë në pyetje seriozitetin dhe integritetin e diturisë së tij.

Ky libër i vërteton ata të cilët e kuptojnë *realitetin* e botës së sotme, se janë njerëz të cilët e kanë studiuar dhe kuptuar shpjegimin dhe udhëzimin e Kuranit, e në veçanti të *Sûres al-Kahf të Kuranit*, se si e shpjegon ajo kohën moderne he modern age. Ata po ashtu e kuptojnë se kjo Sure

duhet të recitohet në çdo ditë të *Xhuma* (i.e., të premte) për mbrojtje nga testi dhe sprova marramendëse e kësaj bote.

Ky libër argumenton se dituria fetare e dobësuar në institucionet e sotme tradicionale të mësimave më të larta Islamike (i.e., Dār al-Ulūm), është e pamjaftueshme për të depërtuar në Kuran dhe për ta shpjeguar realitetin e botës së sotme. Përveç të vërtetës së përhershme që e jep dituria tradicionale fetare, dijetarët e Islamit kanë nevojë që të kenë qasje në ‘dituri strategjike’. Një dituri e tillë jepet përmes asaj që Kurani e quan *al-Basīrah* (i.e., intuita e brendshme shpirtërore) dhe përmes adaptimit të një qasjeje kritike ndaj studimit të mendimit modern që ka dalë nga civilizimi modern perëndimor, i cili në thelb është i pafe. Kjo ndodh për shkak se sfida supreme ndaj Islamit dhe mënyrës fetare të jetesës, ka ardhur nga ai civilizim.

Ne argumentojmë se, përveç nëse dijetarët bekohen me një mprehtësi shpirtërore (natyrisht, përveç diturisë që vjen nga aspekti i jashtëm), përveç nëse ata shohin me ‘dritën’ e Allahut, bota zakonisht i mashtrohet ata. Kjo ndodh për shkakun se është në vetë natyrën e civilizimit modern perëndimor që ‘paraqitja’ dhe ‘realiteti’ shpesh janë shumë të ndryshëm nga njëri-tjetri. Për shembull: Rruga drejt ferrit në mënyrë mashtruese paraqitet si rruga drejt parajsës (i.e., industrializimi, modernizimi, progresi dhe prosperiteti) dhe *anasjelltas*, pikërisht ashtu siç e ka profetizuar Profeti Muhammad (*sallallahu ‘alaihi wa sllam*).

Përgjat gjithë historisë së Islamit kanë qenë *Shuyūkh* (Sheikët) *Sufist*, më shumë se çdokush tjetër, të cilët kanë ecur në rrugën e cila ka çuar në mprehtësinë shpirtërore dhe ata më shumë se çdokush tjetër kanë arritur që të depërtojnë në realitetin e vërtetë të gjërave. Megjithatë, ne jetojmë në një epokë (kohë) në të cilën *Shuyūkh* (Sheikët) autentik *Sufist*, siç ishte mësuesi im i dalluar, mbettë i gjallë kujtimi për të, Maulāna Dr. Muhammad Fazlur Rahman Ansāri (1914-1974), dhe mësuesi i tij i dalluar, një fanar ndriçues me magnetizëm shpirtëror, Maulāna Muhammad ‘Abd al-‘Aleem Siddiqui (1892 -1954), janë shënjestër e sulmeve të liga e të vazhdueshme.

Ky libër poashtu përkujton se ka të tillë mes njerëzve, zemrat e të cilëve janë aq të mbyllura nga Allahu Më i Lartësuar, sa që kurrë nuk mund ta kuptojnë Kuranin:

﴿وَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنْ ذُكِّرَ بِآيَاتِ رَبِّهِ فَأَعْرَضَ عَنْهَا وَنَسِيَ مَا قَدَّمَتْ يَدَاهُ

إِنَّا جَعَلْنَا عَلَى قُلُوبِهِمْ أَكِنَّةً أَنْ يَفْقَهُوهُ وَفِي آذَانِهِمْ وَقْرًا وَإِنْ تَدْعُهُمْ

إِلَى الْهُدَى فَلَنْ يَهْتَدُوا إِذًا أَبَدًا ﴿٥٧﴾

“Kush është më zullumqarë se ai që është këshilluar me argumentet e Zotit të vet, e ua kthejn shpinën atyre dhe harron atë që vetë e punoi? Ne kemi vënë mbi zemrat e tyre mbulesë, në mënyrë që të mos e kuptojnë atë (Kur'anin), kurse në veshët e tyre shurdhim, andaj edhe nëse i thërret ti, ata në rrugë të drejtë, ata si të tillë nuk do të udhëzohen kurrë.

(Kuran, al-Kahf, 18:57)

Cili është shpjegimi Kuranor për 'realitetin' e kohës në të cilën tani ne jetojmë?

Në procesin e analizimit të *Sures al-Kahf*, kemi ardhur në përfundim se bota tani gjendet në Kohën (epokën) e Fundit (i.e., në epokën e al-Kijāmah), dhe aktorët dominues të epokës moderne janë *Daxhalli* (Mesia e rrejtshëm ose Anti-Krishti) dhe Gog dhe Magog. Ky është një konkluzion tejet i rëndësishëm, pasi që konfirmon se ne tani jetojmë në një epokë të mashtrimit, të pafe, të dhunshme dhe të mbushur me rreziqe të pashembullta.

Opinionin ynë, e Allahu di më së miri, është se: 'Epoka e Fundit' ka filluar atëherë kur Allahu e ndryshoi drejtimin e faljes (*Kiblen*) për të gjithë besimtarët, nga drejtimi i Jerusalemit në drejtim të Mekës. *Kibla* në Jerusalem ishte tempulli i shenjtë (*Masxhid al-Aksā*), të cilën e ndërtoi Profeti Sylejman (*alaihi al-Salām*) dhe e cila e kishte një gur të shenjtë. Dhe *Kibla* në Mekë ishte tempulli i shenjtë (*Masjid al-Harām ose Qabja*), të cilën e ndërtoi Profeti Ibrahim (*alaihi al-Salām*) dhe e cila po ashtu e kishte një gur të shenjtë. Ky ndryshim i *Kibles* ndodhi nga shtatëmbëdhjetë muaj pas emigrimit të Profetit Muhamed (*sallallahu 'alaihi wa sallam*) (*Hixhri*) nga Meka në Medinë.

Si rezultat i drejtpërdrejtë i këtij ndryshimi të Kiblës, bota dëshmoi lindjen e një komuniteti të ri (i.e., *Umeti*) brenda fesë së Ibrahimit (i.e., *Millah*), nën udhëheqjen e Profetit Muhammad (*paqja dhe bekimi i Allahut Më të Lartësuarit qoftë mbi të*). Ky Ymet Mysliman i zëvendësoi izraelitët si komuniteti i ri i 'zgjedhur' për të përfaqësuar fenë e vërtetë të Ibrahimit (*paqja qoftë mbi të*). Si pasojë e kundërshtimit që çifutët ia bënë Profetit Muhammad (*sallallahu 'alaihi wa sallam*), si Profet i vërtetë i Një Zotit të vetëm, ai komunitet fetar izraelit (*Banū Isrāīl*) humbi gjithçka çfarë kishte mbetur nga vlefshmëria e tij.

Hebrenjtë ishin të gatshëm që ta pranonin Muhamedin (*sallallahu 'alaihi wa sallam*) si profet të dërguar te Arabët. Por ata e kundërshtuan fort pohimin se një Profet Arab mund t'u dërgohej atyre (i.e., Hebrenjve) të cilët ishin "të zgjedhurit e Zotit"! Për më tepër, ata insistuan se askush pos një çifuti nuk mund të dërgohet si Profet te çifutët.

Si rezultat i drejtpërdrejtë i kundërshtimit që Çifutët i bënë Profetit Muhamed (*sallallahu 'alaihi wa sallam*) dhe të Kuranit që i ishte shpallur ati, Allahu Më i Lartësuar i liroi Dexhallin, Mesian e remë ose Anti-Krishtin, si dhe Gog-un dhe Magog-un, në atë kohë, në botë. E kështu Epoka e Fundit filloi për të gjallë të Profetit të Fundit, Muhamedit (*sallallahu 'alaihi wa sallam*) dhe se është shpjegimi i deklaramit të tij të njohur që e bëri derisa i mbante lart të bashkuar dy gishtat e tij:

Tregoi Sahl bin Sad: E pashë të Dërguarin e Allahut që tregonte me gishtin e tij tregues dhe atë të mesmin, duke thënë: "Koha e ardhjes sime dhe Ora (e Fundit) janë si këta dy gishtërinj. Katastrofa e madhe do të përfshijë gjithçka. Unë dhe Dita e Fundit jemi si këta dy (gishtërinj)."

(Sahīh Bukhāri)

Askush nuk mund t'i shpjegojë ose t'u përgjigjet sfidave të Epokës së Fundit, pa një mprehtësi adekuate, në temën e Dexhallit e të Gogut dhe Magogut. Ajo që demonstroi ky libër, është se Sūrah al-Kahf përbën çelësin për t'i kuptuar këto dy tema. Kështu pra, kjo Sure shpjegon Epokën e çuditshme moderne dhe ogurzezë që vazhdon të shpaloset. Konkluzioni tjetër që e kemi nxjerrë ne si rezultat i studimit tonë të Sures al-Kahf, është se mbijetesa e besimit në Islam nuk është e mundur, përveç nëse besimtarët marrin hapa për tu shkëputur nga qytetet e pafe të kohës moderne dhe të bëjnë përpjekje për ta vendosur Islamin në fshatra të largëta. Kjo ishte pikëpamja e dijetarit të madh turk të Islamit, Badiuzzamān Saīd Nursi. Lideri komunist Kinez Mao Tse Tung, poashtu ka pasur një pikëpamje të ngjashme sa i përket metodologjisë së luftës së tij revolucionare. Sa na përket ne, ne propozojmë një strategji për vendosjen e Islamit në mikro-nivel, në Fshatra të largëta Myslimane, aty ku gratë dhe fëmijët Myslimanë do të mbroheshin nga shtypja, mënyra e pafe e jetesës, nga dekadencia dhe anarkia që po e merr botën. Dijetarët e Islamit, të kohës moderne, të sfiduar nga epistemologjia, përkrahin krejtësisht të kundërtën e kësaj pikëpamje. Ata pohojnë se Myslimanët kanë një obligim që të mbesin një pjesë funksionale e botës moderne dhe se duhet t'i ndjekim ata në vendosjen e vendbanimeve në qytetet e mëdha të kohës moderne, në mënyrë që të luajnë rolin e tyre në udhëzimin e njerëzimit në rrugë të drejtë.

Sūrah al-Kahf, Hebrenjtë dhe Epoka e re.

Surja Al kahf ka një lidhje të veçantë me hebrenjtë dhe me Epokën e Fundit. Çdo hebre dhe i krishterë duhet të jetë i interesuar për ta kuptuar këtë lidhje.

Priftërinjtë Hebrenj (Rabit) në Medinë i patën bërë tri pyetje me të cilat do ta testonin Muhamedin (sallallahu 'alaihi wa sallam). Nëse ai do t'u përgjigjej saktësisht këtyre tri pyetjeve, do të vërtetohej se ai në të vërtetë është Profet. Ky libër jep një shpjegim të hollësishëm të ngjarjeve, tri pyetjeve dhe përgjigjeve të tyre. Libri po ashtu përpiqet të bëjë një analizë të atyre pyetjeve.

Ekzaminimi ynë me kujdes i pyetjeve, si dhe i përgjigjeve të dhëna në Kuran, tregon se pyetjet në brendinë e tyre nuk i janë qasur drejtpërdrejt temës me të cilën testohej Profeti Muhamed (sallallahu 'alaihi wa sallam). Më sakt, qëllimi i vërtetë ishte fshehur prapa pyetjeve që ishin bërë.

Pyetjet ishin bërë me dinakëri, duke pasur për qëllim objektivin themelor për të përcaktuar nëse Profeti Muhamed (sallallahu 'alaihi wa sallam) kishte dijeni për Dexhallin dhe për *Jaxhuxh* (Gog) dhe *Maxhuxh* (Magog), ardhja e të cilëve përcaktonte Shenjat e Mëdha të Ditës së Fundit.

Surja al-Kahf filloi me përgjigjen për pyetjen e parë, në të cilën *Dexhalli* mbeti caku i cili nuk u përmend. Qëllimi primar i këtij libri është që të analizojë Suren për të nxjerrë udhëzimin brenda saj, që do t'i ndihmonte besimtarët që ta thellonin kuptimin e tyre për *Dexhallin* dhe ta forconin kapacitetin e tyre për të mbrojtur vetën dhe familjet e tyre nga *Fitnah* (test dhe sprovë) e *Dexhallit*.

Kur Sūrah iu përgjigj pyetjes së dytë, ajo paraqiti tematikën e *Jaxhuxh* (Gog) dhe *M'ajūj* (Magog).

Sūrah al-Kahf përmban katër ngjarje, që paraqiten nganjëherë si tregime e nganjëherë si parabola. Ngjarja e parë, për të rinjtë dhe shpellën e thellon kuptimin tonë për Dexhallin si dhe Gogun dhe Magogun. Ngjarja e dytë lidhur me njeriun e pasur dhe njeriun e varfër thjesht tregon për Dexhallin. Ngjarja e tretë, sa i përket Musës (alaihi al- Salām) dhe Khidrit (alaihi al-Salām), ndoshta është më e rëndësishmja nga të gjitha dhe prapë e thellon kuptimin tonë për Dexhallin. Dhe në fund ngjarja e katërt dhe e fundit, për udhëtarin e madh, e paraqet tematikën e Gog dhe Magog, si dhe e shpjegon atë. Ky libër i shpjegon këto katër ngjarje dhe parabola të *Sures al-Kahf*.

Para se t'u kthehemi atyre ngjarjeve dhe parabolave të bukura, ne duhet së pari të ekzaminojmë konceptin e kohës në Kuran. Përveç nëse e kuptojmë atë tematikë, ne nuk mund të depërtojmë në simbolikën fetare në Kuran dhe *Hadith*, e që ka të bëjë me Epokën e Fundit, dhe as nuk mund t'i kuptojmë aktorët dominues në Epokën e Fundit, që janë *Dexhalli*, Mesia i remë ose Anti-Krishti, dhe Gog e Magog. Për këtë arsye libri fillon me një tematikë tejet të pazakontë e që është '*Koha në Kuran*'.

Unë kurrë nuk munda ta kuptoja derisa isha student i ri i Maulāna Dr. Ansari në Institutin Aleemiyah të Studimeve Islamike në Karachi (Pakistan), gjatë viteve 1964-1971, arsyen se pse ai i kushtonte aq shumë vëmendje dhe përkushtim mësimi të tematikës së 'kohës multi-dimensionale' në Islam. Vetëm tani, pasi që kam zbuluar lidhshmërinë marramendëse mes 'kohës' dhe Shenjave të Ditës së Fundit, kam arritur më në fund ta kuptoj mençurinë e madhe të atij mësuesi dhe atë që ai mendohej ta shpjegonte në këtë tematikë kaq të vështirë, para shumë kohësh.

Megjithatë, bile as edhe në Dār al-'Ulūm ose në institucionet e studimeve të larta Islamike nuk mësohet më. Një nga shkaqet për këtë, ndoshta gjendet brenda luftës së tanishme që po bëhet në qendrën shpirtërore të Islamit i.e., Tasawwuf ose al-Ihsān. Përveç kësaj, shumica e Sufistëve e kanë braktisur vetë epistemologjinë Sufiste që e kupton vlefshmërinë e diturisë së brendshme shpirtërore si burim i diturisë. Ne kemi dhënë dëshmi për këtë fenomen të koklavitur në esenë tonë me titull '*Ikbāl, Epistimiologjia Sufiste dhe Koha e Historisë*' (të publikuar në librin tonë të eseve me titull '*Shenjat e Ditës së Fundit dhe Koha Moderne*').

KAPITULLI DYTË

KURANI DHE KOHA

Vetë thelbi i *kohës*, siç shpjegohet në *Suren al-Kahf* të Kuranit dhe siç është shpjeguar në këtë ese, është se koha është komplekse dhe multidimensionale. Ekziston një lëvizje multidimensionale e kohës, derisa kalon nëpër epoka. Vetëm besimtarët dhe të drejtë janë të pajisur me Nur (i.e., dritë) e cila ua jep atyre mundësinë për të depërtuar në *realitetin e kohës*. Në një *Sūre* shumë të njohur të Kuranit (i.e., *al-'Asr*) me titull koha, Allahu Më i Dituri paralajmëron se të gjithë, përveç besimtarëve, do të jenë si në det (të humbur), lidhur me këtë tematikë. Do të jenë në gjendje të humbjes për shkak të pamundësisë së tyre për ta kuptuar

subjektin e kohës dhe kështu të notojnë me lumin e kohës derisa rrjedh te një destinacion që dëshmon triumfin final të së Vërtetës mbi të pavërtetën (*Shih Kuranin, al-‘Asr, 103:1-3*).

Të rinjtë në *Sūren al-Kahf* menduan se qëndrimi i tyre i gjatë 300 vjet në shpellë zgjati vetëm një ditë ose një pjesë të ditës, sepse çdo përvojë shpirtërore dhe kontakt aspektin e brendshëm na transporton neve në një botë në të cilën ne humbim njehsimin e *kohës* (i.e., ‘të këtushmen dhe të tanishmen’ ose ‘momentin’). Cilido që e thyen barrierën që na burgos neve në burgun e ‘të këtushmes’ dhe ‘të tanishmen’, mund ta provojë *pafundësinë kohës*. Vetëm dashuria e vërtet për Allahun më të Lartësuarin dhe përkushtimi i singertë në fenë e të vërtetës mund ta thyejë barrierën e *kohës*.

Kjo ese argumenton se askush nuk mund ta kuptojë Dexhallin, organizatorin kryesor të botës së çuditshme sot, përveç nëse fillimisht e liron mendjen e tij nga burgu i ‘së këtushmes dhe tanishmes’ dhe depërton botët e ndryshme të *kohës*.

Të gjithë, përveç atyre të cilët kanë besim në Allahun Më Të Lartësuarin, mbesin të burgosur në vetëdijen se ka vetëm një dimension *kohor*. Kur ata të cilëve u mungon besimi, do të ngrihen në Ditën e Fundit, do t’u largohen perdet nga sytë, kështu që do të shohin me pamje të mprehtë, që deri atëherë nuk ishte e mundur. Pamja e re e mprehtë, në anën tjetër, do t’u shpalosë atyre diçka nga realiteti i *kohës*.

Kurani ka shpjeguar njerëzit që do të nxirren nga ky burg i *kohës* për ta bërë botën të vërtetë. Edhe pse ata mund të kenë jetuar sipas llogaritjes së viteve të jetës së tyre, prapëseprapë pas ringjalljes së tyre në botën e re (e cila do jetë *ghair al-ard*, i.e., e ndryshme nga rregulli i tanishëm i krijimit; shih Kuranin, Ibrāhim, 14:48), ata vetë do të jenë të vetëdijshëm për dimensionin e ri të kohës në të cilin a kanë rilindur. Atëherë ata do të deklarohen se llogaritja e viteve në jetën e mëparshme duket si “një ditë ose pjesë e ditës”:

﴿لَقَدْ كُنْتَ فِي غَفْلَةٍ مِّنْ هَذَا فَكَشَفْنَا عَنْكَ غِطَاءَكَ فَبَصَرُكَ
الْيَوْمَ حَدِيدٌ﴾

“(I thuhet) Ti ishe në një huti nga kjo (ditë) e Ne ta tërhoqëm perdën tënde dhe tash ti sheh shumë mprehtë! (dhe njëra nga gjërat e para që ata shohin tani me pamjen e tyre të kthjellët do të jetë realiteti i kohës’.)”

(Kurani, Qāf, 50:22)

﴿ قُلْ كَمْ لَبِثْتُمْ فِي الْأَرْضِ عَدَدَ سِنِينَ ﴿١١٢﴾ قَالُوا لَبِثْنَا يَوْمًا أَوْ بَعْضَ يَوْمٍ فَسْئَلِ الْعَادِينَ ﴿١١٣﴾ قُلْ إِنْ لَبِثْتُمْ إِلَّا قَلِيلًا ۖ لَوْ أَنَّكُمْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿١١٤﴾ ﴾

Ai thotë: (Ata që kan marrë fund) "E sa vjet keni kaluar në tokë?" Ata thonë: "Kemi qëndruar një ditë ose një pjesë të ditës, pyeti ata që dinë numërimin." Ai thotë: "Mirë e keni, sikur ta dishit njëmend pak keni qëndruar!"

(Kurani, 23:112-114)

﴿ وَيَوْمَ تَقُومُ السَّاعَةُ يُقْسِمُ الْمُجْرِمُونَ مَا لَبِثُوا غَيْرَ سَاعَةٍ ۚ كَذَلِكَ كَانُوا يُؤْفَكُونَ ﴿٥٥﴾ وَقَالَ الَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ وَالْإِيمَانَ لَقَدْ لَبِثْتُمْ فِي كِتَابِ اللَّهِ إِلَى يَوْمِ الْبَعْثِ ۖ فَهَذَا يَوْمُ الْبَعْثِ وَلَكِنَّكُمْ كُنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ ﴿٥٦﴾ ﴾

E ditën kur të bëhet kijameti (ditën e gjykimit), kriminelët betohen se nuk qëndruan (në dynja) gjatë, por vetëm një çast të shkurtër. Kështu kanë qenë ata që i bishtëruan të së vërtetës. E atyre që iu është dhënë dija dhe besimi thonë: "Ju keni qëndruar aq sa u pat caktuar All-llahu deri në ditën e ringjalljes, e kjo pra është dita e ringjalljes, por ju ishit që nuk e pranonit!"

(Kurani al-Rum, 30:55-56)

Këto ajete Kuranore shpalosin një lidhshmëri të tillë mes 'besimit' dhe *kosës*, sa që ata të cilën kanë besim do ta depërtojnë realitetin e *kohës*. Thellësia e depërtimit e atij realiteti do të jetë matje e 'besimit'.

Islami 'Protestant' dhe koncepti I Kohës

Protestantizmi' është një fenomen unik evropian. Ai paraqet një koncept të çuditshëm të fesë, të zhveshur nga bërthama shpirtërore. Kështu që e ka mundësuar daljen e epistemologjisë perëndimore 'me një-sy' që e përkufizon diturinë vetëm nga vrojtimi i jashtëm ekstern, derisa dyshojnë ose e mohojnë diturinë që buron nga brenda ose nga shpirti. Kur ajo epistemologji

ndikoi në mendimin islamik, e krijoj një Islam ‘Protestant’, i cili e braktisi misionin shpirtëror islamik. Gradualisht u bë një krijesë e çuditshme dhe e rrallë që punoi jashtë orarit të punës në emër të *Dexhallit* (mesias së rrejshëm), derisa bënte luftë ndaj *Sufismit* të Islamit dhe në përdorimin e diturisë së intuitës së brendshme shpirtërore në interpretimin e simbolikës fetare.

Profeti Muhameti (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) e ka shpjeguar subjektin e *Dexhallit*, Mesias së rrejshëm ose Anti-Krishtit, në goxha hollësi. Mes gjërave të tjera që ai tha për *Dexhallin*, ishte se:

“ . . ai do të jetoj në tokë (pasi ta ketë liruar Allahu Më i Lartësuari) për një periudhë prej dyzet ditësh, një ditë (që do jet) sa një vitë, një ditë sa një muaj, një ditë sa një javë, dhe të gjitha ditë e tij (i.e., të gjitha ditë e tjera të tijë) si ditët tuaja”.

(Treguar nga al-Nawwās ibn Sama’ān dhe regjistruar në Sahīh Muslim)

Disa dijetarë të Islamit, për fat të keq, janë mashtruar, për shkak të ndikimit të thellë intelektual të sundimit perëndimor modern kolonial Euro-Krishter dhe Euro-Çifut mbi tërë botën e Islamit, në përqafimin e versionit ‘Protestant’ të Islamit. Si rezultat, ata shohin vetëm me ‘një’ sy, atë të ‘jashtmin’ dhe/ose nuk duan, ose nuk kanë mundësi të interpretojnë ndonjë tekst të shenjtë sa i përket *kohës* përtej kuptimit të saj të drejtpërdrejtë. Dijetarët e tillë do të insistojnë se diku në tokë, nëse kërkojmë sa duhet, do të gjejmë një vend ku një ‘ditë’, siç e dimë ne ‘ditën’, mund të zgjasë sa një ‘vit’, siç e dimë ne ‘vitin’. Po ashtu mund të gjejmë një vend ku një ‘ditë’ po ashtu mund të zgjasë sa një ‘muaj’ dhe një tjetër sa një ‘javë’ dhe kur Allahu Më i Lartësuari e lëshon atë në botë, nëse e vazhdojmë hulumtimin tonë në ato vende, do të jemi në gjendje të gjejmë *Dexhallin*.

Fatkeqësisht, më së afërmi që mund t’i qasemi këtij shpjegimi, gjendet në polet e veriut dhe jugut ku mund t’i përfundojmë gjashtë muaj dritë të vazhdueshme dhe gjashtë të tjerë me errësi të vazhdueshme. Por ky fenomen nuk mund ta shpjegojë me këtë Hadith.

Sheikët autentik *Sufist* të Islamit kanë qenë ndriçuesit shpirtërorë të Islamit për më shumë se njëmijë vjet, të cilët kanë depërtuar në zemrën e mënyrën e fetare të jetesës dhe sikurse *Khidri* (*‘alaihi al-Salām*), ata kanë parë me ‘dy’ sy, i.e., të jashtëmit dhe të brendshmit (*Imam al-Ghazzali* është njëri nga ata.), për shkak të thellësisë së besimit ata kanë arritur të jenë në gjendje ta kuptojnë *realitetin* e *kohës*.

Duke e ndjekur rrugën e *Khidrit* (*‘alaihi al-Salām*), ne kemi aplikuar epistemologjinë *Sufiste* të diturisë së intuitës së brendshme për të interpretuar simbolizmin fetar (*t’awīl al-Aḥādīth*). Si rrjedhojë, kemi larguar çdo pikëpamje se kërkimi në pole ose çdo kund tjetër në tokë, mund të përfundojë me gjetjen e *Dexhallit* në tokë. Në vend të kësaj ne qëndrojmë pas pikëpamjes se i vetmi vend në tokë, ku një besimtar do të jetë ndonjëherë në gjendje ta shohë dhe ta njohë *Dexhallin* në person, është në Tokën e Shenjtë. Natyrisht se kjo do të ndodhë në fundin e pushtetit të tij mbi botën, atëherë kur ‘dita e tij’ do të jetë si ‘dita jonë’ do me thënë atëherë kur ai do të jetë në dimensionin tonë *kohorë*.

Ndoshta kjo është për shkak të bekimit hyjnor që i është dhënë Tokës së Shenjtë, që kalimi nga dimensionet e ndryshme kohore në kohën tonë kanë ndodhur shpesh atje. Kjo do të shpjegonte se për se Profeti Muhamed (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) është dashur të dërgohet në Jerusalem, në mënyrë që të ngrihet në Samāwāt (i.e., shtatë shtresat e hapësirës dhe kohës, ndryshe nga ajo e jona, që Allahu Më i Lartësuar i krijoi, pasi që e kishte krijuar tokën dhe gjithçka brenda saj, për të mirën e njerëzimit. Shih Kuranin, al-Baqarah, 2:29).

Porse deri atëherë Dexhalli do t’ia ketë arritur me sukses misionit të tij dhe se ‘dyzetditëshi’ i tij enigmatik do jetë në të kryer. Ata të cilët çuditërisht do ta kenë të pamundur ta dallojnë *Dexhallin* në veprim e sipër, pikërisht këtu në botën tonë, nuk mund të shërbejnë si udhëzues për besimtarët, pasi ata vetë janë të mashtruar.

Por ne nuk ua mohojmë dijetarëve protestantë të Islamit të drejtën për të vazhduar kërkimin. Ata po ashtu presin ‘gomarin’ në të cilin do të hipte *Dexhalli* (sipas një Hadithi të Profetit): “Ai do të udhëtojë me shpejtësinë e reve dhe do t’i ketë veshët e shtrirë gjerë.” Po ashtu, “Ai (*Dexhalli*) do të shkelë në oqean dhe uji do t’i arrijë deri në gjunjë.” Ne e kemi përdorur epistemologjinë *Sufiste* për ta kuptuar ‘simbolikën fetare’ që vepron në këtë *Ahadith* dhe për ta interpretuar atë simbolikë. Simboli i “gomarit” paraqet aeroplanin modern. Dhe teknologjia moderne mundëson depërtimin në thellësitë e oqeanit. Kështu pra ne mund ta kuptojmë profecinë e “shkeljes së Dexhallit në oqean” etj.

Ahmadijah dhe koncepti i ‘kohës’

Lexuesi ndoshta dëshiron të pyes se ku është rëndësia e kësaj pjese të kapitullit. Atëherë na lejoni ta shpjegojmë. Lëvizja Ahmadijah është një krijesë e Islamit ‘Protestant’ dhe si pasojë nuk janë në gjendje ta kuptojnë tematikën e kohës në Islam. Anëtarët e lëvizjes Ahmadija u janë qepur mësimëve kequdhëzuese të themeluesit të tyre, sa i përket tematikës së Dexhallit, Mesias së rrejshëm ose Anti- Krishti, si dhe tematikës së kthimit të Mesias së vërtetë, Jezuit, të birit të Mejremes (*paqja dhe bekimi i Allahut Më të Lartësuarit qofshin mbi të*).

Mirza Ghulam Ahmad, themeluesi i Lëvizjes Ahmadiyah, pohoi se profecitë e Profetit Muhamed lidhur me kthimin e Mesias së vërtetë, Jezuit, të birit të Marisë (*‘alaihi al-Salām*) janë përmbushur në të. Nëse pohimet e tij do të ishin të vërteta (dhe në mënyrë të dukshme janë gënjeshtër), atëherë ai, Mirza, është dashur ta kishte vrarë *Dexhallin* derisa ai (Mirza) ishte akoma gjallë, pasi që kjo ishte Profecia e Profetit. Edhe një herë kjo tregon se *Dexhalli* do t’i kishte jetuar të dyzet ditët e tij në tokë, para se ai gjoja të jetë vrarë nga themeluesi i Lëvizjes Ahmadiyyah në kapacitetin e tij të supozuar të qëndrimit në vend të Jezuit, të birit të Marisë.

Mirza Ghulām Ahmad vdiq gati para një shekulli (që nga koha e shkrimit të këtij libri), por as ai e as ndonjëri nga ndjekësit e tij të kequdhëzuar nuk janë përpjekur deri më sot që t’i interpretojnë dhe as t’i shpjegojnë ‘dyzetë ditët’ e jetës së *Dexhallit* në tokë, para se Mesia (i rremë), ‘Indian’ gjoja, t’i ketë dhënë fund asaj!

Pikërisht për shkak të pamundësisë për të depërtuar në tematikën e kohës dhe të botëve të ndryshme (*Samāwāt*), të hapësirës dhe kohës që Ahmadiyyah e ka adoptuar qëndrimin që e ka përkitazi me udhëtimin e mrekullueshëm të Profetit në Jerusalem dhe ngritjes në *Samāwāt* gjatë

Isrās dhe *Mirazhit*. Ata pohuan se *Isra* dhe *Mirazh* ishte një përvojë shpirtërore që nuk ka përfshirë ndonjë udhëtim të mrekullueshëm përmes shtresave të ndryshme të kohës dhe hapësirës. Ata po ashtu mohojnë se Jezui është ngritur ndonjëherë përmes atyre Samāwāt dhe e kundërshtojnë besimin në kthimin e tij. Në të kundërtën ata e mbajnë qëndrimin se ai i mbijetoi përpjekjes për kryqëzim, për të shkuar pastaj deri në Kashmir, ku gjoja varri i tij është gjetur rastësisht.

Mirza Ghulam Ahmad ishte njëri nga shumë Mesiati e remë (*Dajjalūn kazzabūn*), dalja e mistershme e të cilit ishte profetizuar nga Profeti Muhamedi (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*). Kur e studiojmë ne Mirzën dhe mësimet e tij të rrejshme, marrim mësim të rëndësishëm me të cilin do t’i dallonim gjurmët e *Dexhallit*. Këtu gjendet rëndësia e Lëvizjes Ahmadiyyah dhe me këtë edhe kjo pjesë e këtij kapitulli.

Iqbāl dhe Asad

Por Islami Protestant dhe Ahmadijah nuk janë të vetmit që janë keqduhëzuar në këto dy subjekte të rëndësishme që janë të ndërlidhura ngushtë me konceptin e kohës në Islam. Dijetarët eminentë të Islamit, si Dr. Muhammad Iqbāl dhe Muhammad Asad (*Allahu pastë mëshirë mbi ata të dy*) ishin të sfiduar në mënyrë epistemologjike në subjektin e kohës. Në fakt, Ikbali u shpie deri në konkluzionin e remë se Parajsa dhe ferri janë gjendje e jo lokacione:

“Parajsa dhe Ferri janë gjendje e jo lokacione. Përshkrimet e tyre në Kuran janë përfaqësime vizuale të një fakti të brendshëm, i.e. karakteri. Ferri në fjalët e Kuranit është zjarri i ndezur i Zotit që gjendet mbi zemrën’ - të kuptuarit e dhimbshëm të një njeriu për dështimin e tij. Parajsa është gëzimi i triumfit mbi forcat e disintegrimit.”

(Ikbali, ‘Ringjallja e Mendimit Fetar në Islam’, Oxford University Press. London. 1934 p. 116)

Asadi, në anën tjetër, ishte aq i bindur se Jezui (‘alaihi al-Salām) kishte vdekur dhe kështu pra nuk do të kthehet, kështu Ai në mënyrë publike deklaroi besimin e tij të rrejshëm dhe të rrezikshëm në përkthimin e tij të njohur të Kuranit Famëlartë (Shih përkthimin dhe komentet e tij si në ajetet në vijim: al-Māidah, 5:117, dhe Āle ‘Imrān, 3:55).

Në të dyja rastet, Ikbali si dhe Asadi, keqkuptimi sa i përket realitetit të *kohës* i çoi ata në gabim të thellë.

Përtej ‘kohës nga kuptimi i sajë i drejtpërdrejtë’

Në fakt, *hapësira* dhe *koha*, që të dyja, janë shumëdimensionale dhe parajsa dhe ferri, që të dy, ekzistojnë si vende (*lokacione*) e jo vetëm si *gjendje*, në dimensionet e hapësirës dhe kohës, përveç asaj në të cilën ne tani jetojmë. Në këtë kapitull të rëndësishëm ne do provojmë të e shpjegojmë *kohën* në një mënyrë që me shpresë do t’i inkurajojë skeptikët që ti rishikojnë pikëpamjet e tyre në këtë subjekt.

Allahu Më i Lartësuari ka Deklaruar se Ai e ka krijuar tërë tokën për dy ditë dhe që të dyja, tokën dhe qiejt, për *gjashtë* ditë. Këto nuk mund të jenë ‘ditët’ siç kuptohen drejtpërdrejt nga ne, pasi që ‘ditët’ kanë ardhur në ekzistencë vetëm *pas* krijimit edhe të qiejve dhe të tokës:

﴿ قُلْ أَبِئْكُمْ لَتَكْفُرُونَ بِالَّذِي خَلَقَ الْأَرْضَ فِي يَوْمَيْنِ وَتَجْعَلُونَ لَهُ أُنْدَادًا ذَلِكَ رَبُّ الْعَالَمِينَ ﴾

“Thuaj: "A ju jeni ata që nuk i besoni Atij që e krijoi tokën për dy ditë dhe Atij i përshkruani shok, e Ai është Zoti i botëve.”

(Kuran, Fussilāt, 41:9)

﴿ إِنَّ رَبَّكُمُ اللَّهُ الَّذِي خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ فِي سِتَّةِ أَيَّامٍ ثُمَّ اسْتَوَىٰ عَلَى الْعَرْشِ يُدَبِّرُ الْأَمْرَ مَا مِنْ شَفِيعٍ إِلَّا مِنْ بَعْدِ إِذْنِهِ ذَلِكُمُ اللَّهُ رَبُّكُمْ فَاعْبُدُوهُ أَفَلَا تَذَكَّرُونَ ﴾

“Vërtet Zoti juaj është All-llahu, i cili krijoi qiejt e tokën brenda gjashtë ditësh e pastaj qëndroi mbi Arshin; Ai rregullon gjendjen. Ndërmjetësues nuk do të ketë vetëm poqese lejon Ai. Ky, Madhëria e Tij është All-llahu, Zoti juaj, pra adhurojeni Atë! A nuk merrni mësim?”

(Kuran, Yūnus, 10:3)

Se ka më shumë në ‘kohën’, sesa ajo që kuptohet drejtpërdrejt, po ashtu bëhet e qartë nga deklarimi në vijim i Profetit të bekuar (*sallallahu 'alaihi wa sallam*):

“Treguar nga Abu Dhar: Unë e pyeta, O i Dërguar i Allahut! Cila është Xhamia e parë e ndërtuar në faqen e tokës? Ai u përgjigj: al-Masjid al-Harām (në Meka). Unë (pastaj) pyeta: cila u ndërtua pastaj? Ai u përgjigj: Masjid al-Aqsā (në Jerusalem). Unë (pastaj) pyeta: cila është periudha kohore mes ndërtimit të këtyre dyjave? Ai tha: Dyzet vjet. Ai shtoi: Kudo që mund të jesh dhe vjen koha e faljes, kryeje faljen aty, sepse kjo është gjëja më e mirë për ta bërë (i.e. të bëhet falja me kohë).”

(Sahīh Bukhārī)

Nëse e kuptojmë ‘kohën’ drejtpërdrejt (dyzet vite) në këtë *Hadīth*, atëherë *Hadīth* do të ishte dukshëm i pavërtetë. Kërkon vetëm pak mendim që një njeri ta kuptojë se i Dërguari i Bekuar i Allahut (*sallallahu 'alaihi wa sallam*), në këtë *Hadīth*, nuk i referohet një ‘viti’ në

kuptimin e dymbëdhjetë muajve lunar. Kur ai foli në *Hadīth* për periudhën ‘dyzetvjeçare’ dhe kur iu referua *Hadithit* lidhur me *Dexhallin*, për një ‘ditë’ si një ‘vit’, ai nuk i referohej ‘vitit’ siç e dimë ne ‘vitin’.

Mirë atëherë, ne pyesim, çfarë lloj ‘viti’ po i referohej ai, kur e përshkroi një periudhë kohore, ai përshkroi një periudhë kohore të cilën historia e ka regjistruar mirë, një periudhë më të gjatë se njëmijë vjet, të jetë vetëm ‘dyzet’ vjet gjatësi?

Është e pamundur që të kuptohet deklarimi sa i përket 40 viteve të jetëgjatësisë së *Dexhallit* në tokë (ose dyzet vitet që kaluan mes ndërtimit të dy *Masājideve*), nëse e përkufizojmë veten tonë në kuptimin njerëzor të ‘kohës’. Kjo vjen nga shqisat tona të perceptimit të ‘natës’, të ‘ditës’ dhe të lëvizjes së diellit dhe të hënës. Ata të cilat janë të përkufizuar me epistemologjinë perëndimore, nuk mund ta interpretojnë këtë, edhe pse fizika kuantike mund të hedhë pakë dritë në këtë çështje. Dhe as *Hadithi* përkitazi me *Dexhallin* etj., nuk mund të kuptohen nga ata të cilët janë të burgosur në interpretimin e drejtpërdrejtë të asaj që duhet të shpjegohet në mënyrën simbolike. Në fakt, vetëm epistemologjia *Sufiste* është ajo që mund të zhbllokojë tematikën e *Dexhallit*!

Ne mund të kuptojmë *drejtpërdrejt* një ditë (*jaum*) që do të jetë si dita jonë (*jaum*). Një ditë të tillë (*jaum*) do të përfshinte një ‘natë’ (*lail*) dhe ditën në vijim (*nahār*), me fjalë të tjera prej perëndimit të diellit e në perëndim të diellit. *Dexhalli* do të jetë në dimensionin tonë *kohor*, në ‘ditët si ditët tona’, kur do të jetë në *kohën* e fundit të jetës së tij në tokë. Kjo është mjaft e qartë! Kushdo që është në dimensionin tonë *kohor*, me rregull duhet të jetë po ashtu në dimensionin tonë hapësinor. Kjo është ajo çfarë regjistrimi historik na e tregon. Ne nuk kemi ndonjë dëshmi historike që dikush të jetë në dimensionin tonë *kohor* e të mos jetë në dimensionin tonë hapësinor. Pasi që dexhalli do të jetë në dimensionin tonë *kohor*, si dhe atë hapësinor, në fund të jetës së tij në tokë do të ishte e mundur që ne ta shihnim atë në Jerusalem. Pyetja që duhet bërë është: ku do të jetë *Dexhalli* në tokë gjatë periudhës së tij të ‘një ditë sa një vit’, e pastaj të një ‘dite sa një muaj’ dhe, në fund, të një ‘ditë sa një javë’? Pyetja e dytë është se sa do të zgjasë një ditë sa një vit - pastaj një ditë sa një muaj - pastaj një ditë sa një javë? Ky kapitull i rëndësishëm i librit përpiket t’u përgjigjet këtyre pyetjeve.

Al-Ghaib – bota e jashtëzakonshme e paparë.

Feja ka konfirmuar ekzistimin e botëve të jashtëzakonshme që nuk shihen, të cilat ekzistojnë përtej vëzhgimit (normal) dhe kështu hetimet shkencore në dimensionet kohore dhe hapësinore përtej kësaj tonës (*al-Ghaib*) kanë kërkuar që besimtarët të besojnë në botët që nuk shihen.

Kur *Dexhalli* është në një ditë që është ndryshe nga dita jonë nuk do të jetë e mundur për ne që ta shohim atë (edhe pse ai do të jetë në tokë) pasi që do të jetë në një dimension tjetër të ekzistencës në botën që nuk mund të shihet (*al-Ghaib*). Kjo është pikërisht gjendaj me Engjujt dhe *Xhindet* të cilët janë në tokë porë megjithatë nuk mund të shihen nga qenjet njerëzore. Kurani ka deklaruar se janë dy engjëj në supet e secilit njeri:

﴿ وَإِنَّ عَلَيْكُمْ لَحَافِظِينَ ۖ كِرَامًا كَاتِبِينَ ۖ يَعْلَمُونَ مَا تَفْعَلُونَ ﴾

“Kurse ndaj jush kanë përcjellësit janë shkruar të ndershëm te All-llahu ata e dinë se çka punoni.”

(Kuran, al-Infītār, 82:10-12)

Ai më tutje na ka informuar se është një xhind i ligë (i.e., Shejtani) që është i bashkangjitur me secilin njeri që largohet nga Dhikri (të kujtuarit) e Zotit të vet:

﴿ وَمَنْ يَعِشْ عَنْ ذِكْرِ الرَّحْمَنِ نُقِيضْ لَهُ شَيْطَانًا فَهُوَ لَهُ قَرِينٌ ﴾

“Kush mbyll sytë para këshillave të Zotit, atij ia shoqërojmë një djall që nuk i ndahet kurrë.”

(Kuran, al-Zukhruf, 43:36)

Edhe pse ne nuk mund t’i shohim ata Engjuz dhe *Xhindet* që janë përreth nesh, prapë se prapë çdo besimtar beson në ekzistimin e tyre këtu në tokë! Ja dëshmia e besimit tonë në dimensionet e ekzistencës dhe, kështu pra, edhe të botëve të hapësirës dhe *kohës*, përveç kësaj tonës, që ekzistojnë së bashku me hapësirën dhe *kohën* e botës sonë këtu në tokë.

Jo vetëm që ne besojmë në dimensionet e tilla që e kapërcejnë përvojën tonë të zakonshme, porse ne kemi edhe dëshmi të pamohueshme se një Engjëll mund të futet në dimensionin tonë dhe kështu të paraqitet në hapësirën dhe kohën e botës sonë e ne të mund ta shohim me sytë tanë. Kjo është bërë e qartë në disa raste nga Engjëlli Gabriel (‘alaihi al-Salām). Ja një rast i tillë:

Treguar nga Abdullah ibn Umar ibn al-Khattāb: Babai im, Umar ibn al-Khattāb, më tha mua: Një ditë rrim ulur në Xhami, kur para neve doli një njeri që ishte i veshurë me rroba krejtësisht të bardha, flokët jashtëzakonisht të zeza. Nuk kishte ndonjë shenjë udhëtimi në të. Askush mes nesh nuk e njohu atë. Dhe ngadalë ai u ul me Të Dërguarin (paqja qoft mbi të). Ai u ulë në gjunjë para tij, i vendosi shuplakat në shpatullat e tij, dhe (vazhdoi të bëjë pesë pyetje) . . . (treguesi i Hadithit, Umar ibn al-Khattāb) tha: Pastaj ai (pyetësi) vazhdoi rrugën e tij, por unë qëndrova me të (Profetin e Shenjtë) për një kohë të gjatë. Ai pastaj më pyeti mua: Umar, a e din se kush ishte ky pyetësi? Unë u përgjigja: Allahu dhe i Dërguari i Tij dinë më së miri. Ai (Profeti i Shenjtë) tregoj: Ai ishte Gjibraili (Engjëlli). Ai erdhi te ju që të ju mësoj juve në çështjet e fesë.

(Sahîh Muslim)

Kjo ngjarje ndoshta kualifikohet si ngjarja më e mahnitshme në histori, në të cilën një engjëll e mori formën e njeriut, derisa hyri në dimensionin e hapësirës dhe *kohës* në të cilat ekzistojnë qeniet njerëzore, duke u bërë kështu pra i dukshëm dhe i prekshëm për ta.

Një *Exhin* po ashtu mund të marrë formën e njeriut dhe të hyjë në hapësirën dhe *kohën* e botës njerëzore. Incidenti më i njohur i këtij lloji është paraqitja e *Iblīs*it

(i.e., Shejtanit) në personin e një plaku arab, në një mbledhje të tubuar nga Kurajshit, për të formuluar politikat të cilat do ta zgjidhnin problemin e shkaktuar nga Muhamedi (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*):

“Vet Shejtani (i.e., Iblīs) i përshëndeti ata te dera e vendit të takimit nën maskimin e një sheiku (plaku të mençur), i veshur me një mantel. Kur ata e pyetën se kush ishte ai, ai u përgjigj: ‘një sheikh i cili ka dëgjuar për qëllimin e diskutimit tuaj dhe ka ardhur të dëgjojë atë që keni për të thënë; dhe ndoshta opinionin dhe këshilla ime nuk do të humbin nga ju.’ Kështu që ai hyri me ta.”

(Ibn Ishaq, *Sīrat Rasūl Allah*, Tr. By Alfred Guillaume, Ox. Univ. Press. 1955 p. 221)

Tani, a mundemi të përdorim burimet autoritare për të shpjeguar ekzistimin e dimensioneve kohore, përveç kësaj tonës? A mund ta shpjegojmë ‘një ditë sa një vit’?

Pasi që Kurani deklaron vetë se i shpjegon të gjitha gjërat (*Kuran, al-Nahl, 16:89*), kjo tregon se duhet të shpjegojë edhe ato deklarime të Profetit të bekuar (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*), të cilat janë përtej të kuptuarit normal njerëzor. Qëllimi në këtë ese është që t’i kthehemi Kuranit në përpjekje për të lokalizuar shpjegimin e këtij Hadithi enigmatik përkitazi me jetëgjatësinë 40-ditëshe të *Dexhallit*, Mesias së rrejshëm (në tokë).

‘Koha ka ekzistuar atëherë kur ne nuk kemi ekzistuar,

Islami na ka mësuar se ka qen një *kohë* kur njerëzimi nuk ka ekzistuar dhe se i tërë njerëzimi është krijuar si një veprim i bekimit hyjnor në një moment *kohor*; kështu pra koha ka ekzistuar para ekzistimit të njerëzimit. Islami po ashtu na ka mësuar se do të vijë koha kur gjithçka do të zhduket dhe do të mbetet vetëm miratimi hyjnor. (*Kuran, al-Rahmān, 55:26-7*); kështu pra *koha* do të vazhdojë të ekzistojë edhe atëherë kur njerëzimi nuk do të ekzistoj më.

Merre në konsideratë ajetin (strofën) në vijim:

﴿ هَلْ أَتَى عَلَى الْإِنْسَانِ حِينٌ مِّنَ الدَّهْرِ لَمْ يَكُنْ شَيْئًا مَّذْكُورًا ﴾



“Vërtetë ka kaluar një periudhë kohore, që njeriu nuk ekzistonte fare si një diçka i përmendur?”

(Kuran, al-Dahr, 76:1)

Së dyti, Islami na ka mësuar se njerëzimi fillimisht është krijuar në një vend në *al-Xhanah* (parajsë), në një dimension kohor tjetër nga *koha* biologjike në të cilën tani ne ndodhemi dhe plakemi. E si pasojë e mosbindjes ndaj urdhrit hyjnor, njerëzimi është përjashtuar nga ai dimension *kohor* dhe është vendosur përkohësisht në këtë dimension *kohor*, në të cilin tani ne ekzistojmë.

Kjo tregon se përderisa njerëzimi e ka një realitet i cili varet me kohën, *koha* e ka një realitet që është i pavarur nga njerëzimi. Cili është realiteti i kohës? Allahu Më i Lartësuar ka deklaruar për Vetën e Tij se Ai është *Koha*:

Treguar nga Abu Hurairah: i Dërguari i Allahut tha, Allahu ka thënë, “Pasardhsi i Ademit e dhunon Dahr (Kohën), dhe Unë jamë Dahr (Koha); në Duart e Mia janë nata dhe dita!”

(Sahih Bukhari)

Koha e shejtë dhe epoka moderne e pafe (pa besimin në Zot).

Është një karakteristikë e thjeshtë e epokës moderne të pafe që e përdor çdo hile të mundshme për ta shkatërruar lidhjen e harmonishme natyrore në mes *kohës* dhe *jetës*, siç urdhërohet me Islam, që është e vetmja fe e vërtetë. Përpiqet kështu ta korruptojë perceptimin tonë të *kohës* si dhe kapacitetin tonë për të matur *kohën* në ndonjë mënyrë tjetër, përveç asaj mekanike. Në fakt ajo epokë e pafe kërkon të zëvendësoj konceptin tonë të *shenjtë* për *kohën* me një koncept *laik* për *kohën*.

Për shembull epoka moderne Euro-krishtere dhe Euro-Çifute i ka riemërtuar të dymbëdhjetë muajt e vitit, prej ‘janarit’ deri në ‘dhjetor’, dhe të shtatë ditët e javës, nga e ‘diela’ deri tek e ‘shtuna’, me emrat e zotave pagan evropian. Kjo nuk ka ndodhur aksidentalisht. Megjithatë i ka ikur vëmendjes së dijetarëve modernë islamik.

Po ashtu, dita nuk përfundon më me pamjen spektakolare dhe dramatike të perëndimit të diellit, siç ndodhë natyrshëm. Në vend të kësaj tash përfundon në mesin e natës dhe si pasojë dita e re fillon në një moment krejtësisht relevant, të parëndësishëm dhe të pakuptim, në pjesën kur shumica e njerëzve janë duke fjetur.

Një muaj i ri nuk fillon më me përfundimin e muajit paraprak, ashtu siç është urdhri natyror, me shkëlqimin interesant e të bukur dhe të pakrahasueshëm të hënës së re që me bekim e admiron qiellin menjëherë pas perëndimit të diellit. Por, në vend të kësaj, gjatësia e secilit muaj është caktuar në mënyrë arbitrare nga Papa evropian. Disa muajve në mënyrë arbitrare u janë caktuar 30 ditë e disa të tjerë vuajnë me 31 ditë, ndërsa shkurti i pafat vuan me turpin që nganjëherë të jetë kështu (i.e., 28 ditë) dhe nganjëherë ashtu (i.e., 29 ditë).

Bile, dita nuk është më e ndarë në pjesë që bartin më vete lidhshmërinë me lëvizjen e diellit, derisa kalon nga lindja false në lindjen e vërtetë me dritën shkëlqyese të mëngjesit të

hershëm, pastaj në dritën e shndritshme të ditës, e pastaj dritën e zbehur të zbritjes së diellit dhe pastaj muzgu, drita e hënës, drita e yjeve, data e errët dhe errësira e thellë etj. Por, në vend të kësaj, tani është rregulluar një kalim mekanik i kohës për një ndarje krejtësisht arbitrare të ditës dhe të natës në 24 pjesë të barabarta të quajtura orë dhe secila orë në 60 pjesë të barabarta të quajtura minuta etj. Një ndjenjë e çorientuar e rregullimit dhe një mision për shfrytëzimin efikas të kohës për qëllimet e kësaj bote doli përpara kalimit të saktë dhe të shenjtë të ditës.

Koha e shenjtë ka funksionuar si një sistem i rëndësishëm strategjik i shenjave dhe simboleve që janë bërë shpirti njerëzor i botës së shenjtë. Koha e shenjtë na ka ndihmuar që të nxjerrim sherbel. Laicizmi dhe si pasoj mekanizimi i kohës i theu këto lidhe të shenjta dhe e mbylli rëndësinë e kohës në funksionin e botës materiale.

Po ashtu nuk është krejt e rastësishme që varrezat e qyteteve moderne ndodhen shumë larg qyteteve dhe qytezave. Qëllimi i fshehur i kësaj është burgosja e mendjes dhe zemrës në jetën e kësaj bote dhe në proces e sipër të na bëj që ne të harrojmë vdekjen dhe jetën përtej vdekjes dhe si pasoj dimensionet tjera *kohore*.

Televizionet dhe pjesa tjetër e medias përdoren aq me dinakëri për të manipuluar lajmet dhe ngjarjet, për ta burgosur njerëzimin në *tiraninë* e ‘momentit’. Imazhet dhe ngjarjet shkreptijnë përmes ekranit televiziv me një shpejtësi që na e çrregullon, e zvogëlon dhe ngadalë e shkatërron kapacitetin e mendjes për të menduar dhe logjikuar. Dhe kështu shumica e njerëzve kushtëzohen që të jetojnë të pavëmendshëm dita-ditës dhe prej çastit në çast. E djeshmja venitet dhe nuk e vret më ndërgjegjen. E nesërmja është vetëm se një zgjatje e fantazisë së djeshme.

Një pasojë tërësisht e parashikueshme ka qenë ajo se njerëzit e kanë humbur kapacitetin për ta lidhur të kaluarën me të tanishmen. E as nuk mund presin një të ardhme që do të bashkohej për t’i dhënë kuptim gjithçkaje. Ata nuk mund ta lexojnë dhe ta kuptojnë lëvizjen e historisë. Ata bile as nuk janë në gjendje ta kuptojnë lëvizjen e *kohës* në histori. Kështu pra ata nuk mund ta dallojnë e as ta kuptojnë shpalosjen e agjendës së misterishme imperialiste në tokën e shenjtë, si dhe në gjithë botën e gjerë, e cila është shtyrë përpara me shekuj nga aleanca e çuditshme.

Kjo agjendë është gati të arrijë kulmin me daljen në shesh të shtetit Euro-Çifut të Izraelit, si shteti i tretë dhe i fundit që e *sundon* botën dhe me dikë që e sundon botën nga Jerusalemi dhe se deklaron se vetë ai është Mesia i vërtetë. Ky është mashtrimi kryesor! Megjithatë, epoka moderne në mënyrë misterioze dhe të mahnitshme ia ka arritur që t’i bind kaq shumë njerëz në botën e Islamit që si skllevër ta imitojnë dhe ta ndjekin atë aleancë të çuditshme euro-krishtere dhe Euro-Çifute të civilizimit modern perëndimor, drejt e në gropën e hardhucës (proverb).

Koha dhe Shenjat e Ditës së Fundit,

Feja e vërtetë ekziston kur ‘e vërteta’ depërton dhe pastaj ngulitet në zemër. Mënyrën se si ne e masim kalimin e kohës është çështje shumë e rëndësishme, pasi që e shpalos llojin e zemrës që ka një njeri. Mes Shenjave të Ditës së Fundit, siç është paraqitur nga Profeti Muhamed (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) e që është:

“Koha do të lëviz më shpejt, ashtu që një vitë i plotë do të kaloj si një muaj, një muaj do të kaloj si një javë, një javë si një ditë, një ditë si një orë e kështu me radhë, dhe një orë sa koha që nevojitet për të ndezur një zjarrë.”

(Treguar nga Anas ibn Malik dhe transmetuar në Synetin e Tirmdhit)

Ai shpjegoi se perceptimi i kohës që lëviz më shpejt, do të jetë si pasojë e largimit nga zemra të ‘të kujtuarit’ të Allahut Më të Lartësuarit (*Dhikr*) dhe preokupimi me jetën e kësaj bote (*Dunjas*) që e zënë një vend ekskluziv në zemër. Zemrat e tilla nuk brengosen aspak me gjërat e tilla si *Dhikri* i.e., të ‘kujtuarit’ e Allahut Më të Lartësuarit.

Po çfarë është ‘të kujtuarit’? Kur një njeri e kujton në zemrën e tij një grua që e do, ai rrëqethet sikur një aromë magjepsë t’ia ketë mbështjellë zemrën. Kjo ndodh çdoherë! Kur ai dëgjon të përmendet emri i saj, ndodh e njëjta gjë. Ky është të kujtuarit.

Qartë, të kujtuarit ndodh kur ka dashuri të vërtetë. Kështu pra, kur dashuria për Allahun Më të Lartësuarin largohet nga zemra, ‘koha’ lëvizë shpejt e më shpejt. Në të kundërtën, kur dashuria e sinqertë për Allahun Më të Lartësuarin zë vendin e zemrës, sigurisht që koha do të lëvizë më ngadalë dhe një besimtar do të bashkëveprojë me kalimin e kohës në jetë, në një mënyrë që do të ketë kuptim të plotë dhe dobi.

Këta njerëz të pashpresë të cilët janë të u burgosur në një botë ku koha fluturon përherë e më shumë, po e paguajnë çmimin e shtrenjtë duke u kurthuar përherë e më shumë në momentin e rrëmbyeshëm dhe si rezultat burgosen në të ‘këtushmen’ dhe të ‘tanishmen’. Ata kurrë nuk do të jenë në gjendje të lexojnë dhe të kuptojnë kalimin e kohës ose lëvizjen e kohës në histori. Kështu ata do të vihen në vrapim dhe do të mbesin tërësisht të pavëmendshëm për gjendjen e tyre të mjerë, derisa zhyten në pusin pa fund.

Pasojat e zbrazësisë shpirtërore në Epokën e Fundit do të jenë dështimi i moralit deri në atë masë sa:

“... njerëzit do të bëjnë marrëveshje biznesi me njëri tjetrin dhe pothuajse asnjëri nuk do ta mbaj fjalën”.

Vakuumi shpirtëror dhe kolapsi i moralit do të pamundësojnë gjykimin e drejtë deri në atë masë, saqë do t’i paaftësojnë njerëzit që t’i dallojnë njerëzit me integritet nga sharlatanët:

“... do të thuhet se mes këtij e atij fisi është një njeri i fjalës. Njerëzit do të thojnë sa inteligjent, i shkëlqyeshëm dhe i vendosur është një njeri, kur (në fakt) nuk do të ket aspak besim (në Allahun) në zemrën e tij sa një kokërr meli.”

(që të dyja citatet më lart të marra nga një Hadith të treguar Hudhaifa dhe transmetuar në Sahīh Bukhāri si dhe në Muslim.)

Profeti i bekuar po ashtu paralajmëroi se do të vijë një kohë e tradhtive të mëdha në të cilën:

“Joshjet to të shfaqen në zemrat e njerëzve si një qilim që thurret fije për fije, dhe secila zemër e cila do të ngopet me to do t’i bëhet një njollë e zezë në të. Rezultati i kësaj do të jetë, se do të ketë dy lloj zemrash:

njëra, e bardhë si një gurë i bardhë, i cili nuk do të dëmtohet nga joshja sa të jenë toka dhe qielli dhe tjetra, me ngjyrë të zezë dhe të pluhurosur si enë e shkrumuar, pa qenë në gjendje të dalloj atë që është për tu respektuar, dhe të kundërshtoj atë që nuk është për tu respektuar, por do të jetë e mbështjellura nga pasioni i saj.”

(treguar nga Hudhaifa dhe transmetuar në Sahīh Muslim.)

Nuk mund të ketë aspak dyshim se kjo e ashtuquajtur epokë e ‘progresit’, në të vërtetë është epoka kur janë paraqitur këto shenja të Ditës së Fundi.

Kjo është epoka e laicizmit. Bile edhe shteti është laik e po ashtu edhe politika, ekonomia, shkollimi, tregtia, media, sporti dhe argëtimi. Dhoma e ngrënies, dhoma e ditës, bile edhe dhoma e gjumit sot është laike. Laicizmi fillon me ‘përrjashtimin e Zotit’ dhe e arrin kulmin me ‘mohimin e Tij’! Kur dituria bëhet laike, shpie në të besuarit se dituria vjen nga një burim i vetëm, i.e., vrojtimi ekstern dhe marrja e informatave të arsyeshme. Implikimi i adaptimit të kësaj epistemologjie është konkluzioni i pashmangshëm se pasi që kjo botë materiale është e vetmja botë të cilën mund ta ‘njohim’ ndonjëherë, kjo do të thotë se kjo është e vetmja botë e cila ‘ekziston’ me të vërtetë.

Kështu pra Laicizmi shpie në materializëm, i.e., pranimin, për të gjitha qëllimet praktike, se nuk ka realitet tjetër përtej realitetit material dhe si rrjedhojë pranimin se nuk ka ndonjë dimension tjetër kohor përtej kohës së kësaj bote në të cilën ne ekzistojmë. Materializmi ka çuar, krejt natyrshëm, në lakmi, gënjeshtër, imoralitet, padrejtësi, dhunë, mosbesim (në Zot) dhe tradhti të mëdha, pasi që themelet e moralit të shoqërisë nuk mund të ruhen pa qendrën shpirtërore të fesë. Ajo zemër as nuk mund të ndërtohet e as të jetë e qëndrueshme pa besimin në këto të vërteta të jashtëzakonshme (siç është Zoti, Engjëjt parajsa dhe ferri) që ekzistojnë në një botë përtej botës materiale. Bile edhe kalimi i jetës përmes kohës shumë lehtë mund të bëhet i pakuptim, kur nuk ekziston asnjë kohë tjetër përveç ‘të këtushmes’ dhe të ‘tanishmes’ dhe nëse nuk ekziston asnjë botë tjetër përveç kësaj bote.

Integrimi i jetës me ‘kohën’

Llogaritja e kalimit të viteve është një çështje me rëndësi të madhe. Se si një person e llogarit kalimin e kohës, e përcakton se kush është ai person.

“Më trego se si i llogarit kalimin viteve e unë të tregoj se kush je!”

Omar Khayyami e ka vajtuar kalimin e viteve:

“Çoftë në Nishpor ose në Babylon,
Çoftë filxhan me pije të ëmbël apo të hidhur,
Vera e jetës vazhdon të rrjedhë pikë për pikë,
Gjethet e jetës vazhdojnë të bijën një nga një!”

(Rubaiyyat)

Porse kalimi i *kohës* provokon një përgjigje goxha të ndryshme në zemrën e cila ka besim në Allahun Më Të Lartësuarin dhe në një jetë e cila në mënyrë pozitive integrohet me lëvizjen e *kohës*! Për shembull: i jep një gruaje besimtare mundësinë për të bashkëvepruar në mënyrë pozitive dhe të harmonishme me vitet e saj që i lë pas.

Çdonjëri me një personalitet mjaft të zhvilluar në aspektin etik për të vlerësuar bukurinë, do të pajtohet se asgjë nga rastet e sipërme nuk mund të krahasohet me bukurinë e pamjes së hënës së re dhe yjeve të bashkuar në një përqafim magjepsës. Kalimi i një muaji të ri lunar në qiellin lart, simbolizon kalimin e vetë jetës.

Kështu është edhe kur lind një vajzë e re, duket sikur të ketë dalë hëna e re në qiell dhe duket se një botë e re ka filluar. Të gjithë e kanë admiruar atë. Të gjithë e kanë marrë atë në kraharorin e dashurisë. Ajo zvarritej - ajo ecte - ajo luante - ajo qeshte - ajo këndonte - ajo vallëzonte. Ajo nuk kishte as edhe një brengë në botë, derisa me lojë e kaloi pranverën e fëmijërisë dhe rinisë së saj. Ishte e mrekullueshme për t'u parë me sy.

Pastaj u skuq nga turpi kur i dha mirëseardhjen *verës*, derisa lulëzojnë në një grua më të bukur se një pikë shiu në një ylber që bie ngadalë mbi petalet e një trëndafili. Bota ia nguliste sytë bukurisë së saj dhe prej buzëve të saj dilyn fjalët: *Subhan Allah!* Këngëtari këndonte për të, poetët thurnin vargje për të. Edhe kjo po ashtu ka qenë një mrekulli për t'u parë.

Pastaj *vjeshta* e mbuloi atë derisa gjethet jeshile të jetës së saj filluan të ktheheshin në ngjyrë kafe. Rrudhat u paraqitën rreth syve të saj dhe aty - këtu dilte nga një thinjë.

Më në fund arriti dimri i saj, kur hëna u bë si një degë e palmës, e fishkur e thatë (Kuran, Yāsīn, 36:39) dhe ajo u përgatit që me kënaqësi ta palosë tendën e saj, të thotë lamtumirë dhe të zhduket në errësirën e natës.

Porse ajo ishte plot mirënjohje ndaj Allahut Më Të Lartësuarit gjatë tërë udhëtimit të jetës së saj përmes *kohës*. Kur e kishte stinën e pranverës, ajo e falënderoi Atë për të e po ashtu edhe për verën e saj, e pastaj për vjeshtën e saj dhe më në fund për dimrin e saj. Ajo nuk kishte ndonjë dëshpërim për vjeshtën ose dimrin e saj. Ajo ishte krenare për fijet e thinjura të flokëve, derisa filluan të përziheshin me ngjyrën natyrore të flokëve të saj. Për asnjë gjë që bota mund t'ia afrojë, ajo nuk dëshiroi kurrë të kthehet në pranverën ose verën e saj, pasi që ajo e donte po aq vjeshtën dhe dimrin e saj. Pra ajo me kënaqësi u plak.

Sa më shumë që plakej, aq më shumë bukuri rrezatonte - një shprehje e jashtme e bukurisë së brendshme. E kur erdhi koha e engjëllit të vdekjes për ta marrë atë, kur erdhi koha që hëna të zhdukej në errësirën e qiellit dhe që nata e errët ta mbështillte botën, nuk pati ndonjë merak që po ndahej nga e vetmja botë që ajo kishte njohur ndonjëherë. Ajo dëshironte ta linte këtë botë me mirënjohje ndaj Allahut në zemrën e saj, sepse Ai u ka premtuar atyre që besojnë në të se Ai do t'u dhurojë atyre shumë dhurata e mirësi (Kuran, Ibrāhīm, 14:7).

Ajo nuk psherëtiu! Ajo nuk bëri si në poezinë e Prendoit Indian Bahadur Shah Zafar's lament:

‘Umr daraz maang layay thay char din,
Do arzoo main kat gayay thay, do intizar main!

[Nga ‘thelbi’ i jetëgjatësive,
Kërova dhe një (jetëgjatësi) prej katër ditësh,
Dy (nga të katërtat) më shkuan në dëshirim dhe
Dy të tjerat në pritje!]

Porse, një grua e tillë besimtare ka qenë gjithmonë e gatshme të udhëtojë me *kohën* në botët e tjera të *kohës*. Ajo kurrë nuk e kundërshtoi kalimin e *kohës* dhe kështu ajo kurrë nuk e mohoi Allahun Më Të Lartësuarin - sepse Ai është *koha*. Kushdo që jeton në harmoni me *kohën*, jeton në harmoni me Zotin dhe Krijuesin e tij! Kushdo që mund të depërtojë në *kohë*, përtej të këtushmes dhe të tanishmes, mund të lexojë dhe të kuptojë shenjat e Allahut dhe shenjat e Ditës, derisa ato shpalosen në lëvizjen e historisë.

Dimensioni në të cilin ne e masim kalimin e *kohës* me ditë dhe me net dhe me stinët e jetës sonë, si dhe me stinët e natyrës, na mundësohet neve që të masim qëndrimin tonë individual dhe kolektiv në tokë. Është një test dhe provë. Nuk e paraqet tërësinë e *kohës*. Përkundrazi e përbën themelin për kalimin tonë në dimensione të tjera të *kohës*, që janë të përshkruara në Kuran. Derisa ne rritemi me *kohën*, i.e., në perceptimin tonë të *kohës* dhe mundësisë për të kuptuar *kohën*, derisa shpaloset në jetën tonë, si dhe në botën jashtë nesh, ne njëkohësisht e rrisim kapacitetin tonë për të kuptuar Epokën e Fundit, derisa shpaloset në etapën e fundit të procesit historik. Dhe kjo është, dukshëm, gjëja më e rëndësishme të cilën ne e argumentojmë në këtë kapitull.

‘Koha’ në Kuran

Allahu Më i Lartësuar na e ka mësuar tematikën e ‘*kohës*’ duke i shpërndar perlat e ‘*kohës*’ aty këtu në Kuranin e Shenjtë dhe në jetën dhe fjalët e të dërguarit të bekuar të Allahut (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*), dhe pastaj i ka vendosur pyetsit (hulumtuesit) përgjegjësin për t’i mbledhur ato perla dhe për ti radhitur së bashku si në një qafore.

Mësuesi im i dalluar, bekuar qoftë kujtimi i tij, Maulāna Dr Muhammad Fadlur Rahman Ansāri (rahimahullah) e përshkruajti atë ‘qafore’ si ‘*sistemin e domëthënjes*’ të kësaj teme. Në këtë seksion, ne e kemi bërë një përpjekje modeste por shumë të rëndësishme të këtij kapitulli jo vetëm për t’i gjetur disa nga ato perla të ‘*kohës*’ në Kuran, por poashtu për t’u përpjekur që ti radhisim ato së bashku në një qafore.

Arabët e kanë konsideruar ‘*Kohën*’ (*al-Dahr*) që të jetë realiteti kryesorë. Ata e besonin ‘*Kohën*’ të jetë e vetmja gjë që mbijeton. Gjithçka dhe të gjithë do të zhduken dhe ikin sepse ata to të ‘shkatërrohen’ nga ‘*Koha*’:

﴿وَقَالُوا مَا هِيَ إِلَّا حَيَاتُنَا الدُّنْيَا نَمُوتُ وَنَحْيَا وَمَا يُهْلِكُنَا إِلَّا
الدَّهْرُ وَمَا لَهُم بِذَلِكَ مِنْ عِلْمٍ إِنْ هُمْ إِلَّا يَظُنُّونَ﴾

“Ata edhe thanë: "Nuk ka tjetër, vetëm se kjo jetë jona në këtë botë, po vdesim dhe po lindemi dhe asgjë nuk na shkatërron tjetër pos kohës. Ata për këtë nuk dinë asgjë, ata vetëm fantazojnë.”

(Kuran, al-Jāthiyah, 45:24)

Civilizimi modern dhe i pafë perëndimor, i cili nuk njeh realitet tjetër përtej realitetit material, ka deklaruar se ‘*koha është para*’. Koha është kthyer në produkt që mund të shkëmbehet, të blihet dhe të shitet. Për shembull: sa herë që paratë të jepen me interes, vlera kohore e parasë është e shprehur me pagesën e interesit.

Allahu Më i Lartësuar është përgjigjur (në një *Hadith al-Qudsi*) duke deklaruar se Vetë Ai është *koha* (*al-Dahr*):

“Treguar nga Abu Hurairah: I Dërguari i Allahut tha, 'Pasardhsi i Adamit abuzon me Dahr (Koha), dhe Unë jam Dahr (Time); në Duart e Mia janë nata dhe dita!'

“(Sahih Bukhari)

Kur Allahu më i Lartësuar deklaroi se Ai është *koha*, kjo nënkupton se ekziston diçka si *koha absolute*, i.e., se *koha* ekziston si e pavarur dhe nuk kushtëzohet nga ndonjë gjë tjetër përveçse vetvetes. Dhe kur Ai vazhdon të tregojë: “*në Duart e Mia janë nata dhe dita*”, domethënia e mëtejshme është se *koha*, siç e njohim ne, i.e., është kuptimi i *kohës* që është rrënjësor në ndërrimin e natës dhe të ditës, është i natyrës relative - i.e., relative ndaj kohës absolute të Allahut. *Koha* siç e njohim ne, në të cilën matja bëhet përmes numërimit të ‘ditëve’, ‘netëve’, ‘javëve’, ‘muajve’, ‘viteve’ etj., mund të dëshmojë si *koha* serike.

Kurani shpjegon se *koha* serike është vetëm fillimi i *kohës* dhe është mundësuar për qëllime të shfrytëzimit i.e., ashtu që njerëzit të kenë mundësi për numërimin e kalimit të viteve dhe për matjen e *kohës* në botën e tyre të përkohshme. *Koha* serike është e vërtetë. Nuk duhet të konsiderohet si një iluzion ose si diçka e pavërtetë:

﴿هُوَ الَّذِي جَعَلَ الشَّمْسَ ضِيَاءً وَالْقَمَرَ نُورًا وَقَدَّرَهُ مَنَازِلَ
لِتَعْلَمُوا عَدَدَ السِّنِينَ وَالْحِسَابَ مَا خَلَقَ اللَّهُ ذَلِكَ إِلَّا بِالْحَقِّ
يُفَصِّلُ الْآيَاتِ لِقَوْمٍ يَعْلَمُونَ﴾

“Ai e bëri diellin shëndritës, e hënën dritë dhe asaj (hënës) ia caktoi fazat, që ta dini numrin e viteve dhe llogarinë. All-llahu nuk krijoi këtë për tjetër, pos me qëllim të caktuar. Ai ia sqaron argumentet një populli që kupton.”

(Kuran, Yūnus, 10:5)

﴿وَجَعَلْنَا اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ آيَتَيْنِ ۖ فَمَحَوْنَا آيَةَ اللَّيْلِ وَجَعَلْنَا آيَةَ
النَّهَارِ مُبْصِرَةً ۚ لَتَبْتَغُوا فَضْلًا مِّن رَّبِّكُمْ وَلِتَعْلَمُوا عَدَدَ السِّنِينَ
وَالْحِسَابَ ۚ وَكُلَّ شَيْءٍ فَصَّلْنَاهُ تَفْصِيلًا ۝﴾

“Ne i bëmë natën dhe ditën dy fakte (që dokumentojnë për fuqinë Tonë), e shenjën e natës e shlyem (e errësuam), e shenjën e ditës e bëmë të ndritshme që të mund të angazhoheni për shfrytëzimin e begative të dhuruara nga Zoti juaj, dhe që të mësoni njehësimin e vjetëve dhe llogaritjen (e kohës). Ne kemi sqaruar çdo send në mënyrë të hollësishme.”

(Kuran, Banū Isrāīl, 17:12)

Kurani vazhdon të tregoj se mes kohës ‘rendore’ dhe ‘absolute’ ekzistojnë shtatë botë të ndryshme të kohës, të përshkruara si shtatë *Samāwāt* (që zakonisht përkthehen gabimisht si shatët qiejt)

﴿هُوَ الَّذِي خَلَقَ لَكُمْ مَا فِي الْأَرْضِ جَمِيعًا ثُمَّ أَسْتَوَىٰ إِلَى
السَّمَاءِ فَسَوَّاهُنَّ سَبْعَ سَمَوَاتٍ ۚ وَهُوَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ۝﴾

“Ai (All-llahu) është që për juve krijoi gjithçka ka në tokë, pastaj vullnetin e vet ai drejtoi qiellit dhe i përsosi ata shtatë qiej. Ai është i gjithdijsmi për çdo gjë.

(Kuran, al-Baqarah, 2:29)

﴿تُسَبِّحُ لَهُ السَّمَوَاتُ السَّبْعُ وَالْأَرْضُ وَمَن فِيهِنَّ ۚ وَإِن مِّن شَيْءٍ
إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ ۚ وَلَكِن لَّا تَفْقَهُونَ تَسْبِيحَهُمْ ۚ إِنَّهُ كَانَ
حَلِيمًا غَفُورًا ۝﴾

“Lartmadhëri të merituar i shprehin Atij shtatë qiejt e toka dhe çka ka në to, e nuk ka asnjë send që nuk e madhëron (nuk i bënë tesbihë), duke i shprehur falënderim Atij, por ju nuk kuptoni atë madhërim të tyre (pse nuk është në gjuhën e tuaj). Ai është i butë dhe fal shumë!”

(Kuran, Banū Isrā'īl, 17:44)

﴿ وَلَقَدْ خَلَقْنَا فَوْقَكُمْ سَبْعَ طَرَائِقَ وَمَا كُنَّا عَنِ الْخَلْقِ غَفِيلِينَ ﴾



“Ne krijuam mbi ju shtatë palë (qiej) dhe nuk jemi të pakujdesshëm ndaj asaj që krijuam.”

(Kuran, al-M'uminūn, 23:17)

﴿ قُلْ مَنْ رَبُّ السَّمَوَاتِ السَّبْعِ وَرَبُّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ ﴾

Thuaj: "Kush është Zoti i shtatë qiejve dhe Zot i Arshit të madh?"

(Kuran, al-M'uminūn, 23:86)

﴿ فَقَضَيْنَهُنَّ سَبْعَ سَمَوَاتٍ فِي يَوْمَيْنِ وَأَوْحَىٰ فِي كُلِّ سَمَاءٍ أَمْرَهَا ۚ وَزَيْنَا السَّمَاءَ الدُّنْيَا بِمَصْبِيحٍ وَحِفْظًا ۚ ذَٰلِكَ تَقْدِيرُ الْعَزِيزِ الْعَلِيمِ ﴾

“Dhe ata i krijoi shtatë qiej brenda dy ditëve dhe secilit qiell i caktoi atë që i nvojitej. Qiellin më të afërt (të dynjasë) Ne e stolisë me yje ndriçuese dhe e bëmë të mbrojtur. Ky është caktim i plotfuqishmit, i të dijshtmit.”

(Kuran, Fussilāt, 41:12)

﴿ اللَّهُ الَّذِي خَلَقَ سَبْعَ سَمَوَاتٍ وَمِنَ الْأَرْضِ مِثْلَهُنَّ يَتَنَزَّلُ الْأَمْرُ بَيْنَهُنَّ لِتَعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ وَأَنَّ اللَّهَ قَدْ أَحَاطَ بِكُلِّ شَيْءٍ عِلْمًا ﴾

“Allahu është Ai që krijoj shtatë palë dhe prej tokës aq sa ata (i.e., shtatë shtresa tokësore)ë në to zbatohet vendimi i Tij për ta ditur ju se Allahu ka fuqi për çdo send dhe që me të vërtetë Allahu ka përfshirë çdo send në dijen e vetë.”

(Kuran, al-Talāq, 65:12)

﴿الَّذِي خَلَقَ سَبْعَ سَمَوَاتٍ طِبَاقًا ۚ مَا تَرَىٰ فِي خَلْقِ الرَّحْمَنِ مِن تَفَوتٍ ۚ فَإِذْ جَعَلَ الْبَصَرَ هَلْ تَرَىٰ مِن فُطُورٍ ۚ﴾

“Ai është që krijoi shtatë qiej palë mbi palë. Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh ndonjë kontrast, andaj, drejto shikimin se a sheh ndonjë çarje?”

(Kuran, al-Mulk, 67:3)

﴿أَلَمْ تَرَوْا كَيْفَ خَلَقَ اللَّهُ سَبْعَ سَمَوَاتٍ طِبَاقًا ۚ﴾

“A nuk e keni parë se si All-llahu krijoi shtatë palë qiej (në kate).?”
(Kuran, Nūh, 71:15)

﴿وَبَيْنَنَا فَوْقَكُمْ سَبْعًا شِدَادًا ۚ وَجَعَلْنَا سِرَاجًا وَهَّاجًا ۚ﴾

“Dhe Ne kemi ndërtuar mbi ju një shtatëshe të forte Dhe kemi vënë ndriçuesin që flakëron? ”

(Kuran, al-Naba, 78:12-3)

Këta shtat trupa të fortë zakonisht njihen si shtatë ‘qiejt’. Por ata nuk janë aspak qiej! Porse ata duhet të njihen si shtatë botë të ndryshme të kohës që qëndrojnë mes tokës dhe Allahut Më Të Lartësuarit në Majën e Fronin të Tij (al-‘Arsh). Profeti Muhamed (paqja dhe bekimi i Allahut Më Të Lartësuar qofshin mbi Të) e ka cekur këtë në Hadīthin në vijim:

Treguar nga al-‘Abbās ibn ‘Abd al-Muttalib: “Unë qëndroja ulur në al-Batha me një shoqëri mes së cilës ishte ulur edhe i Dërguari i Allahut (paqja qoft mbi të), kur një re kaloj mbi ta. I dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të) e shikoj atë dhe tha: Si e quani këtë? Ata thanë: Sahab. Ai tha: Dhe muzn? Ata thanë: Dhe muzn. Ai tha: Dhe anan? Ata than: Dhe anan. Abū Daūd tha: Nuk jam shumë i sigurt për fjalën anan. Ai pyeti: A e di distancën mes Samā (qiellit) dhe Tokës? Ata u përgjigjen: Nuk e dim: Distanca mes tyre është shtatdhjet e një, shtatdhjet e dy, ose shtatdhjet e tri vite. Samā që është mbi të është me distac të ngjashme (dhe vqazhdoi deirsa i llogariti shtat Samāwāt). Mbi Samā-n e shtatë është një det, distanca mes sipërfaqes dhe fundit të tij është sa distanca mes njëres dhe tjetres Smawat. Mbi të janë tet dhi të (të egra) të bjeshkës, distanca mes thundrave dhe kofshave të tyre është sa distanca mes njëres dhe tjetërs. Pastaj mbi atë ndodhet Allahu i Bekuar dhe Madhështorë.”

(Abū Daūd)

Do të dukej se një *Ālam* tjetër (botë e kozmosit) ekziston në secilën nga këto shtat *Samāwāt*. Kurani fillon me *Sūrah al-Fātihah* me një përshkrim të Allahut Më Të Lartësuar si *Rab al-Ālamīn* (i.e., Zoti i këtyre shtat botëve):

﴿الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ﴾

“Falënderimi i takon All-llahut, Zotit të botërave.”

(Kuran, al-Fāt ihah, 1:2)

Atë që tregon kjo është se në të njëjtën mënyrë si Allahu Më i Lartësuar, është Rab (Zot -Perendi) për njerëzimin në këtë Ālam, poashtu Ai është Rab për ata që ndodhen në të gjitha Ālamūn (shumësi i Ālam) dhe të cilët po ashtu duhet ta adhurojnë atë:

﴿تُسَبِّحُ لَهُ السَّمَوَاتُ السَّبْعُ وَالْأَرْضُ وَمَنْ فِيهِنَّ وَإِنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ وَلَكِنْ لَا تَفْقَهُونَ تَسْبِيحَهُمْ إِنَّهُ كَانَ حَلِيمًا غَفُورًا﴾

“Lartmadhëri të merituar i shprehin Atij shtatë qiejt e toka dhe çka ka në to, e nuk ka asnjë send që nuk e madhëron (nuk i bënë tesbihë), duke i shprehur falënderim Atij, por ju nuk kuptoni atë madhërim të tyre (pse nuk është në gjuhën e tuaj). Ai është i butë dhe fal shumë!

(Kuran, al-Isrā, 17:44)

Në të vërtet Kurani identifikon këto shtatë botë si dimensione të ndryshme të hapësirës dhe kohës. Për shembull e përmend një botë (*Ālam*) me një dimension kohor në të cilin:

- Një ‘ditë’ është sa pesëdhjetë mijë vjetë:

﴿تَعْرُجُ الْمَلَائِكَةُ وَالرُّوحُ إِلَيْهِ فِي يَوْمٍ كَانَ مِقْدَارُهُ خَمْسِينَ أَلْفَ سَنَةٍ﴾

“Atje ngjiten engjëjt dhe shpirti (Xhibrili) në një ditë që zgjatë pesëdhjetë mijë vjet (ose lartësia e atyre shkallëve është pesëdhjetë mijë vjet).”

(Kuran, al- M’ārij, 70:4)

Poashtu e përmend edhe një botë tjetër (Ālam) me një dimension kohor në të cilin:

- Një ‘ditë’ është sa njëmijë vite:

﴿وَيَسْتَعْجِلُونَكَ بِالْعَذَابِ وَلَنْ تُخْلِفَ اللَّهُ وَعْدَهُ وَإِنَّ يَوْمًا
عِنْدَ رَبِّكَ كَأَلْفِ سَنَةٍ مِّمَّا تَعُدُّونَ﴾

“Ata kërkojnë prej teje t’ua ngutësh dënimin, po All-llahu nuk e thyen premtimin e Vet, pse një ditë te Zoti yt, është sa njëmijë vjet, si llogaritni ju.”

(Kuran, al-Hajj, 22:47)

﴿يُدَبِّرُ الْأَمْرَ مِنَ السَّمَاءِ إِلَى الْأَرْضِ ثُمَّ يَعْرُجُ إِلَيْهِ فِي يَوْمٍ
كَانَ مِقْدَارُهُ أَلْفَ سَنَةٍ مِّمَّا تَعُدُّونَ﴾

“Ai është që udhëheq çështjen (e të gjitha krijesave) prej qiellit në tokë, pastaj ajo (çështja) ngritet te Ai në një ditë që sipas llogarisë suaj është sa njëmijë vjet.”

(Kuran, al-Sajda, 32:5)

- Një ditë sa treqind vjetë

Në *Sūrah al-Kahf* Të Kuranit, rëndësia kryesore e kohës në lidhshmëri me tematikën e *Dexhalli*, është theksuar në mënyrë dramatike, kur Allahu Më i Lartësuari deklaroi se Ai i bëri të rinjtë të qëndrojnë në shpellë për shumë vite. Pastaj Ai i zgjoi ata për të vendosur se cili nga ata do të jetë në gjendje ta vlerësojë saktësisht periudhën kohore të qëndrimit të tyre në shpellë. Ata në fakt patën fjetur për treqind vjet, por megjithatë ndiheshin sikur kishin qëndruar aty për një ditë ose pjesë të ditës:

﴿فَضَرَبْنَا عَلَىٰ آذَانِهِمْ فِي الْكَهْفِ سِنِينَ عَدَدًا ثُمَّ
بَعَثْنَاهُمْ لِنَعْلَمَ أَيُّ الْحِزْبَيْنِ أَحْصَىٰ لِمَا لَبِثُوا أَمَدًا﴾

“Ne u vumë mbulojë mbi veshët e tyre (i vumë në gjumë) në shpellë për disa vite me radhë Pastaj ata i zgjuam (prej gjumit) për të parë se cili prej tyre dy grupeve është më preciz në njehësimin e kohës sa qëndruan gjatë.”

(Kuran, al-Kahf, 18:11-12)

﴿ وَكَذَٰلِكَ بَعَثْنَاهُمْ لِيَتَسَاءَلُوا بَيْنَهُمْ ۚ قَالَ قَائِلٌ مِّنْهُمْ كَمْ لَبِثْتُمْ ۖ قَالُوا لَبِثْنَا يَوْمًا أَوْ بَعْضَ يَوْمٍ ۚ قَالُوا رَبُّكُمْ أَعْلَمُ بِمَا لَبِثْتُمْ ۖ ﴾

Ashtu (sikurse i vumë në gjumë) i zgjuam ata që të pyesin njëri-tjetrin (se sa kanë fjetur). Njëri prej tyre foli e tha: "Sa keni ndejur?" Ata thanë: "Kemi ndejur një ditë ose një pjesë të ditës!" Disa thanë: "Zoti juaj e di më së miri se sa keni ndejur. . . ."

(Kuran, al-Kahf, 18:19)

﴿ وَلَبِثُوا فِي كَهْفِهِمْ ثَلَاثَ مِائَةٍ سِنِينَ ۖ وَازْدَادُوا تِسْعًا ۖ ﴾

“(dhe thonin) Ata qëndruan në shpellën e tyre treqind e nëntë vjet.”

(Kuran, al-Kahf, 18:25)

Disa nga djemtë thanë se ata patën qëndruar në shpellë vetëm për një ditë apo pjesë të ditës. Megjithatë, të tjerët mund të dallonin shpirtërisht se ndoshta *koha* e kaluar në shpellë e ka kaluar atë që është sugjeruar nga disa prej shokëve të tyre. Në të vërtetë disa njerëz sugjeruan se të rinjtë kanë fjetur në shpellë për një periudhë aq të gjatë *kohore*, sa *treqind* vjet solare (e barabartë me 309 vjet lunare).

- Një ditë është sa një njëqit vjetë:

Kurani po ashtu ka përshkruar rastin në të cilin një njeri kaloi pranë një ‘qyteti’, i cili ishte si gërmadhë (i.e., Jerusalemi) dhe vrau mendjen në mënyrë skeptike se si mundet Allahu Më i Lartësuar ta ringjallë këtë ‘qytet’. Pas kësaj Allahu e bëri atë të vdesë (metaforikisht) për njëqind vjet dhe pastaj e ringjalli atë për ta pyetur se sa gjatë kishte qëndruar ai aty. Përgjigjja e tij ishte “një ditë apo një pjesë të ditës”:

﴿ أَوْ كَالَّذِي مَرَّ عَلَىٰ قَرْيَةٍ وَهِيَ خَاوِيَةٌ عَلَىٰ عُرُوشِهَا قَالَ أَنِيَ
يُحْيِي هَذِهِ ۚ اللَّهُ بَعْدَ مَوْتِهَا ۚ فَأَمَاتَهُ اللَّهُ مِائَةَ عَامٍ ثُمَّ بَعَثَهُ ۖ
قَالَ كَمْ لَبِثْتَ قَالَ لَبِثْتُ يَوْمًا أَوْ بَعْضَ يَوْمٍ ۚ قَالَ بَلْ لَبِثْتَ
مِائَةَ عَامٍ فَانْظُرْ إِلَىٰ طَعَامِكَ وَشَرَابِكَ لَمْ يَتَسَنَّهْ ۖ وَانْظُرْ إِلَىٰ
حِمَارِكَ وَلِنَجْعَلَكَ ءَايَةً لِلنَّاسِ ۖ وَانْظُرْ إِلَىٰ الْعِظَامِ كَيْفَ
نُنشِزُهَا ثُمَّ نَكْسُوهَا لَحْمًا ۚ فَلَمَّا تَبَيَّنَ لَهُ ۖ قَالَ أَعْلَمُ أَنَّ اللَّهَ
عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ۝﴾

Ose (nuk je i njohur) me shembullin e atij që kaloi pranë një fshati që ishte rrënuar në kulmet e tij, e tha: "Si e ngjallë All-llahu këtë pas shkatërrimit të tij?" e All-llahu e bëri të vdekur atë (pyetësin - Uzejrin) njëqind vjet, pastaj e ringjalli dhe i tha: "Sa qëndrove (i vdekur)?" Ai tha: "Një ditë, ose një pjesë të ditës!" Ai (All-llahu) Tha: "Jo, por ke ndejur (i vdekur) njëqind vjet, shikoje ushqimin dhe pijen tënde si nuk është prishur, e shikoje edhe gomarin tënd (si i janë shkapërderdhur eshtrat). E për të bërë ty argument për njerëzit (bëmë këtë sprovë), shiko se si i kombinojmë eshtrat e pastaj i veshim me mish. E kur iu bë e qartë atij tha: "U binda se me të vërtetë All-llahu ka mundësi për çdo send."

(Kuran, al-Baqarah, 2:259)

Këto shatë dimensionale të ndryshme të hapësirës dhe kohës duket se më shumë bashkekzistojnë pranë njëra-tjetrës, sesa të fillojë e dyta kur e para përfundon:

﴿ الَّذِي خَلَقَ سَبْعَ سَمَوَاتٍ طِبَاقًا ۚ مَا تَرَىٰ فِي خَلْقِ الرَّحْمَنِ
مِن تَفَوتٍ ۚ فَارْجِعِ الْبَصَرَ هَلْ تَرَىٰ مِن فُطُورٍ ۝﴾

Ai është që krijoi shtatë qiej palë mbi palë. Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh ndonjë kontrast, andaj, drejto shikimin se a sheh ndonjë çarje?"

(Kuran, al-Mulk, 67:3)

Ekziston një përshkrim i mrekullueshëm i afërsisë së dimensioneve të ndryshme *kohore pikërisht këtu në tokë*, në po të njëjtin fragment të Kuran-it, të cekur më lart (Kuran, al-Baqarah, 2:259), në të cilin Allahu Më i Lartësuari përmend udhëtarin i cili kalon nëpër Jerusalem, pasi që e ka shkatërruar Babilonia, dhe i cili nuk mundi ta paramendonte se si mund të kthehej prapë në jetë.

Udhëtari ishte bërë të vdesë (gjumi është një formë e vdekjes) për njëqind vjet dhe pastaj i ishte kthyer vetëdija. Sikurse me të rinjtë, po ashtu edhe udhëtari kishin mendimin se kanë qëndruar në atë gjendje për vetëm një ditë ose një pjesë të ditës. Por, Kurani e jep një përshkrim të gjallë të *dy dimensioneve të ndryshme kohore që ekzistojnë pranë njëra-tjetrës në tokë*, kur e përshkruan fatin e gomarit në një dimension *kohor* dhe të ushqimit në tjetrin. Derisa gomari, në dimensionin tonë kohor, ngordhi urie dhe trupi i tij u shpërbë deri në atë masë, sa edhe vetë eshtrat ishin kthyer në pluhur, ushqimi i cili ishte ruajtur në dimensionin tjetër kohor, mbeti i freskët, bile edhe pas njëqind vjetësh. Mësimi nga ky rrëfim është se të dy dimensionet *kohore* ekzistojnë pranë njëra-tjetrës pikërisht këtu në tokë!

Ne e dëshmojmë pikërisht të njëjtin fenomen në kapitullin tjetër të këtij libri, në ngjarjen e të rinjve të cilët u vunë në gjumë në një shpellë dhe fjetën aty për treqind vjet. Analizat tona të kësaj ngjarjeje tregojnë se trupat e tyre po ashtu gjendeshin njëkohësisht në dy dimensione *kohore* gjatë gjumit të tyre në shpellë. Në dimensionin e parë *kohor* trupat e tyre vazhdimisht rrotulloheshin në të majtë dhe në të djathtë, në mënyrë të sinkronizuar me lëvizjen e diellit, i.e., mëngjes dhe mbrëmje. Në dimensionin e dytë *kohor* trupat e tyre nuk paraqitën asnjë shenjë të rritjes së tyre biologjike dhe të plakjes së tyre, pavarësisht nga kalimi i treqind vjetëve.

Dimensionet e ndryshme kohore dhe hapësinore mund të gjenden në *Tibāqa*, i.e., së bashku ose pranë njëra-tjetrës.

Tani ne mund të kuptojmë se si Engjëjt e padukshëm që regjistrojnë veprat, të cilët ekzistojnë në dimension tjetër *kohor* dhe *hapësinor*, mund të jenë gjithmonë prezent në të dyja supet tona, derisa ne jetojmë këtu në tokë dhe si *Xhindet* e padukshëm po ashtu mund të jenë përherë prezentë rreth nesh. Ata janë prezent mes nesh, megjithëse nuk janë prezent në të njëjtin dimension *kohor* dhe *hapësinor* në të cilin ekzistojmë ne. Për këtë arsye ne nuk mund t'i shohim ata. Merre në konsideratë ajetin Kuranor në vazhdim:

﴿يَبْنِيٰٓ ءَادَمَ لَا يَفْتِنَنَّكُمُ الشَّيْطٰنُ كَمَا اَخْرَجَ اٰبَوَيْكُم مِّنَ الْجَنَّةِ يَنْزِعُ عَنْهُمَا لِبَاسَهُمَا لِيُرِيَهُمَا سَوْءَٔتِهِمَا ۚ اِنَّهٗٓ يَرٰكُمْ هُوَ وَقَبِيلُهُ مِّنْ حَيْثُ لَا تَرَوْنَهُمْ ۗ اِنَّا جَعَلْنَا الشَّيَاطِيْنَ اَوْلِيَآءَ لِلَّذِيْنَ لَا يُؤْمِنُوْنَ﴾

O bijtë e Ademit, të mos ju mashtrojë kurrësi shejtani sikurse i nxori prindërit tuaj nga Xhenneti, zhveshi prej tyre petkun e tyre që t'ju dalë në shesh lakuriqësia e tyre. Vërtetë ai dhe shoqëria e tij ju sheh, ndërsa ju nuk e shihni. (i.e ata ju vëzhgojnë juve nga një dimension kohorë dhe hapsinorë përtej vëzhgimit tuaj – nga një botë e padukshme) Ne i kemi bërë shejtanët miq të atyre që nuk besojnë.

(Kuran: al-‘Arāf, 7:27)

Mësimi nga tregimi më lart sa i përket ‘ushqimit’ dhe ‘gomarit’ shtrihet përtej të kuptuarit të dy botëve të kohës që ekzistojnë krahas njëra-tjetrës këtu në tokë. Ushqimi, derisa gjendej akoma në këtë botë kohore, po ashtu është ruajtur në një botë të dytë kohore, në të cilën ka mbetur i freskët përkundër kalimit të treqind viteve. Me fjalë tjera, në këtë rast ka ndodhur një udhëtim ose kalim I vayhdueshëm mes dy botëve të kohës.

E njëjta gjë ka ndodhur në rastin e djelmoshave në shpellë, siç përshkruhet në Suren *Sūrah al-Kahf*. Trupat e tyre fizikisht kanë mbetur në shpellë, në këtë botë kohore, për treqind vjet, derisa janë ruajtur në një dimension tjetër kohor, në të cilin ata kurrë nuk janë plakur. Dhe i njëjti udhëtim ose kalim përmes botëve të ndryshme kohore ka ndodhur në *Isrā* dhe *M’irāzh* të Profetit Muhamed (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*).

Megjithatë, në shqyrtimin e faktit se Profeti (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) është dashur të dërgohej me *Burāk* në Tokën e Shenjtë, në mënyrë që të transportohej më tutje në *Samāwāt*, e bënë të qartë se ky fenomen i udhëtimit mes dimensioneve tjera kohore dhe kohës sonë, ndoshta është i mundur vetëm në Tokën e Shenjtë. Kështu pra, ‘qyteti’ i rrënuar duhet të ketë qenë Jerusalemi dhe ngjarja e mrekullueshme sa i përket gomarit dhe ushqimit ka ndodhur në Tokën e Shenjtë. Shpella në Suren al-Kahf poashtu duhet të ndodhej diku në/apo afër Tokës së Shenjtë. Nga toka e shenjtë Jezui, i Biri i Mejremes (*paqja dhe bekimi i Allahut Më të Lartësuarit qoftë mbi të dy*), është ngritur në *Samawāt*. Dhe kur ai të kthehet nga *Samawāt*, do të jetë në apo diku afër Jerusalemit, ku do të zbresë ai.

Dr Ansāri dhe Koha Evolucionare

Mësues i ynë, bekuar qoftë kujtimi i tij, *Maulāna* Dr. Muhammad Fadlur Rahmān Ansāri (1914 – 1974) e ka interpretuar udhëzimin hyjnor në një mënyrë të ngjashme me *Maulāna* Jalāluddin Rūmī, që ka shpjeguar se përderisa i gjithë krijimi ka filluar me komandën “*Kun*” (Bëhu!), të gjitha gjërat e krijuara kanë vazhduar të zhvillohen përmes etapave të ndryshme në botë të ndryshme. Ai e përshkroi një botë me dritë, në të cilën qeniet e dritës, do me thënë Engjëjt, erdhën në ekzistencë dhe botën e zjarrit, në të cilën erdhën në ekzistencë Xhinët dhe, në fund, botën e baltës nga e cila doli njerëzimi. Si rrjedhojë, ai besoi se ‘*koha*’, si edhe çdo gjë tjetër në krijimin e Allahut, ka evoluar derisa në fund doli në formën të cilën e shohim tani ne.

Ajo që sugjeron ky kapitull, është se evoluimi i *kohës* ka ndodhur në kalimin ose lëvizjen nëpërmes *Samawāt* ose botëve të *kohës*. Dhe posa ta kuptojmë dhe ta pranojmë këtë koncept, atëherë bëhet i mundur interpretimi i Haditthit tejet të rëndësishëm lidhur me jetëgjatësinë e *Dexhallit* në tokë. Ja një shpjegim i Maulānas për kozmologjinë Kuranore në të cilën koha evoluon. Citimi është marrë nga kryevepra e tij prej dy pjesësh, ‘*Themelet e Kuranit dhe Struktura e Shoqërisë Myslimane*’:

“Marrëdhënja e kozmosit me Zotin si Krijuesi i tij, shfaqet në Kuran në dy nivele, i.e., nivelet e al-Amr dhe al-Khalq, — që të dy të caktuara dhe të bashkuara nën Cilësin e Zotit që lidhet me mbajtjen në zemër, të ushqyerit zhvillimit perfeksionimit, i.e., *al-Rabb*:

﴿..... أَلَا لَهُ الْخَلْقُ وَالْأَمْرُ تَبَارَكَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ﴾

“. Ja, vetëm Atij i takon krijimi dhe sundimi. I madhëruar është All-llahu, Zoti i botëve..”

(Kuran, al-‘Arāf, 7:54)

Kështu pra, Krijimi filloi me Amr-in e Zotit:

﴿بَدِيعُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَإِذَا قَضَىٰ أَمْرًا فَإِنَّمَا يَقُولُ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ﴾

“Ai është shpikës i qiejve e i tokës (pa kurrfarë modeli të mëparshëm) e kur dëshiron diçka, ai vetëm i thotë: “Bëhu!” në atë moment bëhet. (kështu pra origjina e kozmosit poashtu ka ndodhur si rezultat i Komandës së Allahut ‘Bëhu’).”

(Kuran, al-Baqarah, 2:117)

﴿إِنَّمَا أَمْرُهُ إِذَا أَرَادَ شَيْئًا أَنْ يَقُولَ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ﴾

Amri i tij është (i.e ligji i pruerjesë së diçkaje në ekzistencë) është që “Kur Ai dëshiron ndonjë send, urdhëri i Tij është vetëm t’i thotë: “Bëhu!” Ai menjëherë bëhet.”

(Kuran, Yasin, 36:82)

Kështu pra, etapa e parë në krijimin e kozmosit duhet t'u kontribuohet termeve të 'Ardhjes në Ekzistencë'. Ne po ashtu mund ta thërrasim këtë si etapa e ekzistimit të lehtë, të paprekshëm (përkundër materies së prekshme) dhe pafundësia e hapësirës dhe e kohës.

Duke shikuar procesin e krijimit në prapavijën e konceptit të evolucionit të projektuar në mënyrë të hollësishme në Kuran, ne arrijmë në pikëpamjen e krijimit evolucionar, ku - sikurse hipoteza e evolucionit në Shkencën moderne - ne vijmë në pohimin e 'Atomit të Hershëm' si pikënisje, që funksionoi si bërthamë dhe nga e cila u rrit i tërë kozmosi përmes një procesi evolucionar - bile siç e gjejmë të përmendur edhe në Hadith, e cituar në atë që vjen në faqen xiii (shikoni më poshtë), në të cilën jepet koncepti i krijimit të 'Dritës së Parë të Krijuar që funksionoi si Bërthama'.

Pozita unike që ai e mbanë mes të gjitha krijesave, po ashtu është pohuar në mënyrë të drejtë në Hadithin e raportuar nga Shoqëruesi i Profetit të Shenjtë Jabir dhe është përkrahur si autentik në historinë e Islamit nga autoritetet eminente, mes të cilave mund të përmendet si shembull njëri nga komentuesit klasikë të Kuranit, Allama Alusi (shih Tafsirin e tij klasik, Rūh al-Ma'ani, vol.1, p. 51) është akoma me ndikim:

"Jābir raporton: Unë thashë 'O I dërguar i Allahut! Më informo për atë që Allahu e ka krijuar para të gjitha gjërave (të tjera)'. Ai u përgjigj: Me të vërtetë, Allahu i Plotfuqishmi, para të gjitha gjërave (të tjera), ka krijuar Dritën e rrallë të Profetit, përmes Dritës së Tij" (Cekur në autoritetin e *muhaddith* 'Abd al-Razzāq [paraardhësi eminent i *Imām al-Bukhāriut* dhe autori i *Al-Musannaʿ*] nga Allāma Yusuf b. Ismail al-Nabhāni, te *Al-Anwār al-Muhammadiyyah min Mawāhib al-Ludunniyah*, p. 12, Beirut, 1310 A.H.). Hadithi pastaj vazhdon të na informojë se i tërë universi është krijuar nga Zoti, nga ajo Dritë fillestare, të cilën të ndriturit e Islamit e kanë emërtuar si 'Drita e Muhamedit'.

Sa i përket natyrës së procesit të evolucionit, kjo duhet të kuptohet në natyrën e vet rastit, në kushtet e zvogëlimin progresiv të finesës së gjërave të paprekshme dhe të kualitetit dhe rritjes progresive të konkretizimit, kristalizimit dhe kuantitetit: në bazë të kristalizimit progresiv të al-Khalq, që tregon krijimin e objekteve të reja nga materiali ekzistues. Me fjalët tjera, duhet të ketë filluar një rritje përherë e më e thellë e të shprehurit'. Kjo është ajo çka ne kuptojmë nga Kurani, si dhe nga Shkenca.

Në të vërtetë, në Kuran paraqiten gjëra të ndryshme që kanë dalë në ekzistencë dinamike, faza të ndryshme të procesit evolucionarë. Kështu pra, kanë ekzistuar engjëjt, *xhindët* dhe qeniet njerëzore në atë dimension para-fizik, ose i përkohshëm i ekzistencës; e mes tyre engjëjt dhe xhinët ekzistonin aty para ekzistimit të qenieve njerëzore, siç na e dëshmon Kurani i shenjtë (*Kuran, al-Baqarah, 2:30-34*). Pastaj, sipas asaj që e lexojmë në Librin e Shenjtë në kushte të qarta, njerëzimi ishte bërë që të paraqitet para Zotit në dimensionin e përkohshëm ose para dimensionit të ekzistencës në tokë, për ta pohuar Besëlidhjen e Monoteizmit (*Kuran, al-'Arāf, 7:172*) — që nënkupton se qeniet njerëzore kanë ekzistuar në atë fazë të Krijimit. Ngjashëm, ngjarja e 'Besëlidhjesë së Profetëve' është cekur aty se ka ndodhur në etapën e krijimit (*Kuran, Ale 'Imrān, 3:81*, — që e dëshmon ekzistencën e Profetit në atë kohë.

E tërë kjo do të thotë se Mbretëria e Qenieve dhe Gjërave të Krijuara është vendosur gradualisht në aspektin e natyrës së tyre themelore ose ideore, bile edhe që në fazën e parë të krijimit. Porse evolucioni është dashur të vazhdojë dhe ka vazhduar sipas Planit të Zotit. Megjithatë Allahu i ka caktuar masat ose peshoren e rritjes së të gjitha gjërave:

﴿.....قَدْ جَعَلَ اللَّهُ لِكُلِّ شَيْءٍ قَدْرًا﴾

“All-llahu realizon dëshirën e vet dhe All-llahu çdo gjëje ia ka caktuar kohën (afatin).”

(Kuran, al-Talāq, 65:3)

Si rezultat, disa gjëra që kanë dalë nga mundësia në aktualitet, është dashur të qëndrojnë në gjendjen të cilën e kanë fituar - për shembull, engjëjt; ndërsa të tjerët është dashur të vazhdojnë udhëtimin e zhvillimit dhe në fund të dalin në Ekzistimin e tyre të Rregullit Hapësinor dhe Kohor - për shembull njerëzit.

(‘Themelet e Kuranit dhe Struktura e Shoqërisë Myslimane’, Vol. 2, pp 16-17).

Kozmologjia Kuranore e paraqitur më lart, e shpjegon procesin e krijimit evolucionar. Pra kjo vërteton një evolucion të kohës përmes dimensioneve të ndryshme të saj. Implikimi logjik është se të gjitha krijesat kanë evoluar përmes dimensioneve të ndryshme të kohës, para se përfundimisht të dalin në dimensionin e hapësirës dhe kohës në të cilën ne jetojmë dhe vdesim. Kurani vërteton ekzistimin e shtatë Samawāt të ndryshme që ekzistojnë pranë njëra-tjetrës dhe kjo tregon se shtatë dimensione të ndryshme të kohës janë të paraqitura në mënyrë të njëkohshme, të gjitha me mundësi qasjeje dhe të gjitha me mundësi ndikimi në jetën në tokë:

﴿الَّذِي خَلَقَ سَبْعَ سَمَوَاتٍ طِبَاقًا ۚ مَا تَرَىٰ فِي خَلْقِ الرَّحْمَنِ مِن تَفَوُّتٍ ۚ فَارْجِعِ الْبَصَرَ هَلْ تَرَىٰ مِن فُطُورٍ﴾

“Ai është që krijoi shtatë qiej palë mbi palë. Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh ndonjë kontrast, andaj, drejto shikimin se a sheh ndonjë çarje?”

(Kuran, al-Mulk, 67:3)

﴿أَلَمْ تَرَوْا كَيْفَ خَلَقَ اللَّهُ سَبْعَ سَمَوَاتٍ طِبَاقًا﴾

“A nuk e keni parë se si All-llahu krijoi shtatë palë qiej (në kate).”

(Kuran, Nuh, 71:15)

Kurani ngjashëm vërteton se njerëzimi ka kaluar përmes të njëjtit proces të daljes (në ekzistencë) (ose evolucionit) përmes dimensioneve të ndryshme të hapësirës dhe kohës, derisa kemi dalë në këtë botë:

﴿ فَلَا أُقْسِمُ بِالشَّفَقِ ۝ وَاللَّيْلِ وَمَا وَسَقَ ۝ وَالْقَمَرِ إِذَا اتَّسَقَ ۝ لَتَرْكَبَنَّ طَبَقًا عَن طَبَقٍ ۝ ﴾

“Betohem në kuqërrimin e horizontit pas perëndimit dhe në natën dhe çka ajo tubon Dhe në hënën kur ajo është e plotë Ju patjetër do të përjetoni gjendje pas gjendjeje (i.e., nga një dimension i hapësirës dhe kohës në një dimension tjetër, e pastaj një tjetër, etj., në shtat shresa të krijimit).”

(Kuran, al-Inshiqāq, 84:16-19)

Çdo njeri e përjeton fenomenin e ëndrrës së vërtet – nganjëherë të njohura si ëndrrat profetike – kalimi ose evoluimi i ndodhisë së krijuar përmes këtyre botëve të ndryshme. Ëndrrat që bëhen realitet, japin dëshmi të drejtpërdrejtë që ekziston një botë e jashtëzakonshme. Profeti Muhamed (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) tregoi për ëndrrat dhe vizionet e vërteta (dhe kjo përfshin edhe diturinë e brendshme shpirtërore) se ato do të jenë gjëja e vetme, pjesë e profecisë, që do të ngelin në botë pas tij. Por ato përbëjnë edhe diçka tjetër. Kur besimi në Allahun Më të Lartësuar hyn në zemër, atëherë nga zemra largohen dy gjëra – e që janë frika dhe dëshpërimi dhe zë vendin *shpresa* – *shpresa* për të mira në këtë botë dhe në botën tjetër. Kur një besimtar përjeton vazhdimisht ëndrra të vërteta, atëherë *shpresa* transferohet në gëzim, pasi që ato paraqesin vërtetimin e përmbushjes së *shpresës*:

“Kur të ofrohet koha (e përfundimit të botës), ëndrrat e besimtarëve vështirë se dështojnë të bëhen realitet, dhe ëndrra e një besimtari është një e dyzet e gjashta pjesë e profecisë.”

(Sahīh Bukhārī)

Mënyra e vetme me të cilën një njeri mund ta shpjegojë fenomenin e ëndrrës së vërtetë apo profetike, është se *ngjarjet ekzistojnë para se ato të ndodhin*. Me fjalë të tjera, procesi i krijimit të një ngjarjeje fillon me urdhrin hyjnor *bëhu* dhe pastaj kalon përmes dimensioneve të ndryshme hapësinore dhe kohore, derisa arrin të bëhet si ngjarje e kompletuar në hapësirën dhe kohën e kësaj bote. Kur kjo ngjarje kapet përpara se të ndodhë në këtë botë dhe lajmet për ngjarjen komunikohen në formën e një ëndrre, atëherë ne e përjetojmë fenomenin e një ëndrre të vërtetë apo profetike.

Kështu, një ëndërr e vërtetë mund të shpjegohet vetëm nëse një njeri e pranon ekzistimin e dimensioneve ose botëve të hapësirës dhe kohës, përtej asaj që ne e përjetojmë drejtpërdrejt. Ekziston një *realitet* që është i jashtëzakonshëm (ose shpirtëror). ‘Substanca’ shpirtërore del në ‘formën’ materiale në çdo gjë që ekziston dhe çdo gjë që ndodh. Gjithçka që paraqitet në

‘formën’ materiale, është formësuar si e tillë nga Allahu Më i Lartësuar që të mund të shërbejë si simbol (Āyāt) që do të çojë dhe do e zbulojë ‘substancën’ e saj shpirtërore.

Kështu pra, ngjarja që ndodh në ëndrrën e vërtetë të parashikueshme do të jetë një ngjarje e krijuar nga Allahu Më i Lartësuar, e cila fillimisht ekziston vetëm në dimensionin e ‘substancës’ shpirtërore. Më pas del si ‘formë’ materiale dhe pastaj ëndrra bëhet një realitet.

Duhet të bëhet e qartë se ne nuk mund ta gjejmë fizikisht qiellin ose shtresën e dytë, në pikën ku përfundon qielli ose shtresa e parë, pasi që kjo do ta vendoste qiellin ose shtresën e dytë në të njëjtin dimension hapësinor si të parin. Do të ishte më e rrugës që të kuptojmë të shtatë shtresat me dimensionet e tyre të ndryshme hapësinore dhe *kohore* se si e mbështjellin njëra tjetrën, duke u shkrirë në njëra tjetrën, në vend të një ballafaqimi vertikal hapësinor, i *shtatë* qiejve ose shtresave. Kështu që një njeri nuk ka nevojë për një anije kozmike me të cilën të udhëtojë me vite të tëra drite, para se të kalojë një dimension të hapësirës dhe kohës dhe të hyjë në tjetrin. *Një njeri mund të kalojë nga një dimension kohor në tjetrin për një moment të shpejtë.* As nuk kërkohet ndonjë lëvizje në hapësirë ose në kohën tonë që ta marrim këtë hap. Porse ne mund ta bëjmë këtë sa herë që qëndrojmë në adhurim për ta kryer *Namazin* (faljen) tonë. Kjo i shpjegon të dyja: edhe mrekullinë e Profetit të Bekuar *Isrā* dhe *M’irāj*, kur ai udhëtoi për një moment të shpejtë nga Meka në Jerusalem, edhe përmes të shtatë botëve të jashtëzakonshme të hapësirës dhe kohës, para se të kthehet në Mekë. Kjo po ashtu mund ta shpjegojë edhe fenomenin e ngritjes së Jezuit (*‘alaihi al-Salam*) në qiell dhe pastaj kthimin e tij në këtë dimension të hapësirës dhe kohës, në atë *kohë* kur *Dexhalli* do ta ketë kompletuar misionin e tij. Kur Jezui kthehet në dimensionin tonë kohor, pas më shumë se 2000 vjetësh nga ne, ai nuk do të jetë plakur as edhe për një ditë.

Sūrah al-Fātihah dhe botët e ndryshme të botës.

Profeti i bekuar ka deklaruar se *Sūrah al-Fātihah* ka qenë *Sūrah më madhështore e Kuranit*. Asnjëher më nuk është shpallur në ndonjërin nga librat e zbritur, diçka që mund të krahasohen me të, e që mund t’i shëroj të gjitha sëmundjet.

Merre në konsiderat Hadithin në vijim:

Treguar nga Said Al Mualla: Derisa po falesha, Profeti më thirri por unë nuk iu përgjigja thirrjes së tij. Më vonë ai tha, “O i Dërguar i Allahut, isha duke u falurë.” Ai pyeti, “A nuk nuk ka thënë Allahu: o ju që keni besuar, Përgjigjuni Allahut (duke i bindur ati) dhe të Dërguarit të Tij kur ai ju thërret ju?” (8.24) Ai pastaj pyeti, “A të mos ta mësoj ty *Suren më të rëndësishme në Kuran*?” Ai tha, “I Lavdëruar është Allahu, Zot i botëve. (i.e., *Sūrah al-Fāt* iha) që përbëhet nga shtatë ajete të recituara nga Kurani i Mrekullueshëm që më është dhënë mua.”

(Sahīh Bukhāri)

Abdullah Ibn 'Abbās raportoj se Profeti ka thënë: “Gëzohuni për dy dritat që ju janë sjellë ju e që nuk i janë sjellë asnjë Profeti para jush: *al-Fatihah* dhe ajatet e fundit të *Sūrah al-Baqarah* (2: 284-5).”

(Muslim)

Abū Hurayrah raportoi se Profeti ka thënë: “Pasha Atë në dorën e të Cilit ndodhet shpirti im, asnjë si ajo (i.e., *Sūrah al-Fātihah*) nuk është zbritur në Tevrat e as në Injil e as në Zabūr e as (ndokund tjetër) në Kuran.”. (Tirmīdhī) 'Abd al-Malik Ibn 'Umayr raportoi se Profeti tha se “*Sūrah al-Fātihah* është shërim për çdo sëmundje.”

(Tirmīdhī, Dārimi and Bayhaqī)

Treguar nga Alaqah ibn Sahar at-Tamīmi: Alaqah erdhi tek i dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të) dhe e pranoi Islamin. Ai pastaj u kthye prej tij dhe i kaloi disa njerëz që e mbanin një të çmendur të lidhur me zinxhirë. Njerëzit e tij thanë: Kemi dëgjuar se shoqëruesi i juaj ka sjellë shumë të mira. A keni diçka me të cilën mund ta shëroni atë? Unë pastaj recitova *Sūren al-Fātihah* dhe ai u shërua. Ata më dhanë njëqind dele. Pastaj unë erdha te i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të) dhe e njoftova për këtë. Ai pyeti: a është vetëm kjo? Treguesi, Musaddad, tha në versionin tjetër: a ke thënë diçka tjetër përveç kësaj? Unë thashë Jo. Ai tha: Merri se, pasha jetën time, disa e pranojnë për një zinxhir të pavlerë, porse ti e ke bërë këtë për një të pastër.”

(Sunan Abū Daūd)

Transmetuar nga Abū Saīd: Disa nga shoqëruesit e Profetit shkuan në një udhëtim, derisa arritën disa nga fiset Arabe (natën). Ata më vonë iu kërkuar atyre që t'i trajtonin si mysafirët e tyre, por ata refuzuan. Kryetari i atij fisi më vonë u kafshua nga një gjarpër (ose ishte thumbuar nga një akrep) dhe ata u përpoqën ta shëronin atë, por më kot. Disa prej tyre thanë (të tjerëve): “Asgjë nuk i bëri dobi atij, a do të shkoni tek ata njerëz, të cilët po e kalojnë natën këtu, ndoshta ndonjëri prej tyre ka diçka me të (që mund ta shëroj).” Ata shkuan te shoqëruesit (e Profetit) dhe thanë: “Kryetari ynë është kafshuar nga një gjarpër (ose thumbuar nga një akrep) dhe ne i kemi provuar të gjitha, por nuk na kanë bërë dobi. A keni diçka (që hynë në punë)?” Njëri nga ata u përgjigj: “Po, pasha Allahun, mund të recitoj një Rukje, por pasi që ju keni kundërshtuar që të na pranoni si mysafirë, unë nuk do e recitoj Rukjen për juve, përveç nëse ju na paguani neve për këtë.” Ata u pajtuan që t'ua paguaj atyre një kope delesh. Njëri nga ata pastaj shkoi dhe recitoi (*Sūrah al-Fātihah*): Të gjitha lavdërimet i takojnë Zotit të Botëve. Ai pastaj fryu me frymën e tij mbi kryetarin, i cili pastaj u shërua, sikur të jetë çliruar nga prangat. Ai u ngrit the filloi të ecte dhe nuk tregoi asnjë shenjë të sëmundjes. Ata ua paguan atyre atë për të cilën u morën vesh. Disa nga ata (i.e. shoqëruesit) pastaj sugjeruan që ta ndajnë fitimin mes vete, por ai i cili e kishte kryer recitimi tha: “Mos t'i ndajmë para se të shkojmë te Profeti dhe ti tregojmë atij tërë ngjarjen dhe të marrim urdhrin e tij.”. Kështu ata shkuan te i Dërguari i Allahut dhe ia treguan ngjarjen. I dërguari i Allahut pyeti: “Si e keni mësuar se *Sūrah al-Fātiha* këndohet si Rukje?” Pastaj ai shtoi: “E keni bërë gjënë e duhur. Ndajeni (atë që e keni fituar) dhe ndajeni një pjesë edhe për mua.” Pastaj profeti buzëqeshi.

(Sahīh Bukhārī)

Pikëpamja jonë, e Allahu di më së miri, është se ajo që u tha më lart, tregon se shtat *Āyāt* (rreshtat) e *Sūrah al-Fātihah* kanë mundësinë që shpirtërisht ta transportojnë shërbëtorin e vërtetë të Allahut, bile edhe derisa është në *Namaz*, në shtat dimensionet e hapësirës dhe kohës dhe ta dërgojë shpirtin e tij/saj në një afërsi të veçantë me Allahun Më Të Lartësuarin në botën e pa-kohë. Ky fenomen përbën *Mirazhin* e besimtarëve.

Me fjalë të tjera, udhëtimi shpirtëror (*M'irāj*) fillon në vetë fillimin e *Namazit* me recitimin e *Sures al-Fātihah*. Secili nga shtatë *Āyāt* (rreshtat) e *Sūrah al-Fātihah* mund ta transportojë shpirtërisht besimtarin (e Allahut) përmes njëres nga shtatë *Samawāt* ose dimensioneve të hapësirës dhe kohës, derisa të recitohet / thuhet *Amini*, ai arrin shpirtërisht te

‘Arshi’. Ai pastaj do të jetë në prezencën e veçantë të Allahut Më të Lartësuarit dhe pjesa tjetër e *Rekatit* (ose ciklit të faljes) do të kryhet në prezencën e veçantë hyjnore.

Kjo ndoshta e shpjegon se pse i Dërguari i bekuar i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut Më të Lartësuarit qofshin mbi të*) gjithmonë e ka recituar secilin rresht të *Sures al-Fātihah*, veçmas dhe kurrë nuk i ka bashkuar rreshtat së bashku gjatë recitimit. Po ashtu i ka shtuar ata të cilët mendojnë ndryshe që ta pranojnë *Bismallah-un* si rreshtin e parë të *Sūrah al-Fātihah* dhe si rezultat ta pranojnë më tutje domostoshmërinë e leximit të saj me zë në Namaz, së bashku me gjashtë Ajetet e tjera. Tani mund ta përmbyllim me pranimin e shtatë botëve ose dimensioneve të ndryshme kohore në vijim:

1. një ditë sa 50 000 vjet
2. një ditë sa 1 000 vjet
3. një ditë sa 300 vjet
4. një ditë sa 100 vjet
5. një ditë sa një vit
6. një ditë sa një muaj dhe
7. një ditë sa një javë.

Tani më në fund jemi në pozitë që të ekzaminojmë *Hadithin* Enigmatik sa i përket *Dexhallit* dhe jetëgjatësisë së tij në tokë për ‘dyzet’ ditë.

Shfaqja e Dexhallit në Kohë

Askush nuk mund ta shpjegojë tematikën e Kohës së daljes së *Dexhallit*, Mesias së remë (Anti-Krishtit), përveç dhe përderisa nuk arrin që së pari të kuptojë subjektin e ‘kohës’. E kjo ndodhë për shkak se Profeti Muahamed (*paqja dhe bekimi i Allahut Më të Lartësuarit qoftë mbi të*) ka treguar se ‘koha’ është në zemër të misionit të *Dexhallit*, pasi që: “kur ai të lirohet, ai do jetojë në tokë për dyzet ditë – ‘një ditë sa një vit’, ‘një ditë sa një muaj’, ‘një ditë sa një javë’ dhe të gjitha ditët e tij (i.e., të gjitha ditët tjera të tij) si ditët tuaja.”

(Sahīh Muslim)

Tani duhet të jetë mjaft e qartë se *Dexhalli* kalon nëpër tri dimensione të ndryshme të hapësirës dhe kohës, para daljes së tij përfundimtare në formën konkrete në botën tonë, kur do të jemi në gjendje ta shohim atë. Në librin tonë të titulluar ‘*Jerusalemi në Kuran*’ e kemi shpjeguar lokacionin se ku në tokë do të gjendet *Dexhalli* gjatë tri periudhave të jetës së tij, para *kohës* kur ai do të paraqitet në formën e tij fizike në Jerusalem.

Por pyetjet tjera dalin nga kjo:

- Sa e gjatë do të jetë një ditë sa një vit?
- Sa e gjatë do të jetë një ditë sa një muaj?
- Sa e gjatë do të jetë një ditë sa një javë?

Pasi që dimensionet e hapësirës dhe kohës, përveç atyre tonave, nuk mund të vrojtohen normalisht, nuk mund të kemi formulë të përpiktë matematikore përmes së cilës ne mund ta masim ‘një ditë sa një vit’. E as nuk mund të hedhim një vështrim dhe përpjekje racionale të matjes së ‘një dite sa një muaj’ ose ‘të një dite sa një javë’. Por, ne sigurisht e kuptojmë se që të tria periudhat kohore në të cilat Dexhalli kalon tri dimensione të kohës (një ditë sa një vit, një ditë sa një muaj, një javë etj.), janë të atilla që e para është më e gjata, e dyta është më e shkurtër se e para dhe e fundit është më e shkurta. *E vetmja mënyrë për të përcaktuar ose për ta dalluar kalimin e tij nga e para në të dytën dhe në fund në dimensionin e tretë të kohës, para se ai të dalë në botën tonë, është përmes ‘gjurmëve’ të tij. Me këtë dua të them se duhet të vëzhgojmë me kujdes ngjarjet, derisa shpalosen me kalimin e historisë dhe pastaj, me një shfrytëzim të kujdesshëm të Hadithit të Profetit (sallallahu ‘alaihi wa sallam), do të jemi në gjendje ta kuptojmë, bile edhe të parashikojmë kalimin e tij nga ‘dita’ në ‘ditë’.*

Përmes shfrytëzimit të kësaj metode kemi arritur në përfundim se tani *ne gjendemi në momentin e jetës së Dexhallit në tokë dhe të procesit historik, kur ‘një ditë sa një muaj’ është gati të përfundojë dhe ‘një ditë sa një javë’ është gati të fillojë.*

Kur Dexhalli gjendej në një ditë sa një vit, ne kemi vërejtur se ishulli Britanik ka qenë shtabi i tij kryesor dhe Britania u bë shteti sundues në botë. Pastaj kemi vërejtur se kur Dexhalli lëvizti në një ditë sa një muaj, SHBA-ja u bë shtabi i tij kryesor dhe SHBA-ja e trashëgoi nga Britania rolin e shtetit sundues të Botës. Tani ne do të jemi në gjendje që ta kuptojmë se kur të përfundojë ‘një ditë sa një muaj’ dhe të fillojë ‘një ditë sa një javë’, një shtet tjetër e zëvendëson SHBA-në si shteti sundues i botës.

Ky shkrimtar beson, gjatë kohës së këtij shkrimi, se Shteti Euro-Hebreg i Israelit është i gatshëm të bëjë një luftë përmes së cilës do të përpiqet të marrë kontroll të drejtpërdrejtë mbi shumicën e burimeve të naftës që gjendet në dhe përreth lumit Eufrat (i.e., në Iran, Irak, Arabinë Saudite, Kuvajt dhe shtetet e Gjiritit etj.), natyrisht që Britania dhe SHBA-ja do ta ndihmojnë Izraelin në atë sulm.

Profeti Muhamed (sallallahu ‘alaihi wa sallam) i ka profetizuar këto luftëra (i.e., Luftërat Britanike dhe Amerikane në Irak, për të marrë kontrollin naftës së Irakut, dhe luftën e Izraelit, e cila do të ndodhë, kur ka deklaruar:

Treguar nga Abu Huraira: i Dërguari i Allahut tha: “Së shpejti lumi Eufrat do të zbulojë një thesar (sa një bjeshkë) me ar. Kushto do që do të jetë aty në atë kohë, nuk duhet të marrë asgjë nga ai.” Al-A’raj tregoi nga Abu Huraira se Profeti e tha të njëjtën gjë, por ai tha: “Ai (Eufrati) do ta zbulojë një mal me ar (përfundi tij).”

(Sahih Bukhari)

Treguar nga Ubayy ibn Ka'b: E kam dëgjuar të dërguarin e Allahut (paqja qoftë mbi të) të thotë: “Eufrat, së shpejti do ta zbuloj një mal me ar. Kur të dëgjojnë për këtë njerëzit, do të vërshojnë drejt tij, porse njerëzit të cilët do ta kenë atë (thesarin), do të thonë: nëse i lejojmë këta persona që të marrin një pjesë të tij, ata do ta marrin të tërën.” Kështu që ata do të luftojnë dhe nëntëdhjetë e nëntë nga çdo njëqind do të vriten. Abu Kamil në tregimin e tij tha: “Unë dhe Abu Ka'b qëndruam nën hijen e murit mbrojtës të Hasanit.”

(Sahih Muslim)

Unë besoj se profecia për vdekjet masive (99 nga 100) në luftën për të marrë nën kontroll atë mal me ar (të zi), të zbuluar nga lumi Eufrat, mund të kuptohet në numrin marramendës të vdekjeve që veç janë regjistruar se kanë ndodhur në Irak. Megjithatë, Unë besoj se më mirë mund të kuptohet në kontekstin e përdorimit të mundshëm në të ardhmen të këtyre armëve të shkatërrimit në masë, siç janë armët nukleare.

Unë besoj se Izraeli do të shfrytëzojë atë mundësi të kësaj lufte të madhe për ta zgjeruar territorin e tij “nga lumi i Egjiptit deri te lumi Eufrat” dhe kështu do t’i arrijë kufijtë e tij mitik që jepen në Bibël. Unë pres që ajo *kohë* po ashtu të shoqërohet me rëniën e dollarit, ekonomisë dhe pushtetit të Amerikës deri në atë masë, sa që Izraeli do ta zëvendësojë SHBA-në si *shtetin sundues* të botës. Pas të gjithave, një sulm nuklear i Izraelit për të marrë në kontroll naftën, të cilën Profeti i bekuar e përshkroi si “një mal me ar”, do të rezultojë në një ngritje dramatike të çmimit të vajit dhe të arit, sa që do të përshpejtonte shkrirjen e dollarit mashtues. Çmimi i vajit veç është ngritur deri në atë masë, sa që çfarëdo ngritje tjetër dramatike do t’ia jepte Izraelit mundësin për ta mbajtur tërë botën peng të energjisë. Kështu që shantazhi Energjetik do të përdoret nga të ashtuquajturit ‘popull i zgjedhur’ i Zotit, për të themeluar të ashtuquajturin Izraelin e tyre të Shenjtë, si *shtetin sundues* të botës.

Derisa mund të jetë e vërtetë se ky shkrimtar modest është i pari i cili në interpretimin e *Hadithit* lidhur me *Dexhallin* në këtë mënyrë, nuk duhet të zhvlerësojë interpretimin e as nuk duhet të na dobësojë neve për t’i rezistuar shtypjes nga Izraeli. Derisa ngjarjet vazhdojnë të shpalosen, ne me bindje presim që ato ta konfirmojnë interpretimin tonë të profecisë së Profetit të bekuar (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) që gradualisht do t’i japë fitore të vërtetës dhe drejtësisë. Pasi që ky i yni është një opinion, ne duhet ta vendosim interpretimin tonë të simbolizmit fetar në Kuran dhe Hadith nën mbrojtjen e “Allahu di më së miri’.

Më në fund ne mund të llogarisim periudhën *kohore* (duke e përdorur matjen tonë të *kohës*), kur Dexhalli ishte në ‘një ditë sa një vit’ dhe ‘një ditë sa një muaj’ e pastaj do të arrijmë të kuptojmë *kohën* e përafërt që do të kalonte në ‘një ditë sa një javë’, i.e., një periudhë shumë më e shkurtër sesa ‘dita’ e mëparshme. Në fund të ‘një dite sa një javë’ ne mund ta presim lindjen e *Dexhallit* në (hapësirën dhe *kohën*) botën tonë, nga prindër Hebrenj, siç është profetizuar nga Profeti i bekuar (*salallahu ‘alaihi wa sallam*) e që përfundimisht do ta marrë sundimin mbi Izraelin dhe botën, derisa akoma është djalë i ri. Në atë kohë ai do ta shpallë veten e tij se është Mesia. Kur Hebrenjtë e përmbyllin pranimin e pohimit të tij (të rrejshëm), misioni i tij do të jetë përmbyllur me sukses.

Lexuesit ndoshta duan t’u hedhin një sy analizave të paraqitura në librin tonë ‘*Jerusalemi në Kuran*’, në të cilin ne shpjegojmë tri fazat në misionin e *Dexhallit*, të cilat janë të ndërlidhura me tri dimensionet e *kohës* dhe të cilat do të kulmojnë me *sundimin* e tij mbi Botën nga Jerusalemi dhe në mënyrë triumfuese të deklarojë se ai është Mesia i premtuar. Në fazën e parë, që ka zgjatur për një *kohë* të gjatë, një rregull botëror i *Pax Britanikas* ka bërë një luftë të çuditshme koloniale mbi pjesën tjetër të botës dhe me mençuri arriti që përfundimisht ta ‘çliroj’ Tokën e Shenjtë . . .

Pastaj në fazën e dytë të atij plani kryesor – është një etapë e cila është akoma në progres e që do të zgjasë për një periudhë më të shkurtër sesa e para – doli një rregull botror - Pax Amerikana që e zëvendësoi Pax Britanikan e që vazhdoi në mënyrë misterioze ta mbrojë zgjerimin arrogant dhe agresiv të Shtetit Euro-Hebrej me vota të panumërta në Këshillin e sigurimit të OKB-së . . .

E pastaj në etapën e tretë, më të shkurtër dhe të fundit, të planit kryesor, një rregull botërore, Pax Judaika, me një diktaturë universale masonike është gati për ta zëvendësuar Pax Amerikanan . . .

Pika më e rëndësishme që ne e cekim në librin ‘Jerusalemi në Kuran’ është se tani bota gjendet në atë moment *kohor*, kur etapa e dytë e planit kryesor është gati të kulmojë dhe të zëvendësohet me fazën e tretë.

Le të përpiqemi tani që t’i përgjigjemi pyetjes bezdisëse që kërkon një shpjegim të *Hadithit* në të cilin profeti i dashur shpjegoi se si duhet të falemi në *ditën e Dexhallit që është sa një vit, në ditën sa një muaj dhe ditën sa një javë*. Ai deklaroi se ne duhet të llogarisim kohën për pesë faljet (namazet) ditore:

An-Nawwas ibn Sam'an tregoi: I dërguari i Allahut (*paqja qoftë mbi të*) e përmendi *Dexhallin* një ditë në mëngjes. Ai nganjëherë e përshkruante atë si të parëndësishëm dhe nganjëherë e përshkruante (trazirat e tij) si shumë të rëndësishme (dhe ne ndiheshim), sikur ai të ishte nën hijen e drunjve të palmës (së hurmes)... Ne pyetëm: “O i Dërguari i Allahut (*paqja qoftë mbi të*), sa gjatë do të qëndrojë ai (*Dexhalli*) në Tokë?” Ai tha: “Katër ditë, një ditë sa një vit, një ditë sa një muaj, një ditë sa një javë dhe ditët e tjera të tij do të jenë si ditët tona.” Ne pyetëm: “I dërguar i Allahut (*paqja qoftë mbi të*), a do të mjaftojë falja e një dite për faljet e ditës që është e barabartë me një vit?” Ai pastaj u përgjigj: “Jo, por ju duhet bëni një llogaritje të kohës (dhe pastaj të kryeni faljen)...”

(Sahih Muslim)

Pasi që Allahu Më i Lartësuar e krijoi tokën, Ai vazhdoi të krijojë shtatë botë të tjera të hapësirës dhe kohës (*saba'a samawāt*), të ndryshme nga bota jonë. Këto botë ekzistojnë mes kësaj bote dhe *Arshit* të Allahut.

Kur *Dexhalli* të lirohet, tha Profeti i bekuar (*paqja qoftë mbi të*), ai do të jetojë në tokë derisa të kalojë nëpër tri dimensione të ndryshme të hapësirës dhe kohës. Në fund të këtij rrugëtimi përmes këtyre tri dimensioneve, ai do të lindë në këtë botë të hapësirës dhe kohës dhe pastaj dita e tij do të jetë si dita jonë.

Nëse një Mysliman do të udhëtonte dhe të hynte në ndonjërin nga këto *Saba'ah Samawāt* (i.e., shtatë dimensionet e hapësirës dhe kohës), siç bëri edhe Profeti i bekuar (*paqja qoftë mbi të*) në *Mirazh*, atëherë ai duhet të llogarisë kohët e *Namazit* në secilën *Samā* (i.e., secilin dimension të hapësirës dhe kohës). E njëjta është e vërtetë edhe për kryerjen e namazit në varr. Profeti i bekuar e ka përmendur mundësin e namazit në varrë:

Tregoi Anas ibn Malik: I dërguari i Allahut (*paqja qoftë mbi të*) tha: “rastisi që të kaloj pranë Muses, në rastin e Udhëtimit të Natës, afër kodrës së kuqe dhe e gjeta atë duke e falur Namazin e tij në varrin e tij.”

(Sahih Muslim)

Tregoi Jabir ibn Abdullah: I dërguari i Allahut (*paqja qoftë mbi të*) tha: “Kur të varroset trupi i vdekur në varr, para tij paraqitet (pamja e) perëndimi i diellit. Ai pastaj ulet i fërkon sytë e tij dhe thotë: Më lini ta kryej faljen time.”

(Sunan Ibn Mājah)

Profeti Muhamed, plani kryesor dhe 666

Unë besoj se profeti Muhamed i ka profetizuar ato tri etapa të planit kryesor (ky është sistemi përfundimtar i sistemit botëror), përmes të cilit *Dexhalli* (Mesia i rremë, Anti-Krishti) përfundimisht do ta përmbushë misionin e tij për t’u shtirë si Mesia i vërtetë e kështu të sundojë botën nga shteti mashtrues i Izraelit në Tokën e Shenjtë. Profeti tha “kur *Dexhalli* të lirohet, ai do të jetojë në tokë për dyzet vjet - një ditë sa një vit - një ditë sa një muaj - një ditë sa një javë dhe të gjitha ditët e tjera (i.e., të gjitha ditët e tij të mbetura) sa ditët tuaja” (Sahih Muslim). Ai po ashtu profetizoi, e që u bë i njohur si Hadithi i Tamīm Dāri, se një ishull i cili është i specializuar në spiunazh dhe që ndodhej një muaj udhëtim në det nga Arabia, do të jetë baza fillestare e *Dexhallit*, i.e., në etapën e parë të misionit të tij e që do të zgjasë për ‘një ditë sa një vit’. Unë besoj se ky ishull nuk ka mundur të jetë asnjë tjetër përveç se Britania!

Bibla e shpjegon po këtë proces prej tri etapash, që do të kulmojë me sistemin e ri monetar ndërkombëtar të parasë elektronike dhe me Anti-Krishtin që do ta *sundojë* botën nga Jerusalemi. E këtë e ka bërë kur ka deklaruar:

“... dhe ai i bën të gjithë, edhe të vegjlit edhe të mëdhenjtë, të pasurit dhe të varfrit, të lirët dhe të robëruarit, që të marrin një shenjë në dorën e tyre të djathtë, ose në ballin e tyre dhe se asnjë njeri nuk mund të blejë apo të shesë, përveç atij që e ka shenjën, ose emrin e bishës ose numrin e emrit të tij. Këtu ka mençuri. Ai që kupton le të llogarisë numrin e bishës, sepse është numri i një njeriu dhe numri i tij është gjashtëqind, tri herë, dhe gjashtë” (Bibla - Revelata: 13:16-18).

Kur shpjegohet simbolizmi fetar i Biblës, ai zbulon se numri ‘*gjashtëqind*’ në lidhje me Anti-Krishtin i referohet etapës së parë të planit madhor që zgjati për një *kohë* të gjatë dhe ka dëshmuar daljen e shtetit të parë sundues në periudhën e historisë Post-Biblike dhe të *Pax Britanikës*. Numri ‘*trefish*’ i referohet etapës së dytë dhe të tanishme që do zgjasë për një periudhë më të shkurtër *kohore* dhe dëshmon daljen e shtetit të dytë *sundues të botës* dhe të *Pax Amerikana*. Dhe më në fund numri ‘*gjashtë*’ i referohet etapës së tretë dhe të fundit të planit madhor me anë të të cilit Anti-Krishti përfundimisht e përmbush misionin e tij dhe del në formën njerëzore për të *sunduar* botën nga Jerusalemi dhe prej një shteti sundues mashtrues të Shtetit të Izraelit me *Pax Judaika*. Tipari më i dalluar i shpalosjes së planit madhor që nga fillimi i tij me kryqëzatat Euro-Krishtere, kanë qenë pafeja e tyre, dekadencia, mashtrimi dhe shtypja barbare.

KAPITULLI TRE SŪRJA DHE SYNETI

Në përpjekje për të caktuar Synetin (i.e., mënyrën apo shembullin) e Profetit Muhamed (*paqja dhe bekimi i Allahut Më të Lartësuarit qoftë mbi të*) që lidhet me Suren Al-Kahf të Kuranit (Kapitulli 18 i quajtur 'Shpella'), ne i ekzaminojmë dy incidente të cilat kanë ndodhur gjatë jetës së Profetit të bekuar e që u kanë ndodhur shoqëruesve të tij.

Incidenti i parë

Ne e mësojmë nga ngjarja e parë që Profeti i bekuar (*sallallahu 'alaihi wa sallam*) e urdhëroi njërin nga shoqëruesit e tij, Abbād ibn Bishr (*Allahu qoftë i kënaqur me të*), që ta mësojë përmendësh tërë Suren.

Nëse Profeti (*sallallahu 'alaihi wa sallam*) i dha një urdhër të tillë qoftë edhe një shoqëruesi të vetëm, atëherë mësimi përmendësh i kësaj *Sure* duhet të kuptohet si *Synet* i profetit. Është shpresa dhe lutja jonë e zjarrtë, që ky tregim i veçantë do t'i inkurajojë lexuesit tonë që me kënaqësi ta përqafojnë këtë *Synet*, i.e., që të bëjnë çdo përpjekje për të mësuar përmendësh të tërë Suren al-khaf dhe pastaj ta recitojnë atë sa më shpesh që është e mundur në Salāt (i.e., namaz). Ja tregimin e asaj ngjarjeje që i ndodhi Abbād ibn Bishr:

“Abbād me qetësi e hoqi shigjetën nga trupi i tij dhe vazhdoi me recitimin e tij, akoma i zhytur në Namazin e tij. Sulmuesi e gjuajti me shigjetën e dytë dhe të tretë e që të dyja po ashtu e goditën shenjën. Abbād e nxori njërën dhe pastaj tjetrën. Ai përfundoi recitimin e tij, bëri Rukū (përkuljen) dhe pastaj Sexhde (përlulja për toke). I dobët dhe me dhimbje e zgjati dorën e djathtë derisa ishte akoma në përlulje dhe e tundi shoqëruesin e tij. 'Ammari u zgjua. Në qetësi, 'Abbād e vazhdoi Namazin e tij deri në përfundim dhe pastaj tha,

Zgjohu dhe bëj roje në vendin tim! Jam plagosur.”

'Ammāri kërceu dhe filloi të bërtasë. Duke i parë ata dy, sulmuesi u largua në errësirë. 'Ammari u kthye kah 'Abbādi, derisa ai u shtri në tokë, gjaku i rridhte nga plagët e tij.

“Ya Subhānallah (Lavdia i qoftë Allahut)! Pse nuk më zgjove, kur u godite nga shigjeta e parë?”

“Isha në mes të recitimit të ajeteve Kuranore që ma mbushin shpirtin me frikë e me nder dhe nuk desha që ta shkërtoj recitimin. Profeti (*paqja dhe bekimi i Allahut Më të Lartësuarit qoftë mbi të*) më ka urdhëruar që ta mësoj këtë *Sure* (i.e., Sūrah al-Kahf) përmendësh. Kështu që vdekja do të ishte më e lehtë për mua, sesa ta ndërprisja recitimin e kësaj *Sure*”, iu përgjigj 'Abbadi shoqëruesit të tij.

Khalid Muhammad Khalid, 'Rijāl hawla al-Rasūl'; publikoi në
'Njerëzit rreth të Dërguarit', Trusti i Librave Islamike,
Kuala Lumpur (www.ibtbooks.com). 2005 p. 440,

Nëse Profeti i bekuar e ka urdhëruar njërin nga shoqëruesit e tij që ta mësojë përmendësh një *Sure* të Kuranit, nuk do të thotë se ajo është e domosdoshme për të gjithë Myslimanët që ta bëjnë të njëjtën gjë, por u bë *Synet*. Nga ajo që u tha më lart dhe ajo që vijmë në përfundim se mësimi përmendësh i *Sures al-Kahf* është *Synet*. Dhe kushdo që e kryen një vepër që është *Synet* e që Allahu e pranon, do të marrë shpërblim për atë.

Ky shkrimtar ishte i bekuar që e mësoi përmendësh *Suren al-Kahf* gjatë tërheqjes shpirtërore në *‘Itikaf*, në *Ramazanin* e 1424H, derisa e shkruante këtë libër. Ai ndjeu një gëzim të mrekullueshëm si asgjë tjetër që *Dynjaja* mund të ofrojë, kur ai qëndroi në Namaz dhe për herë të parë e ka recituar të tërë *Suren* në Namaz (falje), duke shkuar hapave të Abbād ibn Bashr. Shkrimtari lutet që ata të cilët e lexojnë këtë libër, të frymëzohen ngjashëm për ta mësuar përmendësh të tërë *Suren* dhe ta recitojnë atë në Namaz *Insha Allah*.

Incidenti i dytë

Incidenti i dytë ka të bëjë me një shoqërues të Profetit dhe recitimin e *Sures al-Kahf* që është marrë nga *Sahīh al-Bukhāri*. *Hadīthi* e përmend një Shoqërues, i cili e ka recituar *Suren al-Kahf* dhe është shpërblyer nga Allahu me një *Sakīna* hyjnore (qetësi që e përqafon zemrën) që u zbrit mbi të në formën e një reje dhe që e frikësoi kalin e tij. *Hadīthi* nuk e bën të qartë, nëse *Sakīna* hyjnore u lëshua si përgjigje e recitimit të kësaj *Sure* të caktuar të Kuranit të bekuar, apo ishte përgjigje ndaj recitimit të vet Kuranit, pa iu referuar *Sures*. Pikëpamja jonë është që të dyja këdo mundësi janë të prezente:

“Treguar nga al-Bara bin Azib: Një njeri ishte duke e recituar *Suren al-Kahf*, derisa kali i tij ishte i lidhur me dy litarë pranë tij. Një re zbriti dhe u shpërnda mbi atë njeri dhe vazhdoi të afrohej përherë e më afër tij, derisa kali i tij filloi të kërcëjë (sikur të ishte frikësuar nga diçka). Kur u bë mëngjesë, ai njeri erdhi te Profeti dhe i tha atij për atë që kishte përjetuar. Profeti tha: Ajo ishte al-Sakīna (paqe dhe qetësi) që zbrit për shkak të recitimit Kuranit.”

(Sahīh al-Bukhāri)

Profeti dhe *Surja al-Kahf*.

Nga tregimet e bukura më lart, kemi ardhur në përfundim se mësimi përmendësh i *Sures al-Kahf* është *Synet*. Në të vërtetë Profeti (*paqja dhe bekimi Allahut Më të Lartësuarit qoftë mbi të*) e përmend se si vetë ai e mësoi përmendësh këtë *Sure*, si në vijim:

“Treguar nga Abdullah: Profeti tha: *Sūraet Banī Isrāīl*, *al-Kahf*, *Maryam*, *Tāhā* dhe *al-Anbiyā* janë *Suret* e vjetra, të cilat i kam mësuar me zemër (përmendësh) dhe janë prona ime e parë..”

(Sahīh al-Bukhāri)

“Treguar nga Abdullah bin Masūd: Profeti tha: *Sūratu Banī Isrāīl*, *al-Kahf*, *Maryam*, *Tāhā*, dhe *al-Anbiyā* janë nga fitimet e mia të para dhe prona ime e vjetër”

(Sahīh al-Bukhāri)

Le të vazhdojmë tani me prezantimin e *Sūres* dhe me deklarinimin e Profetit Muhamed, (*Paqja e Allahut qoftë mbi të*) që është i një rëndësie vitale, se besimtarët duhet ta recitojnë *Suren al-Kahf* çdo të *Jaum al Xhuma* (i.e., e Premte) për *Nūr* (dritë) nga *Surja* dhe mbrojtje nga *Fitnah* (test, mashtrim, sprovë) e *Dexhallit*, i.e., Mesia i Rremë ose Anti-Krishti:

“Tregoi Abū Sa’īd: Profeti tha: Nëse ndonjëri reciton *Suren al-Kahf* në *Jaūm al-Xhum’ah* (i.e., ‘e Premte’ e botës Pagane), një dritë do të shndrisë fort për të deri në *Xhumanë* tjetër.”

(al-Tirmīdhī; Bayhaqi transmetoj në *Kitāb al-Da’wah al-Kabīr*)

“Abu Sa’īd al-Khudri raporton se Profeti tha: Kushdo që e reciton *Sūren al - Kahf* në *Xhuma* (i.e., ‘e Premte’ e botës pagane), do të ketë ndriçim nga drita (e *Sures*) prej një *Xhumaje* në tjetrën.”

(Nasā’i, Baihaqi, Hākim)

Ibn ‘Umar raportoi se Profeti tha: Kushdo që e reciton *Suren al-Kahf* në *Xhuma*, do të bekohet me dritën që do të ngrihet nga këmbët e tij deri në pikë të qiellit. Kjo do të jetë dritë për të në Ditën e Ringjalljes dhe ai do të falet për atë që është mes *Xhumasë*, i.e., ose ditën e faljes, e tubuar *Xhumasë* tjetër.

“(Sayyed Sāqib: ‘Fiqh as-Sunnah’ deklaroj se ky Hadith është i lidhur nag Ibn Mardwīyah me një zgjirë transmetues pa të meta)

Ne preferojmë që ta përdorim *Joum al-Xhuma’ah*’ që ndodhet në Kuranin e bekuar, sesa emrin e ‘Premte’³, për ditën e gjashtë të javës. Përkundër faktit se emri e ‘Premte’ u vendos me aprovimin e një Pape Evropian, prapë se prapë emri mbeti me origjinë pagane. ‘Friday’ vjen nga fjala ‘*Fria*’, zot pagan (i gjinisë femërore), dhe ‘dita’ vjen nga ‘*daeg*’, që do të thotë ditë. Kështu pra fjala ‘Friday’ nënkupton ‘dita e Zojës *Fria*’. Ja se çfarë thotë Enciklopedia Enkarta lidhur me ditën e ‘Premte’:

Friday (Anglo-Saxon frigedaeg; nga Gjermanisht e vjetër *Fria*, një Zote; anglishtja e vjetër *daeg* “day”), emri anglez për ditën e gjashtë të vitit. Kjo ditë është mbajtur si e shenjtë për Venerën, perëndeshën e dashurisë nga romakët, që e thërrisnin dies veneris (“dita e Venerës”). Në gjuhën romake emri i kësaj dite është nxjerrë nga Latinishtja, si dhe në frengjishte *Vendredi*, italishte *Venera* dhe spanjishte *Viernes*. Popujt gjermanikë e mbanin këtë si ditë të shenjtë për perëndeshën e dashurisë Norse *Frigg*, ose *Frija*. Te gjuhët gjermanike, si anglishtja e përdorin variantin nga gjermanishtja e vjetër *friatag* (“dita e *Frijas*”), për ta përcaktuar ditën. Emri hebre për ditën e premte *joum shishi*, do të thotë “dita e gjashtë”. Mes shumë popujve sllavë nuk e njohin si ditën e gjashtë të javës, si evidencë është emri rus *pjatneetza*, ose “dita e pestë.

Kështu pra, jo vetëm që është *Synet* që *Sūrah al-Kahf* të mësohet përmendësh, por po ashtu është *Synet* që të recitohet çdo *Joum aj - Xhuma*. Ne lutemi shumë që të gjithë lexuesit e këtij libri, do të inkurajohen, Insha Allah, që ta ndjekin *Synetin* si në mësimin përmendësh të *Sures* dhe në recitim me kënaqësi të saj, në çdo Ditë të *Xhuma*.

³ Pasi që libri është përkthyer nga gjuha Angleze, në original është emri Friday (e premte), që është tamam emri origjinal që i është dhënë.

Profeti (*paqja dhe mëshira e Allahut Më të Lartësuarit çoftë mbi të*) po ashtu ka thënë se kur një besimtar ballafaqohet me *Dexhallin*, ai duhet të recitojë dhjetë ajetet e para të kësaj *Sure*, para tij, dhe *Dexhalli* nuk do jetë në gjendje t'i bëjë dëm atij ose asaj:

“Abū Darda raportoi se i Dërguari i Allahut tha: Nëse ndonjëri i mëson përmendësh dhjetë ajetet e para të Sures al-Kahf, ai do të jetë i mbrojtur prej *Dexhallit*.” (ne jemi përpjekur në kapitullin pasues të këtij libri që t'i përshkruajmë dhe t'i analizojmë dhjetë ajetet e para të Sures al-Kahf).

(Sahīh Muslim)

“Ai mes jush që do të mbijetojë për ta parë atë (*Dexhallin*), duhet të recitojë para tij ajtet hyrëse të Sures al-Kahf.”

(Sahīh Muslim)

“Treguar nga Abū Darda: I dërguari i Allahut (*paqja qoftë mbi të*) tha: Ai i cili i reciton tri ajetet në fillim të Sures al-Kahf, do të mbrohet nga sprova e *Dexhallit* .”

(Tirmīdhi)

Në shpjegimin e kësaj *Sure* duhet të prezantojmë lexuesin me tematikën (subjektin) e *Dexhallit*, Mesias së rrejshëm ose Anti-Krishti në Islam.

Gjëja e parë që ne e dimë për *Dexhallin*, është ajo që është shpallur me vetë emrin e tij. Profeti (*paqja dhe bekimi i Allahut Më të Lartësuar qoftë mbi të*) e përshkruan atë si al-Masīh al-Dajjāl. Al-Masīh nënkupton ‘Mesian’ dhe *Dexhall* do të thotë ‘mashtroes’. Kështu ai do t'i mashtrojë hebrenjtë në pranimin e tij si Mesia i premtuar, kur në fakt ai do të jetë Mesia i rrejshëm.

Allahu, më i lartësuar, i ka premtuar popullit Izraelit se Ai do të t'ua dërgojë atyre një Profet të veçantë, i cili do të njihet si al-Masīh (Mesiah) dhe i cili do ta sjellë prapë epokën e artë (i.e. kohën e Davidit dhe Solomonit). Kur Shteti i Shenjtë i Izraelit e ka sunduar botën nga Toka e Shenjë, Allahu e përmbushi premtimin e tij duke e dërguar *al-Masīhan* në personin e Jezuit, të birin e Marisë së Virgjër.

Megjithatë, shumica e izraelitëve e mohuan pohimin e Jezuit (*paqja qoftë mbi të*), të jetë Mesia. Mes gjërave të tjera, e përgojuan nënën e tij dhe e konsideruan atë të jetë kopil. Si rrjedhojë, ata nuk e pranonin atë të jetë Mesia. Si pasojë ata e konfirmuan kundërshtimin e tyre, kur konspiruan se e kanë kryqëzuar atë dhe atëherë ata e panë atë të vdiste para syve të tyre, ende pa e sunduar botën nga Jerusalemi. Përveç kësaj, vdekja e tij përmes kryqëzimit e konfirmoi në sytë e tyre, sipas Tevratit, të jetë “i mallkuari i Zotit”.

Pasi që e hoqën qafe dikë që ata konsideruan të jetë Mesia i rremë, ata që nga ajo kohë janë duke pritur që të vijë Mesia i vërtetë, për të përmbushur premtimin Hyjnor.

Si pasojë e mosbesimit dhe kundërshtimit të Jezuit dhe ligësisë së tyre në komplotin për ta vrarë atë, pastaj të shesin mend se si e kemi mbytur atë, Allahu Më i Lartësuar u përgjigj duke e lëshuar në botë një *qenie* të krijuar nga Ai, i.e. *Dexhallin*, Mesian e rrejshëm. Misioni i tij do të

jetë që t'i mashtrojë ata që ta pranonin atë si Mesia të vërtetë. Në proces e sipër ai do t'i udhëheq ata me një mashtrim të plotë drejt rrugës për në ferr. Kështu pra *Sūrah al-Kahf*, *Dexhalli* dhe *Çifutët* janë ndërlidhur ngushtë mes veti.

Çdo prezantim i *Dexhallin* po ashtu duhet të përfshijë prezantimin e koncepteve që ndërlidhen me të e që është lëshim i njëkohshëm në botë i fiseve *Jaxhxuxh* (Gog) dhe *Maxhxuxh* (Magog). Shenja e dhënë në Kuran që e konfirmon lëshimin e tyre po ashtu si shenjë të lidhur me *Çifutët*. Një koncept tjetër i ndërlidhur është edhe ai i daljes së *Imam al-Mahdi*, i cili do ta udhëheq ushtrinë Myslimane, e cila do ta shkatërrojë shtetin mashtrues të Izraelit. Më në fund, tematika nuk mund të adresohet ose të kuptohet, pa e ekzaminuar besimin në kthimin e Jezuit (*paqja qoftë mbi të*). Kthimi i tij do të dëshmojë përfundimin e Judaizmit dhe Krishterimit si fe (religjione) dhe Triumfin e të Vërtetës së Islamit.

Le të ekzaminojmë tani historikun e shpalljes së *Sūraes al-Kahf*, pasi që jep edhe më shumë informacion për *Çifutët*.

KAPITULLI KATËRT

HITORIKU I SHPALLJES SË SURES AL-KAHF

Sfida e Islamit

Që nga koha e Profetit Ishmael dhe me mijëra vjet para lindjes së Profetit Muahamed (*paqja dhe bekimi i Allahut më të Lartësuarit qoftë mbi ata të dy*), Arabët pagan të Arabisë nuk kanë pasur kurrë përvojën që një Profet i Allahut Më të Lartësuarit të jetojë në mesin e tyre. Feja e Abrahimit dhe djalit të tij Ishmaelit (*paqja qoftë mi të gjithë ata*), janë korruptuar e po ashtu Arabët, edhe derisa e adhuronin Allahun, po ashtu adhuronin idhujt në vend të Zotit të vetëm që nuk shihet, Allahut. Kështu ata e pranonin Allahun të jetë njëri nga shumë Zotat që ata i adhuronin. Megjithatë, përkundër kësaj periudhe të gjatë kohore të jetës në egërsi dhe të zbrazët nga shpalljet hyjnore dhe udhëzimit profetik, ata prapë se prapë ishin kapur pas disa pjesëve të ngelura nga feja e vërtetë e Abrahamit.

Për shembull, Abrahami kishte ndërtuar *Qabenë*, Tempullin ose Shtëpinë e Zotit në Mekë, dhe e kishte vendosur *Haxhin* e përvitshëm (pelegrinazhin) te ai tempull ose te ajo Shtëpi e Shenjtë. Të gjithë Arabët e nderuan Tempullin ose Shtëpinë e Shenjtë dhe vazhduan ta kryejnë *Haxhin* për mijëra vite, pasi që Abrahami e kishte caktuar atë. Fisi Kuraish, i cili e kishte prejardhjen prej Ishmailit, njihej nga të gjithë Arabët si kujdestar i Qabesë, e kjo jo vetëm që u dha atyre nder dhe respekt të madh mes Arabëve të tjerë, por po ashtu u përkthye në mënyrë të dukshme në privilegj dhe pasuri (për një përshtetësi të hollësishme me të gjitha pjesët e mbetura të fesë së vërtetë të, fesë së Abrahimit ('*alaihi al-Salām*) që kanë mbijetuar mes Arabëve paganë, shikojeni librin tim me titull '*Feja e Abrahimit dhe shteti i Izraelit - Një pikëpamje Kuranore*').

Papritmas një njeri i cili kishte lindur në fisin *Kurajsh* dhe ishte rritur në mesin e tij, pohoi se ai ishte Profet i Allahut Më të Lartësuarit, sikur Profeti Abraham and Ishmail. Muhamedi

(*paqja dhe bekimi i Allahut Më të Lartësuarit qoftë mbi të*) refuzoi t'i adhuronte idhujt dhe zotat e Arabisë pagane. Ai e paraqiste idhujtarinë dhe politeizmin si të rrejshëm. Ai deklaroi se nuk ka zot pos Allahut, i vetmi Zot i cili nuk shihet e i cili ishte Zoti i Abrahamit, Isakut, Ismailit, Moisiut, Davidit, Solomonit dhe Jezuit (*paqja qoftë mbi ta*). Ai deklaroi se Allahu nuk ka vajzë as djalë dhe se Ai kurrë nuk ka qenë baba i ndonjë djali. Ai kurrë nuk është paraqitur në personin e dikujt (as në Egjiptin e lashtë, Indi, Arabi dhe Bethlehem, e as në Çikago). Allahu nuk është paraqitur kurrë në formën e ndonjë sendi, as në dru, mermer apo gur. Allahu është Zoti i gjithë njerëzimit, qofshin Arabë apo jo Arabë, të bardhë apo të zinj. Ai është Zoti i Mekës dhe i Kuraishëve, si dhe Zoti i të gjitha qyteteve të tjera, të gjitha fiseve të tjera dhe të të gjitha racave të tjera.

Muhamedi (*paqja qoftë mbi të*) pohoi se para Allah-ut të gjithë njerëzit janë “të barabartë siç janë dhëmbët e krehrit”. Ai është Zoti i burrave dhe i grave të lira, si dhe Zot i atyre që janë skllavër. Muhamedi (*paqja qoftë mbi të*) i ka denoncuar të gjitha format e shtypjes, përfshirë këtu shtypjen e të dobët, të varfrit, të huajin ose të panjohurin, skllavin, gratë dhe fëmijët. Ai po ashtu e ka ndaluar vrazhdësinë ndaj kafshëve.

Feja e Islamit të cilën ai e predikonte, sfidoi tërë sistemin e dominimit dhe të shtypjes, në të cilën ishte e bazuar shoqëria arabe. Kështu pra, ishte kërcënim i dukshëm për të vendosur rregull. Islami edhe sot e kësaj dite mbetet sfidë për rregullin Euro-botëror bashkëkohor Judea-Krishter të pafe, korrupsionit, dekadencës dhe shtypjes barbare të pandërprerë. Në fakt, është e vetmja forcë në botë që vazhdon të demonstrojë kapacitetin për të sfiduar shtypjen e fuqishme të Evropës (së bardhë) dhe klientët e tyre të ngjyrosur, të cilët së bashku e kanë themeluar dhe mbajnë Rregullin Euro-botëror të presionit barbar të pashembullt.

Kuraishit ishin të tmerruar me shpalljet dhe predikimet e Muhamedit (*paqja qoftë mbi të*). Ai e sfidoi vetë themelin e rregullit të tyre fetar, shoqëror, ekonomik dhe politik. Në fakt, sfida ishte edhe më e madhe se kaq! Arabia krenohej me arritjet e saj të letërsisë. Edhe pse shumica e arabëve as nuk dinin të lexonin apo të shkruanin, ata e kishin gjuhën shumë të zhvilluar, gjuhën arabe, si dhe e çmonin shumë lart poezinë e pakrahasueshme. I nderonin poetët dhe u jepnin atyre statusin më të lartë në shoqërisë. Kështu pra ishte marramendëse për arabët që prej buzëve të Muhamedit të rrjedhë Kurani (drejtpërdrejt ‘leximi’) që e tejkalonte literaturën dhe shkëlqente si poezia më e mirë që ndonjëherë e kishte përjetuar Arabia. Kurani i sfidoi arabët e dyshimtë në një fushëbetejë, në të cilën atyre ua merrte mendja se ishin më të fortit nga të gjithë dhe e gjetën veten e tyre të paaftë për t’iu përgjigjur kësaj sfide publike. Kurani, po ashtu, e sfidon pjesën tjetër të njerëzimit, të cilët kishin dyshim se ky (Kurani) ishte fjala e një Zoti të vërtetë, për të nxjerrë (shkruar) një kapitull (*Sūrah*) sikur njëra nga to. Kërcënimi i Islamit ishte një kërcënim të cilin arabët paganë kurrë më parë nuk e kishin përjetuar. Ajo ishte një gjendje e vështirë për ta.

Si do t’i përgjigjej Arabia pagane asaj sfide? Çfarë mund të bënin ata? Gjithçka që ata kishin provuar, kishte dështuar për ta ndalur Islamin. Ata u këshilluan mes vete dhe vendosën për të kërkuar ndihmë nga Hebrenjtë që banonin në qytetin verior Yathrib (tani me emrin e ri Medina). Ata i pyetën Rabinjtë: “si mund ta dimë, nëse Muhamedi është në të vërtetë një Profet i vërtetë sikur Abrahami dhe Moisiu?” Si rezultat i përgjigjes së Çifutëve ndaj pyetjes, Allahu Më i Lartësuar i zbriti Suren al-Kahf në Kuran. Vetë Kurani e ka ruajtur këtë lidhje mes Sures dhe misionit në Jathirb, kur i rikujton dy pyetjet e bëra nga Rabinjtë:

﴿وَيَسْأَلُونَكَ عَنِ الذِّكْرِينِ﴾

“Dhe ata (i.e., Rabinjt ë e Jathribit) të pyesin ty (O Muhamed) për Dhul Qarnain”

(Kuran, al-Kahf, 18:83)

﴿وَيَسْأَلُونَكَ عَنِ الرُّوحِ﴾

“Dhe ata (i.e., Rabinjt ë e Jathribit) të pyesin ty (O Muhamed) për Rūh”

(Kuran, Banū Isrāīl, 17.85)

Historia e këti misioni në Jathrib, të cilit do i kthehemi ne tani, shpjegonë lidhshmërin mes *Sūres* dhe Hebrejve

Misioni i çifutëve në Jathrib (Medinë)

. Kuraijshët vendosën që të dërgojnë në Jathrib (tani i riemërtuar si *Madīna al-Nabi* ose shkurt *Medīna*), një qytet rrethë 300 kilometra në veri të Mekës, një delegacion që përbëhej nga al-Nadr bin al-Hārith dhe Uqba bin Abū Mu’ayt, për t’u këshilluar me Rabinjt çifutë. Ata e këshilluan delegacionin si në vijim:

“Pyetni ata për Muhamedin; përshkruajni atyre atë që thotë ai, pasi që ata janë populli i parë që i ushtë zbritur libri dhe kanë dije për Profetët, gjë që ne nuk e kemi.”
(‘Jeta e Muhamedit’ – Përkthimi i Ibn Ishaq *Sīrat Rasūl Allah*. Përkthyer nga A. Guillaume, Oxford University Press, Karachi, 1982. p. 136)

Ka qenë një komunitet i madh çifut në Medinë dhe, siç dihet mirë, çifutët gjithmonë kanë pasur profetë, të cilët kanë jetuar në mesin e tyre. Në të vërtetë Muhamedi (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) pati deklaruar se kurrë nuk ka pasur ndonjë kohë, që nga koha e Moisiut (*‘alaihi al-salām*) deri te koha e Jezuit (*‘alaihi al-salām*), që çifutët të mos kenë pasur një profet që jetonte në mesin e tyre. Kuraishët arsyetuan se pasi që Çifutët kishin një përvojë kaq intime dhe një dituri të gjerë për profetët, ata më së miri do të jenë në gjendje t’iu japin këshilla sa i përket vlefshmërisë së pohimit të Muhamedit (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) për statusin e tij si profet.

Në fakt, Arabia po ashtu e dinte se çifutët kishin imigruar në qytetin arab Jathrib, sepse e prisnin një profet që do të vinte në Jathrib. Në të vërtetë çifutët publikisht proklamnin (bërtisnin nga maja e bjeshkës) për shumë vite: “Po vjen një profet! Po vjen një Profet! Kur të vijë, ai do të jetë profeti ynë. Ai do të na fuqizojë dhe ne do t’i mundim armiqtë tanë.” Shumica e çifutëve po prisnin për ardhjen e një profeti të veçantë, i cili u ishte premtuar atyre në mënyrën yjnore e i cili do të njihej si Mesia (al-Masīh). Kur i panë shenjat shpirtërore se një profet po vinte në botë dhe se ai do të vinte në Jathrib, natyrisht se ata supozuan se ai do të jetë Mesiah. E nëse nuk është Mesiah atëherë ai do të jetë Profet ‘i ngjashëm me Moisiun’, i cili do të vinte nga ‘vëllazëria’ e popullit izraelit, ose do të jetë Elijah (i njohur në Kuran si Iljazi). Njerëzit e tij e kishin

persekutuar Elijan dhe ai në mënyrë misterioze ishte ngjitur në qiell. Si pasojë e ngritën besimin se një ditë Elijah do të kthehet:

“... dhe ndodhi që, kur Zoti do ta marrë Elian lart në qiell me një vorbull ere, ... dhe ndodhi derisa ata flisnin akoma, dhe vini re, ja ndodhi një topth zjarri, dhe kuajt e zjarrit, dhe i ndau ata copë- copë: dhe Elijah shkoi lart në qiell me një vorbull ere.”

(2 Mbretërit: 2-11)

Sipas Malaki, Zoti e ruajti Elijan të gjallë për t’ia besuar atij një mision të lavdishëm në kohën e fundit (iv, 5-6), në periudhën e Dhjatës së Re. Ishte besuar se ky mision menjëherë do të përcillej nga ardhja e Mesias (Matt., xvii, 10, 12; Mark, ix, 11). Delegacioni i Kureishëve iu afrua Rabbitëve çifutë të Jathribit, të cilët gjithashtu prisnin një profet dhe i kishin mënyrat adekuate me të cilat do ta dallonin dhe identifikonin atë. Cili ishte kriteri me të cilin çifutët do ta dallonin Profetin e shumëpritur? Çfarë këshille i dhanë ata delegacionit?

Tri pyetjet

Rabijtë Çifutë të Jathribit i këshilluan Kuraishët që ta pyetnin Muhamedin (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) për tri pyetje:

“Pyeteni atë për tri gjëra, për të cilat ne do t’ju mësojmë juve; nëse ai ju jep juve përgjigjet e drejta, atëherë ai është një profet i vërtet, por, nëse jo, atëherë ai është një mashtrues, kështu që merreni mendimin tuaj për të;

Pyeteni atë se çfarë ndodhi me djelmoshat të cilët u zhdukën në ditët e lashta, sepse ata kanë një ngjarje të mrekullueshme;

Pyeteni atë për udhëtarin e madh, i cili i shkeli kufijtë e skajeve të lindjes dhe perëndimit;

Dhe pyeteni atë se çfarë është shpirti (Rūh).

Nëse ai mund t’ju japë juve përgjigjet, atëherë ndiqeni atë, sepse ai është Profet. Nëse ai nuk mundet, atëherë ai është falsifikues dhe trajtojeni atë si të keni dëshirë.

“(Ibn Ishaq, ‘Sīrat Rasūl Allah’, Trans. A. Guillaume, Oxford Univ. Press, Karachi, 1967. p. 136)

Rabajtë patjetër duhet të kenë qenë të interesuar për rezultatin e takimit me Muhamedin (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*). Ata vërtet deshën të dinin përgjigjën e tij për tri pyetjet. Ata me siguri që do të ishin befasuar, nëse ai vërtet është profet, pasi që ata besuan se statusi i profetit ishte privilegji i tyre ekskluziv. Ata sot e kësaj dite besojnë se askush pas Abrahamit (*paqja qoftë mbi të*) nuk mund të jetë profetë, përveç nëse është Çifut. E pse kjo kështu?

Edhe pse Ishmaili ishte po ashtu i biri i Abrahamit (*‘alaihi al-Salām*), Tevrati është korruptuar në mënyrë që rrejshëm të pohojnë se ai ishte një “njeri i egër” dhe se ai ishte përjashtuar nga Besëlidhja që Allahu Më i Lartësuar i bëri me farën e Abrahamit (*‘alaihi al-Salām*). Çifutët besojnë në Tevratin e korruptuar të rishkruar dhe kështu e konsideruan si një gjë të pamundur që një profet mund të dalë nga fara e Ishmailit (*‘alaihi al-Salām* - shikojeni librin tonë me titull “*Feja e Abrahamit dhe Shteti i Izraelit – një pikëpamje e re nga Kurani*”). Muhamedi (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) ishte arab dhe kështu ishte pasardhës i Ishmaelit.

Megjithatë, kjo nuk do t'i kishte penguar ata që të tregojnë interesimin e tyre në rezultatet e këtij ballafaqimi. Sidoqoftë, kur Muhamedi (*sallallahu 'alaihi wa sallam*) iu përgjigj pyetjeve, Kureishët duhet të ktheheshin te ata për të zbuluar nëse përgjigjet kanë qenë të vërteta apo gënjeshtër.

Përgjigjet për pyetjet përfundimisht erdhën në Kuran, por për çudi të madhe, një *Hadīth* në *Sahīh Bukhārī* tregon se Rabajt duhet t'i kenë fshehur ato përgjigje nga njerëzit e tyre, pasi që disa prej tyre akoma ishin injorantë sa u përket përgjigjeve. Pas disa vitesh, kur Profeti (*sallallahu 'alaihi wa sallam*) vetë migroi në Medinë, disa çifutë iu afruan dhe ia bënë atij po të tria pyetjet e njëjta (i.e., *Rūh*). Ai u përgjigj duke recituar përgjigjen Kuranore që Allahu Më i Lartësuari e kishte shpallur para disa vitesh. Megjithatë, Hadithi në mënyrë të çuditshme e bëri të duket sikur të ishte shpallur në atë kohë:

“Tregoi Abdullahu: Derisa shkoja së bashku me Profetin përmes gërmadhave të Medinës dhe pasi u mbështet në tubë me degë të palmës së hurmës, disa çifutë kaluan aty pranë. Disa prej tyre u thanë të tjerëve: Pyeteni atë (Profetin) për Rūh (shpirtin). Disa prej tyre thanë se nuk duhet t'ia bëjmë këtë pyetje, sepse ai mund të na japë një përgjigje që mund të na hidhërojë. Por disa prej tyre insistuan të pyesnin dhe kështu njëri prej tyre u ngrit dhe e bëri pyetjen: O Abul-Kāsim! Çfarë është Rūh (shpirti)? Profeti mbeti i qetë. Mendova se po frymëzohej nga aspekti Hyjnor. Kështu që qëndrova derisa kaloi ajo gjendje (derisa po frymëzohej) e Profetit. Profeti pastaj recitoi:

“Dhe të pyesin ata ty (*O Muhamrd*) lidhur me Rūh, Thuaj: Rūh-u është nga Amr (*urdhër*) i Zotit tim. Dhe nga kjo dijeni juve u është dhënë shumë pak” (*Kuran, Banū Isrāīl, 17.85*).

(*Sahīh Bukhārī*)

Ky Hadith i pohuar duket të kualifikohet si disinformim i qëllimshëm, dhe qëllimi i tij duket të jetë për të hutuar. Ibn Ishāq tregoj të njëjtin incident ndryshe. Ai e citon Abdullah ibn Abbās in në që të kenë qënë vetë Rabinjtë çifutë të Jathribit (i.e., Madina) të cilët iu ofruan Profetit pasi që ai arriti në qytet dhe e pyetën atë:

Më është thënë në autoritetin e Ibn Abbas se ai tha, kur i Dërguari erdhi në Medinë, Rabanjtë çifut e pyetën atë: “Kur ti the – dhe ju keni vetëm pak dijeni për të – a e kishe fjalën për neve apo për njerëzit tu?” Ai tha “që të dyja palët”.

(Ibn Ishāq, Op. Cit., p. 139).

Fakti që Rabajtë pyetën Profetin sa i përket përgjigjes së pyetjes lidhur me shpirtin (*Rūh*), konfirmon se shpallja që erdhi me përgjigjen ndaj pyetjes, patën ardhur më përpara te ta, në Medinë, para ardhjes së Profetit në qytet.

Me t'u kthyer në Mekë, delegacioni Kuraish iu afrua Profetit (*sallallahu 'alaihi wa sallam*), ia bënë atij tri pyetjet dhe e sfiduan atë që t'u përgjigjet atyre, nëse ai me të vërtetë është Profet. Profeti pauzoi për një moment dhe pastaj tha se do t'u përgjigjej pyetjeve të nesërmen, porse harroi të thotë ‘Nëse donë Zoti’ (i.e., *Inshā Allah*) (Ibn Ishaq, Op. Cit., p.136).

Ky shkrimtar është i mendimit se Allahu Më i Urti do ta ketë bërë Profetin të harrojë të thotë Inshā Allah dhe si rezultat shprehja Inshā Allah të zërë një vend të rëndësishëm strategjik në tematikën e Sures al-Kahf dhe Kohës Moderne. Çila është rëndësia e kësaj?

Opinionin ynë është se Allahu Më i Urti e drejtoi vëmendjen në ardhjen e një kohe kur terminologjia e shenjtë (ose fetare), siç është *Inshā Allah* (i.e., “nëse Do Zoti”, ose “të Lutem Zot”), do të zhduken nga fjalori që do të përdoret nga gjuha moderne dhe kur të ndodh një gjë e tillë, do të jetë një shenjë përmes së cilës besimtarët do ta dallojnë që ajo kohë do të jetë sprovë më e madhe për njerëzimin. Ky libër paralajmëron se “Inshā Allah” veç është duke u zhdukur shpejt nga fjalori i gjuhës moderne.

Kuraishët iu afruan Muhamedit (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) të nesërmen për të marrë përgjigjet që ai ua kishte premtuar. Ai nuk i kishte përgjigjet, pasi që Engjëlli Gabriel (*‘alaihi al-Salām*) nuk e pati vizituar atë për t’ia dhënë përgjigjet. Kur kjo vazhdoi për disa ditë, u bë çështje e turpërimit për Myslimanët dhe gëzim për Kuraishët. Në të vërtetë u deshën dy javë para se Engjëlli Gabriel (*‘alaihi al-Salām*) më në fund u paraqit dhe Allahu Më i Lartësuar iu përgjigj pyetjeve duke e shpallur Suren al-Kahf. Ibn Ishak komentoi në këtë çështje si në vijim:

“Kjo vonesë i shkaktoi të Dërguarit një dëshpërim të madh, derisa Engjëlli Gabriel i solli atij Kapitullin e Shpellës (Sūrah al-Kahf), në të cilën ai iu afrua atij për dëshpërimin e tij dhe i tregoi atij përgjigjet për pyetjet e tyre, të rinjtë, udhëtarin e madh dhe shpirtin.”

(Ibn Ishāq, op. cit., p. 137)

Përgjigjet për dy pyetje janë në *Suren al-Kahf*. Ndërsa përgjigjja e tretë, sa i përket *Rūh* (i.e., shpirtit), gjendet në *Sūrat Banī Isrāīl* (Chapter 17 of the Kuran).

Maulāna Abul ‘Ala Maudūdī (*rahimahullah*), dijetari eminent i Islamit, e eliminoi pyetjen sa i përket *Rūh* nga tri pyetjet dhe në vend të saj pohoi se e treta nga pyetjet i përkiste dikujt me emrin *Khidr* (*‘alaihi al-Salām*), takimi misterioz i të cilit me Moisiun (*‘alaihi al-Salām*) ishte shpjeguar në *Suren al-Kahf*:

“Kjo Sure ishte zbritur për t’iu përgjigjur tri pyetjeve të cilat politeistët e Mekës, në këshillim me njerëzit e Librit, i bënë Profetit të Shenjtë në mënyrë që ta testonin atë. Këto ishin: Kush qenë ‘Të Fjeturit e Shpellës’? Cila është ngjarja e vërtetë e Khidrit? Çfarë dinë për Dhul Qarnain?”

(Maudūdī, Përkthimi Anglishtes i ‘Tafheem al-Kuran’, “Prezantimi i Sures al-Kahf”.)

Duket se *Maulana* i ditur dëshironte që të tria pyetjet të përgjigjen në *Suren al-Kahf* dhe kjo ndoshta ishte arsyeja se pse ai e përjashtoi pyetjen lidhur me shpirtin (*Rūh*) dhe e zëvendësoi atë me ngjarjen e Moisiut dhe Khidrit (*‘alaihi al-Salām*). Pohimi i *Maulana* Maududit megjithatë është mjaft problematik, pasi që nuk ka pasur aspak të ngjarë se Rabajtë çifutë do të kishin marrë në konsideratë diturinë e ngjarjeve sikur ajo e *Khidrit* (*‘alaihi al - Salām*) të jetë dëshmi për statusin e Profetit Muhamed (paqja çoftë mbi të). Në fund të fundit, *Khidri* (*‘alaihi al-Salām*) dëshmoi se Moisiu (*‘alaihi al- Salām*) i kishte kuptuar gabimisht që të tria ngjarjet e treguara dhe Moisiu (*‘alaihi al-Salām*) trajtohej si Profeti *par excellence* për çifutët. Sikur çifutët ta kishin

trajtuar diturinë e *Khidrit* (*‘alaihi al-Salām*) si dëshmi të statusit të profetit, atëherë ata do të duhej ta gjenin dhe ta ndiqnin Khidrin (*‘alaihi al-Salām*), i cili ishte bekuar me një dituri të brendshme shpirtërore. Por, në vend të kësaj, ata kanë ngulur këmbë në diturinë juridike që vinte nga Tevrati, si kërkesën e tyre bazë për mbijetesë dhe sukses përmes historisë. Ne nuk jemi bindur nga pohimi i *Maulāna Maudūdī*’s në këtë çështje.

Fakti se Allahu Më i Urti zgjodhi t’i vendosë përgjigjet për dy pyetjet në *Suran al-Kahf*, derisa përgjigjen për pyetjen e tretë në *Suren Banī Isrāīl*, tregon se këto dy *Sure* të Kruranit janë të ndërlidhura së bashku dhe duhet të studiohen. Njëra ndihmon në shpjegimin e tjetrës. Ne kemi vërejtur se *Sūrah al-Kahf* duhet të lexohet në çdo *Yoūm al-Jum’ah* (i.e., të Premte), për t’u mbrojtur nga *al-Masīh al-Dexhall*, Mesia i rrejshëm, i cili do të vërë në cak dhe të mashtrojë çifutët dhe t’i udhëheqë ata deri në shkatërrimin e tyre të plotë. Ne po ashtu vërejmë se *Sūrah al-Kahf* ishte shpallur si përgjigje ndaj testit çifut të profecisë që Rabanjtë çifutë iu dhanë Arabëve paganë. Kjo ndodhi si kundërpërgjigje ndaj kërkesës së tyre për një test, i cili do të përcaktonte vlefshmërinë e pohimit të Muhamedit (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) që është profet. Dhe kështu nuk është befasi që Surja *al-Kahf* është e lidhur me këtë Sūreh të Kuran-it që është titulluar në emër të çifutëve. Në fakt, kjo përbën lidhjen e tretë mes *Sūreh al-Kahf* dhe çifutëve.

Rabinët (çifutë) në Medinë patën deklaruar se do ta pranonin Muhamedin (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) si Profet të vërtetë të Zotit të Abrahamit (*‘alaihi al-Salām*), nëse ai saktësisht do t’u përgjigjej tri pyetjeve që ia bënë atij. Vetëm një Profet i vërtetë me një dituri të veçantë do të kishte mundësinë t’i dinte ato. Rabajtë kishin atë Dituri të fshehtë për shkak të lidhjes së gjatë dhe të vazhdueshme të Profetëve, të cilët u kishin ardhur Izraelitëve. Ata ishin të bindur se Muhamedi (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) nuk mund t’u përgjigjej pyetjeve dhe kështu ata nuk panë asnjë mundësi që ata ta pranonin një gjentil⁴ arab analfabet si një Profet të Zotit të Ibrahimit (*‘alaihi al-Salām*).

Një ekzaminim i pyetjeve zbuloi se Rabajt po e testonin Profetin Muhamed (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) dhe se ata nuk ishin të interesuar për përgjigje të thjeshta ndaj pyetjeve që ata i kishin bërë. Porse ata i fshehën (mbuluan) pyetjet e vërteta pas atyre pyetjeve që i kishin bërë. Cilat ishin ato pyetje të vërteta?

Ne besojmë se Rabajt i bënë pyetjet me dredhi me qëllimin për të përcaktuar nëse Profeti Muhamed (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) kishte njohuri për *Dexhallin* dhe për *Jaxhuxh* (Gog) dhe *Maxhuxh* (Magog). Këto ishin qenie të fuqishme dhe të rrezikshme, të cilat i kishte krijuar Allahu Më i Lartësuar dhe të cilat Ai do t’i lëshonte në botë në Epokën e Fundit. Kur Allahu Më i Lartësuar t’i lëshojë këto qenie në botë, Ai do t’i përdorë ato për t’i testuar, si dhe për ta dënuar njerëzimin. Të vetmit që do mund t’u mbijetojnë me sukses atyre testeve dhe sprovave të Epokës së Fundit, do të jenë ata të cilët do të kenë besim në Allahun Më të Lartësuarin dhe në fenë e vërtetë të Abrahamit (*‘alaihi al-Salām*) dhe të cilët me besnikëri e ndjekin Profetin Muhamed (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*). E tërë pjesa tjetër e njerëzimit do të mashtrohet ose, thënë ndryshe, do ta humbë besimin. Dhe përfundimisht shoqëria e pafe globale që do të shpërthej si rezultat i ‘globalizmit’ në Epokën e Fundit, do t’i gëlltis njerëzit e tillë dhe do t’i bartë ata në zjarrin e ferrit. Profeti paralajmëroi se Gog dhe Magog do t’i transformojnë 999 nga çdo 1000 njerëz në

⁴ Që nuk është Çifut

kopje të pafe të vetes së tyre (*Ahlu Jahxuxh wa Mahxhuxh*) dhe se të gjithë ata do të hyjnë në zjarrin e xhehnemit (*Sahīh Bukhāri*).

Në vend që të pyesin drejtpërdrejt për *Dexhallin*, ata pyetën për disa djelmosha të kohës së kaluar, të cilët u larguan në shpellë dhe patën një përvojë të mrekullueshme. Pastaj, në vend të që të pyesnin drejtpërdrejt për *Jahxhuxh dhe Mahxhuxh*, ata pyetën për një udhëtarë të madh i cili udhëtoi të dyja skajet e tokës. Pyetja e tretë që i përkiste *Rūh* (shpirtit), kishte ndryshim strategjik, ndryshe nga dy të parat. Ishte një pyetje e drejtpërdrejtë dhe si e tillë, roli strategjik i saj, duket të ketë qenë, të krijojë huti.

Tri përgjigjet ndaj pyetjeve –

Rūh-u.

Pyetja lidhur me *Rūh* ishte mjaft dredharake. Shpirti njerëzor ose shpirti njihet si *Rūh*. Kështu është edhe *Rūh al-Quddus* ose Engjëlli Gabriel. Më në fund, kur Allah-u deklaroi se Ai i ka fryrë njeriut nga *Rūh-u* i Tij, domethënia e kësaj ishte se Ai po ashtu kishte Shpirt Hyjnor (*Rūh*). Allahu Më i Lartësuar i shpalli përgjigjet ndaj tri pyetjeve në Kuran si në vijim:

﴿وَيَسْأَلُونَكَ عَنِ الرُّوحِ ۖ قُلِ الرُّوحُ مِنْ أَمْرِ رَبِّي وَمَا أُوتِيتُمْ مِنَ
الْعِلْمِ إِلَّا قَلِيلًا﴾

“Të pyesin ty për shpirtin; Thuaj: "Shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit tim, e juve ju është dhënë fort pak dije". (i.e., për këtë tematik).”

(Kuran, Banū Isrāīl, 17:85)

Pasi që pyetja ishte e drejtpërdrejt, ngjashëm ishte edhe përgjigja, e drejtpërdrejtë. Porse të tria mundësitë e cekura më lart, njëkohësisht, janë adresuar në përgjigjen e përmbledhur. Pyetja u përfundoi aty. Kjo përgjigje u arriti çifutëve në Medinë dhe kur vetë Profeti migroi në Medinë, çifutët e pyetën atë për përgjigjen. Ata donin të dinin se kujt i referohej shpallja, kur deklaroi: “dhe vetëm pak keni ju dituri. A ishim ne, çifutët, apo ata, arabët, të cilëve u është dhënë pak dituri? Të dyja palët u përgjigjën: Profeti (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*).

Është domethënëse se përgjigja më lart ishte vendosur me dekret Hyjnor në *Suren Banī Isrāīl* (*Surja* e shtatmbëdhjetë e Kuranit), kurse përgjigjet për dy pyetjet e tjera ishin vendosur prapë me dekret Hyjnor në *Suren* e radhës, i.e., *Sūrah al-Kahf*.

Kështu Urtësia Hyjnore e kupton se kishte një ndryshim strategjik mes pyetjes së parë dhe dy pyetjeve të tjera dhe ua bëri të njohur çifutëve, si dhe gjithë të tjerëve, përmes kësaj mënyre të thjeshtë se e kupton këtë ndryshim strategjik. Cili ishte ndryshimi?

- udhtari i madhë

Kur u *Surja* iu përgjigj pyetjes së dytë, lidhur me udhëtarin e madh, këtë e bëri në mënyrë që menjëherë dhe në mënyrë direkte ta adresojë pyetjen, duke e cekur udhëtarin si *Dhūl Qarnain*. *Surja* jo vetëm që e shpjegoi udhëtimin e tij në lindje dhe në perëndim, por, çuditshëm, vazhdoi që në mënyrë direkte ta adresojë pyetjen e vërtetë, e cila fshihej pas pyetjes së bërë, e që është *Jahxhuxh* (Gog) dhe *Mahxhuxh* (Magog). E këtë e bëri duke e përshkruar një udhëtim të tretë - përkitazi me të cilin Rabajtë kishin heshtur në mënyrë të çuditshme. Është mjaft e qartë se caku i vërtetë i pyetjes ishte Gog dhe Magog, e që janë njëra nga shenjat e mëdha të Ditës së Fundit (*al-Qiyāmah*). Kjo natyrisht është tematikë për të cilën vetëm një Profet mund të ketë dijeni. Pyetja ishte e tillë që iu qas cakut në mënyrë indirekte. Në këtë pikëpamje ndryshonte nga pyetja përkitazi me *Rūh*.

– të rinjët dhe shpella

Sūrah al-Kahf fillon me përgjigjën ndaj pyetjes më lart. Përgjigjja ishte kurdisur në atë mënyrë që iu përgjigj direkt dhe hollësisht pyetjes së veçantë që ishte bërë, por që ishte e tërthortë ndaj pyetjes së vërtetë që ishte fshehur pas saj. Pyetja e vërtetë do të jetë vetëm në një tematikë të tillë, si ajo e Gog dhe Magog, e që vetëm një Profet do ta dinte.

Së dyti, ka shumë të ngjarë se kjo duhet të jetë një tematikë lidhur me shenjat e Ditës së Fundit (*al-Qiyāmah*). Cili mund të jetë caku i vërtetë i pyetjes?

Përgjigjja në *Suren al-Kahf* jep informatat e hollësishme përkitazi me të rinjtë që ikën në shpellë. Megjithatë, edhe pse ka dëshmi të qartë se përgjigjja e kishte përfshirë edhe *Dexhallin*, Mesian e rrejshëm ose Anti-Krishtin, nuk e adreson *Dexhallin* në mënyrë direkte. Për pak sa nuk e përmendi emrin e tij. Rabajtë u lanë ta vrisnin mendjen. Në të vërtetë *Dexhalli* kurrë nuk është përmendur drejtpërdrejt ndokund në Kuran, pasi që qëllimi hyjnor ka qenë që t'i mbaj çifutët në hamendje. Në fakt përgjigjja i është përshtatur pyetjes lidhur me strategjinë e dukshme.

Pas disa vitesh, pasi që Profeti (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) kishte emigruar në Medinë, ai e adresoi tematikën e *Dexhallit* në goxha detaje dhe pastaj i befasoi çifutët duke deklaruar se recitimi i dhjetë *ajeteve* (strofave) të para të *Sures al-Kahf*, do t'u japë besimtarëve mbrojtje nga testet dhe sprovat e tmerrshme të *Dexhallit*. Dhjetë *ajetet* e para, duke përfshirë edhe strofat hyrëse të ngjarjes së djelmoshave dhe shpellës. Profeti Muhamed po ashtu qartazi e përcaktoi faktin se *Dexhalli* do të dalë si çifut dhe se ai veç është lëshuar në botë. Ai e bëri këtë kur ai publikisht e tha dyshimin e tij se një i ri çifut në Medinë (*Ibn Sayyād*) ishte *Dexhalli*.

Duke iu përgjigjur kësaj pyetje, në atë mënyrë që e bëri, Kurani na njoftoi se Ai i cili e ka dhënë një përgjigje të saktë, megjithëse të shkurtër, për pyetjen përkitazi me udhëtarin e madh, po ashtu e dinte cakun e vërtetë të pyetjes përkitazi me djelmoshat dhe shpellën, e që është *Dexhalli*.

Le ta ritheksojmë shkurt dallimin në mes pyetjeve dhe përgjigjeve:

Pyetja e 1^{re}: caku i pyetjes, i.e., *Rūh-u* ose shpirti ishte adresuar direkt, edhe pse është një pyetje hileqare. Në përgjigje Allahu Më i Lartësuar i referohet të dyjave, edhe pyetjes edhe

atyre që e kanë bërë pyetjen: “Dhe ata të pyesin ty sa i përket . . .” Përgjigja është vendosur në *Suren Banū Isrāīl*.

Pyetja e 2^{te}: Caku i pyetjes (Gog dhe Magog) nuk përmendet drejtpërdrejt. Është i fshehur. Kështu pra përgjigja është vendosur në një Sura tjetër, e që është *Sūrah al-Kahf*. Në përgjigje të pyetjes, Allahu Më i Lartësuar i referohet edhe pyetjes edhe atyre që e bëjnë pyetjen: “Dhe ata të pyesin ty sa i përket...”

Edhe pse caku i vërtetë i pyetjes është i fshehur, Allahu Më i Lartësuar zgjedh që të përmend atë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tregojë se caku ishte Gog dhe Magog, lëshimi i të cilëve në botë do të përbënte njërën nga Shenjat e Mëdha të Ditës së Fundit.

Pyetja e 3^{te}: Përgjigja e tretë, sikurse e dyta, është vendosur në *Sūren al- Kahf*. Kjo tregon ngjashmërinë me pyetjen e dytë dhe pangjashmërinë me të parën. Kështu që ne vijmë në përfundim se caku i vërtetë i pyetjes së tretë, sikurse edhe ai i së dytës, është i fshehur. E çfarë mund të jetë tjetër përveç një subjekti të ngjashëm me atë të Gog dhe Magog?

Në përgjigjen e pyetjes së tretë Allahu Më i Lartësuar nuk i referohet as pyetjes e as atyre që e bëjnë pyetjen. Ai nuk thotë: “Dhe ata të pyesin ty sa i përket...” Kjo nuk mund të jetë e rastësishme. Në përgjigjen e pyetjes së tretë Allahu Më i Lartësuar zgjodhi që cakun e pyetjes, i.e., *Daxhallin*, Mesian e rrejshëm ose Anti-Krishtin, ta lërë pa e përmendur. Iu la të Dërguarit të Allahut që ta identifikojë atë cak, kur ai e vendosi lidhjen mes *Sūres al-Kahf* dhe *Dexhallit*, Mesias së rrejshëm ose Anti-Krishtit.

KAPITULLI PESË NGJARJA E DJELMOSHAVE DHE SHPELLËS

“Pyeti ata se çka ndodhi me djelmoshat të cilët u zhdukën në ditët e lashta, sepse ata kanë një ndodhi të mrekullueshme.” Kjo ishte njëra nga tri pyetjet e bëra nga Rabajtë çifutë të Medinës. Ata me bindje i thanë delegacionit Kuraish të Mekës se nëse Muhamedi (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) mund t’u përgjigjet saktësisht tri pyetjeve, atëherë do të konfirmohet se vërtet ai është profet i Zotit të Abrahamit, pasi që vetëm një Profet mund t’u përgjigjet saktësisht këtyre pyetjeve.

Të gjitha përgjigjet ndaj tri pyetjeve janë shpallur në mënyrë hyjnore dhe përgjigja ndaj pyetjes më lart gjendet në ajetet 9 – 25 të *Sures al-Kahf* të Kuranit. Në Vijim e kemi tekstin e arabishtes dhe përkthimin shqip të atyre ajeteve, me komente të shkurtra shpjeguese sipas nevojës, për një kuptim fillestar të tekstit. Ngjarja fillon me ajetin nëntë dhe përfundon me ajetin njëzet e gjashtë. Përkthimi është nga Sherif Ahmeti.⁵ Komenti ynë është në formatin italics⁶:

⁵ Në origjinalin e këtij libri që është në gjuhën angleze, ceket që përkthimi në anglisht nga arabishtja është i Muhamed Asad,

⁶ Komeni i shkrimtrit (Imran Hosein)

Ajeti 9

﴿ أَمْ حَسِبْتَ أَنَّ أَصْحَابَ الْكَهْفِ وَالرَّقِيمِ كَانُوا مِنْ آيَاتِنَا عَجَبًا ﴾

“(E pasi që jeta e kësaj bote është vetëm test) a mos mentove ti (vërtet) se (parabola) ata të vendosirt në shpellë (të cilët tani ne i lidhim me përgjigjenn ndja pyetjes së rabajve çifutë) dhe (përkushtimi të tyre) të Rekimit (të cilin, ata ndoshta e morën me vete në shpellë) mund të shifen si më të çuditshme se ndonjë mesazh (tjetër) i Yni? (Ky Kuran i cili tani po të shpallet ty, është shenjë e madhe!).”

Ajeti 10

﴿ إِذْ أَوْىءَ الْفِتْيَةُ إِلَى الْكَهْفِ فَقَالُوا رَبَّنَا آتِنَا مِنْ لَدُنْكَ رَحْمَةً وَهَيِّئْ لَنَا مِنْ أَمْرِنَا رَشَدًا ﴾

“Kur djelmoshat u strehuan në shpellë e thanë: O Zoti ynë, na dhuro nga ana Jote mëshirë dhe na përgatit udhëzim të drejtë në tërë çështjen tonë (dhe na dhuro neve një rrugëdalje nga kjo provë e jona në të cilë bota e pafë bënë luftë kundër Islamit).”

Ajeti s 11 & 12

﴿ فَضَرَبْنَا عَلَىٰ آذَانِهِمْ فِي الْكَهْفِ سِنِينَ عَدَدًا ﴾ ﴿ ثُمَّ بَعَثْنَاهُمْ لِنَعْلَمَ أَيُّ الْحِزْبَيْنِ أَحْصَىٰ لِمَا لَبِثُوا أَمَدًا ﴾

“Ne u vumë mbulojë mbi veshët e tyre (i vumë në gjumë) në shpellë për disa vite me rradhë. Pastaj ata i zgjuam (prej gjumit) për të parë se cili prej tyre dy grupeve është më preciz në njehësimin e kohës sa qëndruan gjatë. (Në të vërtetë vetë esenca mësimi i cili mësohet në aspektin hyjnorë në këtë tregim, dhe i cili zbulohet në këtë ese, është se ‘koha’ nuk është e thjeshtë dhe një-dimensionale, përkundrazi e komplikuar dhe multidimensionale. Ekziston një lëvizje multi-dimensionale e ‘kohës’ derisa kalon përmes epokave dhe në kalimin e kohës, vetëm ata të cilët

kanë besim te Allahu Më i Lartësuari dhe veprimet e drejta, mbijetojnë; të gjithë përfundojnë në shportën e mbeturinave të historisë. Shih Kuranin ran, al-‘Asr, 103:1-3.)”

Ajete 13-15

﴿ نَحْنُ نَقُصُّ عَلَيْكَ نَبَأَهُم بِالْحَقِّ إِنَّهُمْ فِتْيَةٌ ءَامَنُوا بِرَبِّهِمْ وَزِدْنَاهُمْ هُدًى ۝ وَرَبَطْنَا عَلَىٰ قُلُوبِهِمْ إِذْ قَامُوا فَقَالُوا رَبُّنَا رَبُّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ لَن نَّدْعُوهُ مِنْ دُونِهِ ۚ إِلَهًا لَّقَدْ قُلْنَا إِذَا شَطَطًا ۝ هَؤُلَاءِ قَوْمُنَا اتَّخَذُوا مِنْ دُونِهِ ءَالِهَةً لَّوَلَا يَأْتُونَ عَلَيْهِم بِسُلْطَانٍ بَيِّنٍ ۖ فَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنِ افْتَرَىٰ عَلَى اللَّهِ كَذِبًا ۝﴾

“(Dhe tash) Ne po të rrëfejme saktë çështjen e tyre. Ata ishin disa djelmosha, kishin besuar Zotin e tyre, e Ne atyre edhe më ua shtuam bindjen (si rezultat i mënyrës se si iu përgjigjen ata testit në besimin të tyre që ia bëri bota e cila bënte luftë kundër Islamit) Edhe i forcua zemrat e tyre (i bëme të qëndrueshëm) sa që kur u ngritën i thanë: (njëri tjetrit, i.e., në mënyrë publike në një aktë të kundërshtimit të botës së pafe)”Zoti ynë është Zoti i qiejve e i tokës, nuk adhurojmë ndonjë zot tjetër pos Tij, e Ne atyre edhe më ua shtuam bindjen: (kështu që ata e kundërshtuan sovranitetin e tjetërkujt përveç Allahut). Nëse do e bënim (një gjë të tillë) ne me të vërtet do e thonim një gjë të tmerrshme (me të vërtet se do ishte një blasfemi!) Ky, populli ynë ka besuar zota tjerë pos Tij, pse pra nuk sjellin ndonjë argument të qartë për atë? A ka më mizor se ai që shpif gënjeshtër ndaj All-llahut?; (ose ai që fabrikon një gënjeshtës përkitazi me Allahun duke e dhënë për shembull një urdhër për t’iu nënshtruar autoritetit të shtetit-komëtarë laikë të botës moderne)?

Ajeti 16

﴿ وَإِذِ اعْتَزَلْتُمُوهُمْ وَمَا يَعْبُدُونَ إِلَّا اللَّهَ فَأْوَرْنَا إِلَىٰ الْكَهْفِ يَنْشُرْ لَكُمْ رَبُّكُمْ مِنْ رَحْمَتِهِ ۚ وَيُهَيِّئْ لَكُمْ مِنْ أَمْرِكُمْ مَرْفَقًا ۝﴾

“Derisa jeni izoluar prej tyre dhe prej asaj që adhurojnë ata, pos All-llahut, atëherë strehoni në shpellë, e Zoti juaj ju dhuron nga mëshira e tij e gjerë dhe u lehtëson në çështjen tuaj atë që është në dobinë tuaj. “(Të rinjtë pasatj e këshilluan njëri tjetrin si në vijim: kur të vendosni se është koha për të iku prej tyre, i.e., botës së shirkut, dhe prej tërë asaj që ata e adhurojnë në vend të

Allahut, shkoni në Shpellë për strehim. Allahu do e shtrijë Mirësin e dhe Bekimin e tij mbi ju dhe do jua rregulloj çështjet e juaj me kënaqësi dhe butësi ashtu që ju të keni rehati dhe lehtësim)."

Ajeti 17

﴿وَتَرَى الشَّمْسَ إِذَا طَلَعَتْ تَزْوُرُ عَنْ كَهْفِهِمْ ذَاتَ الْيَمِينِ
وَإِذَا غَرَبَتْ تَقْرِضُهُمْ ذَاتَ الشِّمَالِ وَهُمْ فِي فَجْوَةٍ مِنْهُ ذَٰلِكَ
مِنْ ءَايَاتِ اللَّهِ مَنْ يَهْدِ اللَّهُ فَهُوَ الْمُهْتَدِ وَمَنْ يُضِلِّ فَلَنْ
تَجِدَ لَهُ وَلِيًّا مُّرْشِدًا﴾

"Dhe ti e shihje diellin kur lindte bartej prej shpellës së tyre nga ana e djathtë, e kur perëndonte largohej nga ata nga ana e majtë, e ata ishin në një vend të gjerë të saj. Kjo ishte një nga argumentet e All-llahut. Atë që e udhëzon All-llahu, ai vërtet është udhëzuar, e atë që e humb, ti nuk do të gjejsh për të ndihmës që do ta udhëzonte:."

Ajeti s 18

﴿وَتَحْسَبُهُمْ أَيْقَاظًا وَهُمْ رُقُودٌ وَنُقَلِّبُهُمْ ذَاتَ الْيَمِينِ وَذَاتَ
الشِّمَالِ وَكَلْبُهُمْ بَاسِطٌ ذِرَاعَيْهِ بِالْوَصِيدِ لَوِ اطَّلَعْتَ عَلَيْهِمْ
لَوَلَّيْتَ مِنْهُمْ فِرَارًا وَلَمُلِئْتَ مِنْهُمْ رُعبًا﴾

"Do të mendoje se ata janë të zgjuar, ndërsa ata ishin të fjetur, (do te mendoje se ata janë zgjuarë sepse) e Ne i rotullonim herë në krahun e djathtë e herë në të majtin.

(besimtarët e rinjë kishin vendosur që të marrin me vete një qen për mbrojtje, e ai qen ishte poashtu me ta në shpellë) Qeni i tyre kishte shtrirë këmbët e para pranë hyrjes. Sikur të kishe hasur në ta, do të ishte kthyer duke ikur dhe do të ishte mbushur frikë prej tyre."

Ajeta 19 & 20

﴿ وَكَذَلِكَ بَعَثْنَاهُمْ لِيَتَسَاءَلُوا بَيْنَهُمْ ۚ قَالَ قَائِلٌ مِّنْهُمْ كَمْ لَبِثْتُمْ ۖ قَالُوا لَبِثْنَا يَوْمًا أَوْ بَعْضَ يَوْمٍ ۚ قَالُوا رَبُّكُمْ أَعْلَمُ بِمَا لَبِثْتُمْ فَابْعَثُوا أَحَدَكُمْ بِوَرِقِكُمْ هَذِهِ إِلَى الْمَدِينَةِ فَلْيَنْظُرْ أَيُّهَا أَزْكَى طَعَامًا فَلْيَأْتِكُمْ بِرِزْقٍ مِّنْهُ وَلْيَتَلَطَّفْ وَلَا يُشْعِرَنَّ بِكُمْ أَحَدًا ﴿١٩﴾ ﴾ ﴿ إِنَّهُمْ إِن يَظْهَرُوا عَلَيْكُمْ يَرْجُمُوكُمْ أَوْ يُعِيدُوكُمْ فِي مِلَّتِهِمْ وَلَنْ تُفْلِحُوا إِذَا أَبَدًا ﴾ ﴿٢٠﴾ ﴾

“Ashtu (sikurse i vumë në gjumë) i zgjuam ata që të pyesin njëri-tjetrin (se sa kanë fjetur). Njëri prej tyre foli e tha: "Sa keni ndejur?" Ata thanë: "Kemi ndejur një ditë ose një pjesë të ditës!" që Disa (ata që ishin të bekuar me dituri) thanë: "Zoti juaj e di më së miri se sa keni ndejur, (dhe pasi që ata duhet të jenë uritur shumë thanë) prandaj dërgoni njërin prej jush me këtë argjend (monedhë argjendi) në qytet, e të zgjedhë ushqim më të mirë, e t'ju sjellë atë juve (për ta shuarë urinë) dhe le të ketë shumë kujdes e të mos i japë të kuptojë askujt për ju. Pse, nëse ata (të qytetit) kuptojnë për ju, do t'ju mbysin me gurë, ose do t'ju kthejnë në fenë e tyre, e atëherë kurr nuk keni për të shpëtuar!”

Ajeti 21

﴿ وَكَذَلِكَ أَعْتَرْنَا عَلَيْهِمْ لِيَعْلَمُوا أَن وَعَدَ اللَّهُ حَقٌّ وَأَنَّ السَّاعَةَ لَا رَيْبَ فِيهَا إِذْ يَتَنَزَّعُونَ بَيْنَهُمْ أَمْرُهُمْ ۖ فَقَالُوا ابْنُوا عَلَيْهِم بُنْيَانًا ۖ رَبُّهُمْ أَعْلَمُ بِهِمْ ۚ قَالَ الَّذِينَ غَلَبُوا عَلَىٰ أَمْرِهِمْ لَنَتَّخِذَنَّ عَلَيْهِم مَّسْجِدًا ﴿٢١﴾ ﴾

Dhe në këtë mënyrë ne kemi tërhequr vëmendjen (e njerëzve) ndaj kësaj ngjarje (i.e ngjarjes historike) ashtu që ata të mund ta dinë (me siguri kur flasin për ngjarjen) - kur debatojnë mes

njëri tjetrit për atë se çfarë u ndodhi atyre (*djemve të shpellës*) – se premtimi i Allahut (*për ringjallje dhe për ardhjen e një kohe të ligë dhe të sprovave që do të vijnë i.e., epoka e Fitnes kur do të lirohet Dexhalli*) është i vërtet dhe se nuk ka dyshim për (*ardhjen e*) Orës së Fundit. “Dhe ashtu (sikurse i zgjuam nga gjumi) i zbuluam (t'i shohim njerëzit), e të kuptojnë se premtimi i All-llahut (për ringjallje) është i sigurt dhe se katastrofa e përgjithshme (kijameti) është e padyshimtë. (i zgjuam) Mu atëherë kur ata (populli) bisedonin për çështjen e tyre dhe thanë: "Ndërtonu atyre një ndërtesë (të jetë shenjë). Zoti i tyre di më së miri për ta. E ata që ishin me shumicë thanë: "Do të ndërtojmë gjithqysh në hyrjen e tyre një xhami (*një vend për adhurim*), në përkujtim t tyre. (*prandaj është e lejuar që të ndërtohet një objektë në përkujtim të një shërbëtori të devotshëm të Allahut, bile mund të ndërtohet edhe xhami në emër të një besimtari të tillë*)

Ajeti s 22

﴿ سَيَقُولُونَ ثَلَاثَةٌ رَّابِعُهُمْ كَلْبُهُمْ وَيَقُولُونَ خَمْسَةٌ سَادِسُهُمْ
 كَلْبُهُمْ رَجْمًا بِالْغَيْبِ ۖ وَيَقُولُونَ سَبْعَةٌ وَثَامِنُهُمْ كَلْبُهُمْ ۚ قُلْ
 رَبِّي أَعْلَمُ بِعِدَّتِهِمْ مَا يَعْلَمُهُمْ إِلَّا قَلِيلٌ ۚ فَلَا تُمَارِ فِيهِمْ إِلَّا مِرَاءً
 ظَهَرَ ۖ وَلَا تَتَّبِعْ فِيهِمْ مِّنْهُمْ أَحَدًا ۚ ﴾

(Kurë kjo ngjarje të tregohet nga Rabinjët Çifutë, si dhe nga të tjerët që do të vijën më pasë). Ata, do të thonë: "Ishin tre, i katërti ishte qeni i tyre, dhe thonë: "Ishin pesë, e qeni i tyre ishte i gjashti i tyre", kjo ishte hamendje, po edhe thonë: "Ishin shtatë, e qeni i tyre ishte i teti!" Thuaj: (*atyre kurë dhe nëse të pyesin për këtë çështje*) "Zoti im di më së miri për numrin e tyre, përveç një pakice nuk di kush për ta, (*a ata pakë nuk i përfshinë Rabinjët çifutë të medinës që e kanë bërë pyetjen*) e ti (Muhammed) mos polemizo për numrin e tyre vetëm ashtu në tërësi, dhe askë mos e pyet (*nga treguesit e ndodhive*) për ta (*pasi që ata veçe kanë korruptuar dhe shkatërruar ndodhinë*)."

Ajeti s 23 & 24

وَلَا تَقُولَنَّ لِشَايٍ إِنِّي فَاعِلٌ ذَٰلِكَ غَدًا ﴿٢٣﴾ إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ
وَأَذْكُرَ رَبَّكَ إِذَا نَسِيتَ وَقُلْ عَسَى أَنْ يَهْدِيَنِّي رَبِّي لِأَقْرَبَ مِنْ
هَٰذَا رَشْدًا ﴿٢٤﴾

“Dhe mos thuaj kurrresi për ndonjë çështje: "Unë do të bëj këtë nesër!" Vetëm (nëse i shton): "Në dashtë All-llah!" E kur të harrosh, (për ta bërë një gjë të tillë e që i ka ndodhurë profetit në këtë rastë) përmende Zotin tënd dhe thuaj: "Shpresojë se Zoti im do të më japë udhëzim edhe më të afërt prej këtij"

Ajeti 25

﴿وَلَبِثُوا فِي كَهْفِهِمْ ثَلَاثَ مِائَةٍ سِنِينَ وَازْدَادُوا تِسْعًا﴾ ﴿٢٥﴾

“(dhe thonin) Ata qëndruan në shpellën e tyre treqind e nëntë vjet”: (300 vite solare janë të barabarta me 309 vite hënore).”

Ajeti 26

﴿قُلِ اللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا لَبِثُوا لَهُ غَيْبُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ أَبْصِرْ
بِهِ وَأَسْمِعْ ۚ مَا لَهُمْ مِنْ دُونِهِ مِنْ وَلِيٍّ وَلَا يُشْرِكُ فِي حُكْمِهِ
أَحَدًا﴾ ﴿٢٦﴾

“Thuaj: "All-llahu e di më së miri sa kanë ndejur, Atij i takon fshehtësia e qiejve dhe tokës. Çfarë (i çuditshëm) është të pamët e Tij dhe çfarë është të dëgjuarit e Tij! Pos Tij ata (njerëzit) nuk kanë ndihmëtarë. Në vendimin e Tij nuk mund t'i përzihet askush.. (dhe as që e danë autoritetin e tij suprem em ndokënd!)”

(Kuran, al-Kahf, 9-26)

Kjo përgjigje e Sures *al-Kahf*, përkitazi me djelmoshat u ishte transmetuar Rabajve në Medin. Që nga ajo ditë e sotë më shumë se 1400 vite kanë kaluar, por me aq sa dimë ne dijetarët Çifut akoma nuk kanë dhënë ndonjë koment lidhur me përgjigjet.

Ky libër zgjeron ftesën në tërë botën e diturisë çifute për tu përgjigjur lidhurë me përgjigjet ndaj pyetjeve të tyre të dhëna në Suren al-Kahf të Kuranit.

Përmbledhja e ngjarjes dhe domedhënja për kohën (epokën) tonë.

Muhammad Asad ka komentuar mbi këtë Sure dhe komentet e tij shpallin një kuptim të thellë në thelbin e vet Sures, si dhe të ngjarjes së djelmoshave të shpellës. Ne e citojmë atë në tërësi, në mënyrë që lexuesit tanë të cilët nuk janë të njoftuar me punën e tij të madhe, do të prezantohen me të dhe mund të përfitojnë jo vetëm prej komenteve të tij, por, po ashtu, edhe nga i gjithë përkthimi:

Kjo Sūrah - e shpallur menjëherë para al-Nahl (Bleta,) i.e., në vitet e fundit të periudhës së Mekës - gati tërësisht i është dedikuar një serie të parabolave ose alegorive të ndërtuara përreth tematikës së besimit në Allah-un Më të Lartësuarin, kundrejt lidhjes së tepruar për jetën e kësaj bote; dhe fraza kryesore në tërë suren është deklaruar në ajetin 7, *"Gjithçka që është mbi tokë, Ne e bëmë stoli të saj, për t'i provuar ata se cili prej tyre do të jetë më vepërmirë"* - një ide e cila është formuluar më së qarti në parabolën e njeriut të pastër dhe njeriut të varfër (vs. 32-44).

Ngjarja e njerëzve të Shpellës - prej së cilës e merr titullin kjo Sūrah - ilustron (në ajetin 13-20) *parimin e braktisjes së botës për hir të besimit* dhe zhytet në alegorinë e vdekjes, ringjalljes dhe zgjimit shpirtëror. Në ngjarjen e Moisiut dhe të sherbelit pa emër (ajetet 60-82), tema e zgjimit shpirtëror kalon nëpër ndryshim të dukshëm: bartet në fushën e jetës intelektuale të njeriut dhe hulumtimin e tij për të vërtetën e plotë. *Paraqitja dhe realiteti duken të jenë krejtësisht të ndryshme - aq të ndryshme, saqë vetëm një dituri e brendshme mistike mund të na zbulojë ne atë se çfarë është ajo që duket dhe çfarë është e vërteta.* Dhe më në fund alegoria e *Dhu al-Karnain*, "Ai me Dy Brirë", na tregon ne se largimi nga bota nuk është në vetvete një plotësim i Besimit të dikujt në Allahun Më të Lartësuarin; me fjalë të tjera, jeta e kësaj bote dhe pushteti nuk duhet të jenë në konflikt me drejtësinë shpirtërore, përderisa ne mbesim të vetëdijshëm për natyrën kalimtare të të gjitha punëve të njeriut dhe përgjegjësinë tonë të plotë ndaj Atij i Cili është Mbi të gjitha kufizimet e kohës dhe dukjes. Dhe kështu Sūrah përfundon me fjalët: "kështu, kushdo që kërkon të takohet me Furnizuesin e tij, le të bëjë vepra të mira dhe të mos të përziej askënd dhe asgjë në adhurimin e Furnizuesit të tij.

... Sa u përket njerëzve në shpellë: Njerëzit e Shpellës ashtu siç janë, shumica e komentuesve prirën që ta shohin atë si një fazë kohore në historinë e Krishterimit të hershëm - e që është persekutimi i të Krishterëve nga Preandori Decius, në shekullin e tretë. Legjenda thoshte se disa të rinj të Krishterë nga Efesusi, të shoqëruar nga qeni i tyre, u tërhoqën në një shpellë të veçuar, në mënyrë që të jenë në gjendje të jetojnë në pajtueshmëri me besimin e tyre, dhe mrekullisht mbetën aty në gjumë, për një kohë shumë të gjatë (sipas disa llogaritjeve që referohen në ajetin 25 të kësaj Sure, rreth tre shekuj). Kur më në fund u zgjuan - pa pasur dijeni për kohën e gjatë në të cilën ata kishin fjetur - ata dërguan njërin nga shokët e tyre në qytet, për të blerë pak ushqim. Në ndërkohë, situata kishte ndryshuar tërësisht: Krishterimi nuk persekutohej më, bile ishte religjioni zyrtar i Perandorisë Romake. Monedha e lashtë (që datonte nga pushteti i Deciusit) me të cilën djaloshi donte të paguante për gjërat që kishte blerë, menjëherë e zgjoi kureshtjen; njerëzit filluan ta pyesnin këtë të huaj dhe kështu ndodhia e Njerëzve të Shpellës dhe gjumi i tyre i mrekullueshëm doli në dritë.

Siç edhe u përmend, shumica e komentuesve të hershëm u mbështetën në legjendën e Krishterë, në përpjekjen e tyre për ta interpretuar këtë referim të Kuranit (në ajetet 9, 26) për Njerëzit e Shpellës. Megjithatë, duket se formulimi i Krishterë për këtë temë ka pasur një zhvillim të mëvonshëm të një tradite gojore shumë më të vjetër - një traditë e cila në fakt kthehet prapa në burime çifute para të Krishtera. Kjo është e dukshme në disa hadithe të vërtetuara mirë (të përmendura nga të gjithë komentuesit e hershëm), sipas të cilave ishin rabajtë (Ahbār) çifutë të Medinës ata të cilët i nxitën kundërshtarët e Muhamedit në Mekë për ta “testuar vërtetësinë e tij”, duke i kërkuar atij që të shpjegojë, mes çështjeve të tjera, ngjarjen e Njerëzve të Shpellës. Duke iu referuar këtij hadithi, Ibn Kathīr thekson në komentimin e tij për ajetin 13 të kësaj Sure: “Është thënë se ata ishin përkrahës të Jezuit, të birit të Maries, por Allahu e di më së miri; është mjaft e qartë se ata jetuan shumë më herët, sesa periudha e Krishterë - sepse po të kishin qenë të Krishterë, pse duhej që Rabajtë çifutë ta ruanin qëllimisht ngjarjen e tyre, duke parë që çifutët i kishin ndërprerë të gjitha komunikimet shoqërore me ta (i.e. të Krishterët).” Prandaj ne mund të supozojmë të sigurt se legjenda e Njerëzve të Shpellës është zhveshur nga rroba e Krishterë dhe nga historiku i veshur i Krishterë - dukshëm ka origjinë çifute. Nëse e shpërfillim këtë shtojcë (false) të mëvonshme dhe e zvogëlojmë ngjarjen në themelet e saj - tërheqja vullnetare nga bota, “gjumi” i gjatë sa një epokë, një shpellë e veçuar dhe një “zgjim” i mrekullueshëm pas një periudhe të pacaktuar kohore - pra nesh na del një alegori goditëse që lidhet me lëvizjen që luajti një rol të rëndësishëm në historinë e religjionit çifut gjatë shekujve që shumë afër i paraprinë ardhjes së Jezuit, e që është zbritja e Vëllazërisë së Essenes (të cilës mund t'i ketë përkitur edhe vetë Jezui) dhe në veçanti ata të degëve të saj që jetuan një vetmi të vetë caktuar në afërsinë e Detit të Vdekur, siç edhe është zbuluar kohëve të fundit. Pas zbulimit të dorëshkrimeve të Detit të Vdekur, u bënë të njohur si “Komuniteti Kumrun”. Shprehja ar-Raqīm, që ndodhet në ajetin e mësipërm të Kuranit (dhe të paraqitur nga unë si “shkrimet”), jep një mbështetje të fortë për këtë teori. Siç është regjistruar nga Tabari, disa nga autoritetet më të hershme - e në veçanti Ibn Abbas - e kanë konsideruar shprehjen si sinonim me marqām (“diçka që është e shkruar”) dhe kështu me Kitāb (“shkrim” ose “shkresë”); dhe Razi shton se “të gjithë gojëtarët dhe pliologët Arabë vërtetojnë se ar-raqīm ka kuptimin [sikurse] al-kitāb”. Pasi që historikisht është përcaktuar se anëtarët e komunitetit Kumran - grupi më strikt mes Esenesve - e përkushtuan veten e tij tërësisht në studimin, kopjimin dhe ruajtjen e shkrimeve të shenja, jetuan në vetmi të tërësishme nga pjesa tjetër e botës dhe admiroheshin shumë për besimin (fenë) e tyre të lartë dhe pastërtinë morale, ka më shumë se mundësi që mënyra e tyre e jetesës bëri një përshtypje shumë të fortë në imagjinatën e shokëve të tyre të fesë së njëjtë, saqë gradualisht u alegorizua në ngjarjen e Njerëzve të Shpellës, të cilët “fjetën” - e kjo është se u shpëputën nga bota e jashtme - për vite të panumërta, vendosën të “zgjohen”, pasi që detyra e tyre shpirtërore ishte përmbushur. Por, cilido qoftë numërimi i legjendës dhe pa marrë parasysh se a është me origjinë çifute apo krishtere, fakti mbetet se është përdorur në Kuran një aspekt i qartë i parabolës: që është ilustrim i fuqisë së Allah-ut për ta shkaktuar vdekjen (ose “gjumin”) dhe ringjalljen (ose “zgjimin”) dhe së dyti, si alegori e besimit që e nxit njeriun ta braktisë botën e ligë ose të pavlerë, në mënyrë që ta ruaj të panjolllosur besimin e tij dhe njohjen nga Allahu të atij besimi, përmes të dhuruarit nga Ai, të zgjimit shpirtëror që e kalon kohën dhe vdekjen.

(Përkthimi dhe Komentimi i
Kuranit Famëlart / famëmadh nga Muhammad Asad. pp. 437-439)

Ne më lart vërejtëm se Ibn Kathīr, komentatori i Kuranit, e vuri në pyetje pikëpamjen e përgjithshme se djelmoshat e shpellës ishin të krishterë dhe mbante qëndrimin se ata jetuan shumë më herët sesa periudha e krishterë. Po të ishin ata të krishterë, ai pyeti: pse rabajtë çifutë qëllimisht ta kenë ruajtur këtë ngjarje? Dhe për qëllim të krahasimit të mirë, do të shtonim: pse do ta kishin konsideruar dijeninë për ngjarjen e tyre (i.e. djelmoshave) si kriter që mund ta vërtetonte pohimin e profetllëkut? Pas të gjithave, çifutët e kishin kundërshtuar Jezuin (‘alaihi al-

Salām) si Mesi dhe si Profet. Ata e kishin konsideruar atë të ketë qenë mashtrues, gënjeshtar dhe kopil (dhe ne kërkojmë mbrojtjen e Allahut nga këto deklarata blasfemike). Prandaj është e qartë se djelmoshat e shpellës i përkisnin Banū Isrāīl-ve.

Pa ndërprerë, gjatë historisë, Izraelitët e kanë tradhtuar Allahun duke thënë gënjeshtër kundër tij. Ky mëkat i blasfemisë është quajtur në Kuran si *Shirk*. Kështu, kur Moisiu shkoi në bjeshkë për takimin e tij me Allahun Më të Lartësuarin, ata e adhuruan një viç nga ari në mungesë të tij. Kjo ngjarje në *Sūrah al-Kahf* duket se lidhet edhe me një rast të ngjashëm, pasi që djelmoshat referohen si “njerëzit tanë”, kur ata thanë: *Këta, njerëzit tanë, kë po adhurojnë zot tjetër, përveç Atij (i.e., Allahut)*. Ajo epokë jo vetëm që dëshmonte për blasfemi të shpërndarë gjithandej (*Shirk*), por, po ashtu, ata të cilët i rezistonin kësaj blasfemie (*Shirku*), kërcënonin dhe persekutonin. Kjo është mjaft e qartë nga fakti se të rinjtë kishin mbajtur me vete një qen për mbrojtje: . . . dhe qeni i tyre ishte shtrirë në prag (të shpellës) me shputat e para të shtrira, si dhe nga paralajmërimi që i ishte dhënë djaloshit, i cili ishte dërguar në qytet për të blerë ushqim: . . . le të jetë shumë i kujdesshëm dhe mos ja zbulojë se kush je askujt, sepse po e morën vesh se kush je, mund të të gjuajnë me gurë (i.e., të terrorizojnë), ose të fusin me zor në fenë e tyre, e me ç’rast kurrë nuk do të shpëtosh.

Djelmoshat e dhanë një shembull të artë në përgjigje të blasfemisë (*Shirkut*) së shoqërisë së tyre me besimin e pa komprometuar në Allahun. Ata nuk u luan në besimin e tyre dhe nuk u komprometuan, përkundër kërcënimeve dhe persekutimit. Përkundrazi, ata treguan një kurajë të mrekullueshme, jo vetëm në shpalljen e besimit të tyre në fytyrë të të gjitha kërcënimeve, por po ashtu në sfidimin e asaj bote të pafe dhe duke e mallkuar mosbesimin e saj: *Kështu, Ne ua forcua atyre zemrat, kur ata qëndruan dhe pohuan (shpallën haptazi në fytyrë të kundërshtimit të botës së pafe): Zoti ynë është Zoti i qiejve dhe tokës. Kurrë ne nuk do të pranojmë asnjë zot pos Tij (kështu ata e kundërshtuan e sovranitetin ndokujt, përveç sovranitetit të Allahut). Nëse ne do e thoshim (një gjë të tillë), do të ishte vërtet një gjë e tmerrshme. Këta njerëzit tanë kanë marrë për t’i adhuruar zotat e tjerë përveç Tij (i.e., Allahut). Pse nuk sjellin një dëshmi të qartë (dhe bindëse) për atë që ata e bëjnë? E kush mund të jetë më i ligë se ai i cili shpikë një gënjeshtër kundër Allahut (duke pohuar të drejtën për të adhuruar tjetërkënd).*

Në fund, kur persekutimi u intensifikua, ata u detyruan t’i braktisnin njerëzit e tyre. Ata iu kthyen *Hixhretit* (i.e., emigrimi nga territori në të cilin kishte persekutim) dhe shkuan në territorin e sigurisë relative. Dhe kështu ata zgjodhën të largoheshin prej qytetit të tyre dhe shtypjes së tij dhe derisa largoheshin, ata u ndalën të pushonin pak në një shpellë: *Kur ikën (morën vendimin për të ikur nga ata, i.e., bota e Shirkut) nga të gjitha ato që adhuronin në vend të Allahut, kërkuan strehim në shpellë*. Në rastin e Profetit Abraham (*‘alaihi al-Salām*), ai dhe familja e tij u larguan nga Babilonia dhe u udhëzuan nga Allahu për të emigruar në Tokën e Shenjtë të Palestinës. Dhe në rastin e Profetit Muhamed (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*), ai dhe shoqëruet e tij u larguan nga Meka në Medinë. Dhe kështu, këta besimtarë të rinj, e dhanë një shembull që ishte i ngjashëm me atë më të lartësuarin nga të gjithë Profetët, i.e., që ta lënë shtëpinë, qytetin, rehatinë, punën etj. dhe të emigrojnë si refugjatë në tokën e largët, në mënyrë që ta ruajnë besimin e tyre!

Profeti (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) i paralajmëron Myslimanët se do të vijë një Kohë, kur ata do të ndjekin shembullin e djelmoshave që ikën në shpellë. Ai e bëri këtë në *Hadithin* e radhës:

Abu Sa'eed al-Khudri tregon se Profeti (sallallahu 'alaihi wa sallam) tha: Koha do të vijë shumë shpejt, kur prona më e mirë e një Myslimani do të jenë dhitë e tij, me të cilat ai do të kërkojë azil në luginë apo në bjeshkë, për hir të besimit të tij.

(Sahih al-Bukhari)

Pasi që *Surja* duhet të lexohet për t'u mbrojtur nga *Dexhalli* dhe pasi që epoka e *Dexhallit* do të jetë epoka e fundit ose epoka e *Kiametit*, del se *Surja* dërgon mesazhin se njerëzimi do të përqafojë një idhujtari të pafe, të njëjtë me përshkrimin më lart. *Surja* po ashtu paralajmëron qartë besimtarët në Islam, të cilët do të mbesin besimtarë dhe të cilët do t'i rezistojnë botës së pafe, sepse do t'i ekspozohen kërcënimit, persekutimit dhe shtypjes, ashtu siç ishin ekspozuar djelmoshat e cekur më lart. Ky është shpjegimi i luftës kundër Islamit që po ndodh rreth botës me intensitetin më të madh.

Kur djelmoshat u futën në shpellë, atë e bënë me një frymëzim të thellë shpirtëror, pasi që menjëherë iu lutën Allahut dhe kërkuan ndihmë dhe mëshirë nga vetë Prania Hyjnore: *O Zot, na dhuro neve mëshirë nga ana Jote*. Allahu Më i Lartësuar ishte kënaqur me një shfaqje të tillë të besimit. Në të vërtetë, Allahu Më i Lartësuar do të kënaqet gjithmonë me një paraqitje të tillë të besimit. Ai iu përgjigj për t'i ndihmuar ata. *Surja al-Kaf* na e dha premtimin e rëndësishëm se Ai do ta bëjë të njëjtën gjë për ne!

Zgjidhja për problemin e djelmoshave lidhur me mbijetesën e besimit të tyre ndodhet në largimin nga bota e pafe. Udhëzimi që sot na është dhënë ne në *Suren al-Kahf*, është shumë i qartë: nëse ndonjëherë bëhet e domosdoshme në këtë epokë që të shkëputemi nga bota e pafe, të ndahemi nga ajo dhe të bëjmë *Hixhret*, në mënyrë që të ruhet besimi në Allahun dhe Islamin, atëherë besimtari duhet ta bëjë këtë. Lufta kundër Islamit veç ka filluar. Do të bëhet përherë e më e tërbuar. Profeti paralajmëroi për vuajtjen e tmerrshme dhe shtypjen e Epokës së Fundit (ditët e sotme) në *Hadithin* në vijim:

"Yahya më tregoi mua nga Maliku, nga Abu Zinad, nga al-Araj, nga Abu Hurayra se Profeti (sallallahu 'alaihi wa sallam) tha: Ora (e fundit) nuk do të vijë, derisa një njeri të kalojë pranë varrit të një tjetri e të thotë: Sikur të isha unë në vendin e tij."

(Muwatta, Imam Malik)

Allahu më i Lartësuar iu përgjigj lutjes së tyre duke i vënë të rinjtë në gjumë dhe duke ua ndaluar dëgjimin e të gjithë zërave që vinin nga bota jashtë (shpellës). Dhe kështu ata fjetën për shumë e shumë vite: *Pastaj Ne ua mbyllëm veshët e tyre (derisa ata mbetën në shpellë) për disa vite*. (Kështu që ata u shkëputën nga bota jashtë shpellës.) Po të ishte e mundur që edhe të tjerët të ikin në një vend të ngjashëm dhe të kenë furnizime për të mbajtur veten e tyre, derisa e jetojnë një jetë të shkëputur nga bota e pafe, atëherë do të arrihej i njëjti qëllim!

Lind pyetja: si ua mbajti (ruajti) Allahu Më i Lartësuar trupat e tyre gjatë viteve që ata kishin fjetur në shpellë? Së dyti, si i parandaloi Ai trupat e tyre për të mos e marrë atë që njihet me emrin plagët e krevatit, diçka që doemos ndodh, kur një pacient rri shtrirë në një pozitë për një periudhë të gjatë kohore.

Ngjarja siç tregohet në *Suren al-Kahf*, na sugjeron fuqishëm në përdorimin e energjisë solare për tu ushqyer, si dhe për vënien e gjërave në lëvizje. Në qoftë se energjia solare mund të përdoret për të lëvizur një trup, po ashtu mund të përdoret për lëvizjen e ventilatorëve, lëvizjen e makinave, furnizimin e fabrikave me energji etj. Ajo që u bëhet me dije besimtarëve në këtë epokë, është se ata duhet të përgatiten për të shfrytëzuar në maksimum energjinë solare për të mbijetuar gjatë periudhës së stërzgjatur të vështirësive të mëdha që do të bie mbi ta, kur *Dexhalli* do ta përdorë naftën si armën kryesore. Ai do ta bëjë këtë, kur ai më në fund do të arrijë ta fusë tërë botën në një varësi të tërësishme dhe të pakthyeshme të naftës për transport, udhëtim, prodhimin e ushqimit, industrinë etj. dhe kur ai të shtyjë çmimin e naftës të rritet në lartësi marramendëse.

Armiaqtë tanë pastaj do të marrin në kontroll të përgjithshëm furnizimet e botës me naftë dhe ta nënshtrojnë njerëzimin në një shantazh politik të nënshtimit ndaj sundimit *mesianik* të Izraelit mbi tërë botën, si çmim për të paguar naftën.

Derisa ky libër shkon në shtyp, duket se Shteti Euro-çifut i Izraelit është i gatshëm të bëjë një luftë nukleare, përmes së cilës do të përpiqet të marrë në kontroll të drejtpërdrejtë të gjitha burimet e mëdha të naftës që gjinden në lumin Eufrates (i.e., Irani, Iraku, Arabia Saudite, Kuvajti shtetet e gjirit, etj.) Propheti Muhammad (*sallallahu 'alaihi wa sallam*) i ka profetizuar këto luftëra (i.e., luftërat Britanike dhe Amerikane në Irak për të marrë në kontroll naftën e Irakut dhe luftën Izraelite që është gati të ndodhë), kur ai deklaroi:

Treguar nga Abu Huraira: i Dërguari i Allahut tha: “Së shpejti lumi 'Efratis' do të zbulojë një thesar (një mal) me ar, kështu që kushdo që ndodhet aty në atë kohë, nuk duhet të marrë asgjë nga ai”. Al-A'raj tregon nga Abu Huraira se Profeti tha të njëjtën gjë, por ai tha: “Ai (Eufratisi) do të zbulojë një mal me ar (nën të).”

(Sahīh Bukhārī)

Treguar nga Ubayy ibn Ka'b: E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (*paqja qoftë mbi të*) të thotë: Eufratisi së shpejti do të zbulojë një mal me ar dhe kur njerëzit do të dëgjojnë për të, do të vrapojnë drejt tij, porse njerëzit të cilët e posedojnë atë (thesarin) do të thonë: Nëse i lëmë këta njerëz që ta marrin atë, ata do ta marrin të tërin. Kështu që ata do të luftojnë dhe nëntëdhjetë e nëntë nga çdo njëqind do të vriten. Abu Kamil në tregimin e tij tha: Unë dhe Abu Ka'b qëndruam nën hijen e murit të Hassanit.

(Sahīh Muslim)

Do të duket nga ngjarjet në Kuran se sa herë që drita e diellit hynte në shpellë në mëngjes, trupat e djelmoshave që flinin josheshin nga ai (dielli) dhe rrotulloheshin drejt ti. Ky fenomen sot njihet si *phototropism*. Pastaj, kur dielli po perëndonte në mbrëmje dhe drita e diellit edhe një herë filtrohej përmes shpellës, por nga një drejtim i kundërt, trupat rrotulloheshin në anën e kundërt. *Dhe (për shumë vite) do ta shihnit diellin derisa lindte, që anonte nga ana e djathtë e shpellës dhe derisa perëndonte largohet nga ata nga ana e majtë, derisa ata qëndronin në hapësirën e hapur në mes të shpellës. Dhe ju do të mendonit se ata janë zgjuar, ndërsa ata janë në gjumë. (do të mendonit se janë zgjuar sepse) Ne i bëmë ata të rrotullohen vazhdimisht, sa në të djathtë, sa në të majtë.* Ky fenomen i rrotullimit konstant i trupave parandalon ulcerat (plagë që shkaktohen nga qëndrimi i gjatë në një pozitë). Së dyti, do të duket se drita e diellit mbi trupat, u dha atyre energjinë minimale që nevojitet për mbijetesën e organeve vitale. Ky proces

quhet fotosintezë. Vetëm Allahu e di se sa kanë fjetur djelmoshat në shpellë, edhe pse Kurani e përmend treqind vjet (solar). Dhe kur Allahu i zgjoi ata nga gjumi dhe filluan ta pyesin njëri-tjetrin se sa gjatë kishin fjetur, menjëherë u duk se kanë pasur kapacitet të ndryshëm për ta kuptuar realitetin e gjërave (që janë ndryshe nga ajo që paraqiten). Disa thanë se ata kishin fjetur për një ditë ose një pjesë të ditës. Kështu dukej të ishte. Të tjerët, të cilët nuk ishin të informuar nga paraqitja, me të drejtë erdhën në përfundim se vetëm Allahu e di se sa kemi fjetur. *Pastaj Ne i zgjuam ata, në mënyrë që t'i testonim se cila nga dy pikëpamjet (e të rinjve që tani ishin zgjuar) ishte më e saktë në llogaritjen e viteve që kishin qëndruar në shpellë.* Derisa pikëpamja e parë paraqiste të kuptuarit joshpirtëror të gjatësisë kohore, të tjerët e dalluan atë. Kështu që edhe njerëzimi në epokën e Fites do të paraqesë këto dy pikëpamje të kundërta lidhur me aspektin shpirtëror të realitetit të 'kohës'. Do të jetë një epokë kur koha do të lëvizë me shpejtësi. Profeti (sallallahu 'alaihi wa sallam) tha:

“Treguar nga Anas ibn Mālik: i Dërguar i Allahut tha: Ora e Fundit nuk do të vije derisa koha të tkurret, një vitë sa një muaj, një muaj sa një javë, një javë sa një ditë, një ditë sa një orë dhe një orë sa kohë duhet për të ndezur një zjarrë.”

(Tirmīdhi)

Ekziston një aluzion i qartë se *Dexhalli* do të jetë përgjegjës për ta vënë në gjumë njerëzimin lidhur me perceptimin e përshpejtimit të vazhdueshëm të 'kohës'. Profeti (sallallahu 'alaihi wa sallam) tha për Dexhallin se “*ai do të jetojë në tokë për katërdhjetë ditë, një ditë sa një vit, një ditë sa një muaj, një ditë sa një javë dhe ditët e tjera sa ditët tuaja!*”

Ata besimtarë të cilët janë të mbrojtur prej Fitnes së *Dexhallit* nga *Surja al-Kahf*, do të jenë në gjendje ta njohin dhe ta kuptojnë 'kohën', 'gjatësinë e kohës' dhe 'kalimin e kohës' në kohën e Fitnes, gati në të njëjtën mënyrë siç e kuptuan disa nga të rinjtë në shpellë, kur kuptuan se ata nuk kishin fjetur një gjumë të rëndomtë të një dite apo një pjesë të ditës.

Në kapitullin e mëparshëm të këtij libri ne e ekzaminuam tematikën e 'Kuranit dhe kohës' dhe u prezantuam me konceptin e Islamit të shtatë botëve të 'kohës', të cilat (të gjitha) kalojnë botën tonë të 'kohës'. Në ngjarjen djelmoshave dhe shpellës ne na është thënë se ata kanë fjetur për treqind vite, megjithatë, kur ata u zgjuan nga gjumi dhe u përpoqën të llogarisnin gjatësinë e kohës së qëndrimit të tyre në shpellë, disa prej tyre u përgjigjën me hamendje se kishin qëndruar “një dite ose një pjese të ditës”. Ajo që paraqet kjo llogaritje, është se nuk ka pasur shenja të dukshme të plakjes, përkundër kalimit të një kohe të gjatë. Flokët në kokat e tyre, mjekrat e tyre, gjatësia e thonjve të tyre, lëkura e fytyrës së tyre etj., të gjitha kishin mbetur të pandryshuara. Kjo tregon se ata u mbijetuan treqind viteve, derisa ekzistonin njëkohësisht në dy dimensione të kohës: së pari, në dimensionin tonë 'kohorë' biologjik, në të cilin trupat e tyre vazhdonin të rrotulloheshin nga e majta në të djathtë, dy herë në ditë, në lindje të diellit dhe perëndimit të diellit dhe së dyti, në një dimension 'kohor' i cili ishte jo biologjik dhe në të cilin nuk janë plakur, përkundër kalimit të treqind viteve.

Kështu, ngjarja na i ka paraqitur dimensionet e ndryshme kohore që ekzistojnë pranë njëra-tjetrës, pikërisht këtu në tokë. Të kuptuarit e kësaj tematike, është vetë çelësi për interpretimin e Hadithit enigmatik, lidhur me jetëgjatësinë e *Dexhallit* në tokë. Dhe pikërisht kjo është arsyeja që ne e filluam këtë libër me kapitullin që ia kemi kushtuar 'kohës'.

Pasi që ata duhet të kenë qenë shumë të uritur, morën vendim që njëri nga ata të shkonte në qytet për të blerë ushqim. Atij ia dhanë ca monedha argjendi për të blerë ushqim. Por ai u paralajmërua që të kishte kujdes, derisa të kërkonte ushqimin: *dhe le të kërkojë ai ushqimin më të pastër dhe le t'ju sjellë ca (që ta shuani urinë).*

Së dyti, ai u paralajmërua që të mos e zbulojë vendndodhjen e të tjerëve në shpellë, për shkak të rrezikut të madh ndaj të cilit ata do të ekspozoheshin: *por le të sillet ai me një kujdes të madh dhe mos i trego askujt vendndodhjen tënde. Sepse nëse ata e kuptojnë se kush je mund të të mbysin me gurë ose të të kthejnë në fenë e tyre, me ç'rast kurrë më nuk do të arrish sukses.*

Ne vetëm mund të spekulojmë lidhur me atë se çka i ndodhi djalit që e la shpellën e shkoi në qytet për të blerë ushqim. Bota duhet të ketë ndryshuar aq sa rrugët, shtëpitë, veshjet e njerëzve etj., duhet të kenë qenë shumë të ndryshme. Ai duhet të ketë shokuar dhe hutuar deri në thelb të qenies së tij, bile edhe mund të jetë tmerruar nga ndryshimi i përgjithshëm që kishte ndodhur, që kur ishte larguar nga qyteti. Kurani nuk preokupohet me hollësi të tilla, as me atë pjesë të ngjarjes. Por e përkufizon vetëm që të na njoftojë se bota e pafe kishte ndryshuar aq shumë gjatë periudhës kur djelmoshat ishin në gjumë, saqë mosbesimi i saj (botës) ishte zëvendësuar me besimin në Allahun Më të Lartësuarit. Kjo ishte e qartë nga vendimi që ishte marrë nga njerëzit e qytetit që ta përkujtojnë këtë ngjarje duke e ndërtuar një *Masxhid*. Vetëm besimtarët do ta merrnin një vendim të tillë!

Fakti që bota e pafe, e cila po i shtypte djelmoshat besimtarë, ishte zhdukur dhe ishte zëvendësuar nga një botë me besimtarë, duhet të ketë dërguar një mesazh të fortë shprese tek Myslimanët në Mekë, të cilët po persekutoheshin nga Arabët paganë, duhet t'i ketë siguruar ata që e Vërteta përfundimisht do të triumfojë mbi gënjeshtren.

Dhe sigurisht na siguron edhe ne se lufta e tanishme mbi islamin nuk do të zgjasë përgjithmonë dhe përfundimisht do të zëvendësohet me fitoren e Islamit. Pasi që recitimi i *Sūres al-Kahf* ofron mbrojtje nga *Fitnja e Dexhallit*, kjo nënkupton se përfshirja e kësaj ngjarjeje në këtë *Sure*, ka për qëllim të japë shpresë për besimtarët në këtë kohë të Fitnes. Kur e tërë bota bashkohet për të bërë luftë kundër Islamit dhe kur besimtarët të bëhen objekt i kësaj shtypjeje, saqë një njeri do të kalojë pranë një varri dhe do të dëshirojë që të jetë në varrë, kjo ngjarje vazhdimisht do t'u ofroj Myslimanëve një përforcim sigurie, se Islami përfundimisht do të ngadhënjejë mbi të gjithë rivalët. Prandaj ata nuk duhet ta humbin shpresën, ose të lejojnë që të ndikohen nga ndjenja e dëshpërimit.

Fakti se të djelmoshat e shpellës i përkushtuan rëndësi aspektit të ushqimi se cili duhej të blihej, tregon se në këtë epokë të *Fitnas* ushqimi ynë do të jetë i korruptuar, i ndotur, i përpunuar gjenetikisht etj., deri në atë masë, saqë ushqimi më nuk mund të kryejë funksionin të cilin ia ka përcaktuar Allahu Më i Lartësuari. Për shembull: qumështi dhe prodhimet e tjera të qumështit duhet të luajnë një rolë që të bëjnë të mundur që trupi të ruajë sistemin e imunitetit. Kur lopët injektohen me hormone, në mënyrë që të shtojnë prodhimin e qumështit, qumështi i prodhuar në këtë mënyrë mund të jetë aq i prishur (korruptuar), saqë nuk mund ta kryejë më atë funksion, ose mund të ketë efekte serioze anësore.

Nabi 'Isa (Jezui) ('alaihi al-Salām) raportohet t'u ketë dhënë këshillë Banū Isrāīlve, që është mjaft e ngjashme me atë që gjendet në ngjarjen e Sūres al- Kahf:

“Yahya më ka treguar mua nga Maliku se kishte dëgjuar që Īsa ibn Maryam thoshte: O Banū Isrāīl! Ju duhet të pini ujë të pastër, të hani gjëra të gjelbra të tokës dhe bukë të elbët. Kujdes nga buka e grurit, sepse ju nuk do të jeni mjaft mirënjohës për të”.

(Muwatta, Malik)

Së fundi, nuk është jo domethënëse që Kuran-i i kushton një vëmendje të shkurtër parasë, e cila duhet të përdoret nga djelmoshat për të blerë ushqimin. Ishte *Wariq* (monedhë argjendi): *Le të shkojë njëri nga ju me këtë monedhë argjendi në qytet. Paralajmërimi i Sūres al-Kahf* është i qartë. Besimtarët duhet t'i përkushtojnë vëmendje të madhe parasë në Epokën e Fundit. Ata duhet të jenë në gjendje të dallojnë mes parasë së vërtetë dhe parasë false. Paratë e vërteta, që janë përdorur nga të gjithë Profetët e Allahut Më të Lartësuar, gjatë gjithë kohëve, kanë qenë monedhat e arit dhe argjendit, ose artikuj të konsumit të gjerë, siç janë gruri, elbi, hurmat, kripa etj. Paraja e vërtetë ka vlerë të brendshme (i.e., vlera e parasë gjendet brenda vetë parasë). Në anën tjetër, vlera e parasë false dizajnohet në mënyrë arbitrare nga ai i cili e lëshon (prodhon) atë. Dhe nuk mund të kthehet në para të vërtetë. Kur vlera e parasë së vërtetë bie, zë vend vjedhja e legalizuar, përmes transferimit masiv të pasurisë nga masat te një elitë grabitqare që gjendet brenda dhe jashtë kufijve të shtetit. Kjo është Ribā. (shih dy librat e mi me këtë tematikë: ‘Rëndësia e Ndalimit të Ribās në Islām’ dhe ‘Ndalimi i Ribas në Kuran dhe Sunnah’.

Ne jetojmë në një kohë, në të cilën njerëzimi është futur në grackë të botës së parasë false dhe njerëzve po u rripret pasuria e tyre. Shumica veç janë të kurthuar në punë skllëvërishe.

Domethënja e thjeshtë e ngjarjes për Myslimanët të cilët jetojnë në botën moderne.

Ne e kemi ekzaminuar domethënien e përgjithshme të ngjarjes. Tani le të ndalemi te shkaku themelor i konfliktit mes djelmoshave dhe botës në të cilën ata jetonin. Shkaku është fakti se bota ka filluar të adhurojë për zot tjerë përveç Allahut. *Kështu, njerëzit tanë kanë adhuruar zot tjerë përveç Atij (i.e., Allahu). Kur ata nuk e sjellin një dëshmi të vërtetë (dhe bindëse) për atë që e bëjnë? Dhe kush është më i ligë se ai i cili e shpik një gënjeshtër kundër Allahut (duke pohuar të drejtën e nënshtrimit ndaj këtyre zotave). Ky ka qen mëkati i blasfemisë (Shirkut), mëkati i vetëm të cilin Allahu nuk e fal kurrë:*

﴿إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ
وَمَنْ يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَقَدْ افْتَرَىٰ إِثْمًا عَظِيمًا﴾

“Por! Allahu nuk e falë kur dikush tjetër pos Tij pranohet si Zot (ose adhurohet si Zot ose si dikush që ka sovranitet, autoritet suprem, etj). Ai falë gjithçka tjetër përveç këtij (mëkati) ati që

dëshiron; dhe kushdo që e pranon ose e adhuron dikë tjetër përveç Allahut si Zot me të vërtetë ka bërë një krim të madhë.”

(Kuran, al-Nisā, 4:48)

Ne sot jetojmë në një botë që krejtësisht është përfshirë nga Shirku. Me të vërtetë Shirku e ka marrë nën kontroll botën. Dhe shumica e dijetarëve të Islamit dhe organizatave të njohura Islamike ose nuk mund ta kuptojnë atë, ose nuk dëshirojnë ta denoncojnë atë në mënyrën e djemve të shpellës në *Suren al-Kahf*.

Shirku i botës moderne mund të dallohet qartë nga fakti se Allahu rreptësisht e ka parandaluar *Riban* (marrja dhe dhënia e parave me interes), lëndët toksike, kumarin, homoseksualizmin dhe lesbianizmin, abortin etj. Megjithatë, shtetet moderne nëpër botë, duke përfshirë edhe të ashtuquajturat shtetet Islamike, e kanë lejuar një pjesë, ose janë duke i lejuar të gjitha ato. Legjislacionet vazhdimisht janë duke u përgatitur për të lejuar të gjitha ato që Allahu i ka ndaluar.

Allahu, po ashtu, e ka lejuar martesën plurale (me më së shumti katër gra), me kusht që burri të jetë në gjendje të mbajë gratë e tij dhe që ai t'i trajtojë ato në mënyrë të barabartë. Allahu ka deklaruar se jeta e Profetit (*sallallahu 'alaihi wa sallam*) vazhdon të jetë modeli më i mirë i sjelljes për besimtarët. Profeti (*sallallahu 'alaihi wa sallam*) ka pasur shumë gra.

Shirku i epokës moderne mund të dallohet qartë nga fakti se sot nëpër botë qeveritë e ndryshme po vënë në vend legjislacionet për të ndaluar atë që Allahu e ka lejuar. Kështu, ligji e parandalon martesën plurale dhe e parandalon martesën e vajzave nën moshën 16 (dhe ndokund nën 18) vjeç.

Dhe kështu ata e ndalojnë atë që Allahu e ka lejuar dhe e kanë lejuar atë që Allahu e ka ndaluar! Tani le të ekzaminojmë ajetin Kuranor në vijim, sa i përket atij që e ndalon atë që Allahu e ka lejuar, ose që e ka lejuar atë që Allahu e ka ndaluar. Po ashtu le ta ekzaminojmë shpjegimin e ajeteve Kuranore që na i ka dhënë Profeti (*sallallahu 'alaihi wa sallam*):

﴿ أَمْ لَهُمْ شُرَكَاءُ شَرَعُوا لَهُمْ مِنَ الدِّينِ مَا لَمْ يَأْذَنْ بِهِ اللَّهُ ۚ وَلَوْلَا كَلِمَةُ الْفَصْلِ لَفُضِيَ بَيْنَهُمْ وَإِنَّ الظَّالِمِينَ لَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴾

“A mos kanë ata (të cilët kujdesenë vetëm për këtë botë) ortakë (zota ose idhuj) që u përcaktuan atyre fé, të cilën nuk e urdhëroi All-llahu? Po, sikur të mos ishte fjala vendimtare (e All-llahut që shpërblimi dhe ndëshkimi të jenë në ahiret), do të kryhej dënimi mbi ta, e megjithatë, mohuesit do të kenë dënimi të dhembshëm. (në jetën që do vijë)”

(Kuran, al-Shūra, 42:21)

﴿ اتَّخَذُوا أَحْبَارَهُمْ وَرُهَبَانَهُمْ أَرْبَابًا مِّن دُونِ اللَّهِ وَالْمَسِيحَ
 ابْنَ مَرْيَمَ وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا إِلَهًا وَاحِدًا ۚ لَّا إِلَهَ إِلَّا هُوَ
 سُبْحَانَهُ عَمَّا يُشْرِكُونَ ﴾

“Ata i konsideruan "ahbarët" (priftër jehudi) të tyre, "ruhbanët" (murgjit e krishterë) të tyre dhe Mesihun (Isain) birin e Merjemes, për zota pos All-llahut, ndërsa ata nuk janë urdhëruar për tjetër (nga pejgamberët) pos për adhurimin ndaj All-llahut një, e që nuk ka të adhuruar tjetër pos tij. I lartë është Ai nga çka i shoqërojnë”

(Kuran, al-Tauba, 9:31)

‘Adi bin Hatim, i cili kishte qenë i krishterë para se ta pranonte Islamin, një herë erdhi te profeti. Kur ai e dëgjoi atë të recitonte ajetin Kuranor, më lart tha: O i Dërguar i Allahut, por ata (çifutët) nuk i adhurojnë ata (Rabjenët). Profeti u përgjigj: Po, por ata ua ndaluan njerëzve atë që është Hallall dhe ua kanë lejuar atyre atë që është Haram dhe njerëzit iu binden atyre. Kjo në të vërtetë është adhurimi i tyre.’

(Sunan, Tirmidhi)

Të krishterët pohojnë se Jezui (*‘alaihi al-Salām*) ua ka dhënë apostujve të tij, para se të ngjitej në qiell, autoritetin për të përcaktuar atë që është e lejuar dhe atë që është e ndaluar. Tregohet që ai të ketë thënë:

“Në të vërtetë ju them se të gjitha gjërat që do të keni lidhur mbi tokë, do të jenë lidhur edhe në qiell dhe të gjitha gjërat që keni zgjidhur mbi tokë, do të jenë zgjidhur edhe në qiell.”

(Ungjilli sipas Mateut: 18:18)

Është e çartë se ky rresht (ajet) sipas Mateut duhet të ishte lexuar (kuptuar) se çfarëdo që ishte ndaluar në qiell, po ashtu duhet të ishte ndaluara edhe në tokë dhe gjithçka që lejohet në qiell, duhet të jetë e lejuar po ashtu edhe në tokë!

Sot, përreth botës, Myslimanët i nënshtrohen autoritetit të qeverive që janë duke bërë *Shirk*. Ata votojnë për ta në elektorat. Ata betohen në kushtetutën që u jep autoritetin qeverive për të bërë *Shirk*. Ata punësohen nga ato qeveri dhe u shërbejnë atyre me besnikëri. Ata i nderojnë, mbështesin dhe u binden këtyre qeverive. Prandaj nuk ka asnjë dyshim se të gjithë ne (*illa ma sha’ Allah*) jemi në *Shirk*! Megjithatë, të gjithë dijetarët e Islamit e adoptojnë një sjellje neutrale ndaj një kombi të tillë, ose e mbyllin njërën sy ndaj këtij *Shirku*, ose, më së keqi, bëhen mbështetës aktivë të këtyre qeverive.

Profeti i bekuar (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) ka paralajmëruar se *Dexhalli* do ta testojë njerëzimin me një bagazh të *Shirkut*. Ai vazhdoi të na paralajmërojë edhe me tutje se sulmi i

Shirkut do të jetë aq i vështirë për tu dalluar, siç do të jetë vështirë të dallohet “një buburrec i zi, në një gurë të zi, në natën e errët”. Është shumë e lehtë për ne për të dalluar përmbushjen e kësaj profecie; emrat e ditëve, të javëve dhe të muajve të vitit që tani janë në përdorim të përgjithshëm nga të gjitha kombet (*ila mā shā Allah*).

Të gjitha ditët e javës, nga e ‘Diela’ tek e ‘Shtuna’, dhe të gjithë muajt e vitit, nga ‘Janari’ në ‘Dhjetor’, që të gjithë janë emërtuar sipas zotave paganë. Kur ne i përdorim këta emra për ditët e javës dhe muajt e vitit dhe të braktisin për të gjitha qëllimet praktike *Synetin* (në respekt të emrave të ditëve të javës dhe muajve të vitit) ne hymë në *Shirk*. Në të vërtetë disa nga emrat e ditëve të javës, si dhe muajve të vitit, janë dhënë në vetë Kuranin. Suna në respekt për ata emra është:


Youm al-Ahad (dita e parë e javës); *Youm al-Ithnain* (dita e dytë e javës); *Youm al-Thalatha* (Dita e tretë e javës); *Youm al-Arba’a* (Dita e katërt e javës); *Youm al-Khamīs* (Dita e pestë e javës); *Youm al-Jum’ah* (Dita e Xhuma ose dita e lutjes së përbashkët); *Youm al-Sabt* (Dita e Sabathit).

(Të paktën dy emra të ditëve të javës ndodhen në Kuran, e që janë *Youm al-Jum’ah* dhe *Youm al-Sabt*.)

Ngjashëm *Syneti*, sa u përket emrave të muajve të vitit, janë si në vijim: *Muharram*; *Safar*; *Rabī’ al-Awwal*; *Rabī’ al-Thāni*; *Jumādi al-Awwal*; *Jumādi al-Thāni*; *Rajab*; *Shabān*; *Ramadān*; *Shawwāl*; *Dhū al-Qa’ada*; *Dhū al-Hajj*.

(Të paktën njëri nga këta emra të muajve është i përmendur në Kuran, i.e., muaji i *Ramazanit*.)

Për shkak të paralajmërimit të madh, përkitazi me *Shirkun* që gjendej në zemër të ngjarjes së djemve të shpellës që Kurani e ka përfunduar ngjarjen, në Ajetin 26, me deklarinimin në vijim përkitazi me Allahun Më Të Lartësuarin dhe Autoritetin e Tij Suprem:



Allahun Më Të Lartësuarin dhe Autoritetin e Tij Suprem: “. . . e as nuk e shkëmben Ai Komanden (ose Qeverisje) e Tij me askën.”

(Kuran, al-Kahf, 18:26)

Kurani na e ka zbritur ne *Duan* (lutjen) e *Nabi Mūsa* (‘alaihi al-Salām), i cili iu lutë Allahut, kur ai u gjet në mes të njerëzve që e kishin përqafuar *Shirk-un* dhe nuk donin të largohen prej tij. Kjo ishte lutja e tij:

﴿ قَالَ رَبِّ إِنِّي لَا أَمْلِكُ إِلَّا نَفْسِي وَأَخِي ۖ فَافْرِقْ بَيْنَنَا وَبَيْنَ ۖ

الْقَوْمِ الْفَاسِقِينَ ﴾ ﴿٢٥﴾

“Ai tha: O Zoti im! Unë kamë fuqi vetëm mbi vetën time dhe mi vllaun tim: kështu që na nda neve nga ky popull rebel!”

(Kurani, al-Māidah, 5:25)

Tani që e kemi zbuluar dhe e kemi shpjeguar blasfeminë universale (*Shirkun*) të botës moderne dhe po ashtu kemi tërhequr vëmendjen për luftën ndaj Islamit, që tani vazhdon nëpër botë, na kujton neve që ta aplikojmë mësimin që kemi marrë nga djelmoshat, në Suren e Kuranit të Bekuar. Kur të bëhet e nevojshme për ta bërë një gjë të tillë, për ta ruajtur besimin tonë në Allahun Më të Lartësuarin, ne duhet të largohemi në të njëjtën mënyrë, siç u larguan ata nga bota e pafe që po bënë luftë kundër Islamit.

Është raportuar se dijetari eminent turk i Islamit dhe mendimtari *Badi’uzzaman Sa’id Nursi*, të ketë këshilluar Myslimanët në Kalifatin e kaluar Turk, që të tërhiqen nga qytetet në fshatra dhe të përpiqen ta ruajnë fenë në dhjetëmijë fshatra myslimane.

Ne kemi po të njëjtën pikëpamje. Ne fuqishëm besojmë se mbijetesa e besimit për Myslimanët në epokën moderne të *Gog* dhe *Magog* qëndron në tërheqjen nga qytetet e botës moderne në fshatra myslimane që gjinden në vende të largëta, ku do të themelohen komunitete mikro-Islamike. Në bërthamën e fshatit të largët Mysliman, duhet të jenë besimtarët më të pastër. Ata duhet të përcaktojnë standardet e sjelljes (e në veçanti të praktikave të adhurimit të Allahut) që të merren nga të gjithë banorët tjerë të fshatit.

Surja al-Kahf i ka këshilluar besimtarët që të rrinë në shoqërinë e këtyre njerëzve, e në veçanti në kohën, e *Dexhallit* dhe të *Gog* dhe *Magog*, dhe të kenë kujdes e të mos largohen nga këta që shërbejnë si model i vërtetë e të joshen nga shkëlqimet e botës moderne. Këtë e ka bërë në ajetin e bukurisë mashtruese, të cilën ne edhe e kemi përkthyer dhe e kemi shpjeguar:

﴿ وَأَصْبِرْ نَفْسَكَ مَعَ الَّذِينَ يَدْعُونَ رَبَّهُمْ بِالْغَدَاةِ وَالْعَشِيِّ ۖ يُرِيدُونَ وَجْهَهُ ۖ وَلَا تَعْدُ عَيْنَاكَ عَنْهُمْ تُرِيدُ زِينَةَ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا ۖ وَلَا تُطِعْ مَنْ أَغْفَلْنَا قَلْبَهُ عَنْ ذِكْرِنَا وَاتَّبَعَ هَوَاهُ وَكَانَ أَمْرُهُ فُرْطًا ۖ ﴾ ﴿٢٨﴾

Përkthim i thjeshtë:

Përkufizojë veten tënde me ata që lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje, e që kanë për qëllim kënaqësinë (*razinë*) e Tij dhe mos i hiq sytë e tu prej tyre e të kërkosh bukurinë e kësaj bote dhe mos iu bind atij që ia kemi shmangur zemrën e tij prej përkujtimit ndaj Nesh dhe i është dhënë epshit të vet, sepse puna e tij ka mbaruar.

(Kuran, al-Kahf, 18:28)

Shpjegimi i përkthimit:

Dhe (*derisa të vijë dita e gjykimit*) le të jenë zemrat tuaja të kënaqura (*në kërkimin e shoqërisë së besimtarëve të sinqertë*), të cilat i luten Zotit mëngjes dhe mbrëmje (*me gjithë zemër e me gjithë shpirt*), duke kërkuar kënaqësinë e Tij (*që do thotë se ky është një adhurim pasionant e jo mekanik*); dhe mos i largoni sytë prej tyre, për të kërkuar madhështitë, shkëlqimet dhe bukuritë e jetës së kësaj bote (*mos të ju sodisë bota e pafe me joshjet e saj dhe t'ju mashtrojë me një ryshfet të vogël e t'ju bëjë që t'ia ktheni shpinën atyre shërbëtorëve të vërtetë të Allahut Më Të Lartësuarit*); dhe të mos i kushtohet vëmendje (*të mos i binden, mos e ndiqni udhëheqësin*) ndonjërit, zemrën e të cilit Ne e kemi shmangur prej përkujtimit ndaj Nesh (*i.e., kujtimin e përhershëm për Zotin në zemrën e tyre*), sepse ai gjithmonë i ka ndjekur (*vetëm*) dëshirat e veta (*i.e., epshin për pushtet, famë ose pasuri etj.*), duke e braktisur krejt çka është e mirë dhe e vërtetë (*dhe bënë luftë kundër shërbëtorëve të drejtë të Allahut*).

Komentim:

Në këtë ajet tejet të bukur të *Surës al-Kahf* na jepet edhe më shumë këshillë dhe paralajmërim përkitazi me metodën me të cilën besimtarët duhet t'u përgjigjen rreziqeve të botës së pafe në kohën e testeve të *Dexhallit* dhe dhunës së korrupsionit të rregullt botëror Gog dhe Magog.

Esenca e udhëzimit është se ata duhet të zgjedhim me kujdes shoqërinë e tyre, njerëzit me të cilët ata shoqërohen dhe Xhematin të cilit ata i përkasin dhe vendin që e zgjedhin për të banuar. Ata duhet të qëndrojnë të bashkuar me ata shërbëtor të sinqertë të Allahut Më Të Lartësuarit, që rrezatojnë besim të thellë, që janë të turpshëm, fetarë dhe që kanë karakter të fortë në personalitetin e tyre.

Besimtarët e tillë do të shfaqin qëndrueshmëri në vendimin e tyre për të mbetur besimtarë ndaj Allahut dhe Të Dërguarit të Tij të bekuar (*paqja qoftë mbi të*), derisa zhvillohet lufta kundër Islamit në tërë botën.

Përveç kësaj, ata duhet ti shmangen shoqërisë së atyre që shfaqin mosbesim, mëkate, lakmi, epsh, krenari, urrejtje, arrogancë, ligësi dhe mëri në sjelljet e tyre dhe kush mbështet ata të cilët po bëjnë luftë kundër Islamit. Të tillët do të jenë ata njerëz të cilët e ndjekin agjendën e tyre të kësaj bote dhe punët e të cilëve do të jenë të kota.

KAPITULLI I GJASHTË PARABOLLA E PASANIKUT DHE TË VARFËRIT

Në kapitullin e mëparshëm u tregua dhe u analizua ngjarja e Surës al Kaf të Kuranit lidhur me djelmoshat, të cilët ikën e u strehuan në shpellë. Ne e përmbyllëm kapitullin duke bërë me dije se djelmoshat ikën nga Shirk-u (blasfemia). Ky është mëkati më i madh dhe më i rrezikshëm nga të gjitha mëkatet, pasi që është mëkati për të cilin Allahu Më i Lartësuari ka deklaruar se nuk do ta falë (i.e., nëse dikush vdes pa e fituar faljen për këtë mëkat).

Por, menjëherë pas përfundimit të ngjarjes së djelmoshave të shpellës, *Surja al-Kahf* i kthehet të njëjtës tematikë, në mënyrë që ta drejtojë vëmendjen te një formë tjetër e Shirkut, që do të dominojë në epokën e *Dexhallit*. Në ngjarjen e dy burrave, njërit prej të cilëve Allahu Më i Lartësuari i kishte dhënë pasuri në formën e dy kopshteve shumë të pëlleshme, përderisa tjetri ishte i varfër, pasi që nuk i ishte dhënë pasuri. Pasaniku ishte korruptuar dhe mashtruar nga pasuria e tij dhe si pasojë besimi i tij ishte shkatërruar. Teorikisht ai e adhuronte Allahun. Megjithatë, faktikisht, ai e adhuronte pasurinë e tij (i.e., *Dunjan*) dhe ai ishte *Shirk*. Më në fund dënimi i Allahut e kapi atë dhe pasuria e tij ishte shkatërruar.

I varfëri, në anën tjetër, e dalloj prishjen që ishte në zemrën e pasanikut, e që ishte blasfemi (*Shirk*), dhe e paralajmëroi atë për dënimin hyjnor që mund të pasonte, i.e., që Allahu Më i Lartësuari mund ta shkatërronte kopshtin e tij dhe kështu t'ia merrte pasurinë.

Njeriu i varfër nuk e lakmonte pasurinë e pasanikut. Përkundrazi, ai e këshilloi atë që t'i përulej superioritetit Hyjnor, duke pranuar se pasuria e ti ka ardhur prej Allahut Më të Lartësuarit. Ai duhet të përgjigjet me mirënjohje ndaj Allahut Më të Lartësuarit, i Cili e jep pasurinë. Njeriu i varfër, po ashtu, e shprehu shpresën e tij se Allahu do t'i japë atij diçka më të mirë në botën tjetër, sesa kopshtet e njeriut të pasur dhe më të mirë sesa varfëria në të cilën ka jetuar në këtë botë.

Ky tregim në *Suren Al-Kahf* saktësisht e përshkruan botën e sotme, të cilën e kanë mbërthyer kthetrat e laicizmit dhe materializmit të pafe, si rezultat i stilit të jetës së re moderne. Lakmia, epshi për pasuri, gjëra materiale dhe seksi janë duke e korruptuar shumicën e gjerë të njerëzve përreth botës. Kjo i përfshin bile edhe shumë myslimanë.

Surja i paralajmëron ata të cilët lëngojnë për këtë botë (*Dynja*) se nuk ka asgjë me vlerë për të ofruar. Gjithçka zhduket dhe kalon. Kështu që, në vend që të jetojmë 'në' këtë botë dhe 'për' këtë botë, ne duhet të jetojmë 'në' këtë botë, por 'për' botën tjetër. Besimtari duhet të orvatet në këtë botë për ta ndjekur misionin e të jetuarit 'për' Allahun. Nëse është i varfër, duhet t'i bartë sprovat e tij me durim, derisa jeton 'për' Allahun, me bindjen se kur Allahu Më i Lartësuari t'ia pranojë nënshtrimin, adhurimin dhe durimin e tij, ai do të shpërblehet me shumë të mira në jetën e përtejme.

Ky mesazh është përmbledhur në një ajet vërtet të paharrueshëm të *Sures al Kahf*:

﴿ أَلْمَالُ وَالْبَنُونَ زِينَةُ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا ^ط وَالْبَاقِيَتُ
الصَّالِحَتُ خَيْرٌ عِنْدَ رَبِّكَ ثَوَابًا وَخَيْرٌ أَمَلًا ﴾ ﴿٤٦﴾

“Pasuria dhe fëmijët janë kënaqsi stoli të kësaj jete por veprat e mira, frutet e të cilave janë të përhershme janë shumë më të dashura para syve të Zotit tuaj”

Ja ku është teksti i Kuranit, i parabolës përkitazi me të pasurin dhe të varfrin. Parabola fillon në ajetin tridhjetë e dy dhe përfundon në ajetin dyzet e gjashtë:

Ajeti 32

﴿ وَأَضْرِبْ لَهُم مَّثَلًا رَّجُلَيْنِ جَعَلْنَا لِأَحَدِهِمَا جَنَّتَيْنِ مِنْ
أَعْنَبٍ وَحَفَفْنَاهُمَا بِنَخْلٍ وَجَعَلْنَا بَيْنَهُمَا زَرْعًا ﴾ ﴿٣٢﴾

“E ti sillu atyre (që kërkuar t'i largosh varfanjakët) si shembul dy njerëz; njërit prej tyre i dhamë dy kopshte (vreshta) nga rrushi dhe ato i rrethuan me hurma, e në mes atyre dyjave bimë tjera.”

Ajeti 33

﴿ كِلْتَا الْجَنَّتَيْنِ ءَاتَتْ أُكُلَهَا وَلَمْ تَظْلِم مِّنْهُ شَيْئًا وَفَجَّرْنَا
خِلْلَهُمَا نَهْرًا ﴾ ﴿٣٣﴾

“Të dy kopshtet jepnin frutat e veta, pa munguar prej tyre asgjë, e në mesin e tyre bëmë të rrjedhë një lumë.”

Ajeti 34

﴿ وَكَانَ لَهُ ثَمَرٌ فَقَالَ لِصَاحِبِهِ وَهُوَ يُحَاوِرُهُ أَنَا أَكْثَرُ مِنْكَ
مَالًا وَأَعَزُّ نَفَرًا ﴾ ﴿٣٤﴾

“Ai kishte edhe pasuri tjetër. E ai atij shokut të vet (që ishte besimtar) i tha: - duke iu krenuar atij - "Unë kam pasuri më shumë se ti e, kam edhe krah më të fortë!"

Ajeti 35

﴿ وَدَخَلَ جَنَّتَهُ وَهُوَ ظَالِمٌ لِّنَفْسِهِ قَالَ مَا أَظُنُّ أَنْ تَبِيدَ هَذِهِ أَبَدًا ﴾

“Dhe ai hyri në kopshtin e vet (e me besimtarin për dore), po duke qenë dëmtues i vetës (duke mos besuar dhe duke u krenuar) tha: "Unë nuk mendoj se zhduket kjo kurrë.”

Ajeti 36

﴿ وَمَا أَظُنُّ السَّاعَةَ قَائِمَةً وَلَئِنْ رُدتُ إِلَى رَبِّي لأُجِدَنَّ خَيْرًا مِّنْهَا مُنْقَلَبًا ﴾

“Dhe nuk besoj se do të ndodhë kijameti, (dita e gjykimit), por nëse bëhet që të kthehem te Zoti im, padyshim do të gjej ardhmëri edhe më të mirë se kjo.”

Ajeti 37

﴿ قَالَ لَهُ صَاحِبُهُ وَهُوَ يُحَاوِرُهُ أَكَفَرْتَ بِالَّذِي خَلَقَكَ مِنْ تُرَابٍ ثُمَّ مِنْ نُّطْفَةٍ ثُمَّ سَوَّكَ رَجُلًا ﴾

“Atij ai shoku i vet (besimtari) i tha - duke polemizuar atë -: "A e mohove Atë që të krijoi ty nga dheu, pastaj nga një pikë uji, pastaj të bëri njeri të plotë?”

Ajeti 38

﴿ لَّيَكُنَّا هُوَ اللَّهُ رَبِّي وَلَا أُشْرِكُ بِرَبِّي أَحَدًا ﴾

“Por për mua, Ai All-llahu është Zoti im, e Zotit tim unë nuk i bëj shok askë.”

Ajeti 39

﴿ وَلَوْلَا إِذْ دَخَلْتَ جَنَّتَكَ قُلْتَ مَا شَاءَ اللَّهُ لَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ ۚ إِنَّ تَرَنَّا أَقْلَ مِنْكَ مَالًا وَوَلَدًا ۝ ﴾

“E pse ti kur hyre në kopshtin tënd nuk the: "Ma shall Allah, la kuvete il-la bil lah" - (Allhu çka do, bëhet, s'ka fuqi pa ndihmën e Tij). Nëse ti më sheh mua se unë kam më pak prej teje edhe pasuri edhe fëmijë (krah më të dobët).”

Ajeti 40

﴿ فَعَسَىٰ رَبِّي أَن يُوْتِيَنِي خَيْرًا مِّنْ جَنَّتِكَ وَيُرْسِلَ عَلَيْهَا حُسْبَانًا مِّنَ السَّمَاءِ فَتُصْبِحَ صَعِيدًا زَلَقًا ۝ ﴾

“Po unë shpresoj se Zoti im do të më japë edhe më të mirë nga kopshti yt, e këtij tëndit t'i shkaktojë fatkeqësi nga qielli e të gdhijë tokë e lëmuar (e zhveshur)!”

Ajeti 41

﴿ أَوْ يُصْبِحَ مَأْوَاهَا غَوْرًا فَلَن تَسْتَطِيعَ لَهُ طَلَبًا ۝ ﴾

“Ose të gdhijë uji i shterur, e ti kurrësi nuk mund ta kërkosh atë!.”

Ajeti 42

﴿ وَأُحِيطَ بِثَمَرِهِ فَأَصْبَحَ يُقَلِّبُ كَفَّيْهِ عَلَىٰ مَا أَنفَقَ فِيهَا وَهِيَ خَاوِيَةٌ عَلَىٰ عُرُوشِهَا وَيَقُولُ يَلَيْتَنِي لَمْ أُشْرِكْ بِرَبِّي أَحَدًا ۝ ﴾

“(Dhe vërtet, u shkatërruan frutat e ti, e ai filloi të rrahë shuplakët për atë që kishte shpenzuar në të, e ajo ishte rrënuar në kulmet e saj dhe thoshte: "O i mjeri unë, të mos i kisha bërë Zotit tim askë shok!”

Ajeti 43

﴿ وَلَمْ تَكُن لَّهُ فِئَةٌ يَنْصُرُونَهُ مِن دُونِ اللَّهِ وَمَا كَانَ مُنتَصِرًا ۝ ﴾



“E nuk pati krah (grup), përveç All-llahut të vërtetë që t'i ndihmojë atij dhe nuk mundi ta pengojë.”

Ajeti 44

﴿ هُنَالِكَ الْوَلَايَةُ لِلَّهِ الْحَقِّ هُوَ خَيْرٌ ثَوَابًا وَخَيْرٌ عُقْبًا ﴾

“Në atë vend ndihma është vetëm e All-llahut të vërtetët. Ai është shpërblyesi më i mirë dhe te Ai është përfundimi më i mirë.”

Ajeti 45

﴿ وَأَضْرَبَ لَهُمْ مَثَلِ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا كَمَاءٍ أَنْزَلْنَاهُ مِنَ السَّمَاءِ فَاخْتَلَطَ بِهِ نَبَاتُ الْأَرْضِ فَأَصْبَحَ هَشِيمًا تَذْرُوهُ الرِّيحُ ۗ وَكَانَ اللَّهُ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ مُّقْتَدِرًا ﴾

“E ti (Muhammed) paraqitjau atyre shembullin e kësaj bote që ëshë si një ujë (shi) që Ne e lëshojmë nga qielli, e prej tij bima e tokës zhvillohet e shpeshëtohet sa që përzihet mes vete, e pas pak ajo bëhet byk (pas tharjes) që e shpërndajnë erërat. All-llahu ka fuqi për çdo send.”

46 Ajeti

﴿ أَلْمَالُ وَالْبَنُونَ زِينَةُ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا ۗ وَالْبَاقِيَاتُ الصَّالِحَاتُ خَيْرٌ عِنْدَ رَبِّكَ ثَوَابًا وَخَيْرٌ أَمَلًا ﴾

“Pasuria dhe fëmijët janë stoli e kësaj bote, kurse veprat e mira (fryti i të cilave është i përjetshëm) janë shpërblimi më i mirë te Zoti yt dhe janë shpresa më e mirë.”

(Kuran, al-Kahf, 18:32-46)

Pasazhi në Suren al-Kahf, i cili tregon parabolën e njeriut të pasur dhe njeriut të varfër, na paralajmëron për rreziqet që na vijnë, kur pasuria e korrupton dhe e shkatërron besimin tonë. Përfundon me një përkujtim për Ditën e Gjykimit dhe fatin që i pret ata të cilët e humbin besimin.

Domethënia e ngjarjes.

Kjo parabolë jep një kontrast mes dy njerëzve dhe mënyrave të tyre të jetesës, që simbolizon jetën në epokën Dexhallit.

Allahu më i Lartësuar nganjëherë jep pasuri, si diçka të dhënë në besim dhe si test në këtë jetë. E Allahu nganjëherë dënon me anë të pasurisë, pasi që pasuria bëhet rruga drejt

shkatërrimit. Nëse pasuria nuk është fituar në mënyrë të lejuar, si për shembull përmes fajdesë së sistemeve dhe sigurimeve moderne, do të jetë *Haram* dhe do të sigurojë që pronari të digjet në zjarrin e ferrit.

Laicizmi, e që përfundon me materializmin që e mënjanon nevojën për Zotin dhe fenë, do ta korruptojë zemrën me sëmundje vdekjeprurëse. Sëmundja dominuese e Epokës së Fundit do të jetë një epsh i madh për pasuri, saqë do t'i verbojë njerëzit nga realiteti shpirtëror. Ata do të shpërlahen nga trutë dhe do të jetojnë një botë iluzive të fantazisë (parajsa e budallenjve), derisa me gëzim ecin rrugës drejt zjarrit të ferrit. Domethënia e kësaj ngjarjeje në *Suren al-Kahf* ndodhet në paralajmërimin që e jep përkitazi me këtë sëmundje.

Bota moderne i jep shkëlqim pasurisë dhe stilit të jetesës në pasuri. Si përfundim, të varfrit fillojnë ta urrejnë dhe ta përbuzin varfërinë e tyre dhe e shtojnë veten të bëjnë çfarëdo qoftë, të lejuar dhe të ndaluar, për ta nxjerrë vetën e tyre nga *mallkimi* i varfërisë. Kjo shpie në hyrjen në banda, vjedhje, krime të dhunshme të plaçkitjes, rrëmbimit etj. Në fakt, e tërë shoqëria korruptohet, sepse të pasurit po ashtu përdorin mënyra të paligjshme që vazhdimisht ta rrisin pasurinë e tyre.

I varfëri, në këtë *Sure*, nuk mburret për asgjë. Besimi i tij ishte në Allahun Më të Lartësuarin. Si rezultat, Allahu e shkatërroi pasurinë e pasanikut dhe i varfëri ishte ai i lumturi në fund. Në këtë parabolë jepet një mesazh i fortë i ngushëllimit, shpresës dhe mbështetjes për besimtarët e varfër, të cilët jetojnë në një botë e cila e njehë njeriun e pasur si 'dikushi' dhe njeriun e varfër 'askushi' - një botë e cila e demonizon varfërinë si diçka të ligë, që duhet të çrrënjohet.

Abdullah Yusuf Ali, e ka përmbledhur thelbin e parabolës në këtë version (të edituar) të komentimeve të tij:

“‘Ai arroganti ishte fryrë me ato që kishte në pronësinë e tij, të ardhurat e tij dhe familjen e madhe e të tjera dhe mendonte se vetëkënaqësia e tij se do të zgjaste përgjithmonë. Ai po ashtu e kishte gabim që e shikonte me përulje shokun e tij, i cili, edhe pse kishte më pakë begati, ishte njeri më i mirë nga ata të dy. Nuk ishte pasuria ajo që e shkatërroi atë, por sjellja e mendjes së tij. Ai ishte i padrejtë, jo dhe aq ndaj fqinjit të tij, sa ishte i padrejtë ndaj shpirtit të vet. Nga dashuria e tij për gjërat materiale, ai harroi ose haptazi e mohoi aspektin shpirtëror. Siç tregon ajeti 37, ai e mori shokun e tij me vete për ta impresionuar me rëndësinë e tij, porse shoku i tij nuk ishte tundur fare. Ja ku del shpirti koprrac i materialistit. Në mendjen e tij 'më mirë' do të thotë më shumë pasuri dhe më shumë pushtet nga lloji i atij me të cilin ai kënaqej në këtë jetë, edhe pse në ralitet, edhe ajo që ai e kishte, qëndronte mbi themele të zbrazëta dhe ishte e përcaktuar të shkatërrohej e të humbte duke e marrë me vete edhe atë.

Argumenti i shokut ishte ndarë në pesë pjesë. Ai protestoi kundër njeriut krenar, i cili e mohoi Allahun. Pastaj ai, në bazë të përvojës së tij shpirtërore, deklaroi se Allahu është Një dhe Ai është Zot. Ai po ashtu ia bëri me dije atij mënyrën më të mirë për tu kënaqur me dhuratën e Allahut, i.e., me mirënjohje ndaj tij. Ai shprehi rehatin dhe kënaqësinë, në atë që Allahu ia kishte caktuar atij. Më në fund, ai i dha atij një paralajmërim të natyrës së shpejtë (kalimtare) të të mirave të kësaj bote dhe sigurinë e dënimit të Allahut për krenarinë e tepruar.”

(Abdullah Yusuf Ali, përkthimi dhe Komentimi i Sūrah al-Kahf të Kuranit, Shënimet 2376-80)⁷

Si duhet t'i përgjigjen besimtarët laicizmit dhe materializmit që sot e dominon njerëzimin dhe botën? *Surja al-Kahf* është çelësi i përgjigjeve. Abdullah Yusuf Ali vazhdon:

“Dënimi i cili iu bë njeriut të pasur e arrogant, ishte me anë të rrufeve (*husbanan*), porse domethënia e përgjithshme e fjalës përfshin çdo dënim përmes llogaritjes (*hisab*), por, ndoshta, fjala është edhe për një tërmet, pasi që i ndërron rrjedhat e ujit, i ndryshon kanalet nëntokësore përmes baltës dhe rërës dhe përfshin nën rrënoja vende të gjëra. ‘Frytet’, ‘harxhimet’, ‘përdredhja e duarve’, a duhet e tërë kjo të kuptohet po ashtu në një kuptim të gjerë metaforik, sikurse edhe në kuptimin e drejtpërdrejtë. Ai kishte të ardhura dhe kënaqësi të mëdha, të cilat, që të gjitha, i humbën. Ai kishte shumë burime të pronësisë së tij. Mendimet e tij ishin pushtuar nga ajo; shpresat e tij ishin ndërtuar mbi të; ishte bërë pasioni absorbues i jetës së tij. Sikur ai vetëm të kishte shikuar kah Allahu, në vend të të mirave jetëshkurtra të kësaj bote!

Në këtë rast, në mendjen e tij, vetja e tij dhe pasuria e tij, i ishin bërë si rival të Allahut! Ai kishte ndërtuar një lidhje dhe i kishte obliguar ata që ishin në varësi të tij dhe ishte krenar që kishte ‘plot pasuri’. Po, ku ishin gjithë këto gjëra, kur erdhi llogaritja e hesapeve? Ai nuk mundi ta ndihmojë as veten e tij; si mund të pritët që të tjerët ta ndihmojnë atë? E gjitha këto është e kotë, pasiguri dhe lojë e kohës. E vetmja shpresë dhe e vërtetë është nga Allahu. Shpërblimet tjera dhe sukseset tjera janë iluzione. Shpërblimi më i mirë dhe sukcesi më i madh vijnë nga Allahu.”

(Abdullah Yusuf Ali, Përkthimi dhe komentimi i Sūres al-Kahf të Kuranit, Shënimet 2380-85)

Bota moderne e pafe ia kishte kthyer shpinën Allahut Më të Lartësuarit dhe këtë e ka bërë aq fshehurazi. Pretendon se akoma beson në Allahun, por në realitet nuk beson!

Ngjarja e dy burrave po ashtu na tregon në mënyrë kërcënuese të ardhmen e njerëzimit me një theks të veçantë në kohën e Dexhallit. Bota e Kufrit the Shirkut do të zhduket në të njëjtën mënyrë siç u zhduken kopshtet e pasanikut, i.e ktastrofata nazyrore natyrore dhe humbja e vazhdueshme e ujit të freskët:

..... وَيُرْسِلْ عَلَيْهَا حُسْبَانًا مِّنَ السَّمَاءِ فَتُصْبِحَ صَعِيدًا
زَلَقًا ۖ أَوْ يُصْبِحَ مَأْوَاهَا غَوْرًا فَلَن تَسْتَطِيعَ لَهُ طَلَبًا ﴿٤١﴾

“ Zoti im do të më japë edhe më të mirë nga kopshti yt, e këtij tëndit t'i shkaktoj fatkeqësi nga qielli e të gdhijë tokë e lëmuar (e zhveshur).”

(Kuran, al-Kahf, 18:40-41)

⁷ Përkthimi në fjalë është Përkthimi i Kuranit në Gjuhën Angleze nga Jusuf Ali

Ajo humbje e ujit të pishëm veç ka filluar. Veç ka filluar llogaritja deri në zero (countdown).

Pasaniku dhe varfanjaku në botën e sotme të Islamit,

Sūrah al-Kahf na jep një mësim shumë të rëndësishëm, përkitazi me pasuritë e botës. E njeh rëndësinë dhe përdorimin e saj dhe e pranon joshjen e pasurisë. Porse pasuria mund të zhduket, kështu që njeriu nuk duhet ta shohë atë (pasurinë) si gjithçka të kësaj jete. Porse, thotë *Sūrah Kahf*, janë veprat e mira ato të cilat i mbijetojnë marshit të kohës, kështu që ne duhet t'i përkushtojmë më shumë vëmendje sjelljes (veprave) së mirë, sesa vrapimit pas pasurisë:

﴿ أَلْمَالُ وَالْبَنُونَ زِينَةُ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا ۖ وَالْبَاقِيَاتُ
الصَّالِحَاتُ خَيْرٌ عِنْدَ رَبِّكَ ثَوَابًا وَخَيْرٌ أَمَلًا ﴾

“Pasuria dhe fëmijët janë stoli e kësaj bote, kurse veprat e mira (fryti i të cilave është i përjetshëm) janë shpërblimi më i mirë te Zoti yt dhe janë shpresa më e mirë.”

(Kuran, al-Kahf, 18:46)

Pasuria dhe fëmija janë kënaqësi të përkohshme të kësaj bote, për të cilën lëngon njeriu, porse ka diçka tjetër që është më e mirë, pasi që qëndron përtej llogaritjes kohore - e ato janë veprat e mira. Dhe kështu derisa bota bëhet përherë e më e korruptuar, në Epokën e Fundit dhe derisa errësira e mbështjell botën, besimtari duhet të përpiqet fuqishëm, që të jetë i drejtë në vepra.

Strategjia e *Dexhallit* për ta korruptuar dhe kontrolluar njerëzimin përmes pasurisë, mund të dallohet lehtë nga ngjarja e pasanikut dhe varfanjakut. Ai e përdor Ribān (fajdenë), si dhe kontrollin e shtetit, për t'i pasuruar ata të cilët nuk i rezistojnë atij dhe, në anën tjetër, për t'i varfëruar ata të cilët i rezistojnë atij. Kjo është strategji ekonomike e *Dexhallit*, përmes së cilës ai kërkon të kontrollojë botën në emër të Shtetit Euro-Çifut të Izraelit. Strategjia duket të jetë shumë e suksesshme. Sot, në botën, ata që kanë pushtet dhe që sundojnë, janë të pasur dhe vazhdimisht pasurohen, ndërsa ata që u rezistojnë sundimtarëve të botës, dobësohen dhe vazhdimisht varfërohen.

Përreth botës Islame sot pasanikët i mbështesin qeveritë, të cilat pastaj bëhen klientë të sunduesve të botës. E masat e varfra në mënyrë efektive janë përjashtuar nga pushteti dhe proceset vendimmarrëse. Kjo ka punuar në mënyrë të admirueshme në dobi të Izraelit. Profeti Muhamed (s.a.v.s.) ka profetizuar se *Dexhalli* do ta bëjë pikërisht këtë:

Nawwās ibn Sam'an ka thënë se I dërguari i Allahut një mëngjes pati folur për Dexhallin... Ai tha: Ai (Dexhalli) do të vijë te njerëzit dhe do t'i ftojë ata (në një fe të gabuar); ata do ta konfirmojnë besimin në të dhe do t'i përgjigjen atij. Ai do t'i japë urdhër qiellit: do të bie shi në tokë dhe do t'i rrisë bimët. Pastaj, në mbrëmje, kafshët e kullosës do të vijnë te ta me gungat e

tyre shumë lart, gjinjtë e tyre plot me qumësht dhe ijet e tyre të larguara. Ai pastaj do të vijë te njerëzit e tjerë dhe do t'i ftoj% ata. Por ata do ta kundërshtojnë atë, kështu që ai do të largohet nga ata; pastaj ata do të vuajnë nga thatësira dhe asgjë nuk do t[u ngelet atyre, sa i përket pasurisë.

(Sahīh, Muslim)

Është vërtet e çuditshme se tema e ndalimit të përdorimit të fajdesë (*Ribā*) në Islam, e cila është një strategji e rëndësisë së madhe, akoma neglizhohet aq shumë. Përvoja e këtij shkrimtari është se vetëm pak myslimanë sot kanë një dituri adekuate për këtë tematikë dhe kjo ndodh për shkak se dijetarët e Islamit i shmangen mësimit të këtij subjekti. Ne shpresojmë që dy librat tanë me tematikë të Ribas (i.e., '*Ndalimi i Ribas në Kuran dhe Synet*' dhe '*Rëndësia e Ndalimit të Ribas në Islam*') do t'i ndihmojnë lexuesit që ta kuptojnë këtë subjekt. Përveç kësaj, ekziston një incizim i seminarit tonë '*Islami dhe Paraja*' që mund të shikohet në ueb-faqen tonë: www.imranhosein.org.

Pasuria i korrupton ata të cilët e përqafojnë materializmin dhe epshi për pasurinë po ashtu i korrupton ata të cilët e fituan pasurinë në mënyrë të padrejtë. Kur këta njerëz të korruptuar bëhen elita sunduese, ata e përdorin pushtetin për t'i shtypur të varfrit. Masat e varfëruara Myslimane, në tërë botën Islame, në mënyrë të patundur e kundërshtojnë dhunën përherë në rritje të shteti Euro-Çifut të Izraelit dhe ata janë të përcaktuar të bëhen një forcë e cila do të njihet. Ky është *morali* i ngjarjes së treguar në *Suren al-Kahf*. Besimi në Allahun Më të Lartësuarin do të përkthehej në një fuqi të pashkatrueshme që përfundimisht do ta mund forcën e Izraelit. E kështu, një përplasje mes elitës sunduese dhe masave të varfëruara duhet të ndodhë eventualisht. Profeti Muhammad (*sallallahu 'alaihi wa sallam*) veç e ka profetizuar se Myslimanët do ta mundin dhunën në Tokën e Shenjtë përmes një konflikti të armatosur.

Elita e pasur grabitqare, e cila në mënyrë të pandryshuar e kontrollon fuqinë, ushtrinë dhe institucionet e tjera shtetërore, kërkon rehati me Izraelin, që do t'i mbrojë interesat e tyre. Kjo përshkruhet si 'procesi paqësor'. Ashtu siç janë të mësuar me pushtetin dhe privilegjet, ata janë të tmerruar me perspektivën e revolucionit të ringjallur Islamik të masave të varfra, që do ta fitojnë pushtetin dhe pastaj do të sillen me ta në mënyrën që Irani Revolucionar Islamik u soll me elitën e tij grabitqare. Kështu, presioni për ta rehatuar Izraelin, vjen nga elita pasanike myslimane, e tmerruar që jeton në frikën vdekjeprurëse të masave të varfëruara Myslimane dhe të drejtësisë Islame të rreptë dhe pa kompromis.

Është mjaft e qartë se grabitqarët pasanikë, të cilët janë korruptuar nga pasuria e tyre, kurrë nuk do t'i bashkëngjiten luftës së armatosur për t'i çliruar të shtypurit në Tokën e Shenjtë. Po ashtu është e qartë se vëllezërit e tyre të varfër, me kënaqësi do ta përqafojnë atë luftë të armatosur.

Ky aspekt i ngjarjes së pasanikut dhe varfanjakut, në *Suren al-Kahf*, është manifestuar kohëve të fundit në mënyrë dramatike brenda zgjedhjeve në Palestinë, në të cilat masat e varfra e demonstrian kapacitetin e tyre të pakompromentuar për t'i rezistuar dhunës së Izraelit, duke votuar për një qeveri të përbërë nga rezistenca Islamike Hamas. Të varfrit e kanë marrë forcën

dhe shpresën e tyre nga ky paragraf i ngjarjes në *Suren al-Kahf*, në të cilën i varfri i drejtohet pasanikut.

Ata të varfërit i kanë mbledhurë forcën dhe shpresën e tyre nga ky paragrafë i ngjarjes në *Suren al-Kahf* në të cilën i varëri i drejtohet pasaniku:

﴿ إِن تَرَنِ أَنَا أَقَلَّ مِنْكَ مَالًا وَوَلَدًا ۖ ﴾

“Nëse ti më sheh mua se unë kam më pak prej teje edhe pasuri edhe fëmijë (krah më të dobët).”

﴿ فَعَسَىٰ رَبِّي أَن يُوْتِيَنِي خَيْرًا مِّنْ جَنَّتِكَ وَيُرْسِلَ عَلَيْهَا حُسْبَانًا ۖ ﴾

﴿ مِّنَ السَّمَاءِ فَتُصْبِحَ صَعِيدًا زَلَقًا ۖ ﴾

“Po unë shpresoj se Zoti im do të më japë edhe më të mirë nga kopshti yt, e këtij tëndit t'i shkaktojë fatkeqësi nga qielli e të gdhijë tokë e lëmuar (e zhveshur)!”

(Kuran, al-Kahf, 18:39-40)

Më në fund ekziston edhe një komplikim, që del kur pasuria e korrupton Zemrën. Një individ i tillë vërbohet nga brenda dhe si pasojë nuk mund ta kuptojë të vërtetën në Kuran. *Sūrah al-Kahf* e ka zbuluar se çka ju bënë këtyre njerëzve Allahu Më i Lartësuari:

﴿ . . . إِنَّا جَعَلْنَا عَلَىٰ قُلُوبِهِمْ أَكِنَّةً أَن يَفْقَهُوهُ وَفِي آذَانِهِمْ ۖ ﴾

﴿ وَقُرْآنًا وَإِن تَدْعُهُمْ إِلَى الْهُدَىٰ فَلَن يَهْتَدُوا إِلَّا أَيْدَا ۖ ﴾

“ . . . Ne kemi vënë mbi zemrat e tyre mbulesë në mënyrë që të mos e kuptojnë atë (Kur'anin), kurse në veshët e tyre shurdhim, andaj edhe nëse i thërret ti ata në rrugë të drejtë, ata si të tillë nuk do të udhëzohen kurrë.”

(Kuran, al-Kahf, 18:57)

Besimtarët të cilët e lexojnë këtë libër, duhet të marrin diturinë me të cilën do t'i dallojnë ‘njerëzit e tillë, të verbër dhe të pashpresë’, të cilët e kundërshtojnë udhëzimin e paraqitur nga dijetarët islamik të udhëzuar drejt dhe të shërbëtorëve modestë të Allahut. Kjo bëhet një urgjencë absolute, kur njerëzit e tillë, të cilët zakonisht i përkasin elitës ‘grabitqare’, i rrëmbejnë komunitetet myslimane dhe vazhdojnë përmes mënyrave të devijimit, mashtrimit dhe dinakërisë (shpeshherë me bllokun e çeqeve), për të ngritur veten e tyre, derisa të njihen si liderë të komuniteteve myslimane. Të pandryshueshëm janë njerëzit që e mbështesin luftën kundër Islamit që po bëhet nga aleanca e sotme Evropiane Çifuto-Krishtere, e cila e sundon botën. Edhe pse ata vetë pohojnë se janë liderët e botës Myslimane, në mënyrë efektive e kanë lënë Islamin

dhe në vend të tij i janë bashkuar asaj aleance sunduese Çifuto-Krishtere. Merr në konsideratë ajetin Kuranor në vijim:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَتَّخِذُوا الْيَهُودَ وَالنَّصَارَىٰ أَوْلِيَاءَ بَعْضُهُمْ أَوْلِيَاءُ بَعْضٍ وَمَنْ يَتَوَلَّهُمْ
مِّنْكُمْ فَإِنَّهُ مِنْهُمْ إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ

“O ju që besuat! Mos zini miq as jehuditë, e as të krishterët. Ata janë miq të njëri-tjetrit. E kush prej jush i miqëson ata, ai është prej tyre. Vërtetë All-llahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin zullumqarë.”

(Kuran, al-Māidah, 5:51)

KAPITULLI SHTATË PARABOLLA E MOISIUT DHE KHIDRIT

Në ngjarjen e takimit të Muses dhe Khidrit (*paqja dhe mëshira e Allahut Më të Lartësuarit qoft mbi ata dy*), *Sūrah al-Kahf* e Kuranit, e ka shpjeguar ‘njërin sy’ të *Dexhallit* derisa na e mëson rëndësinë vendimtare të mësimin epistimologjik, se dituria vjen nga dy burime. Dituria nga burimi i parë njihet si ‘*ilm al-Zāhir*, dhe bazohet në diturin empirike⁸ dhe kërkimeve racionale. Dituria e tillë e cila përfshin diturin shkencore, është e përcaktuar dhe e kufizuar. Dituria nga burimi dytë njihet si ‘*ilm al-Bātin* dhe është dituri e brendshme shpirtërore që poashtu mund të njihet si *përjetim religjiozë*. Kjo dituri i komunikohet individit në mënyrë shpirtërore dhe fillonë nga një dimension i realitetit që e tejkalon rralitetin material. Kjo zakonisht vjen si mendim i intuitës, por poashtu mund të komunikohet përmes ëndrrave të vërteta, ose vizioneve, si dhurat prej Allahut Më të Lartësuarit. Dituria e tillë është e papërcaktuar (e pambarim), e pashtershme dhe pa afatë kohorë.

Profeti Muhamed (*paqja dhe mëshira e Allahut Më të Lartësuarit qoftë mbi të*) deklaroi se dituria e tillë, kur i komunikohet transmetohet një besimtarit përmes ndërmjësimit të ëndrrës ose vizionit të vërtet, apo profetik, e përbën pjesën e fundit të profetllëkut që ka mbetur akoma në tokë pas tij (Muhamedit s.a.s.). Ja *Hadithi* siç është treguar nga disa shoqërues të Profetit:

Tregoj ‘Ubada bin As-Samit : Profeti ka thënë, “Ëndrra (e mirë) e besimtarit të ndershëm është pjesa e dyzet e gjashtë e profetllëkut.”

(Sahih Bukhari)

Tregoj Anas bin Malik: I Dërguari i Allahut tha, “Një ëndërr e njeriut të drejtë është njëra nga katërdhjet e gjashtë pjesët e profetllëkut.”

(Sahih Bukhāri)

⁸ Të mësuarit që fitohet përmes shqisave siç është leximi përmes të pamurit dëgjimi i ligjëratave

Tregoj Abu Huraira: I Dërguari i Allahut tha, “ Ëndrra e vërtet (e mirë) dream e një besimtari të ndershëm, është një e katerdhjeta pjesë e profetllëkut.”

(Sahih Bukhari)

Tregoj Abu Sa'id Al-Khudri: E kamë dëgjuar të Dërguarin e Allahut të thotë, “Ëndrra e mirë është një pjesë nga dyzet e gjashtë pjesët e profetllëkut.”

(Sahih Bukhari)

Yahya më tregoj mua nga Malik nga Zayd ibn Aslam nga Ata ibn Yasar se i Dërguari i Allahut tha, “krejt çka do të mbetet nga profetllëku pas meje do të jetë Mubashshirât.” Ata pyetën, “çfarë është Mubashshirât, o i Dërguari i Allahut?” Ai tha, “ëndrra e vërtet e të cilën e fshehë njeriu i drejtë (i mirë) – ose që i tregohet ati – është pjesa e katërdhjet e gjashtë e profetllëkut.”

(Muwatta Imām Malik)

Treguar nga Abu Huraira: E kamë dëgjuar të Dërguarin e Allahut të thotë, “Asgjë nuk do të mbetet nga profetllëku përveç al-Mubashshirât.” Ata pyetën, “çfarë janë al-Mubashshirât?” Ai u përgjigj, “ëndrrat e vërteta/të mira (që japin myzhde të mira).”

(Sahih Bukhari)

Dituria shpirtërore po ashtu mund të arrihet përmes shpalljeve në librat Hyjnorë. Mes librave hyjnorë, të shpallur janë Torah (*Taurât*), Psalmet (*Zabûr*), Unxhilli (*Injill*) dhe Kurani.

Ne tani jetojmë në një epokë, e cila me të madhe kundërshton pohimin e *‘Ilm al-Bâtin* që të pranohet si dituri. Ekziston një diskutim interesant lidhur me këtë temë, në prezantimin tonë të librit “*Ëndrrat në Islam*”. Ne e kemi paraqitur atë, për dobinë e lexuesve, si Shtojcën 1 në këtë libër. Ekziston edhe një diskutim tjetër i rëndësishëm lidhur me këtë temë në esenë tonë me titull “*Ikbali, Epistimiologjia Sufiste lidhur me Fundin e Historisë*” (Shih librin tonë të eseeve me titull ‘*Shenjat e Ditës së Fundit në Botën Moderne*’). Por, ndoshta diskutimi më i rëndësishëm i të gjitha tematikave të kësaj pike mund të gjendet në fillim të dy kapitujve të punës së rëndësishme të Dr. Muhammad Ikbali, me titull “*Rekonstruimi i mendimit fetar në Islam*”. Libri mund të lexohet në: www.allamaIkbali.com/works/prose/english/reconstruction.

Ngjarja e Musait dhe Khidrit në Surën al-Kahf shpjegon rëndësinë supreme të *‘Ilm al-Bâtin* në Kohën e *Dexhallit*, “i cili do të vijë me një lumë dhe me një zjarr - porse lumi i tij do të jetë zjarr dhe zjarri i tij do të jetë lumë”:

Treguar nga Hudhayfah ibn al-Yaman. Subay’ ibn Khalid tha: “ Unë erdha në Kufah në kohën kur ishte pushtuar Tustari. Unë i mora ca mushq nga ai. Kur hyra në xhaminë e Kufahs, i gjeta aty disa njerëz shtatlartë dhe mes tyre ishte një njeri, të cilin mund ta dalloje, me ta parë, se ai ishte nga njerëzit e Hijazit. Unë pyeta: Kush është ai? Njerëzit u stepën me mua dhe thanë: A nuk e njehë atë? Ky është Hudhayfah ibn al-Yaman, shoqëruesi i të Dërguarit të Allahut. Pastaj Hudhayfah tha: Njerëzit e pyesnin të Dërguarin për Allahun, për të mirën dhe unë e pyetja atë për të ligën. Pastaj njerëzit e shikuan atë. Ai tha: E di arsyen pse nuk e pëlqeni këtë. Unë pastaj e pyeta: I dërguar i Allahut, a do të ketë ligësi, siç ka pasur përpara, pas kësaj të mire të cilën na

e ka dhënë Allahu? Ai u përgjigj: Po. Unë pyeta: Ku është mbrojtja nga ajo? Ai u përgjigj: Në shpatë (i.e., në rezistencën e armatosur kundër dhunës). Unë pyeta: I dërguar i Allahut, çfarë do të ndodhë pastaj? Ai u përgjigj: Nëse Allahu ka në tokë një Kalif, i cili ta rrjepë shpinën dhe ta merr pronën, bindju atij, ose, përndryshe, vdis duke u mbajtur nga trangu i drurit. Unë pyeta: Çfarë do të vijë pastaj? Ai u përgjigj: Pastaj Dexhalli do të dalë përpara i shoqëruar me një lumë dhe zjarr. Ai i cili bie në zjarrin e tij, me siguri se do të shpërblehet dhe do t'i largohet barra prej tij, por ai i cili bie në lumin e tij, do ta mbajë barrën e tij dhe shpërblimi do t'i merret atij. Unë pastaj pyeta: çfarë do të vijë pastaj? Ai tha: Do të vijë ora e fundit.”

(Sunan, Abū Dawūd)

Kuptimi i këtij Hadithi është se ‘paraqitja’ dhe ‘realiteti’ në kohën e Dexhallit do të ndryshojnë dukshëm nga njëra-tjetra. Rruga për në qiell, që simbolizohet nga ‘lumi’, në mënyrë mashtruese do të duket si ‘zjarr’, derisa rruga për në xhehenem, e simbolizuar nga ‘zjarri’, në mënyrë mashtruese do të duket si ‘lum’. Vetëm ata të cilët janë të bekuar nga Allahu Më i Lartësuar me intuitën e brendshme të diturisë shpirtërore, janë ata të cilët mund ta depërtojnë realitetin e brendshëm të ‘lumi’, ‘zjarrit’ dhe natyrës së vërtetë të botës në kohën e *Dexhallit*. Vetëm ata me dituri të vërtetë do ta kuptojnë sulmin e *Dexhallit* dhe kështu nuk do të mashtrohen. Për këtë Arsye Profeti Muhamad (*paqja dhe mëshira e Allahut Më të Lartësuarit qofshin mbi të*) është lutur vazhdimisht: “Oh Allah, me mirësinë tënde m’i trego gjërat ashtu siç janë (ashtu që unë të mos mashtrohem nga mënyra se si paraqiten ato)”.

Dituria shpirtërore në këtë kohë transmetohet drejtpërdrejt në zemrën e besimtarit. Kur besimtari i përkushtohet studimit të Kuranit dhe përpiket të depërtojë në realitetin e brendshëm të Fjalës Hyjnore, ai, më në fund, do të bekohet me dituri që vazhdimisht shpaloset nga Kurani i pashtershëm. *Sūrah al-Kahf* e vajton mos dëshirën e njerëzimit për të udhëtuar në rrugën përmes së cilës mund t’i qasemi diturisë së pashtershme të Kuranit:

﴿وَلَقَدْ صَرَّفْنَا فِي هَٰذَا الْقُرْآنِ لِلنَّاسِ مِنْ كُلِّ مَثَلٍ ۚ وَكَانَ الْإِنْسَانُ أَكْثَرَ شَيْءٍ جَدَلًا ۝﴾

“Në këtë Kur'an Ne shtruam çdo lloji shembulli për hirë të njerëzve, po njeriu (jobesimtar), më shumë se çdo tjetër është kundërshtar (*dhe kështu pra njeriu nuk i kthehet Kuranit për t’ju qasurë asajë diturie të pashtershme*).”

(Kuran, al-Kahf, 18:54)

Ky qortim i Allahut Më të Lartësuarit është dhënë shumë herë në Kuran. Por kokëfortësia, arroganca, krenaria, vetëkënaqësia dhe pranimi i dështimeve të njerëzve të tjerë, bëjnë të mundur që njerëzit ose ta mohojnë Kuranin, ose nuk duan t’i qasen atij si një burim i pashtershëm i diturisë që vazhdimisht shpaloset.

Në vend që t'i nënshtrohet me përlulje dhe të bëjë përpjekje të ndershme për ta kuptuar të vërtetën, njeriu me kokëfortësinë e tij mundohet të argumentojë, derisa pa ndërprerë e kundërshton pohimin se Kurani është fjala e shpallur e Allahut më të Lartësuarit dhe se është burim i pashtershëm i diturisë. Në vend që të përdorë diturinë e përfituar nga aspekti i jashtëm (me anë të shqisave të informimit) për t'i ndihmuar atij për të kuptuar diturinë e shpalosur hyjnueshëm, njeriu sot bombardon me një sulm të vrullshëm të www.external-knowledge.com⁹ (i.e., autostradën e informatave në internet) që duket se është e pashtershme. Kjo bënë që dituria e brendshme shpirtërore të thahet brenda zemrës së ti.

Ngjarja e Muses ('*alaihi al-Salām*) dhe *Khidrit* ('*alaihi al-Salām*) në *Suren al-Kahf* e portretizon në mënyrë të gjallë dallimin mes atij që sheh me një sy dhe kështu është në gjendje të shohë vetëm pamjen e jashtme dhe atij që sheh me të dy sytë e që është në gjendje të shohë me pamjen e brendshme dhe të jashtme. *Khidr* do të thotë i gjelbër dhe është një Hadīth që shpjegon se si *Khidr* ('*alaihi al-Salām*) e ka marrë emrin:

Treguar nga Abu Huraira: Profeti tha: "Al-Khidr është quajtur kështu, sepse ai ishte ulur mbi një tokë të bardhë (të thatë, shterpe) dhe pas kësaj u kthye në gjelbërim me bimë (i.e., aty ku ai ishte ulur)."

(Sahīh Bukhārī)

Mendimi im është se emri dhe titulli që i është dhënë *Khidrit* ('*alaihi al-Salām*), tregon se kushdo që është i bekuar, siç ishte ai, me mundësinë për të parë me të dy sytë, do të ketë dituri që do të jetë e freskët dhe përherë jeshile dhe kështu do të ketë përtëritje shpirtërore. Dituria e tillë do të ketë ndikim te njerëzit, për t'i sjellë prapë në jetë zemrat e vdekura. Dituria gjithmonë do të lulëzojë si bimësi e re jeshile në zemrën dhe mendjen e atij që kënaqet me pranverën e përhershme. Dituria e tillë nuk mund të shterojë kurrë.

Ngjarja e Muses dhe *Khidrit* tregohet në një *Hadīth*. Dhe pasi që ai tregim është tejet i rëndësishëm për ta kuptuar tregimin Kuranor në *Suren al-Kahf*, le t'ia fillojmë duke e paraqitur atë në tërësi:

"Uba'i ibn Ka'ab na tha ne se Profeti ka thënë: "Njëherë Musai iu adresua/ drejtua Banū Isrāīlve. Ai ishte pyetur "kush ishte njeriu më i ditur nga njerëzit". Ai u përgjigj: "Unë (jam më i dituri)". Allah-u e qortoi atë, pasi që ai nuk ia kishte atribuuar Atij (Allahut) burimin e diturisë absolute. Kështu që Allahu i tha atij: "Te bashkimi i dy deteve është një rob Imi, i cili është më i ditur se ti." Moisu pyeti: "O Zoti im! Si mund ta takoj atë?" Allah tha: "Merr një peshk dhe vendose në një shportë të madhe dhe do ta gjesh atë, në vendin ku do ta humbasësh peshkun."

"Musai e mori peshkun dhe e vendosi në shportë dhe vazhdoi së bashku me shërbëtorin e tij Joshua (Yashu'ah ibn Nun), derisa arritën te një shkëmb, ku u shtrinë për të pushuar. Musai fjeti dhe derisa ai po flinte, peshku doli nga shporta dhe u fut në det. Mori rrugë në det (drejt) si në tunel. Allahu e ndali rrjedhën e ujit përreth peshkut dhe u bë si një hark (Profeti e tregoi me shenjë të dorës këtë hark).

⁹ Shprehje në mënyrën figurative

“Udhëtuan tërë natën dhe ditën e nesërme Musai i tha shërbëtorit të tij: na jep ushqimin tonë, sepse vërtet jemi lodhur shumë nga udhëtimi. (Por) Musa nuk u ndie i lodhur, derisa e kaloi vendin të cilën Allahu e kishte urdhëruar ta kërkonte.

“Shërbëtori i tha atij: a e di se kur u ulëm afër gurit, unë e harrova peshkun (dhe askush pos shejtanit nuk më bëri që të harroj të flasë për këtë) dhe ai mori rrugë në det, në një mënyrë të mahnitshme. Aty kishte një rrugë për peshkun dhe kjo i mahniti ata. Musai tha: atë po e kërkonim ne.”

“Që të dy pastaj i ndoqën gjurmët e tyre, derisa u kthyen te guri. Aty ata e panë një njeri që ishte shtrirë i mbuluar me një mbulesë. Musai e përshëndeti atë dhe ai u përgjigj duke thënë: si e përshëndetin njëri-tjetrin njerëzit e vendit tënd? Musai tha: Unë jam Musa. Njeriu pyeti: Musai i Banū Isrāīl? Musai tha: Po. Ai pastaj vazhdoi: unë erdha te ti që të më mësosh nga gjërat të cilat t’i ka mësuar Allahu. Ai tha: O Musa! Kam diçka nga dituria e Allahut që ma ka mësuar Allahu dhe të cilën ti nuk e di, ndërsa ti ke diçka nga dituria e Allahut që ta ka mësuar Allahu, të cilën unë nuk e di. Musai pyeti: A mund të vij me ty? Ai u përgjigj: Po ti nuk do të kesh durim me mua, e si mund të kesh durim për gjërat të cilat janë përtej mundësisë sate të të kuptuarit? Musai tha: do të më gjesh vërtet durimtarë, nëse do Allahu dhe nuk do të të kundërshtoj ty aspak.

“Që të dy pastaj filluan të ecnin përgjatë bregut të detit. Aty pari kaloi një barkë dhe ata e pyetën ekuipazhin e barkës që t’i merrte me vete në barkë. Ekuipazhi e njohu al-Khidrin, kështu që ata i morën këta të dy në anije pa frikë. Kur hipën në barkë, erdhi një harabel dhe qëndroi në qoshe të barkës dhe e zhyti sqepin një a dy herë në det. Al-Khidr i tha Musasë: O Musa! Dituria ime dhe dituria jote nuk e kanë zvogëluar diturin e Allahut, aq sa ky harabel e ka zvogëluar ujin e detit me sqepin e tij. Pastaj papritmas al-Khidr mori një sqepar dhe e nxori një dërrasë dhe Musai nuk e vuri re, derisa ai e hoqi dërrasën me sqepar. Musai i th atij: Çfarë ke bërë? Ata na morën me vete në barkë pa pagesë, e ti me qëllim e bërë një vrimë në barkën e tyre, për t’i mbytur udhëtarët. Vërtet ke bërë një gjë të tmerrshme.

“Al-Khidr u përgjigj: A nuk të thashë se nuk do të mund të jesh i durueshëm me mua? Musai i tha: Mos më fajëso për atë që kam harruar dhe mos u bë i vështirë me mua për fajin tim. Kështu pra, arsyeja e parë e Musait ishte se kishte harruar.”

“Kur u larguan nga deti, ata kaluan pranë një djaloshi që po luante me djemtë e tjerë. Al-Khidr e kapi kokën e djalit dhe e shkuli me dorën e tij (Sufyan, që ritreguesi bëri gjest me majat e gishtave, sikur po shkulte ndonjë fryt). Musai i tha atij: A e mbyte një person të pafajshëm, i cili nuk e ka mbytur askënd? Me të vërtetë ke bërë një gjë të tmerrshme. Al-Khidr i tha: A nuk të thash se nuk do të jesh i durueshëm me mua? Musai tha: nëse të pyes edhe diçka tjetër pas kësaj, të lutem më lërë mua. Kam bërë shumë justifikime.”

“Pastaj të dy vazhduan, derisa arritën në një fshat dhe i lutën banorët e fshatit që t’u japin ushqim, por ata refuzuan që t’i mirëprisnin si mysafirë. Pastaj ata panë aty një mur që ishte gati të rrëzohej dhe al-Khidr e rregulloi atë, vetëm duke e prekur me duart e tij. (Sufyan, ritreguesi

bëri me duart e tij, duke ilustruar se si al-Khidri i kaloi duart e tij përmbi pjesën e sipërme të murit). Musai tha: këta janë njerëzit, të cilëve u kërkuam, por ata as nuk na dhanë ushqim e as nuk na pranuan si mysafirë, megjithatë ti ua përmirësove murin. Po të kishe dashur, do t'ua kishe caktuar një çmim për të.”

“Al-Khidr tha: Këtu ndahemi unë dhe ti dhe po të shpjegoj ato gjërat për të cilat nuk pate durim të prisje (për ti kuptuar). Profeti shtoi: Dëshirojmë sikur Musai të ishte durimtarë, përmes së cilës Allahu mund të na kishte treguar më shumë për ato ngjarje. (Sufyan, ritreguesi tha se Profeti tha: Allahu e Mëshiroftë Musanë! Sikur të kishte qëndruar i durueshëm, do të na kishte treguar më shumë për ngjarjen e tyre)”

(Sahih Bukhāri)

Tani i kthehemi parabolës së *Musait* dhe *Khidrit* siç tregohet në Suren al-Kahf. Pasazhi fillon me Ajetin gjashtëdhjetë dhe përfundon në Ajetin tetdhëjetedy:

Ajeti 60

﴿وَإِذْ قَالَ مُوسَىٰ لِفَتَاهُ لَا أَبْرَحُ حَتَّىٰ أَبْلُغَ مَجْمَعَ الْبَحْرَيْنِ أَوْ أَمْضِيَ حُقُبًا﴾

“(përkjto) Kur Musai djaloshit që e shoqëronte i tha: “Nuk do të ndalem së ecuri deri të arrijë vendtakimin e dy deteve, ose do të udhëtoj një kohë të gjatë.”

Ajeti 61

﴿فَلَمَّا بَلَغَا مَجْمَعَ بَيْنَهُمَا نَسِيَا حُوتَهُمَا فَاتَّخَذَ سَبِيلَهُ فِي الْبَحْرِ سَرَبًا﴾

“Kur arritën ata të dy vendtakimin e atyre deteve, e harruan peshkun e tyre, e ai (peshku) mori rrugën e vet si (strofull) në det.”

Ajeti 62

﴿فَلَمَّا جَاوَزَا قَالَ لِفَتَاهُ ءَاتِنَا غَدَاءَنَا لَقَدْ لَقِينَا مِنْ سَفَرِنَا هَذَا نَصَبًا﴾

“Pasi ata e kaluan atë vend, ai (Musai) i tha djaloshit: "Na jep sillën tonë (ushqimin), meqë nga ky udhëtim jemi lodhur.”

Ajeti 63

﴿ قَالَ أَرَأَيْتَ إِذْ أَوَيْنَا إِلَى الصَّخْرَةِ فَإِنِّي نَسِيتُ الْحُوتَ وَمَا أَنسَنِيهِ إِلَّا الشَّيْطَانُ أَنْ أَذْكُرَهُ ۚ وَاتَّخَذَ سَبِيلَهُ فِي الْبَحْرِ عَجَبًا ۝٦٣﴾



“Ai (djaloshi - Jushaë bin Nun) tha: "A e sheh!?" Kur u strehuam te shkëmbi, unë e harrova peshkun dhe përveç djallit, nuk më bëri kush ta harrojë që ta përkujtojë ty atë, dhe ai në mënyrë të çuditshme mori rrugën për në det.”

Ajeti 64

﴿ قَالَ ذَلِكَ مَا كُنَّا نَبْغِ ۚ فَارْتَدَّا عَلَىٰ آثَارِهِمَا قَصَصًا ۝٦٤﴾

“Ai (Musai) tha: "Ai është (vendi) që ne po e kërkojmë!" Dhe u kthyen që të dy rrugës së tyre prej nga kishin ardhur.”

Ajeti 65

﴿ فَوَجَدَا عَبْدًا مِّنْ عِبَادِنَا ءَاتَيْنَاهُ رَحْمَةً مِّنْ عِنْدِنَا وَعَلَّمْنَاهُ مِّنْ لَّدُنَّا عِلْمًا ۝٦٥﴾

“Dhe e gjetën një robë Tanë, të cilit i kemi dhuruar mëshirë nga ana e Jonë dhe e kemi mësuar me një dituri të posaçme nga Ne.”

Ajeti 66

﴿ قَالَ لَهُ مُوسَىٰ هَلْ أَتَّبِعُكَ عَلَىٰ أَنْ تُعَلِّمَنِي مِمَّا عُلِّمْتَ رُشْدًا ۝٦٦﴾



“Atij (Hidrit - njeriut të mirë e të dijshtëm) Musai i tha: "A pranon të vijë me ty, që të më mësosh nga ajo që je i mësuar (i dhuruar) ti: dituri të drejtë e të vërtetë?”

Ajeti 67

﴿ قَالَ إِنَّكَ لَنْ تَسْتَطِيعَ مَعِيَ صَبْرًا ﴾ ﴿٦٧﴾

“Ai (Hidri) tha: "Sigurisht, ti nuk do të mund të kesh durim me mua!"

Ajeti 68

﴿ وَكَيْفَ تَصْبِرُ عَلَىٰ مَا لَمْ تُحِطْ بِهِ خُبْرًا ﴾ ﴿٦٨﴾

“Si do të durosh për atë që nuk je i njoftuar?”

Ajeti 69

﴿ قَالَ سَتَجِدُنِي إِن شَاءَ اللَّهُ صَابِرًا وَلَا أَعْصِي لَكَ أَمْرًا ﴾ ﴿٦٩﴾

“(Musai) Tha: "Në dashtë All-llahu, do të shohësh se do të jem i durueshëm dhe nuk do të kundërshtoj ty asgjë!."

Ajeti 70

﴿ قَالَ فَإِنِ اتَّبَعْتَنِي فَلَا تَسْأَلْنِي عَنْ شَيْءٍ حَتَّىٰ أُحْدِثَ لَكَ مِنْهُ

ذِكْرًا ﴾ ﴿٧٠﴾

“Ai i tha: "Nëse më shoqëron ti mua, atëherë mos më pyet për asgjë, derisa unë vetë të të tregoj për të"."

Ajeti 71

﴿ فَأَنْطَلَقَا حَتَّىٰ إِذَا رَكِبَا فِي السَّفِينَةِ خَرَقَهَا ۖ قَالَ أَخَرَقْتَهَا لِتُغْرِقَ أَهْلَهَا لَقَدْ جِئْتَ شَيْئًا إِمْرًا ﴾ ﴿٧١﴾

“E ata të dy shkuan (duke ecur) deri kur hipën në anije, ai (i dishmi) e shqeu atë. Ai (Musai) tha: "A e shqeve që ti fundosësh udhëtarët e saj, vërtet bëre një punë të hatashme?."

Ajeti 72

﴿ قَالَ أَلَمْ أَقُلْ إِنَّكَ لَنْ تَسْتَطِيعَ مَعِيَ صَبْرًا ﴾ ﴿٧٢﴾

“Tha: "A nuk të thashë se nuk do të mund të kehs durim me mua?”

Ajeti 73

﴿ قَالَ لَا تُؤَاخِذْنِي بِمَا نَسِيتُ وَلَا تُرْهِقْنِي مِنْ أَمْرِي عُسْرًا ﴾

“(Musai) Tha: "Mos më qorto për se harrova dhe mos më mundo me vështirësi në këtë shoqërim timin (lehtësoma punën)!.”

Ajeti 74

﴿ فَأَنْطَلَقَا حَتَّىٰ إِذَا لَقِيَا غُلَامًا فَقَتَلَهُ قَالَ أَقْتَلْتَنِي نَفْسًا زَكِيَّةً
بِغَيْرِ نَفْسٍ لَّقَدْ جِئْتَ شَيْئًا نُكْرًا ﴾

“Vazhduan të shkojnë deri kur e takuan një djalë të ri, e ai (i dijsmi) e mbyti atë. (Musai) Tha: "A e mbyte njeriun e pastër, pa mbytë ai askë?! Vërtet ke bërë një pumë të shëmtuar!”

Ajeti 75

﴿ قَالَ أَلَمْ أَقُلْ لَّكَ إِنَّكَ لَنْ تَسْتَطِيعَ مَعِيَ صَبْرًا ﴾

“Ai (i dijsmi) tha: "A nuk të thashë se vërtet ti nuk do të mund të kesh durim me mua?”

Ajeti 76

﴿ قَالَ إِنْ سَأَلْتُكَ عَنْ شَيْءٍ بَعْدَهَا فَلَا تُصَحِّبْنِي ۖ قَدْ بَلَغْتَ
مِنَ لَّدُنِّي عُذْرًا ﴾

“(Musai) Tha: "Nëse pas kësaj të pyes (të kundërshtoj) për ndonjë gjë, atëherë mos më lejo të shoqëroj. Tashmë ndaj meje ke arsytim (të mos më shoqërosh)!”

Ajeti 77

﴿فَانْطَلَقَا حَتَّىٰ إِذَا أَتَيَا أَهْلَ قَرْيَةٍ اسْتَطْعَمَا أَهْلُهَا فَأَبَوْا أَنْ يُضَيِّفُوهُمَا فَوَجَدَا فِيهَا جِدَارًا يُرِيدُ أَنْ يَنْقَضَ فَأَقَامَهُ قَالَ لَوْ شِئْتَ لَتَّخَذْتَ عَلَيْهِ أَجْرًا﴾

“Vazhduan të shkojnë deri arritën te bannorët e një qyteti që prej tyre kërkuan t'u japin ushqim, po ata nuk deshën t'i pranojnë si mysafirë (e as t'i ushqejnë) e ata të dy gjetën një mur që gati rrëzohej, e ai e drejtoi atë (murin). (Musai) Tha: "Sikur të kishe dashur do t'u merrje shpërblim për këtë!”

Ajeti 78

﴿قَالَ هَذَا فِرَاقُ بَيْنِي وَبَيْنَكَ سَأُنَبِّئُكَ بِتَأْوِيلِ مَا لَمْ تَسْتَطِعْ عَلَيْهِ صَبْرًا﴾

“Ai (i dijsmi) tha: "Tash ka ardhur koha e ndarjes mes meje e teje, e unë do të tregoj për domethënien e asaj që nuk mund të keshë durim.”

Ajeti 79

﴿أَمَّا السَّفِينَةُ فَكَانَتْ لِمَسْكِينٍ يَعْمَلُونَ فِي الْبَحْرِ فَأَرَدْتُ أَنْ أَعِيبَهَا وَكَانَ وَرَاءَهُمْ مَلِكٌ يَأْخُذُ كُلَّ سَفِينَةٍ غَصْبًا﴾

“Sa i përket anijes, ajo ishte pronë e të varfërve, që veprojnë në det, e unë desha të bëjë atë me të meta, ngase para tyre ishte një sundues që grabiste çdo anije (të aftë - pa të meta)”

Ajeti 80

﴿وَأَمَّا الْغُلَامُ فَكَانَ أَبَوَاهُ مُؤْمِنَيْنِ فَخَشِينَا أَنْ يُرْهِقَهُمَا طُغْيَانًا وَكُفْرًا﴾

“Sa i përket djaloshit, dy prindërit e tij ishin besimtarë, e u frikësua se ai do t'i shpie ata të dy në humbje e në mosbesim.”

Ajeti 81

﴿ فَأَرَدْنَا أَنْ يُبَدِّلَهُمَا رَبُّهُمَا خَيْرًا مِّنْهُ زَكَاةً وَأَقْرَبَ رُحْمًا ﴾ ﴿٨١﴾

“Deshëm që Zoti t'u japë në vend të tij një më të mirë se ai dhe më të afërt në respekt dhe në mëshirë (ndaj prindërve).”

Ajeti 82

﴿ وَأَمَّا الْجِدَارُ فَكَانَ لِغُلَامَيْنِ يَتِيمَيْنِ فِي الْمَدِينَةِ وَكَانَ تَحْتَهُ كَنْزٌ لَهُمَا وَكَانَ أَبُوهُمَا صَالِحًا فَأَرَادَ رَبُّكَ أَنْ يَبْلُغَا أَشُدَّهُمَا وَيَسْتَخْرِجَا كَنْزَهُمَا رَحْمَةً مِّن رَّبِّكَ وَمَا فَعَلْتُهُ عَنْ أَمْرِي ۚ ذَٰلِكَ تَأْوِيلُ مَا لَمْ تَسْطِعْ عَلَيْهِ صَبْرًا ﴾ ﴿٨٢﴾

“Përsa i përket murit, ai ishte i dy djelmoshave jetimë të atij qyteti, e nën të ata kishin një thesar (ari) dhe babai i tyre ka qenë njeri i mirë, e Zoti yt dëshiroi që ata dy (jetimë) ta arrijnë pjekurinë e vet dhe ta nxjerrin ata vetë thesarin e tyre. Kjo ishte mëshirë e Zotit tënd (ndaj tyre). Dhe unë nuk e pranova tërë atë sipas bindjes sime (po sipas udhëzimit të Zotit). Ky, pra, është sqarim i asaj për të cilën nuk munde të kesh durim!”

(Kuran, Sūrah al-Kahf, 18: -60-82)

Kërcënimi që paraqet brendia e verbër dhe mesazhi i Khidr-it, për Myslimant në këtë epokë

Kuptimi i kësaj ngjarjeje në *Surën al-Kahf*, *Surja e Kuranit* e cila na mbron nga *Fitna e Dexhallit*, është se epoka e *Dexhallit* do të dëshmojë daljen e një epistemologjie që do ta pranojë (kuptojë) vetëm diturinë që vjen nga vëzhgimi i jashtëm. Secili që e merr (përqafton) këtë epistemologji të diturisë laike, do të verbohët në aspektin e brendshëm shpirtëror. Kur njerëzit e pranojnë vetëm një burim të diturisë, atë të vëzhgimit të jashtëm, përfundimisht do të bëhen njerëz, të cilët shohin vetëm me një sy, syrin e jashtëm, dhe si pasojë do të verbohën në brendësinë e tyre shpirtërore. Kur njerëzit janë të verbër nga brenda, ose të verbër shpirtërisht, po ashtu do të jenë edhe të shurdhër dhe të përkujtuarit e Allahut (dhikri) do të largohet nga zemrat e tyre. Religjioni (feja) pastaj do të bëhet vetëm një formalitet, diçka e përkufizuar vetëm me ‘emrin’, i.e. në formën e jashtme, porse nga substance e brendshme do të jetë e zbrazët. Kurani e përmend këtë fenomen që do ta karakterizojë epokën e *Dexhallit*:

﴿وَلَقَدْ ذَرَأْنَا لِجَهَنَّمَ كَثِيرًا مِّنَ الْجِنِّ وَالْإِنسِ لَهُمْ قُلُوبٌ لَا يَفْقَهُونَ بِهَا وَلَهُمْ أَعْيُنٌ لَا يُبْصِرُونَ بِهَا وَلَهُمْ آذَانٌ لَا يَسْمَعُونَ بِهَا أُولَٰئِكَ كَالْأَنْعَمِ بَلْ هُمْ أَضَلُّ أُولَٰئِكَ هُمُ الْغَافِلُونَ﴾

“Ne krijuam shumë nga xhinët e njerëzit për xhehennem. Ata kanë zemra që me to nuk kuptojnë, ata kanë sy që me ta nuk shohin dhe ata kanë veshë që me ta nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur, të tillët janë ata të marrët.”

(Kuran, al-‘Arāf, 7:179)

﴿وَنُقَلِّبُ أَفْعَدَتَهُمْ وَأَبْصَرَهُمْ كَمَا لَمْ يُؤْمِنُوا بِهِ أَوَّلَ مَرَّةٍ وَنَذَرُهُمْ فِي طُغْيَانِهِمْ يَعْمَهُونَ﴾

“Ne i rrotullojmë zemrat dhe të parët e tyre (prej besimit) ashtu sikundër nuk e besuan atë (Kur'anin) për herë të parë, dhe i lëmë të bredhin të hutuar në atë mashtrimin e tyre.”

(Kuran, al-An’ām, 6:110)

﴿خَتَمَ اللَّهُ عَلَىٰ قُلُوبِهِمْ وَعَلَىٰ سَمْعِهِمْ وَعَلَىٰ أَبْصَرِهِمْ غِشَاوَةٌ وَلَهُمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ﴾

“All-llahu ua mbylli atyre zemrat, veshët e tyre dhe në të pamurit e tyre ka një perde, e ata kanë një dënim të madh.”

(Kuran, al-Baqarah, 2:7)

﴿الَّذِينَ كَانَتْ أَعْيُنُهُمْ فِي غِطَاءٍ عَنْ ذِكْرِي وَكَانُوا لَا
يَسْتَطِيعُونَ سَمْعًا﴾

“Atyre që sytë i kishin të mbuluar ndaj argumenteve të Mia dhe që nuk mund të dëgjonin (fjallët e All-llahut)..”

(Kuran, al-Kahf, 18:101)

Epoka e *Dexhallit* do të jetë epoka e arritjeve shkencore, për të dalluar diturinë që vjen vetëm nga vëzhgimi i jashtëm. Ajo epokë aq shumë do ta largojë diturin nga feja, sa që do të vijë në përfundim se nuk do të ketë ndonjë realitet tjetër përtej realitetit material. Do ta përqafojë *Kufrin* e materializmit. Opinioni ynë i qëndrueshëm është se ne tani jemi duke jetuar në atë epokë (të *Kufrit*), në epokën e *Dexhallit*, *Kafirit* të madh.

Musai (‘*alaihi al-Salām*) e formuloi gjykimin e tij për të tria rastet, në bazë të vëzhgimit të jashtëm (ose dukjes së jashtme). Dhe në të tria rastet gjykimi i tij ishte i gabuar. Ai e dënoi dëmtimin e barkës. Dhe realiteti ishte se dëmi që i ishte bërë barkës, e kishte mbrojtur atë që të merrej nga mbreti. Kërcënimin që ia paraqet këtu njerëzimit, është se ata po ashtu do të gabohen në gjykimin e tyre dhe mund të paguajnë një çmim të shtrenjtë për gabimet. Myslimanet duhet të kërkojnë udhëheqës që sikurse *Khidri*, të jetë i bekuar me dituri të brendshme dhe kur ta gjejnë një udhëzues të tillë, duhet ta ndjekin atë.

Khidr (‘*alaihi al-Salām*) në këtë ngjarje ka bërë shumë më shumë sesa vetëm ta mbrojë pronën e barkëtarit të varfër. Ai dërgoi një mesazh të fuqishëm të besimtarët, të cilët jetojnë në epokën moderne të *Dexhallit*, Mesias së rremë, se ata do ta mbrojnë pasurinë dhe pronën e tyre e bile edhe jetën e tyre nga grabitqarët, banditët, rrëmbyesit dhe presioni i atyre që i sundojnë ata, nëse sigurohen që pasuria e tyre e dukshme (i.e., barka e tyre), të jetë jo tërheqëse për predatorët. Ai po ashtu e ka dhënë një mësim të rëndësishëm përkitazi me ligjin, i.e. se ligji moral është ligji më i lartë. Prandaj, nëse dikush do ta mbështesë ligjin moral, ai nuk duhet të përfillojë, ligjin në këtë tokë dhe duhet t’i japë përparësi ligjit moral.

Musai (‘*alaihi al-Salām*) e dënoi vrasjen e djaloshit, kurse, në fakt, djaloshi do të rritej e të bëhej një *Kafir*, *Kufri* i të cilit do ishte kërcënim për besimin e prindërve të tij. Me vrasjen e djalit, *Khidr* (‘*alaihi al-Salām*) e hoqi qafe një *Kafir* dhe e shpëtoi besimin e prindërve besimtarë, derisa lutej që Allahu më i Mëshirshmi t’ua zëvendësojë atë dajl me një tjetër që do të jetë burim i rehatisë dhe lumturisë për prindërit e tij.

Khidr (‘*alaihi al-Salām*) në këtë ngjarje bëri më shumë, sesa vetëm të mbrojë besimin e prindërve të djalit. Ai e dërgoi një mesazh të fuqishëm të besimtarët që kur ata të ballafaqohen me *Kufrin* e botës Moderne të pafe, e që është bërë e tillë nga *Daxhalli*, Mesia i rremë, ata duhet të ndjekin shembullin e *khidrit* (‘*alaihi al-Salām*) në vrasjen djalit, pra duke u distancuar nga bota e *Kufrit*, derisa i luten Allahut Më të Lartësuarit për ta zëvendësuar atë me një botë më të mirë, në të cilën besimtarët mund të jetojnë të sigurt dhe me besim. Kuptimi i dytë i vrasjes së

djalit është se ata duhet ta këpusin që në fillim bimën e kufrit e të mos e lënë të rritet, derisa të bëhet Kufur i madh.

Musai (*‘alaihi al-Salām*) e kuptoi riparimin e murit që ishte gati për t’u rrëzuar si nder ndaj njerëzve të qytetit, një nder që ata nuk e kishin merituar, për shkak të pritjes së tyre të keqe ndaj dy udhëtarëve të lodhur dhe të uritur. Për këtë arsye ai mendoi se ata duhet të paguanin për të. Realiteti ishte se me rindërtimin e murit, *Khidri* (*‘alaihi al-Salām*) i parandaloi njerëzit e qytetit për të marrë pasurinë, e cila fshihej nën atë mur. Kështu ai e mbrojti thesarin për dy jetimët, të cilët tani do kishin mundësi ta merrnin atë dhe të përfitonin nga ajo, kur të vinte koha.

Khidr (*‘alaihi al-Salām*) ka bërë më shumë këtu, sesa thjesht të ndërtojë një mur për të mbrojtur pasurinë e jetimëve. Ai dërgoi një mesazh të fuqishëm te besimtarët që ballafaqohen me luftën kundër Islamit, të cilën e ka sjellë *Dexhalli*, mesia i rremë. Kur ata të shohin përpjekjet për shkatërrimin e shtëpisë së Islamit, ata duhet të ndjekin shembullin e *Khidrit* (*‘alaihi al-Salām*), duke e rindërtuar atë shtëpi, kështu që thesari i së vërtetës në Islam të ruhet për gjeneratat e ardhshme. Pikëpamja ime është se shtëpia e Islamit, e cila po rrëzohet me të shpejtë në epokën moderne, mund të rindërtohet ose riparohet përmes themelimit të mijëra fshatrave të vogla myslimane në vendet larg qytetit. Fshatrat e tilla Myslimane do e kenë statutin e ngjashëm me thesarin e fshehur nën mur. Gjëja e rëndësishme është se Allah-u më i Lartësuari Vetë do t’i mbrojë fshatrat e tilla nga të këqijat, në të njëjtën mënyrë siç e ka mbrojtur thesarin në këtë parabolë në *Suren al-Kahf*.

Dexhalli, Musai dhe Khidr-i

Kush është *Dexhalli*? Sa e rëndësishme është tema e *Dexhallit* në Islam? Pse njihet ai si *al-Masīh ad-Dexhall* (Mesia i rrejshëm ose Anti-Krishti)? Si është ngjarja e *Muses* dhe *Khidrit* në *Sūren al-Kahf* të *Kuranit* e lidhur me tematikën e *Dexhallit*? Janë këto pyetje të mahnitshme dhe intriguese, të cilave do të përpikemi t’u përgjigjemi.

Rëndësia e tematikës së *Dexhallit* në Islam është mjaft e dukshme, nga fakti se Profeti i bekuar (*sdallallahu ‘alaihi wa sallam*) u ka kërkuar besimtarëve që të luten në *Namazin* e tyre për mbrojtje nga *Dexhalli*. Merre në konsideratë *Hadithin* në vijim të treguar nga Aisha, Abū Hurairah dhe Anas bin Malik (*Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë këta*):

“Treguar nga Aisha, gruaja e Profetit: i Dërguari i Allahut i lutej Allahut në namaz duke thënë: *Allahumma inni a’udhu bika min adhab alqabri, wa a’udhu bika min fitnah al-Masīh al-Dajjāl, wa a’udhu bika min fitnah al-mahya wa fitnah al-mamat. Allahumma inni a’udhu bika min al-mathami wa al-maghrami. (O Allah, kërkoj mbrojtjen Tënde nga dënimi i varrit, nga sprovat e Mesias-Dexhall dhe nga sprovat e jetës dhe të vdekjes. O Allah, kërkoj mbrojtjen tënde nga mëkatet dhe nga borxhi.)*”

(Sahīh Bukhārī)

“Treguar nga Abū Hurairah: I dërguari i Allahut është lutur (te Allahu) si në vijim: *Allahumma inni a’udhu bika min ‘adhab al-qabri, wa min ‘adhab al-nar, wa min fitnah al-mahya wa al-mamat, wa min fitnah al-Masīh al-Dajjāl. (O Allah, kërkoj mbrojtjen Tënde nga dënimi i varrit, nga*

dënimi i Zjarrit të Xhehenemit dhe nga vuajtjet e jetës dhe të vdekjes, si dhe vuajtjeve të al-Masīh al-Dexhall.)”

(Sahīh Bukhāri)

“Treguar nga Anas bin Malik: I Dërguari i Allahut i lutej Allahut kështu: O Allah! Kërkoj te Ti mbrojtje nga koprracia, përtacia, nga mosha e vjetër (dobësia), dënimi i varrit, nga Fitna (mashtrimi) i Dexhallit dhe nga Fitna (vuajtjet) e jetës dhe vdekjes.”

(Sahīh Bukhāri)

“Treguar nga Aisha: E dëgjova të Dërguarin e Allahut në lutjen e tij të kërkonte mbrojtje te Allahu nga Fitnah (sprova) e Dexhallit.”

(Sahīh Bukhāri)

“Abu Hurairah tha se i Dërguari i Allahut tha: Secili nga ju, kur ta përfundoni Tashahhudin (me të cilin duhet të përfundojë Namazi), duhet të kërkon mbrojtje te Allahu për katër sprova, i.e. nga Vuajtja e Xhehenemit, nga vuajtja e varrit, nga sprovat e jetës dhe të vdekjes dhe nga ligësia e Mesias Dexhall (Antikrishtit).”

(Sahīh Muslim)

Është me të vërtetë e çuditshme që Myslimanët në *Namazin* e tyre duhet t'i luten Allahut Më të Lartësuarit për mbrojtje nga *Dexhalli*, por megjithatë mbesin në gjendje të injorancës së thellë lidhur me këtë tematikë, përkundër faktit se Kurani dhe Profeti (*sdallalahu 'alaihi wa sallam*), që të dy, na kanë mësuar për *Dexhallin*. Pikërisht kjo është gjendja e përgjithshme e myslimanëve sot, i.e. ose gjendja e injorancës, ose e hutisë përkitazi me tematikën e *Dexhallit*.

Profeti (*sdallalahu 'alaihi wa sallam*) jo vetëm që u ka kërkuar besimtarëve të tij t'i luten Allahut për mbrojtje nga *Dexhalli*, por ai po ashtu i ka këshilluar besimtarët që të qëndrojnë sa më larg *Dexhallit*, pasi që ai do të jetë shumë i rrezikshëm. Ai po ashtu na ka informuar pikërisht për natyrën e rrezikut më të madh që vjen nga *Dexhalli*. Do të jetë pamundësia jonë për të kuptuar *realitetin* e botës në epokën e *Dexhallit*, qëllimi primar i të cilit do të jetë që ta korruptojë kapacitetin njerëzor për ta dalluar të 'vërtetën' dhe 'fenë e vërtetë'. Njerëzit qorrazi dhe me kokëfortësi të shkojnë pas gënjeshtres dhe të vërtetës së korruptuar dhe do ta kundërshtojnë të vërtetën e pakorruptuar në Kuran. Profeti (*sdallalahu 'alaihi wa sallam*) shpjegoi se sulmi i *Dexhallit* do të jetë në shkallë globale, kështu që do të përfshihet i tërë njerëzimi:

“Treguar nga 'Imran ibn Husayn: Profeti tha: Ai i cili dëgjon për Dexhallin, le të largohet sa më larg prej tij, se unë betohem në Allahun se një njeri do të shkojë tek ai duke menduar se është besimtar dhe do ta ndjekë atë nga idetë e hutuara që ai ia krijon atij.”

(Sunan Abu Dāūd)

“Treguar nga Anas bin Malik: Profeti tha: nuk do të ketë asnjë qytet në të cilin nuk do të hyjë Dexhalli, përveç Mekës dhe Medinës. Dhe nuk do të ketë hyrje (rrugë për në Mekë dhe

Medinë), në të cilën nuk do të qëndrojnë engjëjt në rreshta për ta mbujtur nga ai dhe Medina do të tundet tri herë së bashku me banorët e saj (i.e., do të ndodhin tri tërmete) dhe Allahu do t'i përzë të gjithë jobesimtarët dhe hipokritët nga ajo."

(Sahih Bukhāri)

Në shikim të natyrshmërisë së testeve dhe sprovave që bën Dexhalli, Profeti (*sdallallahu 'alaihi wa sallam*) ka paralajmëruar se kjo do të jetë Fitnja (sprova ose testi) më e madh që ka njohur njerëzimi, që nga koha e Ademit (*'alaihi al-Salām*), deri në ditën e fundit.

Ai më tutje na ka informuar se kur misioni i *Dexhallit* të jetë afër përfundimit, Allah-u do ta ngritë *Imam al-Mahdi* nga pasardhësit e Profetit Muhammad (*sdallallahu 'alaihi wa sallam*). Dexhalli do ta sulmojë atë për ta shkatërruar. Por, Allahu pastaj do ta zbresë Jezuin (*'alaihi al-Salām*) nga qielli dhe ai do ta vrasë *Dexhallin*. Vetëm atëherë do të përfundojë nata e gjatë dhe e tmerrshme e tundimit dhe ligësisë.

Ne kemi argumentuar në librin tonë '*Jerusalemi në Kuran*', që është një volum shoqërues i këtij libri, dhe tani jemi mjaft afër momentit, kur do të kthehet i Biri i Mejremes. Kjo nënkupton se lëshimi i *Dexhallit* në botë ka ndodhur para shumë kohësh.

Ky shkrimtar (autor) është i bindur se *Dexhalli* është truri i shpërthimit të civilizimit laik materialist perëndimor, mendimit të tij modern dhe stilit modern të jetesës me stil dhe distilim përherë e më dekadent. Është po ai civilizim, i cili po e nënshton njerëzimin ndaj testit suprem (*Fitnas*), për të cilin na kishte paralajmëruar Profeti. Një tipar i thjeshtë i këtij libri është shembulli që *Surah al-Kahf* jo vetëm që duhet të lexohet, por duhet të studiohet, nëse besimtarët duan të mbrohen nga ajo *Fitne e Dexhallit*.

Ky libër paralajmëron se mënyra moderne e jetesës si Euro-Krishterët dhe Euro-Çifutët, e cila tani po adoptohet pa ndonjë kritikë nga shumica e njerëzimit, duke përfshirë edhe shumicën e Myslimanëve, është tinëzare dhe mashtruese dhe mund t'i mashtrojë edhe besimtarët më të mirë. Ne jemi duke jetuar në atë epokë, në të cilën besimi i masave Myslimane veç është ndryshkur. Sigurisht, njëra nga shumë mënyrat me të cilën mund t'i kundërpërgjigjemi kësaj fatkeqësie, është ta kthejmë vëmendjen te *Surja al-Kahf* në *Kuran* dhe të bëjmë përpjekje ta përdorim Suren për ta kuptuar botën sot.

Verbëria e brendshme e Dexhallit – ai sheh vetëm me një sy.

Profeti Muhammad (*sallallahu 'alaihi wa sallam*) na ka transmetuar informata të rëndësishme përkitazi me karakteristikat më të rëndësishme të *Dexhallit*, Mesias së remë. Ai sheh vetëm me 'një' sy dhe si i tillë ka mundësinë të kapë vetëm '*Ilm al-Zāhir* ose diturinë e jashtme. Ai është i verbër në syrin e 'djathtë' dhe kjo simbolizon verbërinë e brendshme. Kështu ai e mohon ekzistimin e '*Ilm al-Bātin* ose diturisë së brendshme shpirtërore:

"Ibn Umar tha: Njëherë i dërguari i Allahut qëndroi mes njerëzve. E lartësoi dhe e madhëroi Allahun, ashtu siç Ai e meriton, e pastaj e përmendi Dexhallin duke thënë: "Unë po ju paralajmëroj juve për të (i.e. Dexhallin) dhe nuk ka pasur profet i cili nuk e ka paralajmëruar popullin e tij për të. Pa dyshim, Noah e ka paralajmëruar popullin e tij për të, por po u them për

të diçka që asnjë Profet nuk i ka treguar popullit të tij para meje. Duhet ta dini se ai ka vetëm një sy dhe Allahu nuk është vetëm me një sy.”

(Sahīh Bukhāri)

“Tregon Abdullah bin Umar: I dërguari i Allahut qëndroi mes njerëzve dhe iu lut dhe e Lartësoi Allahun, ashtu siç e meriton Ai, dhe pastaj e përmendi Dexhallin duke thënë: Po ju paralajmëroj kundër tij dhe nuk ka pasur Profet i cili nuk i ka paralajmëruar përcjellësit e tij për të; por po ju them diçka që asnjë Profet nuk u ka treguar përcjellësve të tij: Dexhalli është me një sy, ndërsa Allahu nuk është me një sy.”

(Sahīh Bukhāri)

“Tregon Abdullahi: Dexhalli ishte përmendur në prani të profetit. Profeti tha: Allahu nuk është i fshehur nga ju; Ai nuk është me një sy dhe me duar bëri kah sytë e tij, duke shtuar: përderisa al-Masīh ad-Dajjāl është i verbër në syrin e djathtë dhe syri i tij është si kokërr rrushi.”

(Sahīh Bukhāri)

“Tregon Ubadah ibn as-Samit: Profeti tha: Ju kam treguar aq shumë për Dexhallin, sa që jam i frikësuar se mund të mos kuptoni. Dexhalli është i shkurtër, me gishta si këmbët e pulës, flokë të dredhura, me një sy, me një sy që nuk sheh, as nuk është i dalë jashtë e as i futur në gropë. Nëse hutoheni lidhur me të, ta dini se Zoti i juaj nuk është me një sy.”

(Sunan Abū Dāūd)

“Ibn Umar tha: ne po flisnim për Hajjat-ul-Wada’, derisa Profeti ishte mes nesh. Ne nuk e dinim se çka do të thoshte Hajjat-ul-Wada’. Profeti e lavdëroi Allahun dhe pastaj e përmendi al-Masīh al-Dajjāl dhe e përshkroi atë në mënyrë ekstensive, duke thënë: “Allah-u nuk e ka dërguar asnjë profet, e ai profetë të mos e paralajmëronte popullin e vet për al-Masīh al-Dajjāl. Noah dhe profetët që e pasuan atë, i paralajmëruan popujt e tyre për të. Ai do të dalë mes jush (O përcjellës të Muhamedit) dhe nëse del që disa nga cilësitë e tij të fshihen nga ju, gjendja e Zotit tuaj është e qartë dhe nuk është e fshehtë nga ju. Profeti e tha këtë tri herë: “Vërtet, Zoti juaj nuk është i verbër në njërin sy, përderisa ai (i.e. Dexhalli) është i verbër në syrin e djathtë, i cili duket si rrush i fryrë jashtë gropës së tij...”

(Sahīh Bukhāri)

“Treguar nga Abdullahu: Profeti e përmendi para njerëzve al-Masīh al-Daexhall (Dexhallin, Mesian e rrejshëm), duke thënë: Allahu nuk është me një sy, derisa al-Masīh al-Dexhall është i verbër dhe syri i djathtë i duket si rrush i fryrë. Derisa flija mbrëmë afër Qabesë, pashë në ëndërr një njeri me ngjyrë kafeje, më i miri që mund ta shihni mes ngjyrës së kafenjës, dhe flokët i kishte aq të gjata, saqë i binin mes supeve. Flokët i kishte të drejta dhe ujët pikonte nga koka e tij dhe ai po i vendoste duart e tij në supet e dy burrave, derisa po i sillej përreth Qabesë. Unë pyeta: Kush është ky? Ata u përgjigjën: Ky është Jezui, i biri i Mejremes. Pas tij e pashë një njeri që kishte flokë shumë të dredhura dhe ishte i verbër në syrin e djathtë, që i përngjante në dukje Ibn Qatan (i.e. një jobesimtari mes arabëve). Ai i kishte vendosur duart e tij në supet e një personi, derisa po bënte Tawaf rreth Qabesë (i.e., sillej përreth Qabesë). Unë pyeta: kush është ky? Ata u përgjigjën: al-Masīh al-Dajjāl.”

(Sahīh Bukhārī)

“Treguar nga Anas bin Malik: Profeti tha: Asnjë profet nuk është dërguar e të mos i paralajmërojë përcjellësit e tij për gënjeshtarin me një sy (Dexhallin). Keni kujdes! Ai është i verbër në njërin sy dhe Zoti juaj nuk është i tillë. Dhe në mes syve të tij (Dexhallit), do të jetë e shkruar (fjala) Kāfir (i.e., jobesimtar). (Ky hadith po ashtu është transmetuar nga Abu Huraira dhe Ibn ‘Abbās.)

(Sahih Bukhārī)

Syri i verbër i Dexhallit duket si rrush i fryrë

“Treguar nga Abdullahu: Profeti e ka përmendur Mesian Dexhall (Dexhallin, Mesian e rremë) para njerëzve, duke thënë: Allahu nuk është me një sy, ndërsa al-Masīh al-Dajjāl është i verbër në syrin e djathtë dhe syri i tij duket si rrush i fryrë...”

(Sahīh, al-Bukhārī)

Përshkrimi përkitazi me rrushin e fryrë tregon se verbëria shpirtërore e *Dexhallit* dhe e të gjithë atyre që e ndjekin atë, do të jetë mjaft evidente për ata, të cilët shohin me të dy sytë. Do të jetë aq qartë e dukshme për ta, ashtu siç do të jetë një rrush i fryrë. Të vetmit që nuk do të jenë në gjendje ta dallojnë atë verbëri shpirtërore, i.e. që nuk janë në gjendje ta dallojnë syrin, i cili duket si rrushi i fryrë, do të jenë ata të cilët vetë janë në verbëri shpirtërore.

Do të jetë e qartë se informatat përkitazi me sytë e *Dexhallit* lidhen me simbolizmin religjioz dhe nuk duhet të merret drejtpërdrejt (fjalë për fjalë). Dëshmia në vijim e tregon në mënyrë përmbyllëse atë që u cek më lart. Së pari, Profeti (*sallallahu 'alahi wa sallam*) dyshonte për një djalë çifut në Medinë se ishte *Dexhalli*, edhe pse ai djalë nuk kishte vetëm një sy. Së dyti, Kur Tamīm al-Dārī u takua me personin e *Dexhallit* dhe pastaj i dha Profetit (*sallallahu 'alahi wa sallam*) dëshminë e një dëshmitari okular lidhur me takimin dhe përshkrimin e tij për Dexhallin, nuk është cekur njëri sy i tij. Kjo duhet të kishte qenë gjëja më e dalluar në tërë paraqitjen e tij fizike, sikur ai vërtet të ishte i verbër në njërin sy.

Fjala Kafir e shkruar mes syve të Dexhallit.

“Treguar nga Anas bin Malik: Profeti tha: Asnjë profet nuk është dërguar e që të mos i ketë paralajmëruar përcjellësit e tij kundër gënjeshtarit me një sy (Dexhallit). Kujdes! Ai është i verbër në njërin sy dhe Zoti i Juaj nuk është ashtu. Dhe në mes syve të tij (Dexhallit) do të jetë e shkruar (fjala) Kafir (i.e., jobesimtar). (Ky hadith po ashtu është transmetuar nga Abu Huraira and Ibn ‘Abbās).”

(Sahīh, al-Bukhārī)

Dëshmia se interpretimi i *Hadīthit* përkitazi me sulmin e *Dexhallit* mbi njerëzimin që u cekë më lart (i.e., sulmi i cili është i lidhur me njërin sy të tij), është epistemologjik, i.e., që i përket diturisë, burimit të diturisë dhe mënyrave për ta fituar atë dituri; ndodhet në *Hadithin* tejet të rëndësishëm, i cili fjalën Kafir e vendos mes dy syve të *Dexhallit*. Pasi që *Kufri* gjindet mes

syve të tij, tregon se ka të bëjë me të ‘parët’ e tij, ose me kapacitetin e tij për të parë dhe kështu pra për të kërkuar dituri. Së dyti, *Hadīthi* e bën shumë të qartë se *Kufri* i *Dexhallit* dhe si rrjedhojë Epoka e *Dexhallit* do të jenë mjaft evidente, i.e., jo të fshehura. Dikush duhet të jetë i verbër që të mos e dallojë Kufrin, pasi që është i shkruar mes syve të tij, i.e., mes mundësive të shikimit nga aspekti i jashtëm dhe aspekti i brendshëm.

Një nga karakteristikat dalluese të civilizimit modern perëndimor Euro-çifut dhe Euro-Krishter është *Kufri* që ka dalë nga Laicizmi i diturisë dhe si rezultat përjashtimi (kundërshtimi) i diturisë shpirtërore si burim të diturisë. E vetmja dituri e pranuar nga perëndimi Judeo-Krishter është dituria e asaj që mund të vrojtohet vetëm me anë të shqisave të informimit ekstern (sytë) etj. dhe si e tillë gjendet në universin material. Perëndimi aspak nuk e fsheh këtë karakteristikë të dalluar, e cila aq shumë është e manifestuar, saqë duket sikur fjala *Kafir* është e shkruar mes syve të saj (i.e. civilizimi perëndimor). Ne nuk themi se Civilizimi modern perëndimor është *Dexhalli*. Porse jemi të mendimit se është krijim i *Dexhallit* (është krijuar nga *Dexhalli*) dhe se i shërben *Dexhallit*. Implikimi i kësaj është se të gjithë ata që e imitojnë civilizimin perëndimor modern, do të jenë përcjellësit e *Dexhallit* dhe përfundimisht do ta përqafojnë mosbesimin e tij dhe do t’u shkatërrohet besimi i tyre në Allahun. Allahu Më i Lartësuar veç ka deklaruar se 999 nga çdo 1000 njerëz do të shkatërrohen dhe do të futen në zjarrin e ferrit!

Allahu Më i Lartësuar nuk është me një sy.

Sa i përket kësaj teme, një njeri me një sy është njeriu i cili sheh vetëm me një sy, i.e., syrin e jashtëm. Të gjithë ata që e ndjekin *Dexhallin* dhe mënyrën e jetesës të cilën do ta themelojë ai, që të gjithë do të bëhen njerëz me një sy. Kur *Hadidhi* deklaroi se Allahu nuk është me një sy, do të thotë se Allahu ka mundësinë t’i shohë që të dyja: edhe atë që është *al-Zāhir* (e dukshme), si dhe atë që është *al-Batin* (e fshehur dhe e mbuluar). Kështu pra, Ai mund të shohë edhe ‘paraqitjen’ edhe ‘realitetin’, që të dyja: edhe ‘formën’, edhe ‘përmbajtjen’. Allahu vetë deklarohet në Kuranin Famëlartë për këtë:

﴿هُوَ الْأَوَّلُ وَالْآخِرُ وَالظَّاهِرُ وَالْبَاطِنُ ۚ وَهُوَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ﴾

“Ai është i pari që s’ka fillim dhe i fundit që s’ka mbarim, i dukshmi dhe i padukshmi, dhe Ai është më i dijsmi për çdo gjë.”

(Kuran, al-Hadīd, 57:3)

Kur Musa (‘*alaihi al-Salām*’) u përgjigj se ai ishte njeriu më i ditur nga të gjithë njerëzit, ai bëri gabim se nuk e pranoi që e gjithë dituria vjen prej Allahut Më të Lartësuarit dhe se Ai, Allahu, është më i dituri nga të gjithë. Ai as nuk e pranoi se dituria e tij është e jashtëzakonisht e pakrahasueshme, e vogël dhe e imët, kur krahasohet me diturin e Atij që është më i dituri nga të gjithë. Dhe pikërisht kjo ndodh, kur dituria bëhet laike (ndahet nga dituria fetare).

KAPITULLI TETË NGJARJA E DHÛL KARNAIN

Rabinjët çifutë në Medinë ia dhanë fisit Arab të Kuraishëve tri pyetje që t’ia bënin Profetit Muhamed (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*), për ta testuar nëse ishte vërtet Profet i Allahut Më të Lartësuarit. Njëra nga tri pyetjet kishte të bënte me udhëtarin e madh, i cili udhëtoi në dy skajet e botës. Kur Rabinjët ia bënë pyetjen, sa na përket neve, ata kërkonin të dinin nëse Muhammadi (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) e dinte apo jo njërën nga Shenjat kryesore të Ditës së Fundit, që është Gog dhe Magog.

Para se të përpiqemi ta shpjegojmë tematikën e *Dhul Karnain* dhe implikimin e tij për epokën moderne, së pari le të cekim përgjigjen Kuranore për pyetjen që ishte bërë nga Rabinjët, përkitazi me udhëtarin e madh. Përgjigja fillon me ajetin tetëdhjetë e tre të *Sures al-Kahf* dhe vazhdon deri në ajetin njëqind e një:

Ajeti 83

﴿وَيَسْأَلُونَكَ عَنِ ذِي الْقَرْنَيْنِ ۖ قُلْ سَأَتْلُوا عَلَيْكُمْ مِنْهُ ذِكْرًا



“Të pyesin ty për Dhulkarnejnin, thuaju: "Do t’ju rrëfej për punën e tij me Kur'an (me shpallje)".”

Ajeti 84

﴿إِنَّا مَكَّنَّا لَهُ فِي الْأَرْضِ وَءَاتَيْنَاهُ مِنْ كُلِّ شَيْءٍ سَبَبًا

“Ne i mundësua atij forcë në tokë dhe i dhamë mundësi për çdo send që të mund të arrijë.”

Ajeti 85

﴿فَاتَّبَعَ سَبَبًا

“Ai iu rrek një aso mundësie (dhe mori rrugën nga perëndimi),”

Ajeti 86

﴿ حَتَّىٰ إِذَا بَلَغَ مَغْرِبَ الشَّمْسِ وَجَدَهَا تَغْرُبُ فِي عَيْنٍ حَمِئَةٍ وَوَجَدَ عِنْدَهَا قَوْمًا قُلْنَا يَبْدَأُ الْقَرْنَيْنِ إِنَّمَا أَنْ تُعَذِّبَ وَإِنَّمَا أَنْ تَتَّخِذَ فِيهِمْ حُسْنًا ﴾ 

Deri kur arriti vendperëndimin e diellit, e gjeti se po perëndon në njëfarë burimi me lym të zi dhe aty e gjeti një popull. E Ne i thamë: "O Dhulkarnejn, ose do t'i dënosh, ose do ti marrësh me të mirë e t'i udhëzosh!"

Ajeti 87

﴿ قَالَ أَمَّا مَنْ ظَلَمَ فَسَوْفَ نُعَذِّبُهُ ثُمَّ يُرَدُّ إِلَىٰ رَبِّهِ فَيُعَذِّبُهُ عَذَابًا نُّكَرًا ﴾ 

"Ai (Dhulkarnejni) tha: "Ai që vazhdon edhe mëtej të jetë zullunqar, atë do ta dënojmë, pastaj i kthehet Zotit të vet e Ai e dënon atë me një dënim të tmerrshëm"

Ajeti 88

﴿ وَأَمَّا مَنْ ءَامَنَ وَعَمِلَ صَالِحًا فَلَهُ جَزَاءٌ الْحُسْنَىٰ وَسَنُقُولُ لَهُ مِنْ أَمْرِنَا يُسْرًا ﴾ 

"Sa i përket atij që besoi dhe bëri vepra të mira, atij i takon shpërblimi më i mirë (Xhenneti) dhe atij nga ana Jonë do t'i bëjmë lehtësi (në jetë).."

Ajeti 89

﴿ ثُمَّ أَتَّبَعَ سَبَبًا ﴾ 

"Pastaj, ai iu rrek një aso mundësie (mori rrugën e lindjes)."

Ajeti 90

﴿ حَتَّىٰ إِذَا بَلَغَ مَطْلِعَ الشَّمْسِ وَجَدَهَا تَطْلُعُ عَلَىٰ قَوْمٍ لَّمْ
نَجْعَلْ لَهُم مِّن دُونِهَا سِتْرًا ﴾

“Deri kur arriti vendlindjen e diellit, e gjeti atë se po lind mbi një popull, që nuk i kemi dhënë ndonjë mbulojë prej tij (diellit).”

Ajeti 91

﴿ كَذَٰلِكَ وَقَدْ أَحَطْنَا بِمَا لَدَيْهِ خُبْرًا ﴾

“Ashtu (bëri edhe me këtë popull), e Ne e kemi ditur gjendjen e tij (mundësitë dhe sundimin e drejtë të tij).”

Ajeti 92

﴿ ثُمَّ أَتَّبَعَ سَبَبًا ﴾

“Mandej, ai iu rrek përsëri një aso mundësie (një rrugë të tretë mes perëndimit e lindjes - nga veriu).”

Ajeti 93

﴿ حَتَّىٰ إِذَا بَلَغَ بَيْنَ السَّدَّيْنِ وَجَدَ مِن دُونِهِمَا قَوْمًا لَّا
يَكَادُونَ يَفْقَهُونَ قَوْلًا ﴾

“Deri kur arriti mes dy kodrave (si penda) dhe mbrapa tyre gjeti një popull që thujse nuk kuptonte asnjë gjuhë (përveç gjuhës së vet).”

Ajeti 94

﴿ قَالُوا يٰذَا الْقَرْنَيْنِ إِنَّ يَأْجُوجَ وَمَأْجُوجَ مُفْسِدُونَ فِي
الْأَرْضِ فَهَلْ نَجْعَلُ لَكَ خَرْجًا عَلَىٰ أَنْ تَجْعَلَ بَيْنَنَا وَبَيْنَهُمْ سَدًّا ﴾



“Ata thanë: "O Dhulkarnejn, vërtet Jexhuxhi dhe Mexhuxhi janë duke bërë shkatërrime në tokë, a bën që ne të japim ty një kontribut (një formë tagri a tatimi), e që të bësh një pendë mes nesh dhe mes tyre?”

Ajeti 95

﴿ قَالَ مَا مَكَّنِّي فِيهِ رَبِّي خَيْرٌ فَأَعِينُونِي بِقُوَّةٍ أَجْعَلْ بَيْنَكُمْ وَبَيْنَهُمْ رَدْمًا ﴾

“Ai (Dhulkarnejni) tha: "Atë që mua ma mundësoi Zoti im është shumë më e mirë (nga ajo që më ofroni ju), po ju më ndihmoni me fuqi punëtore të bëj një pendë të fortë mes jush dhe mes atyre!”

Ajeti 96

﴿ ءَاتُونِي زُبَرَ الْحَدِيدِ ۖ حَتَّىٰ إِذَا سَاوَىٰ بَيْنَ الصَّدَفَيْنِ قَالَ أَنفُخُوا حَتَّىٰ إِذَا جَعَلَهُ نَارًا قَالَ ءَاتُونِي أُفْرِغْ عَلَيْهِ قِطْرًا ﴾

“Më sillni copa të hekurit! E kur e nivelizoi ai me dy anët e kodrave, tha: "Ndizni!" e kur e bëri atë (hekurin) zjarr (si zjarr nga të ndezurit) tha: "Më sillni bakër të shkrirë t'ia hedhë atij!”

Ajeti 97

﴿ فَمَا أَصْطَلِعُوا أَن يَظْهَرُوهُ وَمَا اسْتَطَاعُوا لَهُ نَقْبًا ﴾

“E ata as nuk arritën ta kapërcenin e as ta shponin.”

Ajeti 98

﴿ قَالَ هَذَا رَحْمَةٌ مِّن رَّبِّي ۖ فَإِذَا جَاءَ وَعْدُ رَبِّي جَعَلَهُ دَكَّاءَ ۚ وَكَانَ وَعْدُ رَبِّي حَقًّا ﴾

“Ai (Dhulkarnejni) tha: "Kjo është një e mirë nga Zoti im, e kur të vjen caktimi i Zotit tim, Ai e bën atë rrafsh, e caktimi i Zotit tim është i sigurt.”

Ajeti 99

﴿وَتَرَكْنَا بَعْضَهُمْ يَوْمَئِذٍ يَمُوجُ فِي بَعْضٍ وَنُفِخَ فِي الصُّورِ
فَجَمَعْنَاهُمْ جَمْعًا﴾

“(Kur të vijë caktimi i Zotit, ose kur të dalin Jexhuxh Mexhuxhët) Ne bëjmë atë ditë që ata të përzihen si valët njëra me tjetrën. Dhe i fryhet Surit (për herën e dytë) e të gjithë ata i tubojmë.”

Ajeti 100

﴿وَعَرَضْنَا جَهَنَّمَ يَوْمَئِذٍ لِلْكَافِرِينَ عَرْضًا﴾

“Atë ditë ua prezentojmë zhehenemin jobesimtarëve me një prezentim të hapët (trishtues).”

Ajeti 101

﴿الَّذِينَ كَانَتْ أَعْيُنُهُمْ فِي غِطَاءٍ عَنْ ذِكْرِي وَكَانُوا لَا
يَسْتَطِيعُونَ سَمْعًا﴾

“Atyre që sytë i kishin të mbuluar ndaj argumenteve të Mia dhe që nuk mund të dëgjonin (fjallët e All-llahut).”

(Kuran, al-Kahf, 18:83-101)

Pax Karnain (i.e., rregulli botëror i Dhul Karnain)

Në arabishte i referohet dikujt që i ka dy *Karns*. Kjo nënkupton ose dy ‘brirë’, ose dy ‘epoka’. Por, pasi që Kurani gjithmonë e ka përdorur fjalën *Karn* për t’iu referuar një kohe apo një epoke (ose një flete të librit të historisë) dhe asnjëherë si ‘brirë’, ne do të zgjedhim ta përkthejmë *Dhul Karnain* si njëri që ka ndikim në dy faqet e ndryshme të historisë. Dhe pasi që ne e gjejmë cakun e vërtetë të pyetjes së bërë nga Rabinjët çifutë, për atë Shenjën e madhe të Ditës së Fundit, e që është Gog dhe Magog, ne kemi pikëpamje se *Karnain*, i.e., dy epokat, i referohet edhe epokës në të kaluarën e largët, dhe epokës e cila do të vijë, e që është epoka e fundit ose epoka e *Fitnes*. Ne kemi qëndrimin se ne tani jemi duke jetuar në Epokën e Fundit dhe kështu edhe kjo ngjarje ka lidhje të drejtpërdrejtë me Myslimanët që jetojnë tani.

Kush ishte *Dhul Karnain*? Ky shkrimtar nuk ka gjetur ndonjë nevojë të domosdoshme për t’ia përkushtuar vëmendjen, nëse *Dhul Qarnain* ka qenë ndonjë personalitet historik apo jo.

Por ne besojmë se vëmendja duhet të drejtohet te veprimet e *Dhūl Qarnain* në ushtrimin e pushtetit dhe autoritetit të tij, sepse aty ndodhet thelbi i udhëzimit hyjnor që jepet në këtë ngjarje.

Sūra al-Kahf në këtë ngjarje na ka paraqitur tematikën e pushtetit dhe lidhjen e tij me besimin në Allahun Më të Lartësuarin. *Dhul Karnain* ka pasur besim në Allahun dhe ai ishte bekuar nga Allahu me forcën për të ndjekur qëllimet që i kishte zgjedhur. Kështu ai kishte kapacitetin për të themeluar, siç mund të shprehet në marrëdhëniet ndërkombëtare, si: *Pax Karnain* (i.e., rregulli botëror i *Dhul Karnain*). Në zemër të kësaj ngjarjeje alegorike është përshkrimi i një rregulli botëror, i ndërtuar njëherë e një kohë nga një njeri, i cili kishte besim në Allahun Më të Lartësuarin (i.e., *Pax Islamika*). Ne na paraqitet një përshkrim kritik i rëndësishëm i atij rregulli botëror.

Ngjarja pastaj vazhdon për të paralajmëruar daljen (paraqitjen) e rregullit botëror Gog dhe Magog, që dëshmon se pushteti përdoret pikërisht në mënyrën e kundërt nga ajo e *Dhūl Karnain*. Përfundimisht, premtimi që është dhënë në ngjarjen e diskutuar më herët për djelmoshat dhe shpellën se historia nuk do të përfundojë, para se ajo fletë e historisë të na vizitojë edhe një herë dhe kthimin e një rregulli botëror në të cilin pushteti (forca) do të përdoret, siç është përdorur nga *Dhūl Karnain*. Kjo do të ndodhë kur Mesia i vërtetë, Jezui (Isa a.s), i miri i Marisë (Merjemes), do të kthehet në botë për ta rivendosur të Vërtetën dhe rithemelimin e *Pax Islamicas*.

Pax Karnain – dhe udhëtimi në Perëndim.

Dhūl Karnain udhëtoi në drejtim të perëndimit, derisa arriti në një vend me ujë të errët dhe të zi dhe pa diellin tek perëndonte nën atë det me ujë (në aspektin poetik). Domethënia ishte se kjo ishte pika më largët në perëndim që ai mund të udhëtonte.

Ai e takoi një komunitet të njerëzve në një vend dhe Allahu Më i Lartësuari ia dha atij një zgjidhje për përdorimin pushtetit, për të dënuar ose për të shpërblyer. *Dhul Karnejn* me përgjigjen e tij e dha esencën (thelbin) e Pax Islamicas ose rregullin botëror Islamik. Ai deklaroi se do ta përdor pushtetin dhe autoritetin e tij për ta dënuar opresorin dhe kur të ketë përfunduar së dënuari atë, opresori do të ballafaqohet pastaj me dënim shtesë prej Zotit, kur të kthehet tek Ai.

Ky është lloji i rregullit botëror, të cilin Zoti do që njerëzit ta themelojnë the mbajnë. Një rregull i tillë botëror, i themeluar nga ata të cilët kanë besim në Allahun Më të Lartësuarin, do të dëshmojë një harmoni themelore mes urdhrit (rregullit) qiellor lart dhe rregullit botëror poshtë. Kjo tregon se dhuna largohet dhe vendoset drejtësia. Njerëzimi do të kënaqet me një gjendje të bekuar, në të cilën paqja dhe lumturia do të dominojnë.

Pax Karnain – udhëtimi deri në Lindje

Pas përshkrimit të udhëtimit në Perëndim, *Sūrah al-Kahf* pastaj vazhdon për të shpjeguar udhëtimin e *Dhūl Karnainit* në Lindje, ose te 'lindja e diellit'. Atje ai i pa disa njerëz për të cilët Allahu Më i Lartësuari deklaroi: "Nuk u Kemi dhënë atyre asnjë mbulojë prej tij". Ngjarja e shpjegon se *Dhūl Karnaini* iu përgjigjet atyre njerëzve në një gjuhë jashtëzakonisht të vështirë

për t'u interpretuar. "*Kadhālika*" ishte pjesa e parë e përgjigjes. Dhe kjo nënkupton se ai i *la ata, ashtu siç edhe i gjeti (pa i shqetësuar)*. Pjesa e dytë e përgjigjes e përshkruan *Dhūl Karnain* se e ka kuptuar tërësisht situatën e këtyre njerëzve.

E çka ishte ajo 'mbulesa' që Allahu Më i Lartësuar iu kishte dhënë atyre njerëzve, përveç asaj që ata nuk kishin 'mbulesë tjetër' dhe si e interpretojmë përgjigjen enigmatike të *Dhūl Karnainit* për situatën e tyre.

Qëndrimi që do përpiqemi ta shpjegojmë me masën mbrojtëse, Allahu e Di Më së Miri, është se *Sūrah al-Kahf* është këtu për t'i përgatitur besimtarët për epokën e Fitnes, kur uria e botës moderne për eksplorimin e të gjitha burimeve të tokës e në veçanti naftës, rezultojnë në mosrespektimin flagrant të të drejtave të njeriut. Njerëzit primitivë, prona e vetme e të cilëve janë tokat dhe shtëpitë e tyre, por (për shembull) territori i të cilëve është i pasur me naftë, do ta gjejnë vetën të ngjatur pa të dyja: pa tokë dhe pa shtëpi.

Dhūl Karnain e njehë dhe e kupton se njeriu dhe të drejtat e tij kanë përparësi mbi burimet natyrore, kështu që ai i *la ata njerëz të qetë, pa i ngacmuar pronat, tokën dhe shtëpitë e tyre*. Kur të vijë Epoka e fundit dhe kur masat të bien në varfëri të skajshme, përmes Ribas, besimtarët duhet të sigurojnë që ta respektojnë njeriun dhe të drejtat e tij, derisa përpiqen për t'i shfrytëzuar (për shembull) resurset tokësore.

Pax Karnain – dhe udhëtimi i tretë enigmatikë

Pas përshkrimit të dy udhëtimeve në Perëndim dhe në Lindje, duke iu përgjigjur kështu pyetjes së *drejtpërdrejtë*, të bërë nga Rabinjët çifutë, Kurani vazhdon të përshkruajë një udhëtim të tretë që ishte caku i vërtetë i pyetjes, edhe pse nuk është pyetje e drejtpërdrejtë nga Rabanjët.

Duke e përshkruar udhëtimin e tretë, Surja al-Kahf i cek për herë të parë emrat Gog dhe Magog. Lëshimi i tyre në botë do të shpallë një shenjë të madhe të Ditës së Fundit. Duhet të jetë e qartë se dituria përkitazi me shenjat e Ditës së Fundit, është një tematik përtej mundësisë së intelektit njerëzor. Në të vërtetë nuk mund të jetë tjetër, pos e drejtë e ruajtur e profetëve të Allahut Më Të Lartësuarit.

Sūraja na informon se *Dhūl Karnain*, në udhëtimin e tij të tretë, arriti te një popull që jetonte në një kalim të dy vargmaleve. Ata iu ankuan atij lidhur me Fasadën¹⁰ që Gog dhe Magog bëjnë në territorin e tyre. Ata i kërkuan atij që të ndërtojë një mur, i cili do t'i mbronte ata nga Gog dhe Magog. Ata ishin të gatshëm ta paguanin Dhul Karneinin, për ta ndërtuar atë mur për ta.

Gog dhe Magog (*Jehxhuxh dhe Mahxhuxh*)¹¹ janë dy komunitete të qenieve njerëzore, të cilat, sipas Profetit Muhamed (*sallallahu 'alaihi wa sallam*), janë pasardhës të Nuhut (*'alaihi al-Salām*). Siç është cekur më lart, ata janë agjentë të Fasāds. Porse Profeti i bekuar na ka njoftuar për një gjë që është komunikuar nga Allahu Më i Lartësuar në ligjëratën e drejtë (*Hadīth al-Kudsi*), duke cekur si në vijim: "*Unë kam krijuar krijesa të Mia (i.e., Gog dhe Magog) aq të fuqishme, sa askush pos meje nuk mund t'i shkatërrojë ata*". Kështu pra, ata me fuqinë e tyre të

¹⁰ Fasad nga arabishtja që do të thotë të prishësh (të korruptosh) gjithçka që prek.

¹¹ Emrat sipas Kuranit

padukshme mund të shkatërrojnë paqen në botë. Kjo do të thotë se sjellja e tyre është e kundërt me atë të *Dhul Karnain*.

Dhul Karnein e ndërtoi një mur të hekurt dhe e veshi atë me bakër të shkrirë. Muri e bllokoi tërë vendkalimin dhe si rezultat Gog dhe Magog ishin penguar, pasi që ata as nuk mund ta shponin murin e as ta kalonin atë. Ai pastaj deklaroi se ndërtimi i murit dhe si rezultat pengimi i Gog dhe Magog të ishte një manifestim i Mëshirës Hyjnore. Por, ai vazhdoi të informojë se Vetë Allahu do ta shkatërrojë murin dhe do t'i lëshojë Gougoun dhe Magogun në botë, në Epokën e Fundit.

Surja përmbyllet me një përshkrim të asaj që do ta përjetojë bota, kur Gog dhe Magog do të lëshohen në botë:

﴿ وَتَرْكُنَا بِعَضْمِهِمْ يَوْمَئِذٍ يَمُوجُ فِي بَعْضٍ وَنُفِخَ فِي الصُّورِ
فَجَمَعْنَاهُمْ جَمْعًا ۝ وَعَرَضْنَا جَهَنَّمَ يَوْمَئِذٍ لِلْكَافِرِينَ عَرْضًا
الَّذِينَ كَانَتْ أَعْيُنُهُمْ فِي غِطَاءٍ عَنْ ذِكْرِي وَكَانُوا لَا
يَسْتَطِيعُونَ سَمْعًا ۝﴾

“ (Kurt ë vijë caktimi i Zotitose kur të dalin Jehxhuxh Mahxhuxhët) Ne bëjme atë ditë që ata të përyihen si valët njëra me tjetrën. Dhe i fryhet Surit (për here të dytë) e të gjithë ata I tubojmë. Atë ditë ua prezantojmë xhehenemin jobesimtarëve me një prezantim të hapët (trishtues). Atyre që shtë i kishintë mbyllur ndaj argumenteve të Mia dhe që nuk mund të dëgjonin (fjalët e Allhut).

(Kurani al-Kahf 18: 99-101)

Kur Gog dhe Magog të lëshohen përfundimisht në botë (në Epokën e Fundit), njerëzimi do të dëshmojë daljen e një rregulli botëror, që do të jetë krejtësisht i kundër me atë që Islami ia ofron njerëzimit. Njerëzimi do të dëshmojë se fuqia (pushteti) do të jetë në dorë të atyre që nuk kanë besim në Allahun Më të Lartësuarin. Në vend që të përdorin forcën për t'i liruar të shtypurit dhe për t'i dënuar shtypësit, ajo epokë, kryesisht e pafe, do të dëshmojë se fuqia përdoret për të shtypur (në veçanti) ata që kanë besim në Allahun Më të Lartësuarin dhe sjellja e të cilëve është e drejtë.

Ne kemi argumentuar në librin tonë të titulluar ‘Jerusalemi në Kuran’ (shiko Kapitullin 10) se Allahu Më i Lartësuar i ka lëshuar Gog dhe Magog në botë gjatë jetës së Profetit Muhamed (sallallahu ‘alahi wa sallam).

Kurani u ka dhënë besimtarëve një shenjë me anë të së cilës ata jo vetëm se do të kenë dëshmi të qartë për lirimin e Gog dhe Magog, por, edhe më tepër se kaq, ata do të kenë dëshminë se bota

tani është në kontrollin e Gog dhe Magog. Ata kështu do të jenë në gjendje t'i identifikojnë Gog dhe Magog si Fuqinë Sunduese të botës. Kjo gjendet në referimin e Gog dhe Magog në Suren al-Anbiyāh:

﴿وَحَرَامٌ عَلَىٰ قَرْيَةٍ أَهْلَكْنَاهَا أَنَّهُمْ لَا يَرْجِعُونَ ﴿٩٥﴾ حَتَّىٰ إِذَا
فُتِحَتْ يَأْجُوجُ وَمَأْجُوجُ وَهُمْ مِّن كُلِّ حَدَبٍ يَنْسِلُونَ



“Ndërsa është e pamundur për (banorët e) një fshati të cilin e kemi shkatërruar Ne, të kthehen (në këtë jetë)- Derisa të hapet (penda) e Jexhuxh Mexhuxhëve dhe ata do të zbresin nga çdo bregore me shpejtësi.”

(Kuran, al-Anbiyāh, 21:95-6)

Kur Gog dhe Magog do të lëshohen në botë dhe, përveç kësaj, “të shpërndahen në çdo drejtim”, atëherë në atë kohë njerëzit e Qytetit, të cilët janë dënuar nga Allahu Më i Lartësuar dhe janë dëbuar nga qyteti i tyre (i cili ishte shkatërruar nga Allahu Më i Lartësuar), do të kthehen në atë qytet. Vetëm një qytet është shkatërruar nga Allahu më i Lartësuar dhe përmendet në Hadith përkitazi me Gog dhe Magog. Ai është Jerusalemi.

Pasi që asnjë qytet tjetër (i shkatërruar nga Allahu Më i Lartësuar), përveç Jerusalemit, nuk është cekur në *Hadith*, përkitazi me Gog dhe Magog, ne kemi ardhur në përfundim se qyteti që përmendet në *Sūrah al-Anbiyāh* (ajetet 95 dhe 96), mund të jetë vetëm Jerusalemi.

Nga ky konkluzion dhe identifikim i qytetit, tani del shpjegimi se kthimi i çifutëve në Tokën e Shenjtë është mundësuar përmes intervenimit të Gog dhe Magog. Me fjalë tjera, rregullit botëror Evropian, që tani e sundon botën nga Washingtoni, është rregulli botëror i Gog dhe Magog.

Kurani vazhdon të na paralajmërojë se kur ndodhin këto gjëra, bota do të dëshmojë llogaritjen e kohës “countdown”, deri në Ditën e Fundit:

﴿وَأَقْرَبَ الْوَعْدُ الْحَقُّ فَإِذَا هِيَ شَاخِصَةٌ أَبْصَرُ الَّذِينَ كَفَرُوا
يُؤْيَلْنَا قَدْ كُنَّا فِي غَفْلَةٍ مِّنْ هَذَا بَلْ كُنَّا ظَالِمِينَ ﴿٩٧﴾

“Dhe derisa të jetë afruar premtimi i saktë (*dita e kijametit*) e ai është momenti kur mbeten të shtangët sytë e atyre që nuk besuan (*në ato çaste thonë*): "Të mjerët ne, vërtet ishim krejt të pavetëdijshëm për këtë (*moment*); por jo, është e vërtetë se ishim zullumqarë të mëdhenj!”

(Kuran, al-Anbiyah, 21:97)

Kur të lëshohen Gog dhe Magog, ata do të shpërndahen në të gjitha drejtimet. Kjo tregon se me forcën e tyre të padukshme, ata do ta marrin në kontroll tërë botën dhe, për herë të parë në histori, një lloj njerëzish do ta kontrollojë tërë njerëzimin. E kjo është pikërisht bota jonë sot.

Rregulli botërorë i Gog dhe Magog do të jetë një rregull i Fasad-ës (i.e., dhunë dhe ligësi). *Sūrah al-Kahf* i ka përshkruar dy karakteristikat e Fasad-ës së rregullit botëror, që janë të kundërta me karakteristikat dalluese të rregullit botëror të *Dhūl Karnain*.

KAPITULLI NËNTË SŪRAH AL-KAHF: FILLIMI

Profeti i Bekuar (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*,) i ka këshilluar besimtarët që t’i recitojnë dhjetë *Ajetet* e para të *Sūrah al-Kahf* dhe ka deklaruar se kjo do t’i mbrojë ata nga *Fitna* (i.e., testi dhe sprovat) e *Dexhallit*, Mesias së remë ose Anti-Krishtit:

“Abu Darda ka treguar se i Dërguari i Allahut ka thënë: nëse ndonjëri i i mban mend dhjetë *Ajetet* e para të *Sūrah al-Kahf*, ai do të jetë i mbrojtur nga *Dexhalli*

(Sahīh Muslim)

“Ai i cili jeton për ta parë atë (i.e., *Dexhgallin*), duhet t’i recitojë para tij ajtet hyrëse të *Sures al-Kahf*.”

(Sahīh Muslim)

Tani i ekzaminojmë ato dhjetë *Ajetet* e para, për të gjetur substancën e mesazhit që e japin ato përkitazi me *Dexhallin* dhe rrezikun që ai paraqet për besimtarët. Gjëja e parë që ne e vërejmë në dhjetë *Ajetet* e para të *Sures* është se duke supozuar se *Bismalilahi* nuk llogaritet si ajeti i parë, ato përfundojnë me një *Du’ah* ose lutje. Ja ku është ngjarja që shpjegon *Duah*.

Ishin disa djelmosha, të cilët, edhe pse ishin të rinj, kishin besim në Allahun Më të Lartësuarin. Ata jetuan në një epokë, kur po bëhej luftë kundër Islamit dhe kur besimtarët shtyheshin të që t’i dorëzoheshin mënyrës së pafe të jetesës. Ata rezistuan, derisa u shtrënguan të largoheshin nga shtëpitë dhe qyteti i tyre, në mënyrë që ta ruanin besimin Islam. Ata ikën e u strehuan në një shpellë (dhe shpellat zakonisht gjenden në male) dhe ata bënë një *Du’ah* (lutje) tek Allahy Më i Lartësuar, për t’i ndihmuar, mbrojtur dhe udhëzuar. Dhjetë *Ajetet* e para përfundojnë me atë *Duah*:

﴿إِذْ أَوْى الْفِتْيَةُ إِلَى الْكَهْفِ فَقَالُوا رَبَّنَا آتِنَا مِنْ لَدُنْكَ رَحْمَةً
وَهَيِّئْ لَنَا مِنْ أَمْرِنَا رَشَدًا﴾

“Kur djelmoshat u strehuan në shpellë e thanë: O Zoti ynë, na dhuro nga ana Jote mëshirë dhe na përgatit udhëzim të drejtë në tërë çështjen tonë!”

(Kuran, al-Kahf, 18:10)

Kjo *Du'ah* (lutje) duhet të kuptohet si vetë çelësi me të cilin Myslimani mund të fitojë mbrojtjen Hyjnore nga *Dexhalli*, në momentet e rreziqeve dhe sprovave të mëdha. Për shembull: nëse një Mysliman është duke udhëtuar me avion dhe arrin në një aeroport, ku i ofrohet një zyrtar i emigracionit, i cili është armiqësor kundër Islamit, dhe përgatitet ta keqtrajtoj atë, është kjo *Duah* (lutje), e veçantë, e cila duhet të recitohet në një rast të tillë. Nëse një njeri ka kohë për ta bërë këtë, pastaj mund ta vazhdojë duke recituar të gjitha ajetet në fillim të *Sures al-Kahf*.

Ja dhjetë ajetet e para të *Sures*, së bashku me komentimin tonë, përmes të cilit ne përpiqemi të gjejmë lidhshmërinë me *Dexhallin*, Mesian e rrejshëm ose Anti-Krishtin (nëse lexuesi është i mendimit se ajeti i parë i *Sures* është *Bismilahu*, atëherë kjo në vijim do të jetë ajeti i dytë):

Ajeti 1-rë

﴿الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَنْزَلَ عَلَى عَبْدِهِ الْكِتَابَ وَلَمْ يَجْعَلْ لَهُ عِوَجًا
س﴾

“Falënderimi i takon vetëm All-llahut që ia shpalli robët (i.e. Profetët Muhamed) të vet Librin (i.e., *Kuranin*) dhe në të nuk lejoi ndonjë ‘luaxha (kundërthënie, shtrembërim, devijim nga rruga e drejtë, largim shtrembim si të brendshëm apo të jashtëm, etj.).”

Ajeti fillon me një dramë, pasi që Allahu Më i Lartësuar i Lavdëron Vetveten që ia ka zbritur *Kuranin* Shërbëtorit të Tij Muhamed (*sallallahu 'alaihi wa sallam*). Porse Muhammadi, Arabi (*sallallahu 'alaihi wa sallam*,) nuk ishte çifut dhe si rrjedhojë ky akt Hyjnor i vendosi Çifutët në një dilemë shqetësuese. Kurani i ka akuzuar Çifutët se e kanë korruptuar tekstin e Toras përmes rishkrimit të tij me dorën e tyre:

﴿ فَبَدَّلَ الَّذِينَ ظَلَمُوا قَوْلًا غَيْرَ الَّذِي قِيلَ لَهُمْ فَأَنْزَلْنَا عَلَى الَّذِينَ ظَلَمُوا رِجْزًا مِّنَ السَّمَاءِ بِمَا كَانُوا يَفْسُقُونَ ﴾

“E ata që ishin mizorë atë që u ishte thënë e ndryshuan me një fjalë tjetër, e Ne për shkak se ata kundërshtuan, lëshuam nga qielli një dënim kundër atyre që ishin mizorë.”

(Kuran, al-Baqarah, 2:59)

Ata që e korruptuan tekstin e Toran¹² (‘luaxha), në proces e sipër, e kanë bërë të pamundur për dikë që i beson Toras së prishur, që të pranojë një Profet që nuk është Çifut. Pas së gjithash, ata besuan se populli izraelit ishte populli i zgjedh i Allahut. Ata ishin elita shpirtërore e njerëzimit, fati i të cilëve ishte që përfundimisht ta sundojnë botën, në fundin e historisë. Jo çifutët e kanë pasur një status shpirtëror që, kur krahasohej me atë të çifutëve, ishte dukshëm më inferior, kështu që ishte e pamundur që çifutët të merrnin shpallje hyjnore, që i zbritej një jo-çifuti, ose që një jo çifut të zgjedhej si Profet i Allahut. Në veçanti, Torah e kishte bërë të pamundur që një Arab të pranohet si Profet, pasi që Arabët ishin pasardhësit e Ishmaelit (‘alaihi al-Salām) dhe Torah ishte rishkruar në mënyrë eksplicite, që të deklaronte se besëlidhja e Allahut ishte me Isakun (‘alaihi al-Salām), e jo me Ishmael-in (‘alaihi al-Salām). Përveç kësaj, ai (pra Tevrat i rishkruar) e kishte sharë Ishmail-in (‘alaihi al-Salām) si “njeri të egër - dorën e tij kundër çdo njeriu dhe dorën e çdonjërit kundër tij (Genesis, 16:12).

Megjithatë për rabinjët çifutë që jetonin në qytetin arabë të Jathribit (tani me emrin Medina), ishte sa e qartë, aq edhe shqetësuese, se Muhamedi, Arabi, ishte Profet i vërtetë i Allahut. Çifutët ishin tërbuar, se Allahu Më i Lartësuar i kishte zgjedhur një Arab, që të ishte pranuesi i shpalljes së fundit, e po që se e pranonin atë si Profet, i detyronte ata të pranonin se e kishin shtrembëruar Tevratin. Së dyti, supozimi i tyre për superioritetin racial mbi Arabët nuk do të kishte më mbështetje tekstuale.

Kurani e kupton shqetësimin e çifutëve dhe i përgjigjet atyre:

﴿ بِئْسَمَا أَشْتَرُوا بِهِ أَنْفُسَهُمْ أَنْ يَكْفُرُوا بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ بَغْيًا أَنْ يَنْزِلَ اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ عَلَى مَنْ يَشَاءُ مِنْ عِبَادِهِ ۖ فَبَاءُوا بِغَضَبٍ عَلَى غَضَبٍ وَلِلْكَافِرِينَ عَذَابٌ مُّهِينٌ ﴾

¹² Tevrat

“E shëmtuar është ajo për çka ata e shitën vetvetën. Atë që e shpalli All-llahu të mos e besojnë nga zilia, për shkak se All-llahu nga mirësia e Tij t'i shpallë atij që dëshiron nga robtë e vet. Andaj merituan zemërim mbi zemërim (gazep mbi gazep). Mosbesmtarët kanë dënim që i poshtëron.”

(Kuran, al-Baqarah, 2:90)

Kështu, që nga fillimi ekziston një indikacion i qartë, se *Sūrah* u adresohet kundërshtarëve çifutë të Muhamedit (*sallallahu 'alaihi wa sallam*) dhe Kuranit. Po ashtu, duhet të kuptojmë se vetë këta njerëz janë caku primar i *Dexhallit*.

Këto ajete e drejojnë vëmendjen te të gjitha korrupsionet që kanë ndodhur në tekstet e tyre të shenjta, që kishin zbritur para Kuranit, e në veçanti Tevratit. Kështu, një informatë për ta kuptuar *Dexhallin* dhe për t'i kuptuar sulmet të cilat ai do t'i bëjë kundër caqeve të tij, ndodhet në tekstet e shpikura e në veçanti Tevratit. Së dyti, pasi që Kurani është i pastër nga shtrembërimet, i tillë do të mbetet përgjithmonë. Kurani më së miri mund t'i ekspozojë shtrembërimet me të cilat tekstet (librat) e mëhershme (e në veçanti Tevrat) qenë korruptuar. Prandaj kjo është një çështje e rëndësishë së lartë, që Kurani të shfrytëzohet për t'i gjetur të gjitha korruptimet në tekstet e mëparshme. Kjo kërkon që ne të bëjmë një studim të thellë, jo vetëm të Kuranit, por, po ashtu, edhe të teksteve të mëparshme, tani të korruptuara, siç është Tevratit.

Përveç nëse e studiojmë Tevratin dhe zbulojmë ndryshimet që i janë bërë nga duart e njeriut, ne kurrë nuk do të jemi në gjendje të kuptojmë dhe shpjegojmë ardhjen e një epoqe, në të cilën 'Riba', Alkoholi dhe droga kanë një rol të përgjithshëm dominues. Nuk do të jemi në gjendje të kuptojmë lidhshmërinë mes alkoolizmit dhe 'Fundit të Historisë'. E as nuk do të jemi në gjendje të kuptojmë daljen e Ribas në ekonomi me 'paranë e letrës' (së shpejti të bëhet e padukshme dhe e paprekshme e që është paraja elektronike) dhe kamatës, 'sistemit bankar' që ka marrë kontroll të jetës ekonomike gjithkund.

“Profeti ka thënë: nyjat e Islamit do të zgjidhen një nga një, derisa të zgjidhet secila prej tyre dhe i pari prej tyre që do të zgjidhet, do të jenë rregullat në Librin e Allahut dhe i fundit do të jetë Namazi (falja).”

(Musnad Ahmad)

Njëra nga shenjat e afrimit të Ditës së Fundit (kur botës i vjen fundi), siç është parashikuar nga Profeti Muhamed (*sallallahu 'alaihi wa sallam*), është se sundimi i Librit të Allahut që e ndalon përdorimin e alkoolit, do të injorohet dhe do të ketë konsum të përgjithshëm të alkoolit dhe materieve të tjera dehëse:

“Anas tha se zemra e të Dërguarit të Allahut thotë: mes Shenjave të Orës së Fundit do të jetë largimi i diturisë, dominimi i injorancës, dominimi i imoraliteti (tradhtisë morale), dominimi i pirjes së verës, numri i vogël i burrave dhe numri i madh i grave, ashtu që pesëdhjetë gra do të kenë një burrë (mashkull) që të kujdeset prej tyre.”

(Bukhāri, Muslim)

Është mjaftë e qartë për ata të cilit e ndjekin misionin shpirtëror të Islamit (*al-Ihsān ose Tasawwuf*), se ne tani jetojmë në atë epokë, e cila është përshkruar nga Profeti (*sallallahu 'alaihi wa sallam*) si Epoka e Fundit. Për shembull, njëra nga çdo gjashtë shtëpi në Amerikë tani është e prekur nga alkoolizmi dhe numri është vazhdimisht në rritje. Pjesa tjetër e njerëzimit duket se është e dizajnuar (e gatshme) ta përqafojë nesër atë që Amerika e ka përqaftuar sot dhe kjo po ashtu është një nga shenjat e Allahut. Por, shumica e njerëzve janë të pavëmendshëm për Shenjat e Allahut:

..... وَإِنْ كَثِيرًا مِّنَ النَّاسِ عَنِ أَيْتِنَا لَغَفُلُونَ ﴿٩٢﴾

“... por vërtet shumica e njerëzve janë të pavëmendshëm për Shenjat Tona!”

(Kuran, Yūnus, 10:92)

Arsyeja për këtë mallkim të alkoolizmit është rishkrimi i teksteve hyjnore të dërguara nga Allahu Më i Lartësuar. Kjo është bërë në mënyrë që të shlyhet dallimi hyjnor kundër përdorimit të mjeteve dehëse, si dhe kamatës (*Ribās*). Kushdo që e ka rishkruar Tevratin, ishte aq i ligë, saqë e ka akuzuar rrejshëm një Profet të drejtë se është dehur. Me këtë rast, në atë gjendje të dehur, ai ka fjetur medhe i ka lënë shtatzënë dyja vajzat e tij, njëren pas tjetrës! Ajo ka qenë një gënjeshtër e madhe. Ka qenë një fyerje e madhe për Lutin (*'alaihi al-Salām*), një Profet i Allahut dhe një sharje, fyerje ndaj Allahut Më Të Lartësuarit (Shih librin e Gjenezës në Tevrat).

Allahu iu përgjigj asaj ligësie, duke e pastruar Lutin (*'alaihi al-Salām*) nga pislleku që ia kishin veshur atij:

﴿وَلَوْ طَأَّ أَتَيْنَهُ حُكْمًا وَعِلْمًا وَنَجَّيْنَاهُ مِنَ الْقَرْيَةِ الَّتِي كَانَتْ تَعْمَلُ الْخَبِيثَ إِنَّهُمْ كَانُوا قَوْمَ سَوْءٍ فَسِقِينَ﴾ وَأَدْخَلْنَاهُ فِي رَحْمَتِنَا إِنَّهُ مِنَ الصَّالِحِينَ ﴿٧٥﴾

“Dhe Ne Lutit i dhamë të jetë peygamber dhe i dijshtëm, andaj edhe e shpëtuam prej atij fshatit (vendbanimi) që bënte punë të ndyra, ata ishin popull i dëmshëm e i prishur. Atë (Lutin) e shpëtuam dhe e vëmë nën mëshirën Tonë, vërtet ai ishte prej më të mirëve”

(Kuran, al-Anbiyāh, 21:74-5)

Kur e korruptuan Fjalën e Allahut Më Të Lartësuarit, ata e mbjellën një farë të ligë. Allahu iu përgjigj kësaj me një dënim Hyjnor, duke e krijuar Dexhallin dhe pastaj duke e liruar

atë në botë. Dexhalli, organizatori (truri) i strategjisë që në Epokën e Fundit të rezultojë me rritjen e asaj fare të ligë në një lis të ligësisë së madhe, të cilin nuk mund ta presë askush. Dexhalli e udhëheq njerëzimin me aftësi dhe mashtrim të plotë, në një varësi të përgjithshme në alkool dhe gjëra të tjera, siç është droga. Malkom X mund të ketë deklaruar se alkoolizmi dhe vrasja nga droga, në botën laike perëndimore, është si rasti i *pulave që vijë në shtëpi për t'u pjekur* (metaforë).

Ne kemi demonstruar gjetkë se ajo që është e vërtet për alkoolin, është e vërtet edhe për Ribën. Allahu Më i Lartësuar i ka ndaluar konsumin e Ribas (dhëna e parave me kamatë). Ata e kanë sfiduar fjalën e Allahut, duke e rishkruar Tevratin, për të deklaruar se është e ndaluar për një besimtar (i.e., një izraelit), që të japë para me kamatë për një besimtarë tjetër, por ishte e lejuar dhënia e parasë me kamatë, për jo-izraelitët (jo-çifutët:

“Vëllait tënd nuk do t'i japësh hua me kamatë: interes për të holla, interes për ushqime ose çfarëdo gjëje tjetër që huazohet me interes. Të huajit mund t'i japësh hua me kamatë, por jo vëllait tënd, me qëllim që Zoti, Perëndia yt, të të bekojë në të gjitha gjërat, mbi të cilat do të vësh dorë në vendin ku je duke hyrë për ta pushtuar. . .”

(Ligji i Përtrirë, 23:19-20)

Ndërrimi i Fjalës së Allahut Më Të Lartësuarit ka qenë një krim tekstual (i librave). Ka qenë një vepër *Shirku* dhe një shembull i shtrembërimit, të cilit *Sūraja al-Kahf* i referohet që në fillim të *Sures*. Profeti i Bekuar (*sallallahu 'alaihi wa sallam*) na ka paralajmëruar për pasojat e këtij krimi, kur ka profetizuar se do të vijë një kohë, kur Riba do ta përqafojë tërë njerëzimin me një përqaqim vdekjeprurës:

“Abu Hurairah ka treguar se i Dërguari i Allahut ka thënë: Do të vijë një kohë mbi njerëzimin kur asnjë person i vetëm nuk do të ngelet pa konsumuar riban, e nëse ndonjëri nuk konsumon atë, tymi (ose, pluhuri i) saj do e arrij atë.”

(Ahmad, Abū Daūd, Nasāi, Ibn Mājah)


Tani mund të konkludojmë me vështirimin se ajeti i parë i *Sūrah al-Kahf* u ka dhënë besimtarëve një paralajmërim të rëndësishëm të veçantë. Thelbi i sulmeve të *Dexhallit* mbi njerëzimin do të gjendet në ajetet e tekstit (librit) të shpallur Hyjnor (p.sh. Tevratit), që janë ndryshuar dhe korruptuar. Kështu që besimtarët duhet ta kuptojnë dhe t'i studiojnë ato ndryshime, në mënyrë që t'i dallojnë sulmet e *Dexhallit* dhe t'u përgjigjen atyre në mënyrë adekuate.

Ajeti 2-të

﴿ قِيمًا لِّیُنْذِرَ بَأْسًا شَدِيدًا مِّنْ لَّدُنْهُ وَيُبَشِّرَ الْمُؤْمِنِينَ الَّذِينَ يَعْمَلُونَ الصَّالِحَاتِ أَنَّ لَهُمْ أَجْرًا حَسَنًا ﴾

(ia shpalli) Të saktë (*pa shmangie*), pët t'ua tërhequr vërejtjen (*atyre që nuk besojnë*) ndaj një dënimi të rëndë prej Tij, e për t'i përgëzuar besimtarët që bëjnë vepra të mira, se ata do të kenë një shpërblim të mrekullueshëm.”

Ka implikime shumë domethënëse dhe kërcënuese për njerëzimin, që dalin nga fakti se Allahu Më i Urti ka deklaruar se Kurani jo vetëm që është i pastër nga çdo korrupsion dhe kundërthënie (të brendshme, si dhe të jashtme), porse Vetë Ai (i.e. Allahu) do ta ruaj Kuranin (nga çdo korrupsion). Njerëzit e ligj i patën korruptuar librat (tekstet) e mëparshme, por nuk do të mund ta bëjnë të njëjtën gjë me Kuranin:



“Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij (nga çdo korrupsion).”

(Kuran, al-Hijr, 15:9)

Me fjalë të tjera, Kurani do të funksionojë si dëshmi: ose për, ose kundër shërbëtorëve të Allahut, të cilët besojnë ose nuk besojnë në të (i.e. Kurnain). Së dyti, pasi që Allahu tani na paralajmëron për një dënim të tmerrshëm dhe nuk e veçon se kush do të dënohet, si dhe pse, implikimi është se Kurani është ai i cili do t'i shpjegojë të gjitha gjërat e cekura më lart. Por, edhe ajetet po ashtu e transmetojnë një mesazh shprese dhe shpërblimi, për ata të cilët kanë besim (më së shumti në Kuran) dhe sjellja e të cilëve është e drejtë. Kështu pra, besimi në Kuranin dhe veprat e mira (duke e ndjekur *Synetin* e Pejgamberit Muhamed s.a.s.) janë përgjigjja më e mirë ndaj fitnes (sprovave) së *Dexhallit*.

Një implikim tjetër i këtij ajeti është se vetëm ata besimtarë të cilët e ndjekin Kuranin, kanë mundësi t'u mbijetojnë sulmeve të *Dexhallit*. Kështu, udhëheqja e besimtarëve në këtë epokë duhet të zgjidhet nga shërbëtorët e drejtë të Allahut Më të Lartësuarit, të cilët janë të bekuar me dije të madhe nga Kurani. Por, në veçanti ata liderë duhet të jenë në gjendje ta kuptojnë dhe ta zbatojnë udhëzimin e veçantë Kuranor që i aplikohet epokës moderne.

Ajeti 3-të



“ (*gjendje kënaqësie*) duke qenë në të përgjithmonë.”

Shpërblimi që i pret ata të cilët si rezultat i besimit dhe sjelljes së tyre të mirë i mbijetojnë stuhisë së ligë të *Dexhallit*, është se ata do të marrin një shpërblim të përherëshëm, e që është parajsa. Porse jeta e besimit dhe sjellja e drejtë do të jenë përherë e më shumë nën sulmin e *Dexhallit* që bën luftë kundër feve në përgjithësi dhe Islamit në veçanti. Do të jetë një jetë shumë e vështirë për ta jetuar. Ja ku janë *hadithet*, të cilat e përshkruajnë atë gjendje të vështirë:

Treguar nga Abū Tha'labah al-Khushāni: Abu Umajah ash-Sha'bani tha: e pyeta Abū Tha'labah al-Khushānin: "Cili është mendimi yt për ajetin "Kujdesuni për veten tuaj!". Ai tha: "Betohem në Allahun, e kam pyetur atë që është i mirinformuar për këtë; E kam pyetur të Dërguarin e Allahut për të." Ai tha: "Jo, të nxisim njëri-tjetrin të bëjmë atë që është e mirë dhe të ndalojmë njëri-tjetrin të bëjë atë që është e ligë. Por, kur sheh që po i binden koprracisë, po ndjekin epshin, po preferohen interesat e kësaj bote, secili kënaqet me mendimin e tij, atëherë kujdesu për veten tënde dhe lëre anash atë që e bëjnë njerëzit në përgjithësi, sepse para teje janë ditët që kërkojë durim, e durimi do të jetë sikur me e kap gacën. Ai i cili sillet drejt në atë periudhë, do ta ketë shpërblimin e pesëdhjetë burrave që veprojnë si ai." Një version tjetër ka. Ai tha: dëgjuesit pyetën, "O i dërguari i Allahut, shpërblimin e pesëdhjetë atyre?" Shpërblimin e pesëdhjetëve si ju."

(Tirmīdhī, Ibn Mājah, Abū Daūd)

Treguar nga Anas ibn Malik: I dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të) tha, "Do të vijë një kohë mbi njeëzimin, kur ai i cili e ruan (mbanë) fenë e tij, do të jetë si ai që e kapë (shuanë) gacën."

(Tirmīdhī)

Profeti i bekuar (sallallahu 'alaihi wa sallam) i ka përshkruar Sulmet e Dexhallit si Fitnet (i.e., testet, sprovat) më të mëdha që njerëzimi do t'i përjetojë, që nga koha e Ademit ('alaihi al-Salām) e deri në Ditën e Fundit.

Treguar nga Abū Qatādah: Shkonim te 'Imrān b. Husain, duke kaluar para Hishām b. Amir. Ai një ditë tha: "Ju kaloni para meje për të shkuar te dikush, por (mes të gjallëve) askush nuk ka qëndruar në shoqërinë e të Dërguarit të Allahut (paqja qoftë mbi të) më shumë se unë dhe askush nuk di më shumë hadithe sesa unë. E kam dëgjuar të dërguarin e Allahut (paqja qoftë mbi të) të thotë: Nuk do të ketë krijesë që krijon më shumë telashe sesa Dexhalli, që nga krijimi i Ademit e deri te Ora e Fundit."

(Sahih Muslim)

Kështu pra, drejtësia hyjnore ka urdhëruar që shpërblimi më i madh do të jetë për ata që shfaqin durimin më të madh në ruajtjen e besimit përpara testit më të madh nga të gjithë.

Ajetet 4 dhe 5

﴿وَيُنذِرَ الَّذِينَ قَالُوا اتَّخَذَ اللَّهُ وَلَدًا ۚ مَا لَهُمْ بِهِ مِنْ عِلْمٍ
وَلَا لِأَبَائِهِمْ كَبُرَتْ كَلِمَةً تَخْرُجُ مِنْ أَفْوَاهِهِمْ ۚ إِنَّ يَقُولُونَ
إِلَّا كَذِبًا ۚ﴾

“Për t'ua tërhequr vërejtjen atyre që thanë se All-llahu ka fëmijë Dhe për atë (fëmijë), as ata, e as të parët e tyre nuk kanë kurrfarë dijenie. Sa e madhe është ajo fjalë që del nga gojët e tyre, e ata nuk thonë tjetër vetëm se gënjeshtër!”

Komentatori i njohur modern i Kuranit, Muhammad Asad (*Allahu Më i Lartësuari pastë mëshir mbi shpirtin e tij*), e ka komentuar këtë ajet si në vijimë:

“‘Shumica e komentatorëve klasikë dhe, me sa di unë, të gjithë përkthyesit e hershëm të Kuranit e lidhin përemrin *Bihi* me sigurinë se 'Zoti e ka marrë për vete një djalë' dhe kështu mendojnë se kjo frazë të nënkuptojë: 'Ata nuk kanë dije për të', i.e. nuk dinë për një ndodhi të tillë. Megjithatë, ky përkthim është i dobët deri në atë pikë, saqë mungesa e diturisë jo doemos tregon një kundërshtim negativ të faktit që lidhet me të. Kështu pra, është e natyrshme që *bihi* nuk do të thotë për të (i.e. gjësendin ose konceptin), por do të thotë për Atë dhe lidhet me Zotin. Kështu pra, fraza duhet të kuptohet si kuptimi më i lartë - se ata të cilët bëjnë këso pohimesh absurde, nuk kanë dituri për Atë, pasi që i atribuojnë Qenies Supreme diçka që u atribuohet vetëm krijesave, qenieve jo të përkryera. Ky përkthim mbështetet në mënyrë të pabarabartë nga Tabari dhe si alternativë nga Baidāwī.” (Përkthimi dhe Komentimi i Kuranit Famëlartë nga Asadi).

Nga të gjitha ‘luaxha-t (i.e., shtrembërimet) me të cilat shkrimet e mëhershme ishin korruptuar, njëri që veçohet për t’u përmendur në veçanti, është se Allahu Më i Lartësuari është bërë Baba i një djali. Kurani cek besimin e çifutëve se Uzairi është i biri i Zotit dhe ngjashëm besimi i Krishterë që e njeh Mesian (Jezuiun) si djalë të Zotit:

﴿وَقَالَتِ الْيَهُودُ عُزَيْرٌ ابْنُ اللَّهِ وَقَالَتِ النَّصَارَى الْمَسِيحُ ابْنُ اللَّهِ ذَلِكَ قَوْلُهُمْ بِأَفْوَاهِهِمْ يُضَاهِئُونَ قَوْلَ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ قَبْلُ قَتَلَهُمُ اللَّهُ أَنَّى يُؤْفَكُونَ﴾

“E jehuditë thanë: Uzejri është djali i All-llahut, e të krishterët thanë: Mesihu është djalë i All-llahut. Ato ishin thënie të tyre me gojët e tyre (frazat të thata), që imitojnë thëniet e jobesimtarëve të mëhershëm. All-llahu i vraftë, si largohen (nga e vërteta)!”

(Kuran, al-Taubah, 9:30)

Një deklaram i tillë shkon deri te sharja e Zotit (*Shirku*). Është një mëkat shumë i rëndë. Në fakt është i vetmi mëkat, për të cilin Allahu Më i Lartësuari ka deklaruar se Ai nuk do ta falë (i.e., nëse dikush vdes pa e fituar mëshirën dhe faljen e Allahut, para vdekjes së tij). Kjo referencë që i bëhet *Shirkut* në fillim të *Sūras al-Kahf*, ka domethënie tejet të madhe për të kuptuar rrezikun e paraqitur nga *Dexhalli*, pasi që Profeti (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) ka paralajmëruar se Ymeti i tij do të sprovohet me blasfemi (*Shirk*) dhe se do të jetë e vështirë të

dallohet *Shirku*, “... aq vështirë”, ka thënë profeti, “sa është vështirë të dallohet milingona e zezë në gurin e zi, në natën e errët.” (Treguar nga Aisha, dhe regjistruar në Mustadraq-un e Hakimit)

Arma më e rrezikshme e *Dexhallit* do të jetë mundësia e tij për të mashtruar. Kështu pra, ai aq shumë do ta fsheh *Shirkun*, sa që do të jetë shumë i vështirë për çdonjërin që ta dallojë atë. *Shirku* i *Dexhallit* veç e ka ngritur kokën e shëmtuar në të gjithë botën dhe i gjithë njerëzimi, përveç atyre shërbëtorëve të Allahut Më të Lartësuarit që janë të udhëzuar drejt, janë kurthuar nga ajo blasfemi (*Shirk*). Për shembull: shirku kur njerëzit votojnë në zgjedhje në një shtet Kushtetuta laike e të cilit deklaroi (siç është kushtetuta e vendit tim në Trinidad dhe Tobago): “Kjo Kushtetutë është Ligji suprem i këtij e atij shteti dhe çdo ligj tjetër (përfshirë edhe Ligjin e Të Madhit Zot), i cili nuk është në përputhje me këtë kushtetutë, është i pavlerë, për aq sa nuk është në përputhje.”

Implikimi tjetër i mahnitshëm që del nga “thënia e gënjeshtërave për Allahun”, siç është gënjeshtër se Ai ka një djalë, është se *Dexhalli* do ta kurthojë papritmas njerëzimin me gënjeshtër të mëdha, sa që ai do të tundet. Ndihmësit e tij do të sjellin gënjeshtër të tilla, si p.sh.: “armët e shkatërrimit në masë në Irak”, “Kërcënimi nuklear i Iranit”, se “Arabët dhe Myslimanët kanë qenë përgjegjës për sulmet e 11 shtatorit në Amerikë” dhe të sulmeve pasuese në Londër. Kurani proklamon: “Ata përpiqen ta mashtrojnë All-llahun dhe ata që u besuan, por, në të vërtetë, ata nuk mashtrojnë tjetër kënd, pos vetvetes, por ata nuk e hetojnë.” (Kurani, al-Bakarah, 2:9). Përfundimisht ata janë të mallkuar t’iu besojnë gënjeshtërave të tyre. Prandaj, mysliimanët që jetojnë në këtë epokë, duhet të dëgjojnë fjalët e Profetit Muhamedit (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*), i cili ka paralajmëruar: “Në epokën e fundit do të ketë gënjeshtarë të mëdhenj, kështu që keni kujdes!” Gënjeshtër më e madhe do të jetë aq mirë e thurur në misionin e pandalshëm për ta bërë shtetin mashtrues Euro-çifut të Izraelit si shtetin *sundues* të botës.

Ajeti 6

﴿ فَلَعَلَّكَ بَاخِعٌ نَفْسَكَ عَلَىٰ آثَرِهِمْ إِنْ لَمْ يُؤْمِنُوا بِهَذَا
الْحَدِيثِ أَسَفًا ﴾

”A thua ti, do ta shkatërrosh veten nga hidhërimi pas tyre, nëse ata nuk i besojnë këtij ligjërimi (Kur'anit)?”

“Kjo pyetje retorike i adresohet në rastin e parë Profetit, i cili ishte i shqetësuar thellë nga armiqësia që kishte ngritur mesazhi i tij te paganët e Mekës dhe vuante dhimbje, ngase e kuptonte fatin e tyre shpirtëror. Megjithatë, përtej kësaj u aplikohet të gjithë atyre, të cilët janë bindur për të vërtetën e një propozimi etik; është llahtarisje për indiferencën që ambienti i tij shoqëror reagon ndaj asaj.” (Përkthimi dhe Komentimi i Kuranit Famëlartë nga Asadi).

Njerëzimi është i përbërë nga tre lloj njerëzish. Së pari janë ata të cilëve u ka ardhur e Vërteta dhe e kanë pranuar atë. Pastaj ata kanë vepruar sipas saj. Ata janë besimtarët dhe ata janë

të sigurt për shpërblimin e parajsës. Së dyti, janë ata të cilëve u ka arritur e vërteta, por e kanë kundërshtuar atë. Atëherë ata kanë arritur në një nivel të kundërshtimit të tyre, kur Allahu ua ka vulosur zemrat e tyre ndaj të vërtetës. Pa marrë parasysh se sa u predikon atyre, kurrë nuk mund t'i kthesh ata njerëz në të vërtetën. Ata janë jobesimtarë (*Kuffār*). Parajsa është *Harām* (e ndaluar) për ta. Dhe në fund, janë ata njerëz të cilëve ose nuk iu ka arritur e vërteta, ose iu ka arritur e vërteta, por as nuk e kanë pranuar e as nuk e kanë kundërshtuar atë; ose e kanë pranuar, por nuk kanë vepruar sipas saj etj., është e drejta e hyjnore që dënon, ose i falë njerëzit e tillë.

Në këtë *Āyah* (strofë, rresht), Allahu Më i Lartësuari ia përkujton Profetit të Bekuar (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) se ka të tillë, zemrat e të cilëve janë vulosur dhe sa të duash predikoju atyre, nuk i sjell ata te e vërteta. Përkujtimi po ashtu nënkuptohet edhe për besimtarët të cilët në epokën e *Dexhallit* do të jenë dëshmitarë për numrin përherë e në rritje të njerëzve të cilët janë të destinuar për zjarrin e ferrit. Sado që u predikohet atyre, kurrë nuk do ta ndryshojnë qasjen e tyre armiqësore ndaj Islamit. *Sūrah al-Kahf* këtu i këshillon besimtarët përmes pyetjes që i është bërë Profetit të bekuar (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*), që ta largojnë vëmendjen e tyre nga bota që këmbëngul në kundërshtimin e Islamit. Ata, në vend të kësaj, duhet të përqendrohen në ruajtjen e besimit të tyre. Ja ku janë vetë fjalët e bukura të udhëzimit Hyjnor lidhur me këtë:

﴿وَأَصْبِرْ نَفْسَكَ مَعَ الَّذِينَ يَدْعُونَ رَبَّهُمْ بِالْغَدَاةِ وَالْعَشِيِّ يُرِيدُونَ وَجْهَهُ ۖ وَلَا تَعْدُ عَيْنَاكَ عَنْهُمْ تُرِيدُ زِينَةَ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَلَا تُطِعْ مَنْ أَغْفَلْنَا قَلْبَهُ عَن ذِكْرِنَا وَاتَّبَعَ هَوَاهُ وَكَانَ أَمْرُهُ فُرُطًا ۝﴾

“Përkufizojë veten tënde me ata që lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje, e që kanë për qëllim kënaqësinë (razinë) e Tij, dhe mos i hiq sytë e tu prej tyre e të kërkosh bukurinë e kësaj bote dhe mos iu bind atij që ia kemi shmangur zemrën e tij prej përkjtimit ndaj Nesh dhe i është dhënë epshit të vet, pse puna e tij ka mbaruar .”

(Kuran, al-Kahf, 18:28)

Numri i atyre që e kundërshtojnë Islamin do të rritet në mënyrë konstante në Epokën e Fundit dhe këta njerëz me dëshirën e tyre do t'i bashkëngjiten luftës kundër Islamit, ose do të joshen për ta bërë këtë. Myslimanët duhet ta dallojnë rrezikun e të jetuarit në mes të një ambienti të tillë. Ata duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje ruajtjes së sigurisë personale (natyrisht, duke përfshirë gratë dhe fëmijët e tyre) dhe besimin (fenë) e tyre, sesa të ruajnë punët që paguhen mirë në lamën e dreqit. Ata (myslimanët) mund ta bëjnë këtë më së miri duke e ndjekur shembullin e *Dhul Karnain*, duke ndërtuar një mur që do t'i mbrojë ata nga rregulli botëror *Gog* dhe *Magog*. Ai mur (i padukshëm) më së miri mund të ndërtohet rreth Fshatrave Myslimane që gjinden në vendet larg qyteteve.

﴿ إِنَّا جَعَلْنَا مَا عَلَى الْأَرْضِ زِينَةً لِّهَا لِنَبْلُوهُمْ أَيُّهُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا ﴾



“Gjithçka që është mbi tokë, Ne e bëmë stoli të saj, për t'i provuar ata, se cili prej tyre do të jetë më vepërmirë.”

Asad ka komentuar: “Drejtëpërdrejt Ne e kemi bërë atë që është në tokë si stoli, ashtu që t'i vendosim ata [i.e., tërë njerëzimin] në test”, që do të thotë se Zoti i le ata që t'i shpalosin karakteret e tyre të vërteta përmes sjelljeve të tyre - morale ose imorale - ndaj të mirave materiale dhe dobitë, të cilat ato ua sjellin atyre. Në një analizë më thellë, ky pasazh tregon se motivi i vëretetë që e thekson kundërshtimin e njeriut për të besuar në mesazhin shpirtëror të Zotit, është, pothuajse gjithmonë, lidhja e tepërt dhe e verbër me të mirat materiale të kësaj bote, e përzier me një krenari të rrejshme për atë që ata e quajnë arritje e tyre personale.”

(Asad, Përkthimi dhe Komentimi i Kuranit të Lavdishëm).

Sūrah al-Kahf i paralajmëron besimtarët në këtë Ajet se *Dexhalli* do të vendosë një kurth, duke i nxitur ata që të lakmojnë gjërat e kësaj bote. Kur zemra ngjitet shumë për të mirat e kësaj bote, atëherë ajo zemër fillon të humbë përkujtimin e përhershëm të Allahut. Për t'iu mbijetuar sprovave të *Dexhallit*, besimtarët duhet të jetojnë në këtë botë dhe ta jetojnë jetën e kësaj bote me një *Dhikr* (përkujtim) të përhershëm të Allahut Më Të Lartësuarit. Zotin të cilin e adhurojmë, është ai i cili është suprem në zemër (pa marrë parasysh pohimin e zëshëm me gojë). Zemra e besimtarit në Allahun Më të Lartësuar duhet të jetë zemër, në të cilën Allahu Më i Lartësuar është Suprem. Nëse *Dunjaja* (bota) është më supreme në zemër sesa Allahu, atëherë de fakto që ai është adhurues i *Dunjas* (botës).

Dexhalli jo vetëm që kërkon ta korruptojë besimin (fenë) e besimtarëve përmes pasurisë, por ai, po ashtu, i drejton ata që përfundimisht të besojnë se nuk ka realitet tjetër përveç realitetit material (materializmi). Ai proces përfundimisht arrin në kulmin e ateizmit *de fakto*. Ata të cilët sot e kontrollojnë botën, janë përherë e në rritje të përqafimit të ateizmit. Në të vërtetë, një numër përherë e në rritje i britanikëve publikisht po e konfirmojnë (*de fakto*) besimin tyre ateist. Kjo themelon dëshminë dramatike të suksesit marramendës të *Dexhallit*.

8th Ajeti

﴿ وَإِنَّا لَجَاعِلُونَ مَا عَلَيْهَا صَعِيدًا جُرُزًا ﴾

“Ne kemi për ta bërë gjithçka që është mbi të dhe pa bimë (shkatërrojmë çdo gjelbërim).”

Ashtu siç u krijua çdo gjallesë prej ujit, ashtu në të vërtetë uji do të jetë shkaktari i shkatërrimit përfundimtar i tërë jetës. Mashtrimi i *Dexhallit* do të jetë i tillë, saqë njerizimi do të

jetë arkitekti i shkatërrimit të vet, pasi që mbeturinat dhe tej konsumi i ujit do të çojë në mungesën e tij.

Kjo tematikë e rëndësisë së ujit dhe rolit që uji do të luajë në Epokën e Fundit, është po ashtu e lidhur në mënyrë intime me *Jaxhuxh* (Gog) dhe *Maxhuxh* (Magog), për të cilët *Suraj al-Kahf* ka shumë për të thënë. Me këtë tematikë do të merremi, *Inshā Allah*, në volumn e katërt të këtyre librave për *Sūrah al-Kahf* (i.e., Gog dhe Magog në Kuran dhe *Hadith*).

Përfundimisht toka do të kthehet në një 'pjtë me pluhur'. *Sūrah al-Kahf* pa ndërprerë i kthehet shembullit të ujit, për shembull:

﴿وَأَضْرَبَ لَهُمْ مَثَلَ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا كَمَاءٍ أَنْزَلْنَاهُ مِنَ السَّمَاءِ فَاخْتَلَطَ بِهِ نَبَاتُ الْأَرْضِ فَأَصْبَحَ هَشِيمًا تَذْرُوهُ الرِّيحُ ۗ وَكَانَ اللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ مُّقْتَدِرًا ۝٤٥﴾
 ﴿الْحَيَاةِ الدُّنْيَا ۖ وَالْبَاقِيَتُ الصَّالِحَتُ خَيْرٌ عِنْدَ رَبِّكَ ثَوَابًا وَخَيْرٌ أَمَلًا ۝٤٦﴾

“E ti (Muhammed) paraqitjau atyre shembullin e kësaj bote që ëshë si një ujë (shi) që Ne e lëshojmë nga qielli, e prej tij bima e tokës zhvillohet e shpeshëtohet sa që përzihet mes vete, e pas pak ajo bëhet byk (pas tharjes) që e shpërndajnë erërat. All-llahu ka fuqi për çdo send pasuria dhe fëmijët janë stoli e kësaj bote, kurse veprat e mira (frtyi i të cilave është i përjetshëm) janë shpërblimi më i mirë te Zoti yt dhe janë shpresa më e mirë.”

(Kuran, al-Kahf, 18:45-6)

Abdullah Yusuf Ali ka komentuar shumë bukurë në këto dy ajete Ayāt (rreshta) të Sures al-Kahf si në vijimë:

“Uji i shiut është i mirë në veten e tij, por nuk zgjat dhe nuk mund të ndërtosh një bazë të fortë në të. Shpejt thithet nga toka dhe prodhon dukjen e begatisë së barit dhe bimësisë - për një kohë. Shpejt ato kalben dhe bëhen kashtë e thatë, të cilën edhe era më e lehtë e largon në çdo kënd, si diçka pa vlerë. Uji humbet dhe po ashtu edhe bimësia që i dha një pamje të përkohshme luksoze. Ashtu është edhe jeta e kësaj bote, që është në kontrast me jetën e brendshme dhe atë reale që është në botën tjetër. Zoti është e vetmja Forcë që ngelet përgjithmonë, suprem mbi të gjithë.”

Gjërat e tjera humbin! Por Veprat e Mira kanë një Vlerë të përhershme te Zoti. Ato janë më të mira, pasi shpërblehen në dy mënyra:

1. Ato rrjedhin nga Mëshira e Zotit dhe vetë ato janë shpërblime për Besimin tonë;
2. Ato bëhen themelet e shpresës sonë për shpërblimin më të lartë shpirtëror në Botën Tjetër.”

(‘Kurani i Shenjtë: Tekst, Përkthimi dhe Komentimi i Abdullah Yūsuf ‘Ali, Shënimet 2386 & 2387 të ajeteve 45 & 46 të Sūrah al-Kahf).

Ajtete 9 dhe 10

﴿ أَمَرَ حَسِبْتَ أَنَّ أَصْحَابَ الْكَهْفِ وَالرَّقِيمِ كَانُوا مِنْ آيَاتِنَا عَجَبًا ﴾ إِذْ أَوَى الْفِتْيَةُ إِلَى الْكَهْفِ فَقَالُوا رَبَّنَا آتِنَا مِنْ لَدُنْكَ رَحْمَةً وَهَيِّئْ لَنَا مِنْ أَمْرِنَا رَشَدًا ﴿٩﴾

“(E pasi që jeta e kësaj bote është vetëm një test) A mos mendove ti se ata të vendosurit e shpellës dhe Rekimit (të cilën ata ndoshta e morën me vete në shpellë) ishin nga mrekullitë Tona më të çuditshme?”

“Kur djelmoshat u strehuan në shpellë e thanë: O Zoti ynë, na dhuro nga ana Jote mëshirë dhe na përgatit udhëzim të drejtë në tërë çështjen tonë!”

Sūrah al-Kahf tani u kthehet djelmoshave të shpellës, të cilëve ua kemi përkushtuar një kapitull të veçantë të këtij libri. Fakti që dy ajetet e para të pasusit që i përkushtohet ngjarjes së Shpellës ndodhen brenda dhjetë ajeteve të para të *Sures* (kapitullit), tregon se kjo ngjarje është e lidhur me *Dexhallin*.


Edhe nëse *Bismilah* të numërohet si ajeti i parë i *Sures*, kjo ngjarje prapëseprapë do të fillonte me ajetin e dhjetë të kësaj *Sure*. Kështu që ngjarja e djelmoshave dhe shpellës duhet të kuptohet se u jep besimtarëve udhëzime domethënëse dhe strategjike për mënyrën adekuate se si të ballafaqohen me sprovat e *Dexhallit*.

KAPITULLI DHJET SURAH AL-KAHF: FUNDI

Profeti i bekuar (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) ka këshilluar që kushdo që ballafaqohet me *Dexhallin*, duhet të recitojë para tij dhjetë *Ajetet* (strofat) e parë të *Sure al-Kahf*, e kjo do ta mbrojë (shpëtojë) atë nga *Fitnah* e *Dexhallit*. Pasi që fillimi i *sures* ka një rëndësi të tillë strategjike, del se ne po ashtu duhet të ekzaminojmë edhe fundin e *Sures*, për të nxjerrë ndonjë udhëzim shtesë që Surja mund ta ngërthejë në vete, përkritazi me këtë temë.

Ja ku janë dhjetë ajetet e fundit të *Sures*:

Ajeti 100



“Atë ditë (i.e., kur e dëshmojnë kulmin e globalizimit, njerëzimi do të përjetojë konflikte të pashembullta, luftra, vrasje të rastësishme, vetëvrasje, etc.) ua prezentojmë xhehenemin jobesimtarëve me një prezentim të hapët (trishtues).”

Dhul Qarnain së pari e ndërtoi një mur, i cili me sukses i mbajti Gog dhe Magog, e kështu u dha mbrojtje njerëzve ndaj *Fasādes* (i.e., që korrupton dhe shkatërron), të cilën këto fise ua bënë atyre. Por, ai pastaj i paralajmëroi ata se Allahu Më i Lartësuar i një ditë do ta rrënojë murin dhe kur të ndodhë kjo ngjarje, do të fillojë Epoka e Fundit. Dhjetë Shenjat e mëdha të Epokës së Fundit do të shpalosen në botë dhe mes atyre dhjetë shenjave është edhe lëshimi i Gog dhe Magog.

Ne më herët patëm theksuar se çfarë bote do të bëhet, kur të lëshohen (lirohen) Gog dhe Magog, i.e., krejt e kundërta e rregullit botëror të *Dhul Karnain*. Kur pushteti qëndron në themele që janë tërësisht të pafe (pa besim në Zotin), pushteti i tillë do përdoret për ta shtypur njerëzimin e në veçanti ata të cilët kanë besim në Allahun Më të Lartësuarin dhe sjellja e të cilëve është e drejtë. Një rregull i tillë botëror rezulton më shumë në një gjendje konflikti, sesa në harmoni me rregullin Hyjnor lart. Kurani e ka përshkruar krijimin (e krijesave) nga Allahu të karakterizuar nga paqja dhe harmonia e përkryer.

Në anën tjetër, rregulli botërorë Gog dhe Magog, që do të dalë në Epokën e Fundit, do të karakterizohet me kaos dhe anarki ngjashëm me “valët që përplasen me njëra - tjetrën”. Në atë kohë do t’i fryhet *Surit* (borisë) (por do ata dëgjojnë vetëm ata që janë në qiell). Kur do t’i fryhet *Surit*, kjo do të tregojë fillimin e *Jum al-Kijāmah* ose Ditës së Fundit e kjo, në anën tjetër, do të jetë shenjë për fillimin e procesit të mbledhjes së tërë njerëzimit me anë të urdhrit Hyjnor në shoqërinë e pafe globale të Gog dhe Magog. Ajo shoqëri globale do të përbëhet nga fotokopjet¹³ e Gog dhe Magog e që të gjithë ata do të jenë të destinuar për zjarrin e xhehenemit. Është pikërisht ai proces i ndryshimit kërcënues që sot njerëzimi e ka zgjedhur ta përshkruaj si ‘Globalizëm’! *Sūrah al-Kahf* na ka informuar se shoqëria globale, e karakterizuar nga *Kufri* (mosbesimi) global, do të dëshmojë konflikt, kaos dhe anarki dhe do të jetë si vetë Ferri që shtrihet para botës.

Gog dhe Magog do t’ia arrijnë të joshin 999 nga çdo 1000 vetë në tokë, në stilin e tyre dekadent të jetesës, por shërbëtori i vërtet i Allahut Më të Lartësuarit do t’u rezistojë atyre. Përkundrazi, ata do ta ndjekin shembullin e djelmoshave të shpellës, të cilët do të zgjedhin të largohen nga kjo lloj bote, me qëllim të ruajtjes së besimit në Allahun Më të Lartësuarin. Besimtarët përfundimisht do t’i braktisin qytetet e botës moderne dhe do të rivendosen në vende të largëta, në fshatra, kështu që gratë dhe fëmijët e tyre të mos e shohin ‘ferrin’ e shpërndarë para syve të tyre, të botës së pafe:

¹³ Aspekti figurativ

﴿ كَلَّا لَوْ تَعْلَمُونَ عِلْمَ الْيَقِينِ ﴿٥٦﴾ لَتَرَوُنَّ الْجَحِيمَ ﴿٥٧﴾ ﴾

“Jo, pse, sikur ta dinit me një dije të sigurt (nuk do të bënit ashtu) (i.e., dituria e brendshme shpirtërore), ju pa tjetër do ta shihni Xhehennemin (që në atë kohë do të jetë i shpërndar para pa besimtarëve). . .”

(Kuran, al-Takāthur, 102:5-6)

Ajeti 101

﴿ الَّذِينَ كَانَتْ أَعْيُنُهُمْ فِي غِطَاءٍ عَنْ ذِكْرِي وَكَانُوا لَا يَسْتَطِيعُونَ سَمْعًا ﴾

“Atyre (të cilët tani do e e themelojnë shoqërin kryesore dhe do e jetojnë jetën si të njerëzve të zjarrit të xhehennemit) që sytë i kishin të mbuluar ndaj argumenteve të Mia dhe që nuk mund të dëgjonin (fjallët e All-llahut)!”

Ajetet lidhen me tematikën e zjarrit të ferrit, të cilin “në këtë ditë Ne e kemi shpërndarë para jobesimtarëve” dhe paralajmëron se zjarri i ferrit, i pret ata që kanë sy, por nuk mund të shohin - kanë vesh, por nuk mund të dëgjojnë - kanë zemra, por nuk kuptojnë. Implikimi i pashmangshëm i asaj që u cek më lartë është se vetëm ndriçimi shpirtëror do të jetë në gjendje ta dallojë *Dexhallin*, i cili një ditë do të paraqitet si qenie njerëzore. E vetëm ata do t'i dallojnë Gogun dhe Magogun, të cilët janë evropianë, të cilët kanë ardhur nga fisi Khazar në Evropën Qendrore dhe të cilët u konvertuan në Judaizëm, menjëherë pas Profetit Muhamed a.s. Vetëm ata do ta dallojnë atë moment të asaj drame me dizajn Hyjnor, kur këto qenie të liga do ta ndjekin misionin e tyre për ta mashtruar popullin e Izraelit dhe t'i kthejnë ata në Tokën e Shenjtë për ta kërkuar si të tyren.

Kështu që do të jetë një sulm epistemologjik, që do t'ua pamundësojë shumicës së njerëzve të ‘shohin’, ‘dëgjojnë’ e më pastaj ‘ta kuptojnë’ realitetin e sulmit të *Dexhallit*, që do t'i marrë ata në rrugën për në zjarrin e ferrit.

Siç është shpjeguar në pjesët e tjera të këtij libri, ata do të mashtrohen nga ‘pamja e jashtme’, ndërsa u bëhet e pamundur të depërtojnë në ‘realitetin e brendshëm’ të gjërave. Profeti i Bekuar (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) na ka paralajmëruar për këtë sulm epistemologjik, kur ka deklaruar se *Dexhalli* sheh me një sy, me syrin e majtë, dhe se ai është i verbër në syrin e djathtë. Interpretimi ynë i këtij *Hadithi* është se *Dexhalli* është i verbër ‘në brendi’ dhe se sulmi i tij mbi njerëzimin do të ketë për qëllim që edhe atyre t'u shkaktojë verbërim të brendshëm.

Besimtarët duhet të kërkojnë mbrojtje tek Allahu Më i Lartësuar nga kjo *Fitne* e madhe e *Dexhallit*. Ata duhet të Luten:

“Allahumma arini al-Ashja’a kama hija”

“Oh Allah me Mirësi m’i trego gjërat ashtu siç janë (i.e., që të mos mashtrohem nga ajo se si duken ato)!”

Ajeti 102

﴿ أَفَحَسِبَ الَّذِينَ كَفَرُوا أَنْ يَتَّخِذُوا عِبَادِي مِنْ
دُونِي أَوْلِيَآءَ ۚ إِنَّا أَعْتَدْنَا جَهَنَّمَ لِلْكَافِرِينَ نُزْلًا ۝ ﴾

“A mos menduan ata që nuk besuan (të cilët e kundërshtojnë librin e fundit të shpallurë, i.e. Kuranin dhe Profetin e fundit të Allahut Më Të Lartësuarit, i.e. Muhamedin (paqja qoftë mbi të)) se përkundër meje mund të marrin zota (mbrojtës) robët e mi? Ne kemi përgatitur për jobesimtarët (dhe të gjithë ata që për shoqëri, preferojnë jobeimtarët, para Allahut, të Dërguarit dhe Besimtarëve), xhehenemin vendpritje.”

Nëse liderët tani nuk mund ta kuptojnë se ne tani jemi duke jetuar në epokën kur misioni i *Dexhallit*, i përcaktuar në mënyrë hyjnore, për ta sunduar përfundimisht botën nga Jerusalemi (dhe nga shteti mashtrues i Izraelit), është gati që të kompletohet, si mund të funksionojnë ata si mbrojtës dhe udhëzues të *Ymetin*? Megjithatë, përveç disa përjashtimeve të vogla, këta janë pikërisht aso njerëzish, të cilët e marrin udhëheqësin e komuniteteve Myslimane dhe vendeve (shteteve) Myslimane përreth botë sot. Disa nga ata e ushtrojnë bindjen e tyre me *Synetin* e Profetit Muhamed (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) dhe me një përqafim të singertë të Islamit, por prapëseprapë mbesin tërësisht të pavëmendshëm për kurthet që *Dexhalli* i ka shtrirë para tyre. Ata vuajnë fatin e verbërisë së brendshme për shkak të injorancës së tyre ose kundërshtimit kokëfortë ndaj faktit se Allahu Më i Lartësuari mund të dhurojë dituri në zemrat e shërbëtorëve të Tij. Verbëria e tyre e brendshme po ashtu zbret në ta si dënim hyjnorë për luftën e budallepsur që ata e bëjnë kundër ndriçuesve autentikë shpirtërorë të Islamit (i.e., *Sheikëve Sufist* Autentikë të Islamit).

Disa liderë të komuniteteve Myslimane janë në bashkëpunim të përhershëm dhe të turpshëm me armiqtë e Islamit. Ata e marrin udhëheqjen mbi Myslimanët ose përmes ndihmës së fshehtë apo të hapur nga armiqtë e Islamit, ose përmes përdorimit të zgjuar të blloqeve të çeqeve! Bota Myslimane sot vuan, derisa tufa e tufa të tëra delesh udhëhiqen nga barinjtë që bëhen klientë të ujqërve, të cilët ruhen nga ujqit ose marrin rroga që paguhën nga ujqit. Kjo përfshin edhe komunitetin tim Mysliman në Trinidad dhe Tobago.

Një aleancë Euro-Krishtere/Euro-Çifute është farkëtuar që të bëhet instrumenti bazë për krijimin dhe ruajtjen e rregullit botëror të Gog dhe Magog, që sot po e kontrollon botën. Kurani në mënyrë specifike i ka ndaluar Myslimanët që të lidhin një shoqëri dhe aleancë të tillë dhe i ka paralajmëruar se kushdo që e përqafon ose përfshihet në atë aleancë, do të bëhet anëtarë i familjes së Gog dhe Magog dhe do të hyjë në zjarrin e ferit. (Shih Kuranin, al-Māidah, 5:51)

Surja al-Kahf përfundon me deklarinimin e bindshëm se shërbëtorët e Allah-ut që janë udhëzues të vërtetë, do të t'u rezistojnë jobesimtarëve dhe kurrë nuk do t'i bashkëngjiten asaj shoqërie kryekëput të pafe. Dhe as nuk do të jenë shokë dhe aleatë të aleancës Krishtero-Çifute Evropiane, që tani e sundon botën. Përkundrazi, në vend që të shoqërohen me botën e pafe, shërbëtorët e vërtetë të Allahut Më të Lartësuarit do të luftojnë që të mbesin besnikë ndaj Allahut Më të Lartësuarit, duke u ndarë nga ajo botë.

Ajeti s 103 & 104

﴿ قُلْ هَلْ نُنَبِّئُكُمْ بِالْأَخْسَرِينَ أَعْمَالًا ﴾ ﴿١٠٣﴾
 ﴿ الَّذِينَ ضَلَّ سَعْيُهُمْ فِي الْحَيَاةِ ﴾ ﴿١٠٤﴾
 ﴿ الدُّنْيَا وَهُمْ يَحْسَبُونَ أَنَّهُمْ يُحْسِنُونَ صُنْعًا ﴾

“Thuaj: "A t'ju tregojmë për më të dëshpruarit në veprat e tyre: Ata janë veprimi i të cilëve u asgjësua në jetën e kësaj bote, (sepse ata ia përkushtuan të gjitha përpjekjet e tyre në ndjekje të gjërave të kësaj bote pa qen të vetëdijshëm që e gjith puna dhe mundi i tyre ishin të kotë pasi që ata e kishin humburë rrugën e drejt), e megjithatë ata mendojnë se janë kah bëjnë mirë (i.e., ata besonin se arritjet e tyre ishin të mrekullueshme dhe se ata ishin të suksesshëm në jetën e tyre).”

Civilizimi modern perëndimor, me një sy me ‘shërbëtorët shtëpiak me ngjyrë’, nëpër tërë botën bëjnë një pohim që është tërësisht i pavlefshëm. Ata kërkojnë ta bindin njerëzimin se pasi bota po dëshmon progres të pashembullt teknologjik, gjërat do të bëhen përherë e më mirë dhe si rrjedhojë del se kjo botë (epokë) është më e mira nga të gjitha tjerat. Ata argumentojnë se civilizimi modern perëndimor, i cili është përgjegjës për këtë ‘progres’ të pashembullt, i ka mundur të gjitha civilizimet e mëparshme, duke e përfshirë edhe Islamin, i ka mbytur e i ka grirë! Prandaj njerëzimi duhet t'i braktisë të gjitha mënyrat tjera të jetesës para modernizmit dhe me gjithë zemër ta përqafojë dhe imitojë mënyrën e jetesës moderne Euro-Krishtero-Çifute.

SHBA-ja, MB-ja, Kanadaja, Evropa, Australia, Singaporit etj. portretizohen dhe reklamohen si parajsë mbi tokë dhe të gjitha masat me verbëri shpirtërore janë shpërlarë aq shumë nga trutë, saqë jetojnë në ëndrrat se si të marrin një pasaportë për në ‘parajsën në tokë’. Porse ‘parajsë’ që e josh shoqërinë më të madhe përreth botës, në të vërtetë e dërgon atë drejt e në zjarrin e ferrit. Megjithatë, myslimanët e verbër (*figurativish*), ‘rrogëtarët’ e kritikojnë themelimin e fshatrave Myslimane që kërkojnë të ndahen nga bota moderne. Këta rrogëtarë do të insistojnë që Myslimanët duhet të mbesin pjesë e ‘pjesës së madhe të shoqërisë’, bile edhe atëherë kur ajo shoqëri ia ka mësy shportës së bërllotut historik!

Ajeti 105

﴿أُولَٰئِكَ الَّذِينَ كَفَرُوا بِآيَاتِ رَبِّهِمْ وَلِقَائِهِ ۖ فَحَبِطَتْ
أَعْمَالُهُمْ فَلَا نُقِيمُ لَهُمْ يَوْمَ الْقِيَمَةِ وَزَنًا﴾

(Ata e kan humbur rrugën në kuptimin se) “Të tillët janë ata që nuk besuan argumentet e Zoit të tyre as takimin (*ringjalljen*) e Tij, (nga ky Kuran, që është i fundit dhe më i rëndësishmi nga të gjithë) (dhe këta janë ata të cilët ose e kundërshtojnë pohimin e Kuranit, që është fjala e shpallur e e Zotit të Vetëm, ose atyre që e pranojnë Kuranin, por dështojnë të jetojnë sipas udhëzimit të tij), (ose kan zgjedhur që të kundërshtojnë besimin se ata kanë për ta takuar Atë një ditë, për t’u gjykuar); (e Kështu e tërë puna e (jetës së) tyre do të jetë e pavlerë andaj) veprat e tyre shkuan huq dhe në ditën e gjykimit atyre nuk do t’u jepet kurrfarë vlere” (kur ç’do njeri, VIP a jo) do të; vendoset në peshore për t’u matur).”

Sūrah al-Kahf përfundon me paralajmërimin e rrezikshëm se Allahu Më i Lartësuar do t’u përgjigjet atyre që e tradhtojnë të vërtetën duke refuzuar t’u japë atyre ndonjë rëndësi në Ditën e Gjykimit, kur çdo qenie njerëzore do të vendoset në peshore për tu matur. Ata të cilët peshojnë rëndë në peshore, do të shpërblehen me parajsë, ndërsa ata që peshojnë lehtë në peshore, ose që nuk kanë aspak peshë, do të dënohen me zjarrin e ferit.

Ajeti 106

﴿ذَٰلِكَ جَزَاؤُهُمْ جَهَنَّمَ بِمَا كَفَرُوا وَاتَّخَذُوا ءَايَتِي
وَرُسُلِي هُزُوًا﴾

“Këtë, ngase shpërblimi i tyre është Xhehennemi, për shka se nuk besuan dhe argumentet e Mia (*këtë Kuranin*) e të dërguarit e Mi i morën për tallje.”

Epoka e Fundit do të dëshmojë një luftë të tillë kundër Islamit, saqë besimtarët e drejtë do të tallen e do të persekutohen. Por besimtarët mund të gjejnë prehje nga të qenit të sigurt se Allahu Më i Lartësuar do të merret me ata që u shkaktojnë vuajtje, duke i dënuar ata me zjarrin e xhehennemit. Prandaj *Sūrah al-Kahf* përfundon, ashtu siç edhe filloi, me paralajmërimin për dënim të tmerrshëm nga Allahu Më i Lartësuar.

Ajeti 107

﴿ إِنَّ الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ كَانَتْ لَهُمْ جَنَّاتُ
الْفِرْدَوْسِ نُزُلًا ﴾

“S’ka dyshim se ata që besuan (i.e., besuan se Allahu Më i Lartësuar ka hyrë në zemra te tyre, e kështu ata me të vërtetë ja kanë frikën Ati dhe vërtetë e Duan Atë, e si rezultat ata largohen nga ata të cilët Ai i urren dhe i duanë ata që Ai i donë) dhe bënë vepra të mira, vendpritje për ta janë Xhennetet e Firdevsit .”

Sūrah al-Kahf përfundon, ashtu siç fillon, me një mesazh të fuqishëm të shpresës për ata besimtarë që kanë sjellje të drejtë. Pasi që ata duhet ta përballojnë stuhinë më të madhe dhe më të ligë që ka ndodhur ndonjëherë, shpërblimi i tyre do të jetë parajsa më e lartë nga të gjitha - Xhennatul Firdaus!

Ajeti 108

﴿ خَالِدِينَ فِيهَا لَا يَبْغُونَ عَنْهَا حِوَلًا ﴾

“Aty do të jenë përgjithmonë, e nuk kërkojnë të largohen nga ai (ose t'u ndryshohet).”

Shpërblimi i tyre jo vetëm që do të jetë i përhershëm, por një në të cilin ata do të jenë krejtësisht të kënaqur dhe se nuk do të kërkojnë kurrë që ta ndryshojnë.

Ajeti 109

﴿ أَلْبَحْرُ لَنَفِدَ رَبِّي لِكَلِمَةٍ مِّدَادًا أَلْبَحْرُ كَانَ لَوْ قُلُ
مَدَدًا بِمِثْلِهِ جِئْنَا وَلَوْ رَأَىٰ كَلِمَتُ تَنفَدَ أَنْ قَبْلَ ﴾

“Thuaj: (Kjo është fjala e Allahut Më Të Lartësuarit, dhe fjalët e Zotit tim janë të tilla) "sikur të ishte deti ngjyrë për t'i shkruar fjalët e Zotit tim, deti (uji i tij) do të shterrej para se të përfundojnë fjalët e Zotit tim, e edhe sikur të sillnim shtesë edhe një si ai (deti).”

Kështu pra, njerëzit bëjnë gabim të tmerrshëm, kur e kundërshtojnë Kuranin dhe Profetin dhe bëjnë shaka me ta, ose e neglizhojnë udhëzimin që vjen nga ata. Pikërisht nga Kurani dhe Profeti i bekuar (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) njerëzimi mund të arrijë diturinë, e cila vjen drejtpërdrejt nga Allahu më i Lartësuar. Dituria e botës së jashtme është e rëndësishme po ashtu,

pasi që Allahu Më i Lartësuari është Ai i Cili e ka krijuar botën e jashtme. Por, dituria që Allahu e komunikon në brendi të shërbëtorëve të Tij, është shumë më e rëndësishme. E po ashtu është e pashtershme.

Ajeti 110

﴿قُلْ إِنَّمَا أَنَا بَشَرٌ مِّثْلُكُمْ يُوحَىٰ إِلَىٰ أَنَّمَا إِلَهُكُمُ إِلَهٌُ وَاحِدٌ ۚ فَمَن كَانَ يَرْجُوا لِقَاءَ رَبِّهِ فَلْيَعْمَلْ عَمَلًا صَالِحًا وَلَا يُشْرِكْ بِعِبَادَةِ رَبِّهِ ۚ أَحَدًا﴾

“Thuaj: (O Profet) "Unë (nuk jamë hyjnorë, nuk jamë djalë i tij, asgjë e tillë por se) jam vetëm njeri, sikurse ju, (dhe thuaj O Profet) mua më shpallet se vetëm një Zot është Zoti juaj, e kush është që e shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos përziejë askë!”

Surja filloi me një paralajmërim të rreptë për ata që deklaruan se Allahu më i Lartësuari ka “vetëlindur një djalë”. Ai (Kurani) e përshkruan një thënie të tillë si keburat kalimaten (një gjë vërtet të tmerrshme) dhe kadhiba (gënjeshtër). Surja përfundon duke iu kthyer temës së njëjtë të Shirkut, por kësaj radhe në mënyrë që të sigurojë që mesazhi i Profetit Muhammad a.s., kurrë nuk do të korruptohet ashtu.

Vetë substanca e të vërtetës që është transmetuar nga Profeti i fundit, ka qenë: “Zoti i juaj është Një Zotë”. Në fjalët e saj të fundit *Sūrah al-Kahf* i inkurajon ata që duanë t’i kthehen Zotit të tyre në një gjendje që është e kënaqshme për Të, që të bëjnë dy gjëra. Së pari, ata duhet të jenë të drejtë në sjelljet e tyre dhe së dyti, ata duhet të ushtrojnë kujdes më të madh që të largohen nga mëkati i *Shirkut* (në çfarëdo forme që manifestohet ai).

SHTOJCA 1

Rëndësia Epistimiologjike e Ëndërrave dhe Vizioneve në Islams.

Kurani na Informon se Allahu Më i Lartësuari shkakton dënim (epistimiologjik) ndaj jo-besimtarëve, duke ua mbyllur ‘zemrat’ e tyre ‘veshët’ e tyre dhe duke vendosur një perde para ‘syve’ të tyre (*Kuran, al-Baqara, 2:7*). Si rezultat, njerëzit e tillë kanë zemra të ‘vdekura’ dhe mund të ‘shohin’ vetëm me sytë e tyre të jashtëm. Ata mund të përfitojnë vetëm dituri nga vrojtimi, që quhet vetëm dituri shkencore. Ata nuk janë në gjendje të marrin dituri të ‘brendshme’ ose ‘shpirtërore’ në formën e diturisë, përmes ëndrrave dhe vizioneve të vërteta (i.e., profetike).

Ëndrrat dhe vizionet i përkasin mbretërisë së zemrës njerëzore dhe na japin diturinë që na mundëson të shikojmë në thellësinë e natyrës dhe sjelljes njerëzore. Ëndrrat dhe vizionet e

vërteta (ose profetike) janë *dhurata* hyjnore për zemrën dhe ato vijnë vetëm kur zemra është e shëndoshë, e pafajshme dhe e ngopur me substancën e religjionit, i.e., besimit (*al- Imān*) në Allahun Më Të Lartësuarin. Ata të cilët janë gjallë nga aspekti shpirtëror, mund të bekohen me ëndrra dhe vizione të 'vërteta', përmes të cilave mund të komunikohet dituria e shenjtë. Ata mund të pranojnë dituri të brendshme të ngjarjeve që do të ndodhin në të ardhmen dhe kur ato ngjarje ndodhin në të vërtetë, i vërtetojnë ato vizione. Ata po ashtu mund të pranojnë paralajmërime në ëndrra dhe kur e kanë mundësinë që t'i kuptojnë këto paralajmërime, mund ta shmangin atë shqetësim.

Ëndrrat e tjera, siç janë ankthet, paraqesin *sulme* në zemër, duke u munduar ta keq udhëzojnë, mashtrojnë dhe korruptojnë zemrën. Ëndrrat e tilla po ashtu mund të funksionojnë si mënyrë për ta trazuar zemrën, për ta munduar dhe për ta bërë atë të mos funksionojë mirë.

Më në fund, ka akoma ëndrra të tjera, të cilat funksionojnë ose si *ilaç* për zemrën, ose si *dritare* e zemrës, për të na mundësuar ne që t'i shohim zemrat tona e kështu edhe vetën tonë - kjo mund të gëzojë ose frikësojë shumë që ta shohim veten se si jemi ne në të vërtetë.

Ne sot jetojmë në një botë që është aq e mbushur me korrupsion dhe mosbesim (në Zotin), saqë shumica e njerëzimit, duke përfshirë edhe shumë myslimanë, nuk mund të shohin me sytë e tyre të brendshëm. Shumica e njerëzve më nuk e kuptojnë se i vetmi rast, kur çdonjëri mund të jetë i sigurt për vlefshmërinë e asaj që ai pohon, ta ketë 'parë' nga aspekti i brendshëm, është kur ai 'sheh' ëndrra dhe vizione të vërteta. Në të vërtetë, në botën e sotme të çuditshme ka shumë të ashtuquajtur besimtarë, të cilët në të vërtetë janë skeptikë për diturinë që pranohet nga 'brendia' dhe të cilët nuk tregojnë ndonjë interesim në kërkimin e vizioneve të brendshme.

Mendja fetare që e mbron një skepticizëm të tillë, është diçka e re për këtë *ummah* (komunitet fetarë) dhe ka dalë si pasojë e ndikimit të laicizmit të mendimit dhe diturisë nga civilizimi materialist dominues perëndimor. Ky laicizëm e ka asfaltuar rrugën për materializmin metafizik dhe për sulmin epistemologjik në diturinë e brendshme shpirtërore dhe përfundimisht e ka lindur një fe të re të quajtur humanizëm. Është e bazuar në metodat shkencore dhe racionalizmit dhe dallohet në mospërshtatje me të gjitha gjërat që lidhen me përvojat e jashtëzakonshme. Ëndrra e *vërtet* sigurisht që është një përvojë e jashtëzakonshme!

Është e dizajnuar e jo aksidentalisht, që epoka moderne e pafe ka larguar fenomenin e ëndrrës së *vërtet* (ose profetike), deri në paqartësinë e një muzeu akademik dhe intelektual. Kjo ndodhë për shkak se ëndrra e *vërtetë*, nuk mund të shpjegohet duke përdorur epistemologjinë perëndimore, e cila e programon njerëzimin që të jetë skeptik ndaj vlefshmërisë së diturisë nga çdo burim që tejkalon vëzhgimin shkencor. Metoda djallëzore dhe mashtruese perëndimore është që të kërkojë një shpjegim natyror (shkencor) për përvojat fetare si ëndrrat e 'vërteta'.

Në anën tjetër, fenomeni i ëndrrave të vërteta për myslimanët ka hapur një mundësi të zbritur nga qielli, për të demonstruar vlefshmërinë e epistemologjisë Islame e si rrjedhojë interpretimin shpirtëror, natyrën e universit dhe natyrës. Megjithatë, përveç dijetarëve autentikë *Sufist* të rrallë, si Dr. Muhammad Ikbāl, dijetarët myslimanë që jetojnë në epokën moderne me pushtetin perëndimorë nuk kanë nxjerrë nga ndonjë perspektivë e psikologjisë Islame ndonjë punë teorike në fenomenin e ëndrrave. Është duke u punuar nga dijetarët e stërvitur në

psikologjinë perëndimore (i.e., psikologjia si disiplinë që ishte zhvilluar nga civilizimi laik perëndimor), por për shkak se ata janë duke vepruar në një kornizë tërësisht laike dhe shkencore, nuk mund ta kuptojnë natyrën e këtij fenomeni.

Ne dëshirojmë të bëjmë pyetjen: Pse kjo mundësi e madhe për të përdorur ëndrrat e vërteta si mjet për të shkatërruar epistemologjinë perëndimore, është lëshuar nga Dijetarët Islam dhe nga të ashtuquajturat lëvizje të mëdha të reformimit Islam. Ikbali e ka vrojtuar mendimin fetar në Islam, që në veçanti ka qëndruar i paluhatshtëm gjatë pesëqind vjetëve të fundit (Muhammad Ikbali: 'Rikonstruktimi i Fesë përmes mendimit Islam', Lahore. Instituti i Kulturës Islamike, 1986, p.6).

Kjo është një deklaratë që në të vërtetë duhet t'i alarmojë Myslimanët dhe t'i nxisë mendjet e tyre për të pyetur në këtë amulli të letargjisë intelektuale në mendimin fetar. Pikëpamja jonë është se një version shkencor modern dhe protestant i Islamit, ka dalë si rezultat i ndikimit të sundimit kolonial perëndimor mbi mysliimanët. Ky Islam i moderuar ishte fëmija i vetë epistemologjisë perëndimore, që e ka zhvlerësuar diturinë nga burimet e tjera, përtej vrojtimeve shkencore.

Ky Islam i cili ishte krasitur nga zemra e tij shpirtërore, ka dalë nga Arabia Saudite në formën e lëvizjes *Vehabiste* dhe ka vazhduar të lëshojë një sulm të tmerrshëm dhe të pandalshëm mbi Sufizmin. Në proces e sipër, pa dije e ka 'hedhur tutje beben së bashku me ujin me të cilin është larë bebjë'.¹⁴

Tani e kuptojmë se Sufizmi e pati humbur dinamizmin intelektual dhe kreativitetin dhe si çdo gjë tjetër në civilizimin Islamik, ishte në gjendje të luhatshme. Ikbali shkroi për atë dështim në skicimin e pasusit në punën e njohur, prej të cilës cekim:

"Teknikat e misticizmit mesjetar, sipas të cilave jeta fetare në manifestimin e saj të lartë e zhvilloi vetveten edhe në Lindje, edhe në Perëndim, tani thjesht ka dështuar. E në Lindjen Myslimane ndoshta ka bërë më shumë trazira, sesa gjithkund tjetër, shumë larg nga riintegrimi i forcave të jetës së brendshme të njeriut të zakonshëm, dhe kështu e ka përgatitur atë për të marrë pjesë në marshimin e historisë; i ka mësuar ati ripërsëritjen e rrejshme dhe e ka bërë atë të lidhet në mënyrë të përkryer me injorancën dhe me varfërinë shpirtërore."

(Ikbali, Op. Cit. p. 148-9).

Studenti i ndritur i Ikbali, Maulana Dr. F. R. Ansari, po ashtu ka cekur degradimin e Sufizmit, por ka paralajmëruar, përkundër 'hedhjes së foshnjës bashkë me ujët e banjës':

"Me degradimin e shëmtuar të shoqërisë Myslimane, për shkak të disa faktorëve historikë të njohur mirë nga studentët e historisë Islame, kuptimi e po ashtu edhe praktikimi i Tasawwuf ka degjeneruar në më shumë se një dimension. Po ashtu emri i tij është keqpërdorur për disa nocione dhe ide të gabuara në disa pjesë. Megjithatë, mohimi i kërkimit fetar Islam (i.e., Tasawwuf) në vendin e duhur, çon në mohimin e vetë Islamit. Po ashtu interpretimi i Tasaufit në pikëpamjet e projekteve mistike nga fetë e tjera është një përdhunim flagrat i të vërtetës"

¹⁴ Figurativisht është hedhur edhe e mira edhe e keqja së bashku.

(Ansari: The Quranic Foundations and Structure of Muslim Society. World Federation of Islamic Missions. Karachi. Vol. 1. p. 152 fn)

Sufizmi ka vuajtur fatin e të qenit i rrëmbyer nga oportunistë profesionalë, të cilët prezantuan praktika të devijuara, përmes të cilave ata e vendosën një robëri të vërtetë shpirtërore. Por, në proces të luftës së stilit të Don Kishotit, për të pastruar besimin Islam dhe praktikën e tërë asaj çfarë është pranuar si *Bid'ah* (risi) *Sufiste*, lëvizja moderne e ashtuquajtur lëvizja e ringjalljes (rivendosjes) Islamike, veproi si kali i Trojes, brenda trupit të Islamit, duke ia mundësuar epistemologjisë perëndimore, që të depërtojë në mendimin Islamik. Foshnja ishte hedhur së bashku me ujët e banjës. Një version i satanizuar laik i Islamit u deklarua të jetë ringjallja Islamike. Të ashtuquajturat lëvizje reformatore Islamike vazhduan në vendosjen e qendrave të mësimi dhe nxorën numra të mëdhenj të dijetarëve, të cilët në aspektin intelektual nuk ishin në gjendje t'i përgjigjeshin sulmit të thellë epistemologjik kundër diturisë dhe mendimit Islamik, pasi që ata vetë ishin të kurrthuar në epistemologjinë perëndimore. Edhe më keq se kaq, sulmi i tyre i thellë dhe i keq udhëzuar edhe në Sufizmin autentik, rezultoi në një dëm të brendshëm të vetë aspektit të tyre shpirtëror, saqë edhe ata vetë tashmë nuk kishin mundësinë e bekimit nga Allahu Më i Lartësuar me ëndrra dhe vizione të vërteta të vazhdueshme.

Por, shumë kohë para se materializmi modern perëndimor të ndikonte mbi mendimin fetar, duke e bërë atë laik, bota e Islamit kishte përjetuar po të njëjtin fenomen me daljen e shkollës *Mu'atazilitë* të mendimit fetar. Ikbali e ka përshkruar ngjarjen:

“Mu'atazilah e koncepton fenë thjesht si një trup i doktrinës fetare dhe e injoron atë si fakt vital. nuk i ka marrë parasysh mënyrat jokonceptuale të qasjes ndaj realitetit dhe e ka kthyer fenë thjesht në koncepte të sistemeve logjike, që përfundojnë me një qëndrim tërësisht negativ. Ata nuk mundën të shohin se në fushën e diturisë shkencore apo fetare nuk është e mundur pavarësia e plotë e mendimit nga përvoja konkrete.” (Ikbali këtu i referohet mes tjerash përvojës fetare, e përvoja fetare përfshin ëndrrat e vërteta.).

(Ikbali, op. cit. p. 4)

Ishte gjenialiteti i Dr. Muhammad Ikbali që të ishte në gjendje të dallonte *Sufizmin* autentik nga devijimet. Ishte gjenialiteti i tij, që arriti në artikullimin e epistemologjisë *Sufiste*, në një mënyrë që i shkatërronte objektet e konsiderueshme të shumë modernistëve të edukimit laik në botën perëndimore, si dhe në botën Myslimane. Sikur Dr. Muhammad Ikbali të kishte studiuar më Universitetin Islamik të *Al-Azhar* në Egjipt, në Deoband ose në seminarët e tjerë Islamikë në Indi, ai kurrë nuk do të kishte arritur të dalë si dijetar i madh dhe i urtë, siç ishte. E arsyeja për këtë nuk ishte e limituar në talentin e tij të natyrshëm, por po ashtu edhe në epistemologjinë, të cilën ai e trashëgoi nga Sufizmi autentik, një epistemologji të cilën Islami modern nuk do të mund ta jepte kurrë.

Metoda shkencore laike Evropiane ndryshonte nga metoda shkencore që e arriti Evropën nga Spanja Myslimane. Ajo që bëri Evropa Judeo-Krishtere laike, ishte themelimi i një religjioni të ri dogmatik, që pohonte se vetëm ajo e cila mund të *vëzhgohej*, mund t'i *nënshtrohej një pyetësori shkencor*. Kështu religjioni i ri dogmatik i pati strehuar shprehitë e mendimit konkret që e kundërshtonte vetë substancën e gjakut-jetësor të religjionit, i.e., besimin në *al-Ghaib*, ose

botën e padukshme dhe përvojën e drejtpërdrejtë të asaj bote të padukshme në mrekullinë e Kuranit.

Evropa vazhdoi të vendosë një dogmë të thjeshtë, i.e., pohimin kokëkrisur se *vetëm dituria 'shkencore' është dituria e 'vërtetë'*, përderisa të gjitha të tjerat u përkasin përrallave. E kështu mendja moderne fetare në Evropë ngadalë i mbylli dyert për përvojën 'fetare' dhe ndaj studimit të këtij fenomeni. Ëndrra e vërtetë është përvojë *fetare*. Megjithatë, William James i ka bërë një shërbim jashtëzakonisht të mirë mendimit fetar, me nxjerrën e punës së tij klasike '*Llojshmëritë e përvojës fetare*', në të cilën *ëndrrat e vërteta* e zënë vendin e kryesor.

Çfarë lloj metode shkencore mund të ekzistojë, për të ekzaminuar fenomenin e ëndrrës së vërtetë? Ja për shembull se çfarë mund të jetë një ëndërr e vërtetë: *Mbrëmë kamë ëndërruar që shtëpia e komshiut tim ishte në zjarr. Në mëngjes ishte djegur tërësisht.*

Shpjegimi Islamik për ëndrrën e vërtetë është: ngjarjet që ekzistojnë në botën e padukshme, para se ato të ndodhinë në këtë botë. Kështu, zjarri ekziston në një botë që nuk shihet prej nga është transmetuar si informacion nga engjëjt në ëndërr, para se zjarri të ndodhë me të vërtetë në këtë botë.

Kjo përvojë e ëndrrës së vërtetë nuk mund t'i nënshtrohet një studimi shkencor, sepse psikologjia laike perëndimore, që vepron me metodat e reja shkencore, *nuk mund të tejkalojë fenomenin e vrojtimit*. Frojdi ishte prodhimi i përkryer i mendimit të ri shkencor dhe si rrjedhojë ai bëri një përpjekje të kotë që të gjente shpjegimin natyror për fenomenin e ëndrrave të vërteta.

Pikërisht për shkak të rrezikut të madh nga epistemologjia e re perëndimore dhe religjioni shkencor që e nxjerr atë epistemologji, Ikbali filloi punën e tij të madhe, '*Rikonstruimi i Mendimit fetar përmes Islamit*', me dy kapituj të shkruar shumë për '*Diturinë dhe përvojën fetare*' dhe '*Testi filozofik i shpalljes së përvojës fetare*'. Ai pastaj i pasoi ato me një kapitull tjetër me titull '*A është e mundur Feja?*'

Ikbali bëri një përpjekje të guximshme për t'iu përgjigjur sfidave të bëra nga Islami modern, në kundërshtimin e përvojës fetare si burim të dijes. Ai e filloi punën e tij duke adresuar këtë temë në parathënien e vetë librit. Ne e citojmë atë në tërësi, kështu që ata të cilët nuk janë të njohur me mendimin e tij, ose deri tani nuk kanë mundur ta kuptojnë atë, tani mund të inkurajohen që ta studiojnë punën e tij të madhe:

"Kurani është një libër që përqendrohet më shumë në veprime sesa në ide. Megjithatë, ka njerëz të tillë, për të cilët organiku nuk është e mundur që ta asimilojnë një univers të huaj, duke e ri-jetuar si pjesë vitale atë përvojë të brendshme të veçanta, në të cilën besimi fetar vendoset përfundimisht. Për më shumë, njeriu modern, duke i zhvilluar shprehitë e mendimit konkret - shprehi të cilat vetë Islami i ka ushqyer në etapat e para të karrierës kulturore - e ka zvogëluar kapacitetin e përvojës, të cilën ai e pret edhe më tutje, për shkak të detyrimit të iluzionit. Sa më të pastra të jenë shkollat e Sufizmit, pa asnjë dyshim kanë bërë punë të mirë në formësimin dhe drejtimin evolucionit të përvojës fetare në Islam; porse përfaqësuesit e tyre të ditëve të mëvonshme, për shkak të injorancës së mendjes moderne, janë bërë tërësisht të paafte për të pranuar ndonjë frymëzim të ri nga mendimi dhe përvoja moderne. Ata janë duke i

përjetësuar metodat të cilat janë krijuar për gjenerata të tëra, e që kanë një vrojtim kulturor që dallonte në shumë aspekte të rëndësishme nga ato tonat. ‘Krijimi dhe ringjallja e juaj’, thotë Kurani, ‘janë si krijimi dhe ringjallja e një shpirti të vetëm’. Përvoja jetësore e llojit të unitetit biologjik e thurur në këtë ajet, sot kërkon një metodë psikologjike më pakë të dhunshme dhe më të përshtatshme për një lloj mendjeje më konkrete. Në mungesë të një metode të kështillë, nevoja për një formë shkencore të diturisë fetare është e natyrshme.”


(Muhammad Ikbali: ‘Rikonstrukimi i mendimit fetar në Islam’, Instituti i Kultures Islamike Lahore, 1986. p. v)

Nëse ndonjëherë ka pasur një mbrojtje të pathyeshme ndaj epistemologjisë *Sufiste* të artikuluar në idiomën e mendimit modern, Ikbali e ka arritur atë. Tragjedia që nga viti 1938, kur puna e Ikbaliut ishte publikuar, është se dituria bashkëkohore Islame, që ka dalë nga versioni i Islamit shkencor ‘Protestant’, ka qenë intelektualist i pafat për të kuptuar bile edhe këta tre kapituj të punës së madhe të Ikbaliut. Ikbali e mori sfidën dhe argumentoi çështjen e vlefshmërisë epistemologjike të diturisë dhe përvojës së ‘intuitës’. Ai deklaroi:

“ . . . As nuk ka ndonjë arsye për të supozuar se mendimi dhe intuita e kundërshtojnë njëra-tjetrën në thelb. Ato burojnë nga e njëjta rrënjë dhe e plotësojnë njëra-tjetrën. Njëra i kap pjesët e realitetit, ndërsa tjetra e kap atë në tërësi. Njëra e ngulit shikimin në brendësi e tjetra në aspektin e përkohshëm të realitetit. Njëra është kënaqësia e tanishme e tërësisë së realitetit; tjetra ka për cak përshkrimi tërësinë, duke i veçuar dhe duke i mbyllur pjesët e ndryshme të tërësisë për vrojtim ekskluziv. Që të dyja janë të nevojshme për njëra-tjetrën, për një ripërtëritje reciproke. Që të dyja e kërkojnë vizionin e Realitetit të njëjtë që e shpalos vetën në pajtueshmëri me funksionet e tyre në jetë. Në fakt, intuita, siç e pati thënë Bergsoni, me të drejtë është vetëm një lloj më i lartë i intelektit.”

(Muhammad Ikbali: ‘Rikonstrukimi i Mendimit Fetar në Islam’, Instituti i Kultures Islamike Lahore, 1986. p. v)

Po ashtu duhet të jetë çështje e rëndësishme së madhe për lexuesit tanë skeptikë se vetë Kurani ka zgjedhur udhëzimin e tij për njerëzimin, duke insistuar që në fillim (*Kuran, al-Baqarah, 2:1*) që besimi fetar është tërësisht i ndërtuar mbi besimin në atë që është përtej vrotimit tonë normal - i.e., përtej botës së mendimit konkret (*al-ghaib*). Ëndrrat e vërteta i përkasin asaj bote. Me të vërtet përvoja më e thellë (në brendi) e jetës së Profetit Muhamed (*sallallahu ‘alaihi wa sallam*) ishte udhëtimi i natës (jo ëndërr) në atë botë të padukshme - një udhëtim në të cilin ai ka udhëtuar në mënyrë që ai të ketë një përvojë të drejtpërdrejtë të botës së përtejme. Kështu kurani deklaron:



“Ai vërtet i ka parë Shenjatë më të mëdha të Zotit të tij.”

(Kuran: al-Najm:- 53:18)

Dituria duhet të desekularizohet,¹⁵ nëse duam t'ia lejojmë të Vërtetës fetare ta luaj rolin, të cilin mund ta luajë vetëm e vërteta. Ai është rol i cili e rivendos shoqërinë njerëzore në besimet dhe vlerat e fesë autentike, e që është e vetmja që mund ta tërheqë njerëzimin drejt jetës në paqe, lumturi, kënaqësi dhe sukses.

Në mënyrë që dituria të desekularizohet, ne duhet ta demonstrojmë ekzistimin në këtë botë të diturisë që ka ardhur nga *al-Ghaib*, i.e., një botë që nuk shihet dhe një burim i cili i kalon përvojat normale. Vetëm kur dituria të jetë desekularizuar, mendja moderne mund të aplikohet me seriozitet për të rivendosur jetën e shenjtë. Dijetari i madh i ndjerë i Islamit Ismail Faruki, i cili (sikur mbreti i Arabisë Saudite Faisal, Presidenti i Pakistanit Ziaul Haq, Presidenti i Panamasë Omar Torrejo, i Ekuadorit Jamie Roldos, i Kilit Salvador Allende etj.) ra në një akt të terrorizmit, shumë para se ata terroristë ta fillonin luftën e tyre të ashtuquajtur 'lufta kundër terrorit', u përpoqën ta desekularizonin diturinë. Për fat të keq, ai e përdori termin e shpikur '*Islamizimi i Diturisë*' dhe duke e bërë këtë, qëllimi thelbësor i desekularizimit të diturisë u turbullua për ata të cilët e trashëguan misionin e tij të shenjtë, misionin e të vërtetës.

Një studim serioz në fenomenin e ëndrrave, nga një dijetar i psikologjisë Islame, mund të japë një kontribut të madh drejt desekularizimit të diturisë dhe ri drejtimit të mendimit në kuptimin e parësisë së asaj që është e shenjtë dhe kuptimit të harmonisë themelore mes formës '*materiale*' dhe substancës '*shpirtërore*' në universin e jashtëm dhe botën njerëzore. Për më tepër, nevojitet dituria e cilësisë dhe e kalibrit të Dr. Muhammad Ikbali, për ta studiuar aspektin *metafizik të ëndrrës së vërtetë*..

¹⁵ Që dituria të mos jetë laike, e ndarë nga feja, por të jetë pjesë e fesë dhe e besimit.